

ÇËSHTJA E KOSOVËS DHE DIPLOMACIA NDËRKOMBËTARE 1990 – 2010

DOKTORANTI: RESHAT NURBOJA

Dorëzuar : Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në **SHKENCA
SOCIALE**, me profil **SHKENCA POLITIKE**, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Dr. Petrit Nathanaili**

Numri i fjalëve: 71.256

Tiranë, shkurt 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë e imja dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar nga unë dhe deri më tani nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni për vlerësim. Punimi është punë origjinale dhe është kryer duke i respektuar në përpikëri standardet dhe kriterët e përcaktuara për punimet e disertacionit.

Autori

ABSTRAKTI

Studimi është një analizë politiko - historike i procesit të çështjes së Kosovës dhe diplomacisë ndërkombëtare 1990 -2010.

Qëllimi, është të shpjegohet nga këndvështrimi historiko-politik procesi i pavarësimit të Kosovës dhe roli i diplomacisë ndërkombëtare në këtë drejtim. Të ofrojë një analizë të hollësishme të qendrimeve unike ndërkombëtare që fillimisht ishin pro ekzistencës dhe vazhdimësisë së Jugosllavisë dhe kundër pavarësimit të Kosovës e deri të ndryshimi i këtyre qendrimeve.

Studimi në thelbin e vet nuk shtjellohet nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare por nga aspekti politik dhe historik i saj, meqenëse faktori ndërkombëtarë që nga fillimi çështjen e Kosovës nuk e ka trajtuar si problem të së drejtës ndërkombëtare por e ka perceptuar dhe konceptuar si problem i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe nga këndvështrimi humanitar...

Rezultatët e studimit vërtetuan hipotezën bazë se politika e Serbisë e identifikuar me presidentin Millosheviq, ishte faktori kyq i ndryshimit të kursit të diplomacisë ndërkombëtare ndaj çasjës së zgjidhjes së problemit të Kosovës. Poashtu, rezulton se ndërhyrja ndërkombëtare në Kosovë, parimisht është bërë për shkaqe humanitare në mbrojtje të vlerave universale të civilizimit dhe qytetërimit botërorë siq janë të drejtat dhe liritë e njeriut, trashëgimia kulturore e materiale etj., kuptohet duke mos i anashkaluar edhe interesat apo motivet gjeostrategjike sidomos nëse kemi parasysh tendencat permanente të Rusisë për dominim gjegjësisht rikthimin e saj në këtë pjesë të Ballkanit dhe Evropës Juglindore.

Gjetjet e studimit determinojnë nevojën për rishqyrtimin e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Kartës së Kombeve të Bashkuar lidhur me sovranitetin, të drejtat dhe liritë e njeriut, intervenimin humanitar etj.

Me qëllimin e argumentimit të hipotezës të parashtruar kam përdorur metodologjinë integruese - e përgjithshme. Për studimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të punimit kam përdorur kryesisht metodat: deskriptive, të analizës, dhe të asaj krahasuese.

Fjalët kyçe: Kosova, diplomacia ndërkombëtare, lufta, ndërhyrja humanitare, pavarësia.

ABSTRACT

The study introduces a political-historical analysis of the process of Kosovo and International Diplomacy issue during 1990-2010.

The aim here is to explain from the historic-political perspective the process of independence of Kosovo and the role of International Diplomacy in this direction. Provide a detailed analysis of the unique international attitudes which initially were pro-existence and continuity of Yugoslavia and against the Independence for Kosovo leading to the change of these attitudes.

Study at its core is not discussed from the perspective of international law but in terms of political and historical aspect, as the International factor from the very beginning hasn't treated the issue of Kosovo as a problem of international law but has perceived and conceived it as a problem of rights and freedoms and humanitarian problem.

The results of the study confirmed the basic hypothesis that the policy of the president of Serbia Millosheviq- was a key factor to change the course of International Diplomacy toward the approach for the resolving of the Kosovo problem. It also shows that the aim of international intervention in Kosovo in principle was mainly based on humanitarian grounds to defend the universal values of civilization and world civilization, such as human rights and freedoms, cultural heritage materials, etc., whereas, not ignoring the interests and geostrategic motives, particularly, if we consider the permanent trends of Russia for dominance in this part of the Balkans and Eastern Europe.

The findings of the study determine the need for a review of the International Law and the United Nations Charter, regarding the sovereignty, human rights and freedoms, humanitarian intervention, etc.

On the purpose of set forward hypothesis argue, I have used the general integrative methodology For further study and development of the paper I have used the methods, such as; descriptive analysis, and comparative methods.

Key words: Kosovo, international diplomacy, war, humanitarian intervention, independence

Dedikuar:

*Popullit të Kosovës,
i cili është dashur të paguajë “çmimin” shumë të lartë,
që të lirohet dhe pavarësohet nga okupimi dhe robëria shekullore!*

Moto e punimit:

"Diplomacia pa forcë është sikurse simfonia pa instrumente muzikore".

(Henry Kissinger)

FALENDERIME

Si kandidat për doktoraturë, pranë shkollës doktrale në Universitetin Evropian të Tiranës (UET), dua të shpreh falënderimet më të thella për gjithë personelin akademik të UET, i cili me angazhimin e tij ka bërë që unë të thelloj dijenitë në procesin e punimit të doktoraturës në degën e shkencave sociale. Leksionet, provimet, literatura dhe e gjithë fryma akademike ka bërë që unë të bëhem më i përgatitur për sfidat e mëtejme në rrugëtimin tim akademik.

Falënderim i veçantë i takon udhëheqësit tim doktroral prof. dr. Petrit Nathanailit, i cili me përkushtimin, angazhimin, këshillat dhe sugjerimet e tij profesionale më ka udhëzuar dhe më ka drejtuar drejt konceptimit dhe realizimit të një punimi serioz dhe përmbajtjesor doktroral. Profesor Nathanaili, me njohuritë e tij shkencore dhe me shkathtësi prej pedagogu e punëtori shkencor, i cili pranon dhe respekton bashkëpunimin reciprok kandidat – pedagog, më ka drejtuar gjatë shtjellimit të temës me qasje e vëzhgim kritik, nga njëra anë, të përkrahjes dhe inkurajimit, nga ana tjetër, ka bërë që unë deri në fund t’u përmbahem kriterëve të domosdoshme ndërkombëtare shkencore mbi studimet doktrale, sipas rregullores përkatëse për nivelin e këtyre studimeve në Universitetin Evropian të Tiranës.

Profesor Nathanaili, gjatë procesit të punimit doktroral, në veçanti më ka ndihmuar në orientimin e hulumtimit dhe në metodologjinë që duhej të përdorja. Pa angazhimin, inkurajimin dhe ndihmen e profesor Nathanailit, sigurisht nuk do të kisha arritur të përfundoja këtë punim studimor doktroral, sipas kriterëve të parapara.

Falënderime të mëdha i takojnë edhe familjes sime, duke filluar nga bashkëshortja Adnora dhe fëmijët e mi Art-i e Lir-i, të cilët kishin mirëkuptim, durim dhe respekt për kohën që më duhej t’ia kushtoja studimeve të mia doktrale, duke huazuar nga “KOHA”, që natyrshëm u takonte t’ua përkushtoja atyre. Ata respektuan agjendën time të studimeve, duke u vënë në dispozicion për të kryer edhe obligime që nuk ju takonin. Bashkëshortja Adnora, në një periudhë të caktuar kohore, në interes të studimit, kompensonte edhe rolin tim në familje, duke më siguruar kohën e domosdoshme për t’u thelluar në studime dhe në gjurmime.

Falënderoj edhe kolegët nga shkolla doktrale, me të cilët debatonim në mënyrë të vazhdueshme për punën dhe studimet, në përgjithësi, dhe temën e punimit tim doktroral, në veçanti. Po ashtu falënderoj edhe kolegët nga puna, të cilët më mbështetën dhe më inkurajuan për punë dhe hulumtim.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

ABSTRAKTI	iii
ABSTRACT	iv
FALENDERIME	vii
PËRMBAJTJA E LËNDËS	viii
SHKURTESAT:	ix
I. KAPITULLI I PARË - HYRJE	1
1.3. Qëllimi dhe objektivat.....	7
1.4. Shpjegimi i shkurtër i strukturës së punimit	8
II. KAPITULLI I DYTË	9
Skeleti Teorik dhe Modeli Analitik i Tezës – Konteksti teorik	9
2.1. Burimet dhe literatura	9
2.2. Çasja teorike e punimit.	11
2.3. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave hulumtuese	15
III. KREU I TRETË – Konteksti historik	18
3.1. Fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë - Shkaqet dhe arsyet.....	18
3.2. Luftërat në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë	33
Sllovenia	33
Kroacia	35
Bosnjë-Hercegovina.....	37
3.3. Konferenca e Daytonit dhe Kosova	41
3.4. Kosova dhe diplomacia ndërkombëtar.....	46
3.5. Paraqitja e UÇK-së – Rruga drejt të panjohurës	52
3.6. Unifikimi i imponuar i spektrit politik dhe ushtarak të Kosovës	67
3.8. Konferenca në Rambuje.....	71
3.8. Sulmet e NATO-së dhe përfundimi i luftës	79
3.9. Marrëveshja ushtarako – teknike e Kumanoves.	825
3.10. Rezoluta 1244	87

IV. KAPITULLI I KATËRT.	91
4.1. Administrimi ndërkombëtar në Kosovë : UNMIK –u	91
Sukseset dhe deshtimet e UNMIK-ut në Kosovë	92
Përmbajtja dhe përkufizimi i Planit të Ahtisaarit.....	106
4.4. Opinioni i GJND-së lidhur me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës	112
4.5. Njohja ndërkombëtare e Pavarësisë së Kosovës.....	116
4.6 . Dialog maratonik – pa rezultate të qendrueshme.....	132
4.7. Procesi i shtetndërtimit në Kosovë	136
Diskutime.....	148
V. Kapitulli Pestë: Konkluzione dhe rekomandime	158
BIBLIOGRAFIA/LITERATURA	163

SHKURTESAT:

RSFJ - Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë e përbër nga 6 republika e 2 krahina autonome: Sllovenia, Kroacia, Bosnie e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia me Kosovën dhe Vojvodinën si Krahina Autonome në kuadër të Serbisë dhe Federatës Jugosllave. Të gjitha bashkë: republikat dhe krahinat si elemente konstituive të Federatës Jugosllave me të drejta të barabarta

RFJ – Republika Federative e Jugosllavisë e përbër vetëm nga Serbia dhe Mali i Zi

SHBA- Shtetet e Bashkuara të Amerikës

NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior

UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës

TMK - Trupat Mbrojtëse të Kosovës

FSK - Forcat e Sigurisë së Kosovës

BDK - Bashkimi Demokrat Kroat

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

KFOR - Forcat Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovë

COMKFOR- Komanda e KFOR-it (The Kosova Force Commander)

UNMIK- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (Unitet Nation Mission in Kosova)

KS - Këshilli i Sigurimit

PE - Parlamenti Evropian

BE - Bashkimi Evropian

KO - Komuniteti Evropian

UNOSEK - Zyra e të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës (Office of the Special Envoy of the Secretary-General of the United Nations for the future status process for Kosova")

EULEX - Misioni Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë

Plani Z-4 - është skica e marrëveshjes për territoret me populate shumicë serbe në Kroaci Krajina, Baranja Jugore, Sllavonisë dhe të Sremit Perendimor të hartuar nga Grupi i përbërë nga: SHBA, Rusia BE dhe KB në vitet 1994/95.

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (North Atlantic Treaty Organization)

EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (European Union Rule of Law Mission in Kosovo)

AP - Asambleja e Përgjithshme

PSSP - Përfaqësuesi Special i Sekretariatit të Përgjithshëm .

PAKOJA E AHTISAARIT – Plani Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës

KIPRED-Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave

LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës

OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (The Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD))

Grupi i Kontaktit - Grup informal i disa shteteve i cili fillimisht është formuar me rastin e luftës në Bosnje e më pastaj ka vazhduar punën përkitazi me Kosovën. Shtetet anëtare janë: SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Italia, Franca dhe Rusia.

Emisari Special - *emisari* i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB- së në negociata për statusin final të Kosovës - Martti Ahtisaari

HDZ - Bashkësia Demokratike Kroate (Parti Politike Kroate)

APJ - Armata Popullore e Jugosllavisë

RSK -Republika Srpska Krajina

SANU – Akademia e Shkencës dhe e Arteve të Serbisë

UNPROFOR - Forcat mbrojtëse të Kombeve të bashkuara të vendosura në Kroaci për të mbrojtur aktivitetet humanitare ndërkombëtare në Bosnie e Hercegovinë

I. KAPITULLI I PARË - HYRJE

Punimi ka në fokus çështjen e Kosovës dhe çasjen e diplomacisë ndërkombëtare ndaj kësaj problematike me qëllim të pasqyrimin, analizimit dhe të shpjegimit të qëndrimit fillestar unik ndërkombëtar i cili në të gjitha variantët e zgjidhjes së statusit të Kosovës, atë e konsideronin si pjesë të pandashme të RSFJ-së, RFJ-së, Serbisë e asesi të pavarur e deri te evoluimi i këtij qëndrim në mbështetjen dhe ndihmen ndërkombëtare për arritjen e një pavarësie të mbikëqyrur ndërkombëtare për Kosovën.

Qendrimin fillestar të tyre bashkësia ndërkombëtare nuk nguronte ta proklamonte edhe publikisht që nga: Konferenca e parë për Jugosllavinë në vitin 1991¹, Marrëveshja e Dejtonit në vitin 1995, Bisedimet në Rambuje në vitin 1999, Rezoluta 1160 e vitit 1998, Rezolutën 1244 të 10 qershorit 1999, bisedimet në Vjenë në vitin 2006 etj., të gjitha këto qendrimet e shihnin Kosovën në kuadër të RSFJ-së, RFJ-së, e të Serbisë. Një qëndrim ndryshe, të kundërt me atë të deri atëhershëm, bashkësia ndërkombëtare filloi ta implemetoi me Planin Gjithpërfshirës të Statusit Final për Kosovën, shpalljen e pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt të vitit 2008, e do ta rrumbullaksoi studimin me mendimin këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth të drejtës së Kosovës për shpalljen të njëanëshme të pavarësisë së saj.

Arsyet dhe argumentimet e një evoluimi të tillë të atyre qëndrimeve do të bazohen në: analizimet e dokumenteve, rezolutave, marrëveshjeve, raporteve e analizave të institucioneve përgjegjëse ndërkombëtare, të instituteve kredibile, konventave, botimeve, memoareve, dëshmimeve dhe intervistave, kujtimeve të pjesëmarrësve – akterëve kryesor dhe vendimmarrës ndërkombëtar, shkrimeve të pjesëmarrësve tjerë të drejtpërdrejtë, ose shkrimeve të tjerëve për sjelljet dhe çasjen e aktorëve përgjegjës ndërkombëtar, e lokal lidhur me konfliktet në Jugosllavi.

Studimi në thelbin e vet nuk ka synim shtjellimn e saj nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare por nga aspekti politiko - historik i saj, meqenëse faktori ndërkombëtarë që nga

¹ Konferenca e parë ndërkombëtare për Jugosllavinë e cila u mbajt me 26 e 27 gusht të vitit 1991. Konferenca u inicua nga Britania e Madhe që mbante presidencën e Komunitetit Evropian. Konferenca është drejtuar nga Lordi Carington dhe kishte për qëllim gjetjen e modaliteteve për zgjidhjen e konflikteve në mes republikave në Jugosllavi. Në këtë Konferencë çështja e Kosovës u anashkalua tërësisht. Kjo u konfirmua që në fillim me rastin e formimit të Komisionit të Arbitrazhit të njohur si Komisioni i Badinterit, i cili padrejtësisht nuk e konsideronte Kosovën si etnitet i barabartë me republikat tjera të jugosllavisë, edhe pse edhe Kosova sit ë gjitha republikat tjera ishte element i barabartë konstituiv i Federatës Jugosllave sipas Kushtetutës së vitit 1974.

fillimi çështjen e Kosovës nuk e ka trajtuar si problem i së drejtës ndërkombëtare por e ka perceptuar dhe konceptuar si problem i të drejtave dhe lirive të njeriut i cili për shkak të rrethanave të krijuara në terren, në proces e sipër ka evoluar në problem humanitar ndërkombëtar.

Punimi, ka për qëllim që duke pasur parasysh të gjitha burimet më lart të cekura dhe duke u bazuar në të dhënat faktike zyrtare dhe kredibile të shpjegoj evoluimin e të gjithë procesit dhe qëndrimeve të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me çështjen e Kosovës gjatë periudhës 1990 - 2010, edhe pse zgjidhja dhe pavarësia e Kosovës konsiderohet dhe trajtohet si rast “sui generis”.

Rasti i Kosovës, ka vënë në spikamë apo në debat politik, diplomatik e mbi bazë shkencore nevojën për analizë dhe shqyrtim të shumë çështjeve deri më atëherë të “heshtura” në të Drejtën Ndërkombëtare dhe Kartën e OKB-së lidhur me sovranitetin, të drejtat e njeriut, intervenimin humanitar dhe jo vetëm në ato kapituj por edhe në doktrinat më rëndësi të veçantë për Kosovën siq ishte p.sh. rasti i vendimit për intervenimin e NATO-së edhe jashtë territoreve të shteteve anëtare etj.

Punimi ka për qëllim të vë në spikamë edhe rolin, rëndësinë dhe domosdoshmerinë e lidërshiptit ndërkombëtarë në veçanti të SHBA-së në zgjidhjen e çfarëdo çështjeje konfliktioze brenda shtetërore apo ndërshtetërore që rrezikon të marrë përmasa rajonale apo më gjërë, dhe në këtë mënyrë rrezikon paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Këtë e konkretizojmë me heshtjen mos të them mos gadishmërinë fillestare të Vashingtonit, që SHBA-të të përfshihen drejtërsedrejti në zgjidhjen e problemit të Jugosllavisë e në kuadër të saj edhe të Kosovës, edhe pse natyrshëm dihej se çështja e Kosovës nuk mund dhe nuk duhej të injorohet dhe të trajtohet vetëm si problem i të drejtave të njeriut gjegjësisht, problem i brendshëm i Jugosllavisë, sidomos në rrethanat e krijuara të reja në RSFJ, nëse për asgjë atëherë për faktin se Kosova nga një anë kufizohej me Shqipërinë e nga anët tjera edhe nga shtetet tjera ku një pjesë e konsiderueshme e tyre përbëhej nga populli shqiptarë që nënkuptonte se fillimi i luftës aty dhe mos ndërhyrja ndërkombëtare në lokalizimin me kohë të këtij konflikti pashmangshëm do të zgjerohej në tërë rajonin...

Mosinteresimi fillestar i SHBA-së për inkuadrimin e saj në zgjidhjen e problemeve brenda RSFJ-së, qendronin në arsyen se Jugosllavia me shpërbërjen e Paktit të Varshavës e kishte humbur rëndësinë strategjike që e kishte më parë për “perëndimin”... SHBA, ishte e preokupuar me Luftën në Gjirin Persik të vitit 1991, ishte e interesuar shumë për procesin e

transformimit apo shpërbërjes të Bashkimit Sovjetik, ashtu që për administratën e SHBA-së, kriza jugosllave është vlerësuar si problem lokal dhe problem evropian i cili nuk rrezikon apo sfidon seriozisht interesat nacionale amerikane, stabilitetin dhe sigurinë e Evropës apo kredibilitetin e organizatave ndërkombëtare sikurse janë OKB, NATO etj. Këtë përinterim të SHBA-ve për “konfliktin jugosllav” mund ta pasqyrojmë me deklarin e sekretarit të shtetit në mandatin e Kryetarit Gjorgj Bush, Xhejms Beker i cili në mënyrë të qartë ka pranuar mosinteresimin e SHBA-së për Jugosllavinë, duke thënë “Ne nuk kemi qen në atë luftë”²

Njëkohësisht, punimi ka për qëllim të intensifikoi debatin shkencor, të parashtruar nga Emisari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në procesin e zgjidhës së statusit final të Kosovës, z. Martti Ahtisaari, “Ndoshta ka ardhur koha që të rishikohet se a do të duhej të ndërrohet Karta e OKB-së dhe rregullat e tjera të drejtësisë ndërkombëtare lidhur me situata të tilla, për shembull përcaktimi i së ashtuquajturës luftë e justifikuar, me qëllim që ato rregulla të ishin më të përshtatshme për kushtet e sotme”³

Një vlerësim apo dilemë e parashtruar lidhur me këtë çështje nga një fitues i Çmimit Nobel për Paqe (viti 2008), siq është z. Martti Ahtisaari, me arsyetimin për ndarjen e çmimit nga komiteti Nobel Norvegjez, “ për angazhimin dhe kontributin e dhënë në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe ndërtimin e përhershme të paqes në shumë kontinente të botës për më shumë se tre decaie”⁴, vetvetiu determinon nevojën e një debati dhe analize të tillë mbi baza të infrastrukturës ligjore ndërkombëtare, politike dhe të asaj shkencore.

Konkretisht lidhur me këtë problematikë, z Ahtisaari, vlerëson se në infrastrukturën ligjore ndërkombëtare, të parashihet p.sh. “ përcaktimi i së ashtuquajturës luftë e justifikuar, me qëllim se ato rregulla të ishin më të përshtatshme për kushtet e sotme”

Në këtë drejtim edhe ky studim është një kontribut i dhënë për këtë çështje.

1.1. Përmbledhje e shkurtër e literaturës, avantazhet/kufizimet

Punimi bazohet në një shumëllojshmëri burimesh ekzistuese: historike, politike, diplomatike, nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare, të drejtave të njeriut, intervenimit humanitar ndërkombëtar të shtjelluara gjatë vijimit dhe finalizimit të procesit të zgjidhës së problemit të

² Sibel, Lora (korospodente e Finasial Times për Ballkanin) dhe Litl, Alan(korospondent i radio televizionit të BBC në Jugosllavi). *Vdekja e Jugosllavisë.Otokar Kersovani, Rijeka – Kroaci, 1996. Fq.22*

³ Ahtisaari, Martti. *Detyra në Beograd*. Trend, Prishtinë, 2008. Fq.34.

⁴ Arsyetimi i komisionit të Çmimit Nobel për ndarjen e çmimit z. Martti Ahtisaari.

njohur edhe si “Shpërbërja apo shkatërrimi i Jugosllavisë”, por edhe nga analizimi dhe këndvështrimi i ngjarjeve nga pjesëmarrësit e drejtpërdrejt ndërkombëtar dhe vendor në ato procese të publikuara në formë të deklarimeve publike, monografive, analizave juridike e politike etj.

Megjithatë, në funksion të qëllimit dhe objektivave të studimit, është shfrytëzuar kryesisht literatura që drejtpërsëdrejti shtjellon këtë problematikë dhe periudhë kohore dhe atë nga pjesëmarrësit që në çfarëdo forme kanë qenë pjesëmarrës aktiv në relacionin: Kosovë – Serbi - Diplomaci Ndërkombëtare rreth zgjidhjes së çështjes së Kosovës.

Në këtë drejtim, si **burime parësore** janë shfrytëzuar dhe analizuar: dokumentet e institucioneve shtetore, si p.sh. White House, U.S State Department. US Congress, National Security Council, Council for Foreign Relations. Raporti i CIA-së, (CIA Report on the war in former Yugoslavia: Balkan Battleground: A Military History of Yugoslav Conflict, 1990-1995. Dokumentet e OKB-së, siq janë: deklarata, rezoluta, raporte, marrëveshje të përfaqësuesve special të Sekretarit të OKB-së për Jugosllavi. Kroaci, Bosnie e Hercegovinë e në veçanti të përfaqësuesve ndërkombëtar për çështjen e Kosovës. Si dhe dokumentet, rezolutat, raportet deklaratat, analizat këndvështrimet e NATO-së, BE-së, poashtu edhe të institucioneve, zyrtarëve, analistëve të Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës, Rusisë etj. Si burim i rëndësishëm në shtjellimin dhe analizimin e këtij punimi është shfrytëzuar edhe dokumentacioni i Gjykatës Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë. Poashtu, në interes të këtij studimi janë shtjelluar dhe analizuar edhe Kushtetutat e Jugosllavisë, Serbisë dhe ato të Kosovës në kuadër të RSFJ-së, kushtetuta e 7 shtatorit 1990 të Republikës së Kosovës, sikurse edhe Kartën e Kombeve të Bashkuara. konventa, marrëveshje, propozime, parime, rregullore tjera.

Si **burime dytësore** janë trajtuar – monografi, kujtime, dëshmitë dhe pikëpamjet e zyrtarëve, diplomatëve të shteteve të ndryshme, me theks të veçant këndvështrimet e ndërmjetësve ndërkombëtar në procesin e zgjidhjes së problemit të pjesëmarrëse në procesin e zgjidhjes së çështjes Jugosllave dhe të asaj të Kosovës. Janë shtjelluar dhe analizur nga këndvështrimi kritik edhe punime analitike dhe studimore, intervista e shkrime të ndryshme analitike lidhur me problematikën që është edhe lëndë e këtij studimi etj. Burimet dytësore janë përcaktuar për nga besueshmëria dhe kredibiliteti i autorëve.

Ndërsa si **burime tjera** janë shfrytëzuar: studimet dhe analizimet e instituteve ndërkombëtare vendore dhe ndërkombëtare, vendimet nga institucionet vendore dhe

ndërkombëtare, vendime të gjykatave dhe dokumente të tjera procedurale relevante, intervista gjysmë të strukturuar, revista, gazeta, webfaqe etj.

Avantazhet e kësaj literature të shfrytëzuar qendron në faktin se janë të shumta dhe përmbajtësore, janë zyrtare dhe kredibile meqenëse burojnë nga institucionet përkatëse shterore dhe ndërkombëtare si dhe nga autorë e ekspert me renome ndërkombëtarë të cilët në forma të ndryshme ishin pjesmarrës apo vezhguës analitik i të gjith procesit të shpërbërjes së jugosllavisë dhe pavarësimit të Kosovës, ndërsa kufizimet e literaturës kryesisht bazohen në pamundësinë e inkorporimit të të gjithë atij materiali të shumtë ekzistues në studim për shkak të kriterit të përkufizimit të vëllimit të studimit nga shkolla doktorale për teza të disertacioneve. Ky kriter i përcaktuar nga UET, nuk ka ndikuar në cilësinë e studimit, me që një gamë aq vëllimore dhe përmbajtësore të burimeve mundëson përkufizimin cilësor të një analizë përmbajtësore historike, empirike dhe teorike të këtij studimi, të cilat në vete ngërthejnë një debat të gjërë lidhur me të drejtën e pavarësimit të Kosovës, intervenimet humanitare, të drejtat e njeriut etj. Edhe pas pavarësimit të Kosovës akoma në çarqe të caktuara politike, diplomatike, të ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare etj., debatohet rreth Kosovës dhe pavarësimit të saj. me theks të veçantë konstatimit ndërkombëtar se Kosova është rast “sui generis” dhe si e tillë do të mbetet në marrëdhëniet dhe të drejtën ndërkombëtare.

Edhe pse ky studim bazohet kryesisht në analizën historiko politike të çështjes së Kosovës në raport me diplomacinë ndërkombëtare, studimi nuk ka mundur ta apstrahoj as analizën e kësaj problematike edhe nga ana e së drejtës ndërkombëtare e cila si zakonisht interpretohet dhe konceptohet nga këndvështrime të ndryshme e jo vetëm në mënyrë stereotipe juridike... Këtë botëkuptim e ka argumentuar edhe mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me të drejtën e Kosovës për shpalljen e “njëanshme” të pavarësisë së saj.

1.2. Debati lidhur me çështjen e studimit

Çështja e Kosovës që nga fillimi e paraqitjes së saj, si çështje apo problem ndërkombëtar ka nxitë debate të shumta në shumë çarqe të ndryshme ndërkombëtare, kryesisht lidhur me të drejtën e saj për pavarësi – shkëputje fillimisht nga RSFJ, më pastaj nga RFJ, e në fund edhe nga

Serbia. Këto debate vazhdojnë edhe sot pas pavarësimit të Kosovës, por me një intensitet dhe analiza më të përmbajtura për shkak në një mënyrë këtij debati politik, diplomatik dhe juridik i ka dhënë fund Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me vendimin e saj “Pro” të drejtës së Kosovës, për ta shpallur pavarësinë e saj.

Debatët, kryesisht në të kaluarën, por edhe sot nga çarqe të caktuara zhvillohen rreth interpretimit dhe konceptimit të themeleve të sistemit të sotëm të së drejtës ndërkombëtare e cila ende figuron se bazohen në **parimet vestfaliane**⁵ të sovranitetit shtetëror, të cilat për ithtarët e kësaj doktrine sovranitetin shtetëror e konsiderojnë si parim themelor dhe të vetëm të së drejtës ndërkombëtare me çka në kontinuitet ia mohojnë Kosovës të drejtën e pavarësimit të saj, nga ana tjetër: analistë, ekspertë, lider botëror, diplomatë, organizata të drejtave të njeriut, ato humanitare etj., proklamojnë dhe insistojnë së rasti i Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës, Ruandës e tani edhe rasti i Sirisë, Krimesë e shumë vendeve të tjera determinojnë domosdoshmërinë e evoluimit të sistemit aktual ndërkombëtar në të gjitha fushat e jo vetëm në atë të së drejtës dhe sovranitetit të shteteve, për shkak se organizimi i sistemit aktual ndërkombëtar ka mbetur shumë prapa zhvillimeve të shteteve, shoqërisë ndërkombëtare dhe të njerëzimit...

Debati, aktualisht i nënshtrohet një trysnie të gjërë shoqërore dhe profesionale për evoluim si rezultat i ndikimit gjithnjë e më të madh të vlerave etike në të drejtën dhe shoqërinë ndërkombëtare.

Sistemi ndërkombëtar së bashku me konceptin e sovranitetit është në evoluim e sipër, për disa ky proces po levizë tejte ngadalë e për disa të tjerë tejte shpejtë. Për disa, evolumi i së drejtës ndërkombëtare ka shkuar aq larg sa që ua merr të drejtën shteteve për të qeverisur pjesë të territorit, në rastet të keqtrajtimit të rëndë të popullatës, edhe pse ky përcaktim publik nga një pjesë e konsiderueshme e faktorit ndërkombëtar parimisht pranohet, iniciativat që këto parime të marrin edhe formën e shkruar, mbesin të pa formalizuara.

Debati, rreth pavarësimit të Kosovës, mund të themi se ka përfunduar për pjesën dërmuese të ekspertëve dhe shteteve me mendimin këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, se Kosova ka pasur të drejtë shpalljen e pavarësisë së saj. Edhe pas vendimit të GJND-së, debatët teorike, politike, diplomatike dhe juridike ende vazhdojnë dhe sigurisht kjo

⁵ Parimet Vestfaliane të vitit 1648: Tre shtyllat qëndrore të sistemit Vestfalian, janë veçanërisht të rëndësishme për t'u përmendur, pasi mbeten edhe sot të rëndësishme, të paktën formalisht: barazi juridike mes shteteve sovrane, pritshmëria që integriteti territorial i shteteve do të respektohet, dhe një marrëveshje e përgjithshme për të mos ndërhyrë në punët e brendshme të të tjerëve.

çeshtje edhe në të ardhmën në aspektin teorik do të debatohet meqenëse nga aspekti praktik Kosova tani më si shtet i pavarur është pranuar nga 116⁶ shtete në mesin e të cilëve janë pjesa dërmuese e shteteve më të fuqishme ekonomike, e ushtarake botërore dhe europiane dhe pothuaj të gjitha shtetet me demokraci të avansuar. Problem në zhvillimin, funksionimin e shtetit të Kosovës dhe integrimin e saj në BE, dukshëm e pengon mospranimi i pavarësisë së saj nga pesë shtete të kësaj bashkësie të shteteve evropiane (Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja).

Ky studim, sigurisht do të japë një kontribut modest në debatin ndërkombëtar rreth të drejtës së Kosovës për pavarësimin e saj, meqenëse, ofron një analizë e cila qartëson rastin e Kosovës kundruall rasteve tjera në të kaluarën, të tashmën (Krimea) apo rasteve tjera në të ardhmën.. Çasja teorike e studimit kryesisht është mbështetur në Teorinë e Shkollës Angleze, por meqenëse e dijmë se një teori si e vetme në shkencat shoqërore dhe politike nuk mund të ofron shpjegime të mjaftueshme lidhur me ndërtimin e marrëdhënieve shoqërore dhe përcaktimin e rregullave që determinojnë sjelljet e individit dhe grupeve shoqërore Teorinë e Shkollës Angleze e kam plotësuar edhe me Teorinë Realiste dhe atë Liberale, të cilat më gjërisht do t'i pasqyroj në kapitullin përkatës.

1.3. Qëllimi dhe objektivat

Të shpjegohet nga këndvështrimi historiko-politik dhe të analizës kritike procesi i pavarësimit të Kosovës dhe roli i diplomacisë ndërkombëtare në këtë drejtim; Të hedhë dritë mbi shkaqet dhe arsyet e evoluimit aq përmbajtësor të qëndrimit të diplomacisë ndërkombëtare lidhur me këtë çështje, nga qëndrimi fillestar unik dhe këmbëngulëse në favor të ekzistencës dhe vazhdimësisë së Jugosllavisë dhe kundër pavarësimit të Kosovës, e deri te ndryshimi rrënjësor i këtij përcaktimi fillestar. Në fokus, rëndësi e veçantë i është dhënë politikës së jashtme së Fuqive të Mëdha me theks të veçantë të SHBA-ve si promotore kryesore e diplomacisë ndërkombëtare në periudhën e globalizmit dhe unilateralizimit amerikan dhe çasjes së tyre në zgjidhjen e një problemi regjional i cili nuk ishte e nuk konsiderohej me interes vital nacional për SHBA-të por që me kohë merr permasa sa që kercnonte kredibilitetin e SHBA-ve si forca e vetme globale në botë.

⁶ Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, njohjen ndërkombëtare të pavarësisë të Kosovës e kanë njohur 116 shtete. Dy shtetet e fundit janë shteti Madascar me 24 11 2017 ndërsa shteti aktualisht i fundit është shteti Barbados i cili e ka njohur Republikën e Kosovës me 15 shkurt 2018 (qasur me 16 shkurt 2018, ora 19:51)

1.4. Shpjegimi i shkurtër i strukturës së punimit

Punimi është i ndarë në pesë kapitujë duke e përfshirë këtu edhe kapitullin e konkluzioneve dhe të rekomandimeve.

Në **kapitullin e parë, hyrja**, pasqyron elementet kryesore të studimit. Në këtë kapitull prezantohet problematika e përgjithshme e shtjelluar në punim, me theks të veçantë pasqyrimin e objektit qensor të analizës: Çështjen e Kosovës dhe raportin e diplomacisë ndërkombëtare rreth kësaj problematike në periudhën kohore 1990 -2010, me theks të veçantë raportet e Fuqive të Mëdha ndaj RSFJ-së e në kuadër të saj edhe ndaj Kosovës.

Në këtë kapitull poashtu shpjegohet shkurtimisht edhe përmbledhja e literaturës dhe materialeve tjera relevante duke shpjeguar avantazhet dhe kufizimet e tyre., Shpjegohet debati i dikurshëm dhe aktual lidhur me problematikën studimore, qartëson pyetjet kërkimore dhe argumentimet kryesore të hipotezave dhe në fund shpjegohet struktura e tezës së disertacionit

Në **kapitullin e dytë**, shpjegohet konteksti teorik i studimit, bëhet një analizë më e thelluar dhe më përmbajtësore e literaturës së shfrytëzuar, hipotezat e nxjeruna nga to dhe një analizë kritike e saj. Kapitulli i dytë, poashtu përfshinë edhe një diskutim analitik dhe kritik të shkollave ekzistuese teorike dhe përcaktimin e arsyeshmërisë dhe argumentimit të teorive të përzgjedhura, dhe në fund ky kapitull rrumbullaksohet me zhvillimin e metodologjisë së përdorur në punim.

Në **kapitullin e tretë**, në mënyrë deskriptive pasqyrohet konteksti historik i problematikës së punimit.

Ndërsa në **kapitullin e katërt**, shtjellohet analiza e procesit të përgjithshëm përmes periudhave kohore bazuar në materialet e përpunuara ku pasqyrohen ndryshimet që kanë rezultuar në politikën e jashtme të SHBA-ve ndaj çështjes së Kosovës.

Dhe **kapitulli i fundit**, kapitulli i pestë, pasqyron Konkluzionet dhe Rekomandimet e këtij studimi. Në këtë kapitull do të përmbledhen konkluzionet/përfundimet e kapitujëve të punimit duke u mbështetur në funksion të hipotezave dhe pyetje të parashtruara hulumtuese.

II. KAPITULLI I DYTË

Skeleti Teorik dhe Modeli Analitik i Tezës – Konteksti teorik

2.1. Burimet dhe literatura

Ekziston një konstatim i përgjithshëm se para se të konkuludojmë diçka të re lidhur me ndonjë çështje të caktuar, së pari duhet të bëjmë një përmbledhje të njohurive ekzistuese për çështjen në fjalë.

Edhe pse studimi ka të bëjë me një të kaluar të afërt, në dispozicion të studimit, analizimit apo të informimit ekzistojnë burime dhe literatura të shumta e të shumëllojshme që pasqyrojnë këtë problematikë, duke u nisur nga: dokumentet zyrtare të shteteve të ndryshme, deshmive të aktorëve ndërkombëtar e vendor pjesmarrës në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe zgjidhjen e çështjes së Kosovës, marrëveshjet, rezolutat, kushtetutat, ditare, memoare, intervistat, analiza të shumta, punime disertacioni, prononcime në media të aktorëve kryesor të procesit, video inçizimeve, si dhe materiale të vlefshme për këtë çështje që kanë rezultuar nga puna e Gjykatës Ndërkombëtare për ish Jugosllavi.

Një njohuri e tillë paraprake nga këto burime të shumta më ka detyruar, që në nisje të punimit të bëj selektimin e burimeve dhe të literatures përkatëse të cilat në kontinuitet të punimit i kam nënshtruar shtjellimit nga aspekti kritikë dhe analitik. Gjetjet në literaturë më kanë mundësuar dhe ndihmuar përcaktimin e drejtimit të çasjes së literatures drejt gjetjeve të argumentimit të hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të parashtuara, dhe kuptohet arritjes deri të konkluzionet dhe rekomandimet e argumentuara dhe të dokumentuara..

- **Burimet dhe literaturën e shfrytëzuar** e kam ndarë në disa grupe:
- **Grupin e parë të burimeve** e përbejnë dokumentet e institucioneve të shteteve të caktuara apo të atyre ndërkombëtare: Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974, Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974, në bazë të të cilave është analizuar statusi i Kosovës në kuadër të Jugosllavisë si element konstituiv i Federatës Jugosllave e barabartë me Republikat e RSFJ-së, dhe interpretimi i saj historikë, politikë, dhe juridik nga çarqe të ndryshme diplomatike, Rezolutat e OKB-së për ish Jugosllavi, dokumentet nga Konferencat Ndërkombëtare për ish Jugosllavi e Kosovë, Dokumentete e OKB-së, NATO-së, BE-së, Shtepisë së Bardhë (White House), Stait

Departamentit(U.S. State Department) dhe Kongresit (U.S. Congress) të SHBA-së, Këshillit të Sigurisë Nacionale(National Security Council) dhe të Këshillit të Punëve të Jashtme(Council for Foreign Relations), Raporti i CIA-së mbi Luftën në Jugosllavi, të publikuar në vitin 2003 (*CIA Report on the war in former Yugoslavia: Balkan Battleground: A Military History of Yugoslav Conflict, 1990/1995.*), duke përfshirë edhe prononsimet, raportet, analizat zyrtare të shteteve apo zyrtarëve pjesmarrës në zgjidhjen e problemit të Jugosllavisë dhe të Kosovës.poashtu edhe Raportet e Sekretarit Gjeneral mbi Administrimin e Misionit të OKB-së në Kosovë për vitet 2000-2010. Duke u bazuar në këto burime të lartcekura kemi pasqyruar dhe analizuar në kontinuitet qendrimet dhe çasjen ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës. Në këtë drejtim është domëthënëse edhe analizimi i dokumentacionit përkatës i Gjykatës Ndërkombëtare për ish Jugosllavi në të cilën shpalosen këndveshtrimet dhe ngjarjet përmes deshmive të akuzave apo deshmitarëve të ngjarjeve të veçanta e të cilat plotësojnë mozaikun e një tabloje të tërsishme të problemit të shtjelluar në këtë studim.

Grupin e dytë të burimeve e përbëjnë: prononsimet publike të shteteve apo zyrtarëve pjesmarrës të drejtpërdrejt në këtë proces, të ndërmjetësuesëve, diplomatëve, politikanëve e aktorëve tjerë pjesmarrësve aktiv në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë të cilat i kanë paqyruar me anë të: memoarëve, intervistave me ta, shkrimet dhe analizat e autorëve e analistëve tjerë për sjelljen, qendrimet, punën e aktorëve kryesor dhe çasjen e diplomacisë ndërkombëtare në zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Janë shfrytëzuar dhe analizuar edhe disa nga kablogramet diplomatike të publikuara të Wikileaks-it etj.

Grupi i tretë i burimeve ka përfshi, analizat dhe studimet e institutive kredibile ndërkombëtare por edhe të atyre ish Jugosllave apo të Kosovës, punimet e ndryshme të tezave të disertacionit etj.

2.2. Çasja teorike e punimit.

Edhe pse, nuk ka asnjë teori e cila si e vetme i shpjegon çështjet e caktuara politike, diplomatike apo të marrëdhënieve ndërkombëtare – por ekzistojnë shumë teori konkurruese të cilat për çështje të caktuara ndërlidhën në mes veti për çështje të njëjta, prap se prap jam përcaktuar që në kuadër të kontekstit teorik të punimit të bazohem kryesisht në **Shkollën Teorike Angleze** e cila në thelbin e saj përfshinë shumë elemente të shpjegimit të raporteve: Kosovë – Serbi – Bashkësi Ndërkombëtare, meqenëse Shkolla Teorike Angleze gjegjësisht rryma e saj “Solidariste” (si p. sh. Bill Clinton dhe Tony Blair, përkrahës të këtij koncepti teorik, dhe dy nga aktorët kryesor të kyçur në zgjidhjen e problemit të Kosovës), perceptojnë se **“në rastet kur Kombet e Bashkuara dështojnë të mbrojnë të “drejtat e njeriut” si p. sh. në rastin e Ruandës, Bosnjës dhe Kosovës, atëherë duhet të intervenohet për shkaqe humanitare që të shpëtohen jetërat e njerzëve dhe siguria rajonale dhe ndërkombëtare”**

Shkolla Teorike Angleze - Anëtarët më të njohur të kësaj teorie: Hedley Bull, Martin Wight⁷, John Vincent dhe Adam Watson, Robert Jackson, Tim Dunne dhe Nicolas Wheeler (vitet 90-2000) Barry Buzan Richard Little etj. Shkolla Angleze synon të japë një interpretim të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, që bashkërendon teorinë dhe historinë, moralin dhe fuqinë, faktorët dhe strukturën⁸

Njëri nga themeluesit e teorisë së “Shkollës Angleze” (The International Society) është Hedley Bull. Në librin e tij “The Anarchical Society”(1977) autori paraqet shtetet sovrane si pikënisje të marrëdhënieve ndërkombëtare, por në rastin e Kosovës thirja në sovranitet nga një numër i konsiderueshëm i shteteve, analistëve e teoricienëve ishte argumentim më i zbehtë në krahasim nga thirja humanitare për ndërprejën e një katastrofe humanitare me premisa të një gjenocidi klasik që Serbia po e ndërmerre në Kosovë, sidomos pas Masakrës serbe të 11 korrikut të vitit 1995 ndaj popullit boshnjak në Bosnje e Hercegovinë, me ç’rast janë vrarë mbi 8000 civil....

⁷ Petar Popovic. *Prijepori o teorijama medjunarodnih odnosa. Politicka kultura, Zagreb, 2012*

⁸ Tim Dunne, Milja Kurki, Steve Smith: *Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare*

Sipas “Shkollës Angleze” janë pesë institucione përgjegjëse për ruajtjen e sistemit dhe regullit ndërkombëtar:

- **Ekulibri i forcës,**
- **E drejta ndërkombëtare,**
- **Diplomacia,**
- **Funkcioni i Luftës, dhe**
- **Fuqitë e Mëdha**

Sipas interpretimit të autorit “shkolla klasike angleze” është një kombinim me elemente realiste si për shembull “ekuilibri i forcës”, “Fuqitë e mëdha”, “Lufta” (high politics) dhe gjithashtu me elemente të Liberalizmit si “Diplomacia”, dhe të “Drejtat e Njeriut”(low politics). Politika e ashtuquajtur „new world order“ mbas vitit 1990 në aspektin: politik, ekonomik dhe ushtarak dështon.(sepse shfaqen shumë luftra rajonale dhe etnike për shkak të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë). Mbas përfundimit të luftës së Ftohtë, dhe të rrethanave të krijuara në ish shtetet e bllokut komunist, ish Bashkimit Sovjetik dhe në Ballkan, lind, gjegjësisht zhvillohet një debat politik në “shkollën angleze”, që si pasojë lindin dy rryma: Rryma “Pluraliste” dhe Rryma “Solidariste”. Secila nga këndvështrimi i vet argumenton posaqërisht „Intervenimet Humanitare“ në baza ligjore, morale dhe politike. Këto dy rryma si të tilla pasqyrojnë më së miri edhe koloritin e pikëpamjeve të ndryshme ndërkombëtare ndaj vlerësimit dhe çasjes së problemit të Kosovës.

Koncepti i Rrymës “Pluraliste” në kuadër të Shkollës Teorike Angleze e që karakterizohet më shumë si pesimiste, realiste dhe konservative.(në kontekst të gjendjes natyrore ose të Luftës), në rastin e Kosovës, pothuaj e kanë mbështetur pjesa dërmuese e toricientëve, analistëve, diplomatëve e politikanëve botërorë. Kjo rrymë sipas Jean Bodin, është e ndërtuar në principet e „**sovrانيتit absolut**“, dhe si e tillë preferohet edhe nga **Hans Morgenthau dhe Henry Kissinger**. Kjo rrymë është kundër ndërhyrjes në punët e brendshme në një shtet sovran si për shembull në ish-jugosllavi (shumë shtete të BE-së ishin të ketij mendimi).

Ndërsa nga ana tjetër “**Solidaristet**“ karakterizohen më shumë si optimista, idealista dhe liberal (si p. sh. **Bill Clinton dhe Tony Blair**). Qasja e tyre është shumë e qartë, në rastet kur Kombet e Bashkuara dështojnë të mbrojnë të “drejtat e njeriut” si p. sh. në rastin e Ruandës,

Bosnjës dhe Kosovës, atëherë duhet të intervenohet që të shpëtohen jetërat e njerzëve dhe siguria rajonale dhe ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës, ky botëkuptim teorikë me shumë hezitime, kundërshtime, kalkulime, vështërsi e paknaqësi e kritika u jetësua në praktikë. Njëkohësisht, kjo dëshmon edhe faktin se botëkuptimet e forcave brenda lidërshipt botëror në kohë reale luajnë rol shumë të rëndësishëm në zgjidhjen e ndonjë vatre të krizës me rrezikshmëri të përmasave regjionale apo ndërkombëtare. Në kuadër të këtij konceptimi, mund të konkludojmë se Kosova ka pasur shumë fat që problemi i saj është parashtruar të zgjidhet nga një lidërship ndërkombëtar ku rol të rëndësishëm vendimmarrës kanë pasur Tony Blair, Madeleine Albright e Bill Clinton, pse jo edhe Boris Yeltsin i Rusisë e jo p.sh. presidenti aktual rus Vladimir Putin, këtë, konkludim do ta mbështesë edhe me faktografi përkatëse, në vazhdimi të punimit.

Meqenëse Shkolla angleze është një kombinim me elemente realiste dhe liberale, në vijim në mënyrë të përgjithshur i pasqyroj edhe këto teori, si teori mbështetëse dhe plotësuese.

Disa nga qëndrimet bazë epistemologjike të realizmit, ndërlidhen me faktin se të gjitha teoritë realiste pikënisje e kanë supozimin se “Në mungesë të një sovрани ndërkombëtar, secili shtet do të jetë potencialisht i kërcënuar nga cili do shtet tjetër, dhe nuk do të ketë rrugëdalje për sigurinë e tij, veçse të rrokë armët për të mbrojtur vetveten”⁹, e në këtë kontekst përmes qëndrimeve epistemologjike të teorisë realiste mund të shpjegohet edhe avancimi nga përcaktim i pothuaj gjithë spektrit politik të Kosovë që çështjen e Kosovës ta zgjidhin ekskluzivisht me mjete politike dhe paqësore drejt evoluimit të saj në luftë të armatosur.

Nga ana tjetër, në bazë të qëndrimeve *ontologjike* të realizmit konsistojnë në faktin se shtetet janë aktorët më të rëndësishëm në sistemin anarkik ndërkombëtar¹⁰, e në kuadër të këtij konteksti, Kosovës nuk i’u pranonin atributin e shtetit, edhe pse ajo ishte element konstituiv i Federatës Jugosllave, e barabart me të gjitha republikat e kësaj federate, të cilave bashkësia ndërkombëtare iu pranonte të drejtën për shkëputje dhe pavarësi.

Realizmi, si teori është shfrytëzuar kryesisht për shkak të botëkuptimit të Wight, se asnjë teori nuk mund të pranohet gjithmonë si e saktë, por e rëndësishme është debati mes tyre dhe se e vërteta nuk është veti e asnjë teorie, por e dialogut mes tyre”¹¹.

⁹ Francis Fukuyama, *Fundi i Historisë dhe Njeriu i Fundit* (Prishtinë: Zenith, 2006), fq. 264-265.

¹⁰ Morgenthau, Hans. *Politika Ndërmjet Kombeve...*, fq. 3-17.

¹¹ Scott Burchill et al, *Theories of International Relations, 2nd. edition* (London: Palgrave, 2001), fq.22-23.

Realistët nuk shqetësohen aq tepër për parimet morale, ata zakonisht nuk janë mbështetës të intervenimit humanitar.

Në kuadër të Realizmit jam mbështetur në:

- nivelin e analizës të shkaqeve në zhvillimet e marrëdhënieve ndërkombëtare të shteteve të cilat shpjegojnë shumë ngjarje në kontekst të këtij studimi;
- niveli i analizës nga këndvështrimi i individit – natyra e njeriut;
- analiza nga niveli i shtetit – natyra e shtetit;
- dhe nga aspekti i analizës të sistemit organizativ të shteteve në nivel ndërkombëtar gjegjësisht natyrën e sistemit ndërkombëtar e që të gjitha së bashku ndërlidhen me vlerësimet e Hans Morgentau të pasqyruar në librin e tij **“Politics among nations“, ku politikën ndërkombëtare dhe politikat tjera i definon si “luftë për fuqi (mbisundim)” dhe se shkaqet e ndodhjeve në marrëdhëniet ndërkombëtare gjinden në natyrën e njeriut”...**

Duke i'u përmbajtur konceptit se asnjë teori si e vetme nuk mund të pranohet gjithmonë si e saktë dhe e mjaftueshme, dhe se për këtë arsye, e rëndësishme është debati mes tyre, meqenëse e vërteta nuk është “pronë” e asnjë teorie, por e dialogut mes tyre, i kam ballafaquar teorinë realiste në kontekstin e dilemës së sigurisë me teorinë liberaliste e cila kundërshton një teori të tillë me argumentimin se sistemi ndërkombëtar funksionon me një hierarki mjaft të qartë dhe me një strukturë organizative mjaft të definuar siq është rasti me OKB-në, e cila sipas teoricienëve liberal duhet të jet përgjegje e ruajtjes së paqes dhe të *sigurisë kolektive*. Sipas këtij koncepti, siguri i të gjithë shteteve, mike apo kundërshtarë në mes veti, është i ndërvarur, në atë mënyrë që pasiguria e një shteti i bënë të pasigurta edhe të gjitha shtetet tjera¹².

Sa i përket studimit të çështjes së Kosovës, liberalistët dallojnë përmbajtësish në konceptimin e organizimit dhe të sigurisë ndërkombëtare nga realistët. Poashtu, liberalistë kanë mendim të kundërt edhe lidhur me organizimin, ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare, ndërhyrjen humanitare sovranitetin shtetëror e përdorimin e forcës ndërkombëtare.

Për këtë arsye, nga aspekti **liberal** i analizimit të punimit jam mbështetur, në periudhën e Iluminizmit Skocez, kur Adam Smithi iu referua “planit liberal për barazi, liri dhe drejtësi”, i cili koncept drejtpërsëdrejti argumenton dhe shpjegon ngjarjet, veprimet dhe vendimet e faktorit ndërkombëtar në raportin Kosovë – Serbi – Bashkësi Ndërkombëtare.

¹² Goldstein, Joshua. *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*. Dituria Tiranë 2003., Fq. 128.

2.3. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave hulumtuese

Me metodologjinë e aplikuar në studim kam pasqyruar mënyrën e realizimit të punimit duke u bazuar në elementet e përgjithshme të saja dhe analizimet e krahasimet e tyre për të ardhur deri të përfundimet e qëndrueshme, dhe njëkohësisht është shpjeguar edhe çasja dhe arsyeshmëria e metodave të përdoruara në punim.

Për studimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të punimit jam bazuar në metodologjinë integrale e cila kryesisht shfrytëzohet në hulumtimet e shkencave shoqërore me qëllim të zhvillimit dhe trajtimit të hipotezës kryesore dhe hipotezave ndihmëse. Në kuadër të saj, për analizë janë përdorur metodat:

- ✚ Fillimisht jam bazuar në **metodën deskriptive** me qëllim të pasqyrimit dhe shpjegimit të ngjarjeve, aktorëve, situatave, proceseve, fakteve, marrëveshjeve, rezolutave, ligjshmërisë, ndryshoreve shkak-pasojë, evaluimit të raporteve ndërshtetërore dhe diplomatike rreth çështjes së Kosovës.
- ✚ **Metodën e analizës**, të cilën e kam shfrytëzuar në mënyrë kronologjike në të gjithë punimin. Përmes analizës strukturale është analizuar i tërë procesi i zhvillimit të procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, luftërave, ngjarjeve, këndvështrimet dhe interesat e ndryshme të shteteve, përmbajtjen e dokumenteve, konkluzioneve nga takimet e rëndësishme, paraqitjet publike me analiza të situatave dhe qëndrimeve të aktorëve kryesor të angazhuar në zgjidhjen e kësaj problematike, si dhe analizat e ekspertëve të ndryshëm, punimet, veshtrimet e publikuara
- **Metodën e analizës krahasuese** për të krahasuar faktet e gjetura në punimet, shkrimet analizat e të tjerëve lidhur me proceset e shtjelluara me gjetjet e arritura gjatë këtij studimi si dhe ngjajshmëritë dhe dallimet e shteteve dhe burimeve të ndryshme për çështje të njëjta..

Pasi që pyetjet kërkimore janë të domosdoshme dhe shumë të rëndësishme në punimet shkencore, meqenëse përmes tyre shprehim qëllimin e punimit dhe njëkohësisht me anë të tyre trasojmë e tërë procesin e studimit, pyetjet kërkimore në këtë studim, **bazohen në faktorët kryesorë, të cilët kanë ndikuar në ndryshimin e “kursit” të diplomacisë ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës, e cila pasqyrohet nga analizat krahasimore të pyetjeve**

kërkimore: Angazhimi i SHBA dhe shteteve tjera perendimore në Kosovë ishte interes gjeostrategjik apo etik e humanitar.

- Sa kanë ndikuar masakrat – sidomos ajo e Srebernicës, dhuna, pastrimet etnike në 4 luftërat e filluara nga Serbia në ish-Jugosllavi, në ndryshimin e përcaktimit fillestar ndërkombëtarë se në çdo variant zgjidhja e problemit të Kosovës është paraparë brenda Jugosllavisë?
- Sa ishte Kosova interes gjeostrategjik ndërkombëtar kur kemi parasysh përkrahjen dhe ndihmen e rezervë që i jepte Serbisë, Rusia me tendencë të bëhet faktor ndikimi në këtë pjesë të Ballkanit?
- Sa varet zgjidhja e problemeve ndërkombëtare nga lidshipi të shteteve të fuqishme ndërkombëtare?
- Dhe në fund, si pyetje përmbyllëse parashtrohet pyetja: Rasti i Kosovës në diplomacinë ndërkombëtare a do të mbetet rast “sui generis” apo do të zbatohet si praktikë diplomatike?

Një gamë aq vëllimore dhe përmbajtësore të burimeve ka mundësuar një analizë përmbajtësore historike, empirike dhe teorike të këtij studimi dhe njëkohësisht mbështetjen e një hipoteze të parashtruar. .

Punimi im i doktoraturës ka një hipotezë qendrore që ka për qëllim të mbështesë një supozim të përgjithshëm se politika injoruese e Serbisë ndaj bashkësisë ndërkombëtare dhe pretendimet e saj për pastrime etnike dhe dhunë me përmasa të gjenocidit ka ndikuar që SHBA, në procesin final të çlirimit dhe pavarësisht të Kosovës të evoluoi qëndrimin e saj fillestar që Kosova parashihej të mbetet pjesë e RFJ-së/Serbisë, dhe rolit të SHBA-së që këtë ripozicionim të saj rreth të ardhmës së Kosovës ta mbështeste edhe pjesa tjetër e bashkësisë ndërkombëtare e cila ishte këmbëngulëse që Kosova në të gjitha variantet e zgjidhjes së statusit të saj të mbetet pjesë e Serbisë me një autonomi të ashtuquajtur substanciale.

Hipoteza 1: Në ndryshimin e qëndrimit fillestar unik të diplomacisë ndërkombëtare për mosnjohjen e mos pranimin e drejtës së Kosovës për pavarësi e deri te pavarësia e saj ka ndikuar politika e mosbashkëpunimit, mospranimit dhe kundërshtimit të liderit serb Slobodan Milosheviq ndaj propozimeve të shumta të ofruara nga SHBA-të dhe shteteve e tjera të fuqishme të Evropës (Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës etj.) për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, të gjitha në kuadër të Jugosllavisë/Serbisë.

Nga kjo, hipoteza kryesore ndërlidhet edhe me dy hipoteza tjera që e plotësojnë njëra tjetrën:

Hipoteza 2: Çeshtja e Kosovës në diplomacinë ndërkombëtare u konceptua si rast “sui generis” me qëllim të çasjës së saj nga aspekti etikë e humanitarë e anashkalimit të “shumë kuptimësive” politike të së drejtës ndërkombëtare.

Hipoteza 3. ka për qëllim të mbështesë faktin se zgjidhja e drejtë e çështjes së Kosovës pa përfshirjen e drejtpërdrejt të SHBA-së, nuk do të ishte e mundur.

Hipotezat do të argumentohen përmes analizimit dhe komentimit të dokumenteve përkatëse ndërkombëtare, vendimeve dhe qendrimeve të konferencave, takimeve dhe ofertave të diplomacive ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe kuptohet pikëpamjeve dhe këndvështrimeve të aktorëve kryesor ndërkombëtar të paraqitura përmes intervistave, publikimeve dhe analizave të tyre të publikuara në formë të monografive, librave , kumtesave apo punimeve në konferenca të ndryshme shkencore.

III. KREU I TRETË – Konteksti historik

3.1. Fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë - Shkaqet dhe arsyet

Një nga sfidat më problematike, me të cilat më është dashur të ballafaqohem, për të nxjerrë vizionin e përmbajtjes së punimit, ishte konceptimi i pikënisjes për plotësimin e mozaikut, i cili në vete ngërthen një histori të tërë njerëzore, humanitare, kombëtare dhe ndërkombëtare, me një fjalë tërë procesin e evoluimit të diplomacisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare rreth çështjes së Kosovës, gjatë periudhës 1990-2010, por e cila në vete përfshinë edhe një parahistori të gjatë gjeostrategjike, politike, diplomatike etj. Në fund, pas grumbullimit të materialit dhe të materies së studiuar dhe pas analizimit përmbajtësor të saj, vetvetiu m'u imponua se elementi i parë i mozaikut të përgjithshëm, pa dyshim duhet të jetë një **vështrim i shkurtër i pozitës historiko politike dhe juridiko kushtetuese të Kosovës në kuadër të ish Jugosllavisë (RSFJ-së)**, me çka më përmbajtësisht do të kuptohen, do të analizohen dhe do të vlerësohen vendimet përfundimtare për zgjidhjen e çështjes së Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare..

Siç thotë doktori i historisë, Noel Malcolm, në parathënien e botimit të dytë të librit tij Kosova, një histori e shkurtër, “detyra e zhbërjes së paragjyqimeve është e ngadalshme dhe në rrethanat e tanishme (mendohet në rrethanat kohore që shtjellohen në këtë punim (vër. e autorit), mund të duket se ajo kaplohet tërësisht nga ngjarjet e ditës”¹³. Ky konstatim, edhe pse i referohet Serbisë, parimisht mund t'i dedikohet edhe diplomacisë ndërkombëtare.

Kosova, që nga përfshirja e saj i saj në kuadër të RSFJ-së, në vitin 1945, ishte në konflikt permanent me institucionet e Serbisë dhe të atyre të Jugosllavisë lidhur me statusin dhe të drejtat e saja në kuadër të kësaj federate.

Në kundërshtim me proklamimet e koalicionit botëror antifashist se çdo popull, pas fitimit të luftës, do të vendosë vetë për të ardhmen e vet, Serbia-Jugosllavia, me përkrahjen e heshtur të faktorit ndërkombëtar, më 8 shkurt 1945, okupoi Kosovën¹⁴ dhe e vendosi nën administrimin e vet ushtarak. Nën masat e administrimit ushtarak në korrik të vitit 1945, në Prizren, u organizua një tubim jo kompetent dhe jo legjitim, i një grupi njerëzish të vetëquajtur

¹³ Malcolm, Noel, *Kosova një histori e shkurtër*, SHB “KOHA”, Prishtinë & Shtetpi e Librit, Tiranë, 2001. fq. 303

¹⁴ Akademia e Shkencave, *Qen. Enci. Shqip. Kosova në vështrim enciklopedi, botimet “Toena”, 1999, fq. 118 e 119.*

nga Serbia “përfaqësues të Kosovës”, të cilët nuk ishin të caktuar e as të zgjedhur nga populli i Kosovës, i cili vendosi pa të drejtë që Kosova t’i bashkohet Serbisë federale, që paraqet një akt të dhunshëm Aneksimi.

Serbia dhe Jugosllavia, në kontinuitet ndër vite ndërmerrnin aksione të dhunëshme shtetërore me qëllim të frikësimit dhe shtypjes së kërkesave shqiptare për një status dhe të drejta nacionale më të barabarta në kuadër të Federatës Jugosllave.

Ndër strategjitë dhe aksionet më të dhunshme shtetërore jugosllave ndaj shqiptarëve të Kosovës ishin të ashtuquajturat “intensifikimi i shpërnguljes sa më masive të shqiptarëve nga Kosova si dhe “aksionet e mbledhjeve të armëve” nga popullata shqiptare të cilat u ndërmerrnin në mënyrë permanente që nga viti 1945, OZNA - UDBA jugosllave-serbe. “Vetëm gjatë vitit 1956, policia jugosllave kishte malltretuar, rrahur, kërcnuar e burgosur mbi 60.000 shqiptarë gjatë aksionit të mbledhjes së armëve¹⁵.

Në këto rrethana, gjatë viteve të qëndrimit të Kosovës brenda Federatës jugosllave, pozita e saj kushtetuese zhvillohet dhe ndryshon përmbajtësisht nëpër disa etapa, deri në Kushtetutën e vitit 1974 të RSFJ-ë, ku Kosova bëhet pjesë e sistemit kushtetues të Serbisë, por edhe element konstituiv i Federatës jugosllave.

Në vitet ’50-ta të shekullit XX, një rrymë e fortë e aparatit shtetëror, udhëhequr nga famëkeqi Aleksandër Ranković, fillon të ushtrojë një terror të vërtetë kundër shqiptarëve, meqenëse shqiptarët konsideroheshin dhe trajtoheshin si “element i pabesueshëm”¹⁶

Përgjimi i kryetarit të RSFJ-së Josip Broz Tito, dhuna dhe devijimet e mëdha të Sigurimit Shtetëror të Jugosllavisë dhe të atij të Serbisë, posaqerisht ndaj shqiptarëve sjellin deri të mbajtja e të ashtuquajturit “Plenumi i Brionëve”, me ç’rast shkarkohet Aleksandar Ranković¹⁷, dhe nis një proces i një demokratizimi të vogël i natyrës socialiste. Pak kohë pas Plenumit të Brionëve¹⁸, fillojnë ndryshimet kushtetuese, të njohura si amandamentet kushtetuese, të cilat finalizohen me

¹⁵ Slavko Gaber dhe Tonci Kuzmanić, *Kosovo-Srbija-Jugoslavija* (Lubjanë: Krt 1989), fq. 71-72.

¹⁶ Perović, Latinka. *Zatvaranje kruga-ishod rascepa 1971-1972*. Svjetlost., Sarajevo 1991. Fq. 41.

¹⁷ Aleksandar Ranković ishte një nga 3 personalitet më më ndikim në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore., shef i shërbimit të sigurimit shtetëror jugosllav e njohur si OZNA. Ranković ishte ministër i policisë jugosllave dhe nënkryetar i RSFJ-së. Mbi të gjitha tek populli serb Aleksandar Ranković konsiderohet si ikonë e nacionalizmit serb ndërsa tek shqiptarë e Kosovës si personaliteti dhe armiku më famëkeq i tyre

¹⁸ Arkivi i Jugosllavisë, seria e dokumenteve “Burimet për historinë e Jugosllavisë”. Në Mbledhjen e Katërt të Komitetit Qëndror të PKJ të njohur si “Plenumi i Brionëve” i cili është mbajtur me 01 korrik 1966 sipas vendit të mbajtjes Aleksandar Ranković u shkarkuar nga pozita e Nënkrëtarit të Jugosllavisë dhe ai u përjashtua nga Partia Komuniste.

Kushtetutën e vitit 1974, kur Kosova fitoi një entitet të fortë juridik, si element konstituiv i Federatës Jugosllave, dhe në një mënyrë apo formë me përgjegjësi dhe kompetenca u avansua në nivel të barabartë me republikat tjera, dhe njëkohësisht u zbehen lidhjet e saja me Serbinë.

Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës¹⁹ e 27 shkurtit 1974, në nenin 1 të saj, e definonte Kosovën si bashkësi shoqërore politike, por me lidhje hibride politiko-juridike, ku thotë se Kosova është në kuadër të Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Kjo kushtetutë mundësoi pjesëmarrjen e shqiptarëve në organet më të larta të administratës e të pushtetit ekzekutiv. U formua Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria dhe Avokati Shoqëror etj.

Në vitin 1981, konkretisht me 11 mars filluan demonstratat e studentëve shqiptarë të Kosovës, kinse për kushte më të mira, por më vonë këto demonstrata eskaluan në kërkesën bazike për Kosovën Republikë e barabartë me të gjitha republikat tjera jugosllave. Në këto demonstrata, sipas versionit zyrtar, u vranë 9 demonstrues dhe 15 u plagosën²⁰ dhe u burgosën qindra e mijëra nxënës, studentë, punëtorë, fshatarë, intelektualë etj. Demonstrat e tilla të popullit të Kosovës vazhduan në kontinuitet deri sa filloi lufta në Kosovë në vitin 1998.

Ndërmjet viteve 1981-1990, në Kosovë për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata gjithpopullore me kërkesën Kosova Republikë dhe kundërshtimin e suprimimit të autonomisë së Kosovës janë burgosur dhe dënuar, mbi baza denoncimesh dhe akuzash politike, **3.348** veta. Vetëm në ditën kur Serbia, arriti ta bëj suprimimin e autonomisë së Kosovë përmes zyrtarizimit të ndryshimeve kushtetuese të Serbisë, me 28 mars 1989, sipas të dhënave zyrtare policore janë vrarë 22 shqiptarë., ndërsa sipas të dhënave të publikuara nga “Amnesty International” gjatë kësaj dite janë vrarë mbi 140 shqiptarë, janë plagosur disa qindra sosh, e mbi 900 të tjerë janë burgosur e denuar me procedurë të shpejt²¹.

Poashtu, vrasje dhe burgosje të shumta kishte edhe në ushtrinë jugosllave (APJ) gjatë shërbimit ushtarak të shqiptarëve. Në burgjet ushtarake janë prangosur **1.100** ushtarë dhe oficer shqiptarë, pastaj janë vrarë **63** ushtarë shqiptarë²². Brenda këtyre viteve kanë qenë hapur dosjet për qindra mijëra qytetarë shqiptarë. Sipas një të dhëne zyrtare, e paraqitur në Kuvendin

¹⁹ Shih Kushtetutën e Krahinës Autonome të Kosovës të vitit 1974

²⁰ Isak Sherifi. *Tema e doktoratës me titull “Zhvillimet politiko-diplomatike në ish-Jugosllavi me theks të veçantë Kosova dhe Maqedonia 1981-2008”*

²¹ Amnesty International Yugoslavia. *Police Violence in Kosovo* – London: Plutobooks 2000.fq. 52

²² Mr. Fehmi Ajvazi. *Spastrimi etnik Kosovës.Zemra shqiptare. 19.12.2007*

Federativ në Beograd, nga ish-sekretari i Punëve të Brendshme të Kosovës, Rrahman Morina, nëpër duart e organeve të Sigurimit Shtetëror kanë kaluar **584.273** shqiptarë të Kosovës²³.

Në vitin 1986, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë boton apo publikon²⁴ në gazetën ditore “Večernje Novosti” të datës 24 shtator të vitit 1986, Memorandumin e saj, i cili do të bëhet program dhe platformë drejtuese e politikës zyrtare të Qeverisë së Serbisë, për mbizotërimin e saj në Jugosllavi, dhe ndrrimin e statusit juridik dhe politik të Kosovës në Kushtetutat e Jugosllavisë dhe të asaj të Kosovës të vitit 1974.

Memorandumi i Akademisë të Shkencave dhe Arteve të Serbisë në thelbin e vet pasqyron “vajtimin për Kosovën” gjegjësisht kritiken e hapur drejtuar kryetarit të Jugosllavisë Josip Broz Titos e cila sipas Akademisë Serbe ka pasur qëllim dobësimin e Serbisë në raport me republikat tjera të Jugosllavisë²⁵. Prandaj sipas këtij Memorandumi, Serbia, ka të drejtë të veprojë në mbrojtjen e popullit serb që aktualisht jetojnë jashtë Serbisë e në veçanti të serbëve në Kosovë²⁶.

Në Memorandum demonstratat e Shqiptarëve në Kosovë të vitit 1981, emertohen si agresion neo-fashist, duke e potencuar se në “Kosovë e Metohi” shqiptarët po zbatojnë: gjenocid fizik, politik dhe juridik ndaj popullatës serbe.²⁷ Përpjekjet serbe për jetësimin e këtij memorandumi rezultuan me luftërat dhe masakrat më të mëdha ndaj njerëzimit pas Luftës së Dytë Botërore. Serbia inicioi dhe filloi luftën në Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe në Kosovë. Duke u bazuar në këtë Memorandum të Serbisë, në shtator të vitit 1987, në Plenumin e VIII-të të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë, Slobodan Millosheviqi promovoi dhe paralajmëroi politikën e tij nacionaliste me sloganin bazë “Serbia od tri dela mora biti cela”²⁸ gjegjësisht i përkthyer në shqip “Serbia e ndarë në tri pjesë duhet të bëhet e plotë” që nënkuptonte se Kosovës dhe Vojvodinës do t’i hiqet atributi i elementit konstituiv të Jugosllavisë.

²³ Kosovo-Srbija-Jugoslavija. Univerzitetna Konferenca - Knjizna zbirka Krt 46. Ljubljana, maj 1989, fq. 66.

²⁴ Gazeta ditore **Večernje novosti** në dy vazhdimë, 24. dhe 25. shtator 1986.

²⁵ Shih “Memorandumin e parë të SANU (Akademisë të Shkencave dhe Arteve të Serbisë) të vitit 1986.

Në vitin 2012 kjo Akademi e ka hartuar edhe një Memorandum tjetër me aspirate të njejta.

²⁶ Judah, Tim. Kosovo, what everyone needs to know. Oxford University Press, 2008, fq. 61-63

²⁷ Shih “Memorandumin e parë të SANU (Akademisë të Shkencave dhe Arteve të Serbisë) të vitit 1986.

²⁸ Lora Silber –korospondente e Finansiell Times për Ballkanin & Alan Litel, korospondent i radio televizionit BBC *Smrt Jugoslavije (vdekja e Jugosllavisë)*. Otokar Kersovani, Rijeka-Kroaci, 1996, fq. 52

Duke e parë populli i Kosovës se politika ekspansioniste, tani publike e Serbisë po merr përmasa të rrezikshme për Kosovën dhe jo vetëm për te, në vitin 1988, organizohen demonstrata gjithpopullore të shqiptarëve të Kosovës kundër politikës serbe për ndryshimet e amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974, e cila e përcaktonte Kosovën si element konstituiv i Federatës Jugosllave e barabart me republikat tjera të Jugosllavisë. Pikënisje e këtij kundërshtimi ndaj tendencave të Serbisë ishte “Marshi” (ecja) i organizuar me 17 nëntor 1988, i minatorëve të “Trepçës”, të cilët u organizuan dhe nga Mitrovica u drejtuan drejt Prishtinës për të kundërshtuar vendimin arbitrar të Serbisë për shpartallimin e udhëheqësisë së Partisë Komuniste të Kosovës²⁹. Këtij marshi të minatorëve iu bashkëngjiten më se gjysmë milioni shqiptarë, me qëllim të mbrojtjes së suprimimit të autonomisë së Kosovës sipas Kushtetutës të vitit 1974, me të cilën Kosova ishte element konstituiv e Federatës jugosllave, që këmbëngulte dhe proklamonte Serbia, se kjo do të ndodhë me çdo kusht.

Me 20 – 27 shkurt të vitit 1989, minatorët e Trepçës (Stan Trgut në Mitrovicë) prap kaluan në veprim, nisën grevën e tyre. Kjo grevë paralajmroi botën për rrezikun e shpërbërjes së Jugosllavisë (RSFJ-së) dhe njëkohësisht dergoi një mesazh opinionit dhe diplomacisë ndërkombëtare për nevojën e një çasjeje më serioze dhe më përmbajtësore ndaj këtij problemi që rrezikonte stabilitetin dhe sigurinë e tërë regjionit, çka në vitet në vijim edhe u konfirmua.. Gjatë kësaj greve, jeta në Kosovë është ndalur, të gjitha shkollat, fabrikat etj, u solidarizuan me minatorët dhe hynë në grevë gjithpopullore në objektet e tyre...

Serbia, për shkak të gjendjes së krijuar në Kosovë si shkak i grevës së minatorëve, kërkonte nga Kryesia e Federatës së Jugosllavisë që të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, se sipas Kushtetutës jugosllave dhe të asaj të Kosovës të vitit 1974, këtë të drejtë Serbia nuk e posedonte edhe pse e konsideronte Kosovën pjesë të saj.

Situata e krijuar në Kosovë me hyrjen në grevë të minatorëve dhe pothuaj të gjithë pjesës tjetër të popullit, rrezikonte seriozisht konfliktin e armatosur në Kosovë... Kjo situatë detyroi apo obligoi pothuaj përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të Sllovenisë që të organizojnë një tubim përkrahjeje të minatorëve shqiptarë. në Ljubljana në objektin e njohur si ‘Cankarjev dom’. Joze Skoljc, udhëheqësi i atëhershëm i rinisë së Sllovenisë, në tubimin përkrahës në fjalë, ka thënë: “Shqiptarët në Jugosllavi janë në pozicione të njehta sikurse Jevrejët në Luftën e Dytë

²⁹ Lora Silber –korrespondente e Finansiell Times për Ballkanin & Alan Lital, korrespondent i radio televizionit BBC *Smrt Jugoslavije (vdekja e Jugosllavisë)*. Otokar Kersovani, Rijeka-Kroaci, 1996, fq. 51

Botërore”, ndërsa kryetari i Lidhjes Komuniste të Sllovenisë z. Milan Kučan deklaroi se “Jugosllavija po mbrohet në minierën “Trepça”³⁰

I gjithë ky rrugëtim i Kosovës drejt mbrojtjes dhe avansimit të statusit dhe të drejtave nacionale të popullatës së saj, i pasqyruar më lart në mënyrë kronologjike nuk ishte temë shqyrtimi e as shqetësimi serioz, pothuaj nga asnjë institucioni relevant ndërkombëtar.

Gjatë tërë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, bashkësia ndërkombëtare, Kosovën e cilësonte dhe e trajtonte vetëm si problem i të drejtave të njeriut dhe i’a mohonte të drejten e vetëvendosjes në dallim prej republikave në Jugosllavi, edhe pse edhe ato si Kosova kishin statusin e elementit konstituiv të Federatës Jugosllave.

Poashtu, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të materialit, m’u imponua se element i domosdoshëm për shtjellim duhet të jetë medoemos edhe Greva e urisë së minatorëve të Stan Trgut, të cilët kërkonin një çasjeje më ndryshe të faktorit ndërkombëtar ndaj çështjes së Kosovës.

Greva e urisë së minatorëve të Stan-Tërgut të datës 20-28 shkurtit 1989, e cila, jo vetëm se bashkoi si kurrë më parë popullin e Kosovës, por njëkohësisht i dërgoi edhe mesazh alarmues gjithë botës demokratike, se Serbia në Kosovë po zbaton një politikë ndëshkuese me përmasa dhe formë të një gjenocidi klasik. Ky mesazh, praktikisht dhe simbolikisht, u përhap nga Horizonti i 13-të, (në thellësinë prej 800 m.) i minierës “Trepça”. Mesazhi proklamonte se në Kosovë po mbrohen demokracia dhe humanizmi si vlera të qytetërimit botëror.

Greva e Minatorëve të Kosovës, bëri jehonë në tërë botën. Për pasqyrimin e kësaj greve në Kosovë erdhën më shumë se 400 gazetarë nga vende dhe shtete të ndryshme të botës³¹. Njëkohësisht, kjo grevë u shfrytëzua nga republikat e tjera të Jugosllavisë së AVNOJ-it që të rishqyrtojnë dhe të mbrojnë statusin dhe pozitën e tyre juridiko-kushtetuese në kuadër të RSFJ-së³².

Në këtë drejtim, jehonë të veçantë kishte fjalimi i njohur i Milan Kuçanit, ish-kryetar i Lidhjes Komuniste të Sllovenisë, i mbajtur më 27 shkurt 1989, në tubimin e lartcekur në Cankarjev Dom të Lubjanës, ku ai përkrahu minatorët e “Trepçës”. Mes të tjerash, Milan Kučan, në pronosimin e tij, tha: “Atje (në Kosovë, vër, e autorit) po mbrohet Jugosllavia e AVNOJ-it”³³.

³⁰ Lora Silber –korrespondente e Financier Times për Ballkanin & Alan Lital, korrespondent i radio televizionit BBC *Smrt Jugoslavije (vdekja e Jugosllavisë)*. Otokar Kersovani, Rijeka-Kroaci, 1996, fq. 51

³¹ Haziri, Mustafë, *Greva e minatorëve të “Trepçës”*, botoi lidhja e historianëve të Kosovës “Ali Hadri”, 2011.

³² Buxhovi, Jusuf, *Kthesa historike-Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LDK-së*, SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2008.

³³ “Naša Borba”, 28 shkurt 1989, Beograd., nga ballina, “Rilindja”, Prishtinë, 28 shkurt 1989.

Kjo grevë kishte edhe një veçanti tjetër, sepse po në atë grevë, në Horizontin e Tetë të minierës, u apelua te populli se në interes kombëtar të ndërpritet gjakmarrja dhe të falen të gjitha gjaqet e deri atëhershme, meqenëse gjakmarrja ishte pengesë mjaft domethënëse për fuqizimin e unitetit kombëtar, i cili ishte domosdoshëm në ato rrethana për sensibilizimin dhe realizimin e synimeve të popullit të Kosovës.

Shkak i këtij apeli ishte fakti se në mesin e minatorëve pjesëmarrës në grevë ishin edhe dy minatorë-grevistë, të cilët i kishin familjet në gjak dhe interesi i përbashkët kombëtar e njerëzor i kishte bashkuar në një qëllim dhe për një qëllim³⁴.

Këtë apel të tyre, pas disa muajve (2 shkurt 1990), e shndërruan në iniciativë dhe veprim disa studentë nga Peja (Have Shala, Brahim Dreshaj, Adem Grabovci, Lulëzim Etemaj, Myrvete Dreshaj, Ethem Ceku, Flamur Gashi etj.)³⁵. Ky aksion luajti rol të veçantë në unitetin dhe ngritjen e vetëdijes së përgjithshme intelektuale dhe kombëtare. Gjatë këtij aksioni, u falën mbi 1000 gjaqe³⁶. Të gjithë këtë storie po e paraqes me qëllim të pasqyrimin të rolit dhe ndikimit të kësaj greve në unifikimin e të gjithë spektrit politik dhe jo politik të Kosovës.

Pluralizmi politik në Jugosllavi u paraqit në fund të vitit 1988, me vendim të KQ të LKJ-së, ndërsa në Kosovë, kjo u bë tek pas qëndrimit të Kongresit të Partisë Komuniste të Serbisë, të mbajtur në nëntor 1989, në të cilin është marrë vendimi që Partia Komuniste nuk ka arsye dhe nuk dëshiron që administrativisht të vështirësojë formimin e partive politike³⁷. Me këtë u mundësua të formohen partitë politike edhe në Kosovë.

Subjekti i parë i formuar plural në Jugosllavi ishte UJDI (Iniciativa Demokratike e Bashkuar Jugosllave), e cila u formua në shkurt të vitit 1989, me tendencë të kundërvimit të nacionalizmit serb dhe të ristrukturimit të Jugosllavisë mbi bazat e pluralizmit politik dhe të pluralizmit të interesave³⁸. Pas një muaji, dega e kësaj partie u formua edhe në Kosovë, në krye me Veton Surroin, Shkëlzen Maliqin dhe me afro pesëdhjetë të tjerë, të cilët ishin pjesëmarrës në Kuvendin themelues të kësaj partie projugosllave.

Më pastaj, u formua edhe Lidhja e Forcave Reformiste Jugosllave (Savez Reformskih Snaga Jugoslavije), të cilën e ka udhëhequr kryetari i atëhershëm i Këshillit Ekzekutiv të Jugosllavisë, Ante Marković. Kjo parti është angazhuar për reforma ekonomike dhe politike, dhe

³⁴ Pushkolli Fehmi, *Mbrojtja Kombëtare Shqiptare 1878-1990*, Zëri i Rinisë, Prishtinë, 1991, fq.176.

³⁵ Çetta, Anton, *Pajtimi i gjaqeve*, SHB "ERA", Prishtinë, 2001. fq. 3.

³⁶ Krasniqi, Riza, *Emisioni monitor*, TV Dukagjini, 4 maj 2009, ora 20:10.

³⁷ Revista "Komunist", 22. 11. 1989.

³⁸ Kraja, Mehmet. *Vitet e humbura*. Rozafa Prishtinë, 2003. Fq.186.

ishte subjekti që u përkrah pa rezervë nga pothuaj i gjithë faktori ndërkombëtar..

Ndërsa në Kosovë, sipas akterëve kryesorë të themelimit e shoqatave të para të pavarura të qytetarëve, idetë e para për themelimin e këtyre organizatave kanë qenë insistimet e gazetarëve apo njerëzve të tjerë nga jashtë, të cilët sugjeronin se me suprimimin e të gjitha institucioneve të Kosovës nga Serbia të formohen shoqatat e pavarura të qytetarëve, të cilat do t'i përfaqësojnë dhe do të mbrojnë interesat e popullit të Kosovës.

Në këtë drejtim, sqarime më të hollësishme jep shkrimtari dhe njëri ndër themeluesit e LDK-së, z. Jusuf Buxhovi, i cili në librin e tij “Kthesa historike”, përkujton ato kohëra: “Me rastin e ardhjes në Prishtinë, diku nga mesi i majit, Horst Wesler, njëri nga redaktorët përgjegjës të radios “Westdeutsche Rundfunk”, i sugjeroi Jusuf Buxhovit që sa më parë Kosova të formojë një Këshill për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut³⁹.

Horst Wesler, e mësoi Buxhovin se me anë të këtij këshilli ndihmohet që rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut të mos mbesin të pashënuara, por njëherësh me anën e tyre krijohet një mekanizëm i ligjshëm trysnie ndaj pushtetit, që të marrë në mbrojtje qytetarët. Po ashtu, krijohet mundësia që faktori ndërkombëtar të këtë të dhëna të verifikuara rreth asaj se çfarë po ngjan në Kosovë, pa lejuar që ato nga regjimi serb të kamufloheshin⁴⁰.

Po ashtu, edhe sugjerimi për themelimin e partisë politike, sipas Jusuf Buxhovit, njërit nga ideatorët dhe themeluesit të subjektit të parë “politik” në Kosovë, të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) u takon intelektualëve nga jashtë. Sipas Buxhovit, “rreth kësaj çështjeje më kishin sfiduar gazetarët gjerman Viktor Majer dhe Horst Wesler, ndërkohë që ky i fundit kishte sjell edhe një sygherim personal të ministrit të jashtëm gjerman Hans Dietrich Gensher, që sa më parë t’ia fillonim organizimit partiak mbi bazat e pluralizmit politik⁴¹”.

Sipas Majerit, partia politike ua krijon legjitimitetin e veprimit. Ajo ju mbron, ajo ju siguron një adresë për gazetarët e huaj, për diplomatët, për misionarët e ndryshëm që mund ta ndihmojnë Kosovën. Rruga legale është e hapur dhe njëherësh është e mundimshme, por me qartësi, dhe ç’është më e rëndësishme, me anën e saj pasqyroni kërkesat tuaja brenda dhe jashtë, pa ndodhur që të manipulohen a të shtrembërohen nga Beogradi dhe propaganda e tij shumë

³⁹ Buxhovi, Jusuf, *Kthesa historike*, SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2008, fq. 165.

⁴⁰ Po aty, fq. 165.

⁴¹ Po aty, fq. 178.

perfide dhe e përgatitur për shumëçka. Ai, po ashtu sugjeroi që të mos lejohet që Beogradi të flasë në emrin e Kosovës, sepse kjo do të ishte më fatale, sesa marrja e autonomisë me dhunë⁴². Valët politike, po që se dëshirojnë të jenë të pëlqyeshme dhe të pranueshme, ato nuk mund të jenë pa pjesëmarrjen direkte a indirekte të faktorit amerikan.

Rrëfimet e akterëve kryesorë të këtyre ngjarjeve tani tregojnë angazhimin e SHBA-ve në çështjet që ato i vlerësojnë si interes të vet. Kjo më së miri pasqyrohet me angazhimin e tyre për zgjedhjen e kryetarit të një partie, që në shikim të parë askush nuk e kupton çfarë i duhet kjo SHBA-së.

Shpërbërja e Lidhjes Komuniste të Kosovës u bë brenda një kohe shumë të shkurtër. Të pakënaqur me situatën e rëndë në Kosovë, nën trusninë e presionit dhe të represionit serb dhe të bindur se një pjesë e madhe e fatkeqësive kishte ardhur nga vete Partia Komuniste, anëtarët e Lidhjes Komuniste të Kosovës me shpejtësi braktisën partinë.

Idetë për formimin e partive të para politike u zhvilluan brenda dhe jashtë Kosovës dhe shtytja për këtë po ekzistonte nga brenda dhe nga jashtë. Kështu, bazuar në sugjerime nga miq të shumtë, një grup i vogël shkrimtarësh dhe intelektualësh në përbërje: Jusuf Buxhovi, Ibrahim Berisha, Mehmet Kraja dhe Xhemal Mustafa kishin biseduar disa herë kishin biseduar duke pirë kafe në kafeterinë “Elida” në Prishtinë, “kishin zënë ngojë çështjen e formimit të një partie politike, meqë tashmë ekzistonin edhe kushtet ligjore për të⁴³”. Dhe kështu, pasqyrohet nisma e themelimit të Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK). Kështu, me 23 dhjetor 1989, në Kuvendin Themeluës, u zgjodh kryesia, në këtë përbërje: Ibrahim Rugova, kryetar, Jusuf Buxhovi, sekretar, Fehmi Agani, Nekibe Kelmendi, Ali Aliu, Bujar Bukoshi dhe Mehmet Kraja, anëtarë⁴⁴. Pas mbledhjes themeluese, anëtarësimi në LDK fillon më 4 janar të vitit 1990.

Numri i anëtarëve të LDK-së fillon të rritet me shpejtësi të paparë, shkaqet e së cilës është lehtë të kuptohen. Ka ndodhur që numri i anëtarëve të rinj të kapë shifrën, prej “dhjetë mijë fletëregjistrime brenda ditës⁴⁵”.

Sipas një shënimi zyrtar të LDK-së, kjo parti, e cila në vitet e para të themelimit të saj konsiderohej dhe pranohej si lëvizje e përgjithshme e popullit të Kosovës, numëronte më se 700.000 anëtarë. Më pastaj, njëra pas tjetrës, u formuan një mori partishë politike, shoqata etj., si

⁴² Buxhovi, Jusuf, Vep. e cit., fq. 167.

⁴³ Buxhovi, Jusuf, *Kthesa historike*, SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2008, fq. 177.

⁴⁴ Kraja, Mehmet. *Vitet e humbura*. Rozafa Prishtinë, 2003. Fq. 193.

⁴⁵ Kraja, Mehmet, *Vitet e humbura*, SHB “Rozafa”, Prishtinë, 2003. fq. 213.

Partia Parlamentare, Partia Republikane⁴⁶, Partia Fshatare, Partia Socialdemokrate, Partia Demokristiane etj.⁴⁷.

Krijimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës ishte vërtet lajm, jo vetëm për Kosovën por edhe për pothuaj të gjitha agjencitë e rëndësishme në Evropë dhe në SHBA.

Gazetari i njohur Bajner, në një shkrim në “Uashington Post”, të botuar në fillim të janarit 1990, themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës do t’i atribuojë mesazhit që vinte nga shqiptarët e Kosovës për Perëndimin, që t’u ndihmonte që të ktheheshin ku e kishin vendi⁴⁸.

Programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, qysh të hënën, pra, më 25 dhjetor 1989, iu dërgua, ashtu siç e kërkonte ligji, organeve policore krahinore e gjykatës (që të bëhej regjistrimi në regjistrin e shoqatave të pavarura, ani pse në vend atëherë ende nuk kishte ligj federativ për partitë politike, pastaj Ambasadës së SHBA-ve në Beograd, Ambasadës së Anglisë në Beograd, Ambasadës së Gjermanisë në Beograd, si dhe Ambasadës së Francës në Beograd⁴⁹.

Edhe pse LDK, është konsideruar dhe konsiderohet si partia më emblematike në historinë e Kosovës, ajo sipas programit të saj nuk ishte parti, por shoqatë dhe këtë e dokumenton programi i saj, me të cilën është regjistruar e në të cilën shkruhet: “Ne të nënshkruarit, morëm nismën që të themelojmë: Lidhjen Demokratike të Kosovës, si shoqatë për veprim shoqëror – politik e kulturor të të gjithë atyre që aprovojnë orientimet programore të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe intencat e saj... sipas programit të tyre LDK angazhohet për Jugosllavinë demokratike, federative dhe për reformën e sistemit politik në këtë drejtim⁵⁰”.

Pa marrë parasysh përcaktimet e saja programore, themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës shënon një kthesë të madhe në orientimin e lëvizjes shqiptare të Kosovës, por edhe të lëvizjes shqiptare në Jugosllavi si forcë që është mbështetur në fuqinë e popullit e jo të lidershit apo anëtarësisë së saj, meqenëse përcaktimet programore të themeluesëve dhe lidershit të saj ishin stereotipe dhe të tejkaluara në kohë e hapësirë... Mirëpo, populli e posaqerisht diaspora shqiptare kësaj shoqate i’a dha atributin e një Levizjeje politike që e ka bërë unifikimin më të madh ndonjëherë në historinë e popullit shqiptarë për realizimin e synimeve të saja kombëtare.

⁴⁶ Partia Republikane e Kosovës, është themeluar dhe drejtuar nga autori i këtij punimi (Reshat Nurboja) për 8 vite 1990 - 1998

⁴⁷ Po aty, fq. 211-213

⁴⁸ Buxhovi, Jusuf, *Kthesa Historike* SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2008, fq. 232.

⁴⁹ http://sq.wikipedia.org/wiki/Historia_e_LDK-së C3%AB (qasur më 17. 2. 2015)

⁵⁰ Buxhovi, Jusuf, *Kthesa Historike* SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2008, fq. 212.

Edhe nga vet disa themelues të LDK-së, pranohet se “ Programi ishte i mbushur me fraza, me periudha të gjata e konfuze, pra një tekst i shkruar pa sintaksë shqip dhe pa mendim të qartë politik⁵¹...Ishte pra një program i dobët dhe ndoshta mirë pse ishte i tillë dhe mirë pse u miratua në Kuvendin Themelues, sepse në të kundërtën, as policia nuk do të na linte të mbanim kuvendin, as partia nuk do të mund të regjistrohej...Programi i partisë, megjithatë mbeti i dobët, jashtëzakonisht i dobët, me siguri programi më i dobët ndër të gjitha partitë që asokohe u themeluan në mbarë Jugosllavinë dhe sigurisht më i dobëti ndër programet e tjera politike, që më vonë u themeluan në Kosovë⁵²”. Po e potencoj programin e LDK-së, për ta pasqyruar edhe përkrahjen dhe çasjen e diplomacisë ndërkombëtare ndaj këtij subjekti “politik” dhe të Kosovës...

Kryetari i LDK-së dr. Ibrahim Rugova shumë shpejt merr rolin e një prijësi karizmatik shqiptar, duke gëzuar përkrahje pa rezervë pothuaj nga tërë faktori vendor e ai ndërkombëtar. Presidenti Rugova ishte për shqiptarët, sikurse Arafati për palestinezët. Objektivat e tija zhvilloheshin nga autonomia reale, përmes Republikës së Kosovës deri te pavarësia e plotë⁵³.

Roli i LDK-së, si parti politike, por edhe si lëvizje nacionale, ka rëndësi shumë të çmuar për një periudhë të vështirë, nëpër të cilën ka kaluar populli shqiptar i Kosovës dhe shqiptarët në Jugosllavi. Kjo parti politike rrënon tërësisht Lidhjen Komuniste të Kosovës dhe, në fazën e shkatërrimit të sistemit jugosllav, LDK-ja arrin të krijojë jetën paralele në Kosovë duke e anashkaluar tërësisht pushtetin e instaluar serb. Është kjo parti dhe aktivistët e saj që kontribuojnë në punimet e Kuvendit të Kosovës (që shpërbëhet nga Parlamenti i Serbisë në mënyrë kundërkushtetuese), kuvend ky që shpall Deklaratën e 2 Korrikut⁵⁴. Pastaj aktivistët e kësaj partie ndikuan direkt në shpalljen e Kushtetutës së Kaçanikut me 7 shtator 1990.

“Në shtator 1991, një referendum i “fsheht” mbarëpopullor në Kosovë miratoi pavarësinë me “po”-në e 87.01% të votuesve të popullsisë së Kosovës”ëpoashtu në muajin shtator organizuan edhe referendumin si dhe organizuan . Kështu LDK-ja mori përgjegjësinë për të organizuar në tërësi jetën në Kosovë”⁵⁵.

⁵¹ Kraja, Mehmet. *Vitet e humbura*. Rozafa Prishtinë, 2003. Fq.193.

⁵² Po aty.

⁵³ Simić, Predrag, *Kosovska kriza 1995, Put u Rambuje -2000*, SHB “Nea”, Beograd, 2000, fq. 31.

⁵⁴ Obstruksionet e kryetarit të Parlamentit të Kosovës, i cili nuk lejonte që të mblidhej Kuvendi i Kosovës, bënë që parlamentarët shqiptarë, më 2 korrik, të mblidheshin para dyerve të Kuvendit dhe të shpallnin Deklaratën, me të cilën Kosova shpallej e barabartë me njësitë e tjera të ish-Federatës jugosllave.

⁵⁵ Abazi, Enika. *Çështja e Kosovës dhe diplomacia ndërkombëtare 1990-1999: Një konflikt i parashikueshëm*. Qendra e studimeve albanologjike-Instituti i histories. Tiranë, 2013. Fq.196.

Tendencat për hegjemoni dhe supremaci të një populli, të një republike, në një anë, dhe tendencat për demokraci dhe vetëvendosje, në anën tjetër, janë shkaqet themelore që determinuan nismën e procesit të shpërbërjes së Federatës jugosllave, e cila u themelua gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Sipas diplomatit amerikan Warren Zimmermann, ambasador në ish-Jugosllavi, shkaqet e shpërbërjes së Jugosllavisë janë, siç përshkruan ai, se katastrofa e Jugosllavisë nuk ka qenë rezultat kryesisht i armiqësive të vjetra etnike ose fetare, as e shembjes së komunizmit në fund të luftës së ftohtë, madje as edhe e dështimeve të politikës së vendeve perëndimore. Nuk ka dyshim, se këta faktorë i kanë përkeqësuar gjërat. Por, vdekja e Jugosllavisë dhe dhuna që pasoi, janë rezultat i veprimeve të vetëdijshme të udhëheqësve nacionalistë⁵⁶.

Edhe pse kishte të dhëna të konfirmuara se Jugosllavia kishte marrë rrugën e shpërbërjes, megjithatë qëndrimet e diplomacisë ndërkombëtare, përgjithësisht, së paku deklarativisht, ishin në drejtim të ruajtjes së tërësisë territoriale të Jugosllavisë. Pranoreshin ndryshime të brendshme me marrëveshje dhe pranoreshin ndryshimet në sistemin politik, por pothuaj të gjithë, pa përjashtim nga bashkësia ndërkombëtare, deklaroheshin se nuk do të përkrahej separatizmi dhe secesioni i asnjë njësie federative.

Në këtë kuptim, qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare ishin thuaja unike dhe nuk vërehej ndonjë dallim ndërmjet qëndrimeve amerikane dhe atyre evropërore. E rënia e sistemit komunist në ish-BRSH dhe në Evropë, mund të ishte koincidencë në kuptim të rrënimit të Jugosllavisë. Këtu nuk kishim të bënim me tendencë të demokratizimit dhe të ndryshimeve demokratike, sado që edhe këtu Partia Komuniste u shkatërrua në Kongresin XIV⁵⁷.

Përkundrazi, të gjithë nacionalistët e kombeve të ndryshme jugosllave, vepronin dhe planifikonin që shkatërrimi i Jugosllavisë pikënisje ta ketë Kosovën, por rrjedhat globale politike, konkretisht rrënimi i Murit të Berlinit, me 9 nëntor 1989, dhe këto ndryshime në një masë fillojnë të ndryshojnë qasjen, në radhë të parë të diplomacisë amerikane ndaj proceseve brenda Jugosllavisë, të cilat po paralajmëronin fillimin e tragjedisë. Poashtu, rrënimi i Murit të Berlinit dhe i Bashkimit Sovjetik mundësuan dominimin absolut global të SHBA-ve në botë.

⁵⁶ Zimmermann, Warren, Burimet e një katastrofe, shtëpia botuese Besa, Tiranë, 1996, nga parathënia.

⁵⁷ Arkivi i Jugosllavisë, seria e dokumenteve "Burimet për historinë e Jugosllavisë". Kongresi XIV i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, u mbajt me 20-22 janar 1990 në Beograd, ku delegacionet sllovene dhe kroate i braktisën punimet, meqenëse është refuzuar propozimi slloven (Borut Pahor) që Deklarata dhe Statuti i LKJ-së të mos miratohen me mbivotim.

Ky ndryshim i raporteve të forcave në nivel global determinonte nevojën për reredefinimin e supozimeve mos të them planifikimeve në të cilat është mbështetur politika e SHBA-ve gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.

Serbia dhe politika serbe ishin shprehur thuaja krejtësisht qartazi se qëllimi i tyre dallonte nga të tjerët, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Qëllimi serb ishte krijimi i “Serbisë së Madhe” dhe marrja e territoreve nga pothuaj të gjitha republikat e tjera, ku jetonin serbët. Krahinat, politikën as që po i bënte hesap.

E gjithë politika serbe po zhvillohej me demagogji dhe me parullën e ruajtjes së cili tentonte që nën parullën e mbrojtjes së Jugosllavisë, ta kthente atë në një diktaturë të sunduar nga serbët⁵⁸, duke synuar që të gjithë serbët e Jugosllavisë, të cilët jetonin në pesë nga gjashtë republikat e saj, t’i fuste nën autoritetin e Serbisë⁵⁹.

Pavarësisht kësaj, siç u theksua, ruajtja e tërësisë territoriale ishte qëllim i bashkësisë ndërkombëtare e edhe e SHBA-së. Kështu, administrata e Bushit të Vjetër, pothuaj deri në fund të mandatit, besonte se Jugosllavia duhet të jetë e bashkuar, së paku për aq kohë sa kjo mund të bëhet me mjete demokratike⁶⁰. Por ky unitet, së paku deklarativ i bashkësisë ndërkombëtare, karshi ruajtjes së tërësisë territoriale të Jugosllavisë, e kishte fundin e vet.

Nuk do të shkojë gjatë dhe do të kuptohet se tendencat ndërkombëtare për ruajtjen e RSFJ-së ishin të pabazuara dhe të paqëndrueshme, me që shumica e republikave dhe Kosova tani më nuk e shihnin veten në kuadër të Jugosllavisë. Ishte e vështirë të mbahej diçka, që tashmë kishte filluar të marrë kahun e shpërbërjes. Aq më tepër, kur tash kishte filluar edhe merrej jeta e njerëzve. Ndryshimet e dhunshme të Kushtetutës së Kosovës shënuan rrënimin e sistemit kushtetues jugosllav dhe prishën bilancin e vendimmarrjes në organet federative. Në strukturat federative, Serbia, pas këtyre ndryshimeve, siguroi shumicë votash dhe vendimet imponoheshin. Në anën tjetër, ndryshimeve kushtetuese i paraprinë të ashtuquajturat mitingje dhe protesta të serbëve, fillimisht në Kosovë, me tendencë të zgjerimit në gjithë Jugosllavinë.

Me mitingjet, të cilat, për ironi mbanin sloganin “Përkrahje të serbëve dhe të malazezëve”, në Kosovë po përhapej fryma nacionaliste serbe, e cila po shënonte një unitet popullor serb nën flamurin e urrejtjes ndaj të tjerëve, në veçanti ndaj shqiptarëve. Këto mitingje,

⁵⁸ Zimmermann, Warren, *Burimet e një katastrofe*, SHB “Besa”, Tiranë, 1996, nga parathënia.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Po aty.

të cilat më vonë morën emrin “Jogurt Revolucionari”⁶¹, krijuan klimë përçarëse, frikë, urrejtje ndaj të tjerëve dhe ngjallën krijimin e mekanizmave mbrojtjes të gjithë popujt dhe të gjitha njësitë e ish- Federatës jugosllave.

Me fillimin e shkatërrimit të Jugosllavisë, për shkak të tentimit të dominimit të Serbisë mbi sistemin kushtetues të RSFJ-së, detyrimisht u iniciuan veprimet mbrojtëse të entiteteve të tjera brenda këtij shteti. Logjikisht, Kroacia dhe Sllovenia kërkonin revidimin e Kushtetutës jugosllave të vitit 1974, në mënyrë që të forconin garancitë për pozitat e tyre⁶².

Procesi i shkatërrimit praktik i Jugosllavisë nisi me shpalljen e pavarësisë së Sllovenisë, në qershor të vitit 1991, i cili veprim u shoqërua me një luftë dhjetëditëshe⁶³ të Njërive të Mbrojtjes Territoriale të Sllovenisë kundër Ushtrisë së Jugosllavisë (JNA). Dhe, këtu, në esencë, fillon më në fund edhe luhata, vërtet edhe fundi i përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për ruajtjen e Federatës jugosllave. Kështu, me 26 mars 1991, Këshilli Evropian miratoi një deklaratë zyrtare, me të cilën përkrah unitetin territorial dhe duke tërhequr vëmendjen kundër përdorimit të forcës⁶⁴, duke tentuar që këtë qëndrim të BE-së t’ia përcjellë Jugosllavisë.

Më 30 qershor, ministrat e Jashtëm të KE-së (De Mikelis i Italisë, përfaqësuesi i Luksemburgut, z. Pos dhe Van der Bruk i Holandës⁶⁵), u mbledhën në Beograd dhe, duke iu kërcënuar Presidencës jugosllave, në emër të Këshillit të Evropës, kërkuar që t’i përmbahen Kushtetutës federative dhe të lejohet që kroati Stipe Mesiq të vendosej president i Kryesisë së RSFJ-së, që pengohet nga Serbia dhe Mali i Zi. Por, është e njohur e përgjithshme se kjo marrëveshje zgjati vetëm disa orë dhe kështu RSFJ mori drejtimin përfundimtar të shpërbërjes.

Tentimet për ruajtjen e Jugosllavisë pos diplomacisë ndërkombëtare kishte edhe nga vet përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe të gjashtë republikave të RSFJ-së. Por kishte dallime të pakalueshme në mes të koncepteve të rregullimit shtetëror të kësaj Jugosllavie. Deri sa Sllovenia dhe Kroacia insistonin në formimin e një konfederate të shteteve të pavarura, Serbia me Slobodan Millosheviqin në krye këmbëngulte në ruajtjen e centralizimin e federatës

⁶¹ Jogurt revolucionari emërtohet lëvizja, kur në Novi-Sad udhëheqësit legalë të Vojvodinës u detyruan të dorëhiqeshin, sespe nga masat e tërbuara qëllorshin me jogurt.

⁶² Weller, Marc. *Shtetësia e kontestuar*, “KOHA”, Prishtinë, 2009, fq. 93.

⁶³ Buja, Ramë, *Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë*.

⁶⁴ Deklarata për bashkëpunimin joformal politik evropian-Mbledhja ministrore për Jugosllavinë, Chateau de Sennigen, 26 mars 1991, fq. 4b e 61.

⁶⁵ Weller, Marc, *Shtetësia e kontestuar*, “KOHA”, Prishtinë, 2009, fq. 94.

ekzistuese. Por që nga fillimi ishte e qartë se nuk do të arrihej asnjë marrëveshje në këtë drejtim edhe nga vet shkakut se tani më Sllovenia dhe Kroacia kishin vendosur të mos jenë më pjesë e çfarëdo forme të ekzistimit të Jugosllavisë, sepse ato vetëm i kishin ndërprerë zbatimin e infrastrukturës ligjore të Jugosllavisë brenda republikave të tyre.

Me 19 maj 1991, Kroacia organizon referendumin ku 93.2% e qytetarëve votojnë për Kroacinë e Pavarur. Njëkohësisht, popullata serbe në një pjesë të Kroacisë, në Krajinë në referendumin e organizuar nga serbët, 99% të serbëve votojnë që kjo pjesë t'i bashkohet Serbisë. Tani më ishte e qartë se kjo ishte fillimi i fundit të RSFJ-së. Parlamenti i Europës në maj të vitit 1991, miraton Rezolutën ku potencohet se “republikat dhe krahinat autonome të jugosllavisë duhet të gëzojnë të drejtën që në mënyrë të lirshëm dhe demokratike të përcaktohen për të ardhmën e tyre, në bazë të kufijve të pranuar brendshme⁶⁶. Edhe në këtë, fazë të ngjarjeve, Bashkësia Ndërkombëtare ende për çudi, së paku publikisht e përkrahte unitetin e Jugosllavisë.

Në takimin e KEBS(OSCE) në Berlin, me 16 qershor 1991, nga të gjitha 36 shtete anëtare, në mënyrë unanime është përkrahur uniteti i Jugosllavisë, transformimin demokratik të vendit dhe zgjidhjen paqësore të krizës jugosllave. Shtetet anëtare të KEBS – tani OSCE⁶⁷ ende besonin në qëndrueshmërinë dhe ekzistimin e Jugosllavisë. Këtë qëndrim të KEBS-it, sekretari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, James Baker, dëshironte t'ia përcillte në takimin që e kishte me shumë aktorë të rëndësishëm të krizës jugosllave, në Beograd. Në takime maratonike që kanë zgjatur mbi 12 orë, James Baker u takua me Kryeministrin e Jugosllavisë, Ante Marković, me ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Budimir Lončar, si dhe takime të ndara me të gjithë kryetarët e republikave, poashtu edhe me liderin e shqiptarëve Ibrahim Rugovën, me ç'rast iu ka bërë të njohur se bashkësia ndërkombëtare do ta ndihmon Jugosllavinë në transformimin e saj politik dhe ekonomik, po që se këtë e bën me marrëveshje dhe mënyrë paqësore.⁶⁸ Në fund të vizitës së sekretarit shtetëror të SHBA-së, James Baker, u pa qartë se asnjë nga bashkëbiseduesit nuk kishte dëshirë dhe vullnet të ekzistoj Jugosllavia, dhe se lufta dhe shpërbërja e Jugosllavisë është e pashmangshme.

⁶⁶ Gow, James. Deconstructing Yugoslavia”. Survival, vol. 33, - july-august 199, p.308

⁶⁷ KEBS – tani OSCE: Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë

⁶⁸ Baker, James. The politics of diplomacy – revolution, war and peace, 1989-1992. New York: G.P.Puntam's Sons, 1995. p.479.

3.2. Luftërat në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë

Sllovenia

Në fillimin e vitit 1991 kriza jugosllave arrin kulmin e saj. Sllovenia dhe Kroacia ndërpresin zbatimin e ligjeve federative në republikat e tyre. Nga muajo mars filluan njëtori i kryetarëve të 6 republikave të Jugosllavisë që të gjejnë një zgjidhje kompromisi për të ardhmën e federatës Jugosllave. Propozimeve të Kroacisë dhe Sllovenisë për një konfederatë të shteteve sovrane kundërvijë nga kryetari i Serbisë, Slobodan millosheviq i cili ishte për një centralizimin e federatës. Sllovenia, kishte ofruar një afat kohor prej gjashtë muajëve që të gjindet një zgjidhje e pranueshme për të gjithë në të kundërtën do ta shpallë pavarësinë e saj. Meqenëse, nuk u arrit një zgjidhje e pranueshme për të gjithë, edhe për arsye se as Sllovenia e as Kroacia nuk ishte e interesuar të gjindet ajo, meqenëse, paraprakisht Sllovenia me 23 dhjetor 1990 me referendum ishin përcaktuar të jetë shtet i pavarur e poashtu edhe Kroacia me 19 maj 1990 permes referendumit përcaktohet për pavarësi e jo si pjesë e ndonjë Jugosllavie tjetër. Dhe për shkak të shpalljes së pavarësisë nga ana e Sllovenisë me 27 qershor 1991, dy ditë më pas u sulmua nga APJ dhe kështu filloj Lufta dhjetëditëshe në Slloveni e cila ishte rrjedhojë e tendencave sllovene për demokraci dhe pavarësi. Sllovenia ishte republika më e zhvilluar brenda Federatës jugosllave dhe në fakt edhe më e avancuara në kuptim të demokracisë socialiste, në kuptim të zhvillimit të kulturës demokratike, të të drejtave të njeriut etj.

Presionet drejt “Serbisë së Madhe”, së pari në Kosovë dhe pastaj duke kërcënuar edhe pjesët e tjera të Jugosllavisë, bënë që pjesa dërrmuese e elektoratit slloven të votojë për shtetin e pavarur dhe sovran slloven në referendumin e vitit 1990⁶⁹. Sllovenia, në përpjekjet e saj për refuzimin e projektit Serbi e Madhe, merr masa preventive, duke krijuar trupa mbrojtëse që njihen si trupat e mbrojtjes territoriale, të cilat në rast nevojë do të viheshin kundër agresionit të mundshëm, e që ishte në dukje, sepse Armata Popullore e Jugosllavisë ishte e shtrirë në gjithë territorin e Jugosllavisë dhe, në këtë kontekst, ajo ishte edhe brenda Sllovenisë.

Më 28 shtator 1990, në Slloveni u miratua amendamenti kushtetues, sipas të cilit, në situatë të paqes dhe të emergjencave, komanda e Mbrojtjes Territoriale do t’i transferohej

⁶⁹ <http://www.slovenija2001.gov.si/10years/path/qar/> (qasur mw 17. 2. 2015).

Presidencës sllovene. Presidenca, me kryetar Milan Kučanin, në atë kohë dhe gjatë kohës së luftës, menjëherë emëron komandantin e ri të Mbrojtjes Territorial Janez Slapar⁷⁰.

Më 25 qershor të vitit 1991, Kuvendi slloven miraton Ligjin kushtetues për pavarësi. Me këtë ligj, simbolet dhe flamujt jugosllavë hiqen dhe në anën tjetër vendoset kufiri me Kroacinë. Të njëjtën, ditë në Beograd mbledhet Këshilli Ekzekutiv Federativ, i cili nxjerr urdhër për mbrojtjen e kufijve në Slloveni dhe me këtë armata dhe forcat policore jugosllave marrin dritën jeshile për sulme të armatosura kundër Sllovenisë. Sulmet e APJ-së kundër Sllovenisë filluan më 26 qershor 1991. Armata jugosllave ishte në epërsi të madhe ushtarake, qoftë për nga numri i ushtarëve, qoftë për nga armatimi. Gjatë natës, midis të premtës dhe të shtunës (më 28 dhe 29 qershor 1991), përfaqësuesit sllovenë takohen në Zagreb me tre ministra të Punëve të Jashtme të Komunitetit Evropian dhe me kryetarin e Këshillit Ekzekutiv Federativ. Aty arrihet një marrëveshje për ndërprerje të armiqësisë, e cila ishte shumë e paqartë dhe si e tillë edhe kurrë nuk u zbatua⁷¹.

Sllovenia kufijtë e vet i futi nën kontroll më 4 korrik 1991, kurse më 7 korrik 1991, përfaqësuesit e Sllovenisë, përfaqësuesit e RSFJ-së dhe përfaqësuesit e Komunitetit Evropian takohen në ujdhesat Brione. Deklarata e Brioneve krijon moratorium tremujor në pavarësinë sllovene. Megjithatë, forcat e armatosura sllovene mbajtën sovranitetin e plotë ndaj territorit slloven. Si rezultat, Presidenca e RSFJ-së, më 18 korrik 1991, mori vendim për tërheqje të trupave dhe të armëve të APJ-së nga Sllovenia brenda tre muajve, Ndërmjet 25 dhe 26 tetorit, ushtarët e fundit lëshuan portin e Koprit⁷².

Sipas një vlerësimi, APJ-ja kishte 44 të vrarë dhe 146 të plagosur, kurse sllovenët kishin 19 të vrarë dhe 182 të plagosur. Fatmirësisht ky është numër i vogël i viktimave, krahasuar me çka do të shohim në luftërat në vijim. Në Slloveni, lufta pakditëshe me të drejtë trajtohet si fitore ushtarake kundër APJ-së, por ka edhe një të vërtetë që është folur dhe është pranuar gjithandej. Sllovenia si ish-republikë ishte jashtë domenit të interesave të krijimit të “Serbisë së Madhe”. Dhe mendohet se Serbia dhe Milosheviqi, në brendi, ishin pro largimit të Sllovenisë nga Jugosllavia.

Procesi i shkatërrimit praktik të Jugosllavisë nisi me shpalljen e Pavarësisë së Sllovenisë,

⁷⁰ <http://www.slovenija2001.gov.si/10years/path/war/> (qasur mw 17. 2. 2015).

⁷¹ <http://www.slovenija2001.gov.si/10years/path/war/> (qasur mw 17. 2. 2015).

⁷² <http://www.slovenija2001.gov.si/10years/path/war/> (qasur mw 17. 2. 2015).

në qershor të vitit 1991, i cili veprim u shoqërua me një luftë dhjetëditëshe⁷³ të njërive të Mbrotjtjes Territoriale të Sllovenisë kundër Ushtrisë së Jugosllavisë.

Martti Ahtisaari në librin e tij “Detyra në Beograd” potencon rolin dhe ndikimin e liderëve të shteteve të fuqishme në rrjedhat e një çështjeje të përcaktuar, si interes a dëshirë e tyre. Këtë e argumenton me faktin se vetëm në bazë të vullnetit, sidomos të Gjermanisë dhe të ministrit të saj të Punëve të Jashtme, Hans-Dietrich Genscher, vendet e Bashkimit Evropian njohën pavarësinë e Sllovenisë dhe të Kroacisë në vitin 1992.

Përfundimisht, Sllovenia filloi të njihej ndërkombëtarisht. Shteti i parë që njohu pavarësinë e Sllovenisë, ishte Kroacia, e cila këtë njohje e bëri më 26 qershor 1991, kurse Komuniteti Evropian, në mënyrë indirekte, njohu Slloveninë në dhjetor të të njëjtit vit, pasi konsiderohej se ajo i plotësonte kushtet që Komuniteti Evropian kishte vendosur për shtetet që krijohen nga ish-BRSS dhe rrjedhimisht edhe nga ish-Jugosllavia. Në fund, më 22 maj 1992 Sllovenia bëhet anëtare e OKB-së.

Kroacia

Lufta e kroatëve për pavarësi ka zgjatur në periudhën prej vitit 1991 deri në vitin 1995. Lufta në Kroaci u zhvillua ndërmjet forcave kroate, në njërën anë, dhe forcave të APJ-së, si ushtri federative, dhe forcave lokale serbe në anën tjetër. APJ-ja konsiderohet se ka ndërprerë sulmet kundër forcave kroate në vitin 1992. Por, kjo çështje është shumë e diskutueshme, sepse realisht një pjesë e këtyre forcave formalisht është shndërruar në shtyllë e fortë mbështetëse për forcat serbe në enklavat kroate.

Lufta në Kroaci shpërtheu nga shkaku se kroatët dëshironin të krijonin shtetin e pavarur kroat, ndërkohë që serbët kërkonin krijimin e “Serbisë së Madhe”, duke marrë pjesë të konsiderueshme të territorit kroat, ku banonin serbë vendorë. Fillimisht, APJ dëshironte të mbante nën kontroll gjithë territorin kroat, por kur kjo bëhet e pamundur, atëherë forcat serbe krijuan të vetëshpallurën Republikën Serbe të Krajinës.

Si ja filloi: Në përpjekjet për pavarësi, në njërën anë, dhe në angazhimet për Serbi të Madhe, në anën tjetër, në Kroaci u mbajtën zgjedhjet e para shumëpartiake, në prill të vitit 1990, të cilat i fitoi partia HDZ (Hrvatska Demokratska Zajednica), të cilës i printe Franjo Tudjman, i

⁷³ Buja, Ramë, *Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë*

cili u zgjodh kryetar i Kryesisë së Kroacisë. Ai publikoi Programin e pavarësimit të Kroacisë dhe të daljes së saj nga Jugosllavia.

Lufta në Kroaci fillon me incidente të vogla nëpër zona me popullsi të përzier kroato-serbe, por me shumicë serbe. Serbët atje kishin filluar të realizonin atë që njihej “Balvan Revolucija”⁷⁴. Konflikti përshkallëzohet dhe merr përmasa pas shpalljes së pavarësisë së Kroacisë, më 25. 6. 1991, kur APJ-ja vihet hapur në anën e serbëve të Kroacisë, të cilët ishin organizuar në formacione të shtetit të tyre. Qëllimet serbe ishin të qarta, të cilat definohej lehtë si përpjekje për përkufizim terriroresh dhe ridefinim kufijsh, në mënyrë që aty ku jetonin serbët, të vendoseshin kufijtë e “Serbisë së Madhe”.

Lufta në Kroaci fillimisht ishte më e vështirë për kroatët, të cilëve u mungonte armatimi i rëndë për të përballuar APJ-në, e cila ishte më e fortë për nga armatimi.

Rrethimi i Vukovarit dhe rrethimi i Dubrovnikut nga ana e forcave ushtarake të Jugosllavisë serbe bënë që presioni për njohje të Kroacisë dhe të Sllovenisë të shtohet, sidomos nga ndikimi gjerman. Qyteti i Vukovarit u bë simbol i rezistencës kroate, ndërkohë që lufta merr përmasa. Ajo u ndërpre me të ashtuquajturën Marrëveshje të Sarajevës për armëpushim. Por, përpjekje e plane paqeje do të bëhen në vazhdimësi. Në këtë vazhdë përmendim Planin e Vensit⁷⁵, plan ky që hap rrugën për vendosje të trupave ndërkombëtare të paqes, të njohura si kaskadat blu.

Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet të Tudjmanit, në njëerën, dhe Millosheviqit dhe Kadijeviqit, në anën tjetër, në Kroaci do të sjellë UNPROFOR-in, me qëllim të vendosjes dhe sigurimit të paqes. Pavarësisht kësaj paqeje të vendosur, kjo nuk është respektuar dhe lufta ka vazhduar, duke kaluar nëpër shumë operacione ushtarake, krahas përpjekjeve diplomatike për të gjetur një zgjidhje për paqe të qëndrueshme në Kroaci. Sigurisht këtu kishim të bënim me përkufizim terriroresh, ku forcat serbe, të ndihmuara nga Serbia, donin të okuponin terrirore kroate, duke tentuar që vijën kufitare ta vënin si kufi verior dhe perëndimor të “Serbisë së

⁷⁴ “**Balvan Revolucija**”, i datës 17. 8. 1990, ka tërë përmbajtje: Kryengritësit serbë në Kroaci refuzojnë dëgjueshmërinë ndaj shtetit kroat dhe kur fillojnë të vendosin barrikada nëpër rrugë të Dalmacisë, që dëmton turizmin veror të këtij shteti. Meqenëse bllokadat ishin nga Balvania, incidenti merr emrin “Balvan Revolucija”. Edhe pse nuk kishte viktima, tensionet ndërnacionale acarohen ndërmjet serbëve dhe kroatëve, kështu që ky incident është paralajmëtar i luftës në Kroaci.

⁷⁵ Shih Planin e Sajrus Vens (Cyrus Vance) dhe lordit Owen për Bosnjen dhe Hercegovinën. Në nëntor të vitit 1991, përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara Sajrus Vens propozon Planin sipas të cilit Krajina të demilitarizohet (armatimi të mbyllet në depo sipas sistemi të “çelsit të dyfishtë”) dhe të cilat armë do të ruhen nga forcat paqësore të KB (“helmetat blu”) të cilat do të ishin të vendosur në tërë terriroren deri sa do të mbaheshin bisedimet politike.

Madhe”. Asaj pjese të territorit të Kroacisë që nga Serbia njihej si Srpska Krajina, diplomacia ndërkombëtare i kishte ofruar disa opsione, nga të cilat palni Z-4 ishte një plan shumë ambicioz, i cili serbëve në Kroaci u siguronte një autonomi mjaft të gjerë. Këtë serbët refuzojnë ta pranojnë. Përpyekjet serbe që me luftë të përkufizojnë territore harronin se Kroacia ishte njohur ndërkombëtarisht dhe se ndarja e territoreve të saja po bëhej krejtësisht e pamundur.

Lufta në Kroaci zgjati nga viti 1991 e deri në vitin 1995, në forma dhe intensitete të ndryshme. Në gusht të vitit 1995, forcat kroate, në bashkëpunim me Korpusin V të Armatës së Bosnjë-Hercegovinës, nga zona e Bihaçit, zhvilluan operacionin OLUJA, me çka pjesa perëndimore e RSK-së vihet nën kontrollin kroat, përfshirë edhe qytetin kryesor Knin. Kjo ka shkakuar një ekzod masiv të serbëve, sikundër edhe numër të madh të krimeve të luftës⁷⁶.

Në fakt edhe situata politike e sigurisë në Kosovë, i ndihmuan, u shfrytëzuan dhe argumentuan e përshpejtuan tendencat e Sllovenisë dhe Kroacisë për t’u ndarë nga Jugosllavia⁷⁷.

Lufta e Kroacisë për pavarësimin e saj fatkeqësisht u pagua me shumë jetë njerëzish dhe me dëme të mëdha. Burime të ndryshme japin numra të ndryshëm, por të dhënat përafërsisht të sigurtat për të vrarët dhe viktimat, janë afërsisht si vijon: 10.668 të vrarë dhe 2.915 të “zhdukur”, gjithsej: 13.583 të vrarë, 37.180⁷⁸ të plagosur. Ndërsa sipas një publikimi në New York Times Numri i të vrarëve llogaritej në mes të 6.000-10.000, 400.000 banorë ishin refugjatë dhe 30% e territorit mbeti i okupuar nga serbët⁷⁹.

Bosnjë-Hercegovina

Martti Ahtisaari në librin e tij “Detyra në Beograd”, në këtë mënyrë e paraqet fillimin e luftës në Bosnjë-Hercegovinë: “Jo shumë kohë pas fillimit të luftërave në Sllovemi dhe në Kroaci, Bosnjë-Hercegovina, me më pak se katër milionë banorë, ndoqi shembullin e Sllovenisë dhe të Kroacisë. Presidenti Izetbegović organizoi referendumin për pavarësi. Serbët e Bosnjës e bojkotuan votimin, kurse shumica dërrmuese e kroatëve dhe e myslimanëve përkrahën pavarësinë dhe në fillim të marsit të vitit 1992, ajo u shpall.

⁷⁶ http://sh.wikipedia.org/wiki/Rat_u_Hrvatskoj (qasur me 12. 2. 2015)

⁷⁷ Howard Clark, “*Civil Resistance in Kosovo*”, (London: Plutobooks 2000), fq. .51.

⁷⁸ Hrvatski Memorijalno Dokumentacijski Centar Domovinskog Rata

⁷⁹ New York Times, *Casualty Figures*, 28 shkurt 1992.

Aktivitetet e politikës ekspansioniste dhe luftës për territore, gjithnjë me qëllim të krijimit të “Serbisë së Madhe” vazhdojnë edhe në Bosnjë-Hercegovinë. Këtu, fatkeqësisht, lufta filloi të marrë përmasa shumë dramatike, luftë e cila, varësisht nga burimet që kemi, ka marrë qindra e mijëra jetë njerëzish. Thjesht, lufta e Bosnjë-Hercegovinës ka marrë përmasat e genocidit të ushtruar nga një shtet, nga një popull, nga një ushtri kundër një populli tjetër. Pra, Serbia, me gjithë arsenalin e vet, ushtron gjenocid kundër popullatës shumë pak të mbrojtur myslimane të Bosnjë- Hercegovinës.

Në Prill të vitit 1992, SHBA-ja dhe Komuniteti Evropian njohin pavarësinë e Bosnjës, një shteti kryesisht mysliman, ku pakica serbe përbënte 32 për qind të popullatës. Milosheviqi kundërpërgjigjet ndaj njohjes së Deklaratës së pavarësisë me sulme kundër Sarajevës, kryeqyteti i Bosnjës, i njohur si nikoqir i Lojërave Olimpike Dimërore të vitit 1984. Sarajeva shpejt bëhet e njohur si qytet, ku serbët godasin me snajper qytetarët e pashpresë në rrugë, përfshirë kështu edhe rreth 3.500 fëmijë⁸⁰.

Aksionet serbe kundër popullatës myslimane bëhen shumë të njohura, sipas mënyrës së zbatimit ajo konsiderohej si spastrim etnik. Lufta në Bosnjë-Hercegovinë shënon një ndër luftërat më të tmerrshme qysh nga Lufta e Dytë Botërore, ku popullata e pambrojtur myslimane i nënshtrohet sulmeve barbare dhe tmerreve nga vrasjet masive, shfarosje në masë, dhunime, kampe përqendrimi dhe shkatërrimi masiv të territoreve, objekteve fetare dhe kulturore etj. Bosnja mbeti e vetmuar. Bashkësia ndërkombëtare vendnumëronte, ndërsa Serbia haptas i ndihmonte serbët e Bosnjës në misionin e tyre për serbizimin dhe pastrimin etnik të Bosnjës. Gati 100.000 ushtarë të Serbisë, qindra tanke dhe dhjetëra aeroplanë u dërguan në Bosnje, për të marrë pjesë në luftime. Dhe, përkundër raportimeve tronditëse të medieve të shkruara dhe elektronike, fuqitë e vendosje për një kohë të gjatë të gjithë aktivitetet e tyre kundër luftës dhe përkrahjes së popullatës së pambrojtur i bënë në formë të përkrahjes verbale dhe deklaratave e rezolutave shterpe. Një pjesë e madhe e bashkësisë ndërkombëtare mbetet shumë indiferente.

Tek pas vrasjeve të dhjetëra e mijëra civilëve në këtë luftë, bashkësia ndërkombëtare filloi të eksperimentojë dhe të shqyrtojë plane për ndaljen e luftës në Bosnjë. Në kuadër të saj, “në pranverë të vitit 1993, ish-ministrit të Punëve të Jashtme të Shteteve të Bashkuara, Cyrus Vance, si përfaqësues i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së dhe ish-ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë, lordi Owen, si përfaqësues i BE-së, e kishin prezantuar planin i tyre për ndarjen e

⁸⁰ <http://www.historyplace.com/worldhistory/genocide/bosnia.htm> (qasur mw 21. 2. 2015).

Bosnjës në dhjetë kantone, sipas modelit të Zvicrës. Ky i ashtuquajtur plan VOPP nuk u miratua kurrë, po as plani për ndarjen e Bosnjës ndërmjetserbëve të Bosnjës dhe lidhjes së myslimanëve dhe të kroatëve me proporcion 49-51 për qind”⁸¹.

Edhe në këto rrethana të injorimit total të bashkësisë ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara tentonte të ushtronte ndikimin e tyre përmes rezolutave. Një rezolutë e tillë formale, u miratua në fund të muajit mars të vitit 1993, përmes së cilës u vendosen sanksione ekonomike ndaj Serbisë dhe u dërguan trupat ndërkombëtare të UNPROFOR-it, më qëllim për t’i mbrojtur dhe siguruar shpërndarjen e ndihmave humanitare, kryesisht në ushqim e medikamente të cilat u mungonin popullatës civile myslimanëve, ndersa nga ana tjetra edhe reagimi i SHBA-së poashtu ishte pothuaj i njëjtë, presidenti i SHBA-së, Bill Clinton i ngriu fondet jugosllave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë drejtim, Kombet e Bashkuara ndalojnë interferimin ushtarak të trupave të veta kundër serbëve. Kështu, ato mbesin neutral pa marrë parasysh sa e rëndë që po bëhej situata⁸². Derisa bashkësia ndërkombëtare gjatë vitit 1993 nuk ndërmerr aksione ushtarake kundër serbëve, serbët me paturpësi dhe me egërsi ushtronin genocid kundër myslimanëve të Bosnjës. Nën trusninë e operacioneve luftarake, Bosnja ngadalë ndahet në tre entitete: pjesa serbe e Bosnjës, pjesa kroate dhe pjesa myslimane apo boshnjake.

Serbët që dominonin me forcë ushtarake, krijuan në mënyrë jo legjitime të ashtuquajturën Republikë Serbe (Republika Srpska), të cilës i printe Radovan Karadjic⁸³, një lider fashist, i cili në një moment nuk kishte përtuar që gazetarëve t’u deklaronte se serbët dhe myslimanët janë si qentë dhe macet. Ata nuk mund të jetojnë bashkërisht në paqe. Kjo është e pamundur⁸⁴. Më 5 shkurt të vitit 1994, me një goditje në atë që njëhej si tregu Markale në Sarajevë, nga forcat serbe u vranë 68 persona dhe rreth 200 të tjerë u plagosën rëndë. Ky sulm dhe transmetimet televizive për këtë krim makabër krijojnë një opinion më përkrahës dhe më solidarizues për boshnjakët dhe me këtë rast filluan të dëgjohej zërat për intervenim ushtarak kundër forcave serbe.

Presidenti amerikan Bill Clinton i cili gjatë fushatës zgjedhore kishte premtuar se do të parandalonte spastrimin etnik në Bosnjë, tash lëshon një ultimatum përmes NATO-s, duke

⁸¹ Ahtisaari, Martti. *Detjra në Beograd*.Trend, Prishtinë, 2008. Fq. 20

⁸² <http://www.historyplace.com/worldhistory/genocide/bosnia.htm> (qasur më 21. 2. 2015).

⁸³ Lider nacionalit serb që aktualisht po gjykohet në Gjykatën e Hagës dhe i cili në një kohë të gjatë ishte krejtësisht nën komandën e Slobodan Milosheviqit.

⁸⁴ <http://www.historyplace.com/worldhistory/genocide/bosnia.htm> (qasur më 21. 2. 2015).

kërkuar tërheqjen e artilerisë serbe nga Sarajeva. Përpjekjet diplomatike amerikane çojnë deri tek unifikimi i forcave boshnjako-kroate, aleancë apo unifikim që nuk arrin shumë në luftën kundër serbëve. Kurse, forcat serbe ishin të vendosura të shkonin me planin e tyre, pa marrë parasysh pasojat që po i shkaktonin tjerëve. Për më tepër, në një moment të caktuar ato kapin një numër të caktuar paqeruajtësish, të cilët shihen të përkitazi e të prangosur nëpër shtylla të tensionit të lartë që do të përdoreshin si shënjestër për sulmet e NATO-s.

Paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara krijuan zona të mbrojtura dhe pikërisht është një zonë e ashtuquajtur e mbrojtur, që do të shënojë kasaphanën më të madhe të ndodhur pas Luftës së Dytë Botërore. Forcat serbe, nën komandën e komandantit famëkeq serb Ratko Mladiq, në zonën e Srebernicës. bënë kasaphanën e njohur të Srebernicës, ku masakrohen 8000 meshkuj të moshave prej 12 deri në 60, për të vazhduar me dhunime masive të femrave boshnjake.

Prapë, për shkak të autoritetit dhe ekspertizës që e gëzon në arenën diplomatike ndërkombëtare, po e pasqyroj një përcaktim dhe vlerësim të Martti Ahtisaarit, të publikuar në librin e tij “Detyra në Beograd”, përkitazi me raportin e OKB-së dhe të bashkësisë ndërkombëtare ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Bosnjë. Ai thotë: “Fillimisht, ndaj gjithë kësaj lufte barbare nga ana e Serbisë dhe serbëve të Bosnjës, OKB-ja përpigj të ushtronte ndikim në këtë situatë me anë të Rezolutës, sipas së cilës u vendosën sanksionet ekonomike ndaj Serbisë dhe u dërguan trupat e UNPROFOR-it, fillimisht në Kroaci për të mbrojtur aktivitetet humanitare në rajon.

Një sjellje e tillë e bashkësisë ndërkombëtare, jo vetëm që nuk ofronte zgjidhje për përfundim të luftës, përkundrazi përçonte mesazh se nuk është edhe aq e interesuar të kyçet në zgjidhjen e kësaj vatre të krize humanitare. Për këtë arsye, lufta vazhdoi deri në vitin 1995. Vetëm Masakra e Srebernicës, ku në mënyrë më brutale u vranë 8000 civilë myslimanë, e detyroi më fund bashkësinë ndërkombëtare që të mos heshtë, por të veprojë, në emër të humanizmit, civilizimit dhe të qytetërimit botëror. Deri atëherë, në Bosnjë kishin vdekur rreth 300.000 njerëz dhe 2.7 milionë të tjerë ishin bërë refugjatë”⁸⁵.

Më 30 gusht 1995, më në fund fillon sulmi masiv i NATO-s, i prirë nga SHBA, si kundërpërgjigje për vrasjet masive në Srebernicë, duke vënë në shënjestër pozitat e artilerisë serbe gjithandej Bosnjës. Bombardimet vazhduan edhe në tetor. Bombardimet u bënë nga 60

⁸⁵ Ahtisaari, Martti. *Detyra në Beograd*. Trend, Prishtinë, 2008. Fq. 20

aeroplanë, nga bazat në Itali dhe nga aeroplanbartësja USS ‘Theodore Roosevelt’ në Adriatik⁸⁶. Forcat serbe humbin sipërfaqe në favor të boshnjakëve, të cilët në një mënyrë armatoseshin nga bota islame. Si rezultat, gjysma e Bosnjës merret nga trupat myslimano-kroate⁸⁷.

I ballafaquar me sulmet e forcave të NATO-s. Milosheviqi detyrohet të futet në bisedime paqësore, të cilat organizohen në Dayton (OHIO) të SHBA, të cilat fillojnë më 1 nëntor të vitit 1995, të njohura me emrin bisedimet e Konferencës së Daytonit. Tri javë bisedime në Dayton, të cilat, pos tjerash, sjellin ndarjen e Bosnjës në dy entitete: pjesa serbe e Bosnjës dhe pjesa e federatës boshnjako-kroate e Bosnjës.

Lufta e Bosnjës, sipas Richard Hoolbroke, konsiderohet dështimi më i madh i Perëndimit që nga viti 1940⁸⁸.

I dërguari i Komisionit për Hetimin e Shkeljeve të Ligjit për të Drejtat Humanitare të OKB-së, Sherif Bassiouni, në dëshminë e tij para Kongresit të SHBA-ve, më 4 prill 1995, kishte vërtetuar strategjinë e pastrimit etnik dhe taktikën e vrasjeve, gjymtimeve, dhunimeve të civilëve e forcave serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë⁸⁹.

Dhe, ishte Daytoni ku u vizatua një hartë e re për Ballkanin, me një Jugosllavi të re federale të përbërë nga vetëm dy republika, Serbia dhe Mali i Zi dhe duke suksesuar të drejtat dhe detyrimet ndërkombëtare. Konfliktet ulterior në zonat e banuara me shqiptarë nga extinct RFJ dhe me pasojat, ishin direkt a indirekt të përkitazia me plight kosovaro-shqiptarë, qoftë në vitet 2000-2001 gjatë konfliktit juglindor të Serbisë apo në vitin 2001 në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë⁹⁰.

3.3. Konferenca e Daytonit dhe Kosova

Masakra ndaj 8000 burrave mysliman⁹¹ të moshës prej 12 deri në 77 vjeç⁹² në këtë qytet (Srebernicë), e mbushi më fund kupën e bashkësisë ndërkombëtare e cila nuk mund më të heshte dhe rrinte duarkryq ndaj masakrave që i ndërmerre Serbia dhe serbet e Bosnjes ndaj popullit të pambrojtur civil boshnjak, dhe kështu NATO e udhëhequr si zakonisht nga SHBA-të -filloi me

⁸⁶ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare (autobiografi)*, SHB “Dudaj”, Tiranë, 2004, fq. 229.

⁸⁷ <http://www.historyplace.com/worldhistory/genocide/bosnia.htm> (qasur më 22. 2. 2015).

⁸⁸ <http://www.historyplace.com/worldhistory/genocide/bosnia.htm> (qasur më 22. 2. 2015).

⁸⁹ US Congress files, April 4, 1995.

⁹⁰ http://fride.org/uploads/Cap5_Kosovo_ENG_oct9.pdf, fq. 121.

⁹¹ Ahtisaari, Martti, *Detyra në Beograd*. Trend, Prishtinë 2008. Fq. 20.

⁹² Potocari Memorial center: Preliminary List of Missing Persons from Srebrenica ‘95

30 korrik 1995 fushatën e bombardimeve ndaj forcave ushtarake serbe e cila tentonte okupimin e kryeqytetit të Bosnjes, Sarajevën. Vetëm ky sulm i NATO-së detyruan serbet të pranojnë mbajtjen e Konferencës së Paqes në mes të Kroacisë, Serbisë dhe Bosnjës e cila u mbajt me 21 nëntor 1995 në bazën ajrore Wright-Patterson, Ohia.

Rasti i Srebrenicës, është dëshmia më e mirë e mentalitetit vrastar dhe frikacak të ushtrisë serbe, kur nga frika e bombardimeve i lidhnin ushtarët e forcave paqesore të Kombeve të Bashkuara për shtylla elektrike pothuaj në tërë territorin e të ashtuquajturës “Republika Srpska” Kur ndalonin bombardimet, ata tregonin “trimërinë” e tyre duke vrarë gra, fëmijë e pleq të moshuar e të lodhur, të rraskapitur, të uritur dhe duar thatë.

Pas tri javë bisedimesh të rënda, me ndërmjetësuesin brilant, Holbrooke, u nënshkrua Marrëveshja e Dejtonit, më 21 nëntor 1995, me çfarë lufta në Bosnjë mori fund⁹³. Nga rezultati i Marrëveshjes së Dejtonit u tregua se përdorimi i kufizuar i forcës, qoftë dhe vetëm i forcës ajrore, mund të sillte ndryshime vendimtare. Gjithashtu, ajo tregoi rëndësinë e unitetit të aleatëve dhe të rolit drejtues të amerikanëve, rëndësinë e përdorimit të forcës ndaj atyre, siç ishte Milosheviq dhe Mladiq⁹⁴.

Të gjitha këto ngjarje treguan se diplomacia ndërkombëtare, deri në ndërhyrjen në Bosnjë, ishte e brishtë, e pakoordinuar dhe jo unike, dhe çka ishte edhe më përmbajtësore tregoi se Europa nuk është në gjendje të menagjoi dhe arrin zgjidhjen e ndonjë konflikti kompleks dhe me përmasa ushtarake çfarë ishin ato në dy republikat (Kroaci e Bosnje) pa ndihmen dhe kyçjen direkte të SHBA-së.

Marrëveshja e Dejtonit, paralajmori Kosovën se po qe se dëshirojnë të mos mbesim në kuadër të Serbisë, është “KOHA” e fundit që të ndryshojmë strategjinë paqësore të zbatuar deri në këtë vit (1995), që ishte një politikë e mençur dhe në interes të popullit të Kosovës, por dy luftërat në ish Jugosllavi dhe sjellja injoruese e Serbisë ndaj diplomacisë ndërkombëtare kishte ndryshuar doktrinat dhe parimet stereotipe ndërkombëtare.

Këto luftëra dëshmuuan se po qe se Kosova dëshiron ta avancojë pozitën e vet në skenën ndërkombëtare, duhet të ndryshojë rrënjësisht organizimi dhe veprimi politik. Për fat të keq, alternativa e Kosovës e udhëhequr nga LDK-ja, nuk kishte arritur dhe nuk shprehte interesim të zhvillohej krahas zhvillimeve dhe ndryshimeve në politikën e përgjithshme në rajon, ngeli në

⁹³ Albright, Madeleine, Vep. e cit., fq. 231.

⁹⁴ Po aty.

nivel të organizimeve partiake, me çfarë u argumentua fakti shkencor e historik se asnjë parti politike, sado që ajo të jetë e fortë dhe e përkrahur, për një kohë të gjatë nuk mund t'i kryej përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve shtetërore, që të themi ishin të brishta, mos të them nuk ekzistonin në Kosovë.

Liderët e lëvizjeve paqësore në Kosovë, duke mos dashur të kuptojnë dhe të pranojnë një realitet të ri që e kishin sjellur luftrat në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë, apo duke e vlerësuar se Kosova nuk posedon potencial të domosdoshëm t'i kërkoj të drejtat e tyre përmes luftës apo llojeve tjera të konfrontimit fizik me Serbinë dhe pushtetin e instaluar serb në Kosovë, vazhdonin me çasjen e tyre të improvizimit të kundërshtimit të pushtetit serb, me organizimin e një sistemi paralel të pushtetit shqiptarë në Kosovë, por kjo nuk ishte në përputhje me synimet e popullit dhe represionit, terrorit dhe dhunës që po e zbatonte Serbia në Kosovë.

Në këto rrethana, u paraqit një lidhshmëri e ri, i cili procesin e ndalur e lëvizi para, kjo ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), e cila, imponoi spektrin politik shqiptarë dhe bashkësisë ndërkombëtare domosdoshmërinë e shqyrtimit dhe zbatimit të një strategjie të re të çasjes ndaj Kosovës.

Ka shumë mendime pse lufta në Kosovë nuk shpërtheu gjatë kohës kur lufta kishte filluar në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë. Përpjekje që konflikti të bartet në Kosovë ose në jug, siç ishte zakoni të thuhej, kishte në kontinuitet, posaçërisht nga lidhshmëria kroate. Janë organizuar takime të ndryshme, ku është kërkuar nga liderët kosovarë që të futeshin në luftë dhe kështu të formohet një front i përbashkët kundër Serbisë dhe serbëve tjerë të armatosur që jetonin jashtë Serbisë dhe për këtë premtoheshin armatime dhe ndihma të tjera.

E fakti pse konflikti, megjithatë, nuk shpërthente në atë kohë në Kosovë, mund të analizohet nga këndvështrime të ndryshme, edhe pse, Kosova në vazhdimësi mbetej çështje serioze, që priste zgjidhje. Kosova nga shumë analistë dhe diplomatë ndërkombëtarë cilësohej si “Kuti e Pandorës”, e cila një ditë do të hapej. Këtë të gjithë e dinin.

Lidhur me atë pse lufta nuk po shpërthente në Kosovë, kur ato filluan në Kroaci e Bosnje e Hercegovinë po e elaboroi me një analizë interesante të një studiuesi serb, pse: “Kutia e Pandorës në Kosovë nuk po hapej gjatë luftës civile në pjesët e tjera të Jugosllavisë (Slloveni, Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë). Shkaqet për këtë mund të gjinden në këto tri teori: 1. Separatistët në Kosovë nuk ishin të kënaqur me balansin e pushtetit dhe ata donin të prisnin

derisa Serbia të lodhej nga luftërat civile, 2. Fqinji, Shqipëria, po kalonte nëpër tranzicionin postkomunist dhe nëpër trazira dhe 3. Deri te Konferenca e Paqes në Dayton 1995, e cila i dha fund luftës në Bosnjë-Hercegovinë, shqiptarët në Kosovë shpresonin se bashkësia ndërkombëtare do të fuste çështjen e Kosovës në negociatat e Daytonit. Meqenëse kjo kurrë nuk ndodhi, shqiptarët refuzuan të mbështesin Rugovën pacifist dhe filluan të mbështesin të ashtuquajturën UÇK (Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës), e cila ishte themeluar në vitin 1993⁹⁵.

Është me interes që shkurtimisht të përmend se politika serbe, por edhe strukturat e tjera të shoqërisë serbe, luftën dhe konfliktin që kishin shpërthyer në Jugosllavi, gjithmonë e paraqitnin si luftë civile. Arsyeja për këtë është e thjeshtë: Konfliktin (luftën) donin ta trajtonin vetëm si problem të brendshëm. E për Kosovën as që donin të bisedonin. Madje në Dayton, Milosheviqi kishte refuzuar që të përmendej fare Kosova, si parakusht të pranoi të marrë pjesë në atë konferencë. Në atë kohë, Rugova dhe përkrahësit e tij insistonin të kishin të drejta të njëjta me serbët e Kroacisë, por këtë e ndryshuan, kur kroatët ndërmorën operacioni ushtarak Oluja⁹⁶, në muajin gusht 1995. Pa marrë parasysh se elita politike e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare bënë çmos që të parandalonin shpërthimin e luftës në Kosovë, konflikti në Kosovë, megjithatë shpërthen⁹⁷. Me çasjen e tillë të diplomacisë ndërkombëtare ndaj gjendjes në Kosovë në një formë të caktuar u nënkuptonte se “lufta është mjeti i vetëm për arritjen e qëllimeve dhe interesave të tyre”⁹⁸.

Lëvizja pacifiste, të cilës i printe dr. Ibrahim Rugova, duke mos arritur që të imponohet dhe duke mos arritur që të fusë Kosovën në agjendën e Konferencës së Daytonit, filloi të zbeh autoritetin, dhe besimin në çarqe të caktuara të njerëzve që e kuptuan se është koha e fundit kur duhet të përcaktohen a do të vazhdojnë me lëvizjen paqësore e të mbesin pjesë e Serbisë edhe për një kohë shumë të gjatë apo do të pranojnë konfliktin që po i’a imponon Serbia e po hyjnë në një rrugë me shumë të panjohura, e cila realisht sipas të gjitha analizave të rrethanave të atëhershme nuk rezultonin në favor të Kosovës, por kjo ishte rruga e vetme që kishte Kosova nëse donte t’a jetësonte kushtetuten e saj të 7 shtatorit 1990, dhe vendimin e 87.1% të popullit për pavarësi të shprehur përmes referendumit në vitin 1991.

⁹⁵ Simić, Predrag, *Put u Rambuje: Kosovska kriza 1995-2000*, SHB “Nea”, Beograd, 2000, fq. 23 -25.

⁹⁶ Gjatë këtij operacioni ushtarak pothuaj të gjitha enklavat serbe që ishin krijuar dhe që luftonin, sidomos në Dalmaci, u zhbënë dhe serbët nga ato pjesë të Kroacisë u larguan në mënyrë të papritur dhe shumë shpejt.

⁹⁷ Simić, Predrag, *Vep. e cit.*, fq. 36.

⁹⁸ Abazi, Enika, *Çështja e Kosovës dhe diplomacia ndërkombëtare 1990-1999: Një konflikt i parashikueshëm*. Qendra e studimeve albanologjike-Instituti i histories. Tiranë, 2013. Fq.204

Gjendja e rëndë në Kosovë, dhuna dhe terrori i vazhdueshëm kundër popullatës shqiptare bënë që në trupin social shqiptar të paraqiten, në formë më të shprehur, kërkesa për një lëvizje ndryshe. U krijua një opinion se bota angazhohet vetëm kur fillon lufta. Me të vërtetë, përvojat sllovene, kroate, boshnjake këtë opinion e vërtetuan. Bazuar në këtë, u paraqitën opsionet për dinamizim të jetës dhe të rezistencës, duke kundërshtuar pacifizmin e LDK-së dhe të presidentit Rugova, i cili filloi të kritikohej çdo ditë e më shumë nga një grup i caktuar njerëzish, por nga ana tjetër kishte akoma besimin dhe respektin e pakontestueshëm të pjesës dërmuese të popullit të Kosovës, çka ishte edhe e natyrshme, se LDK e kishte bindur popullin se synimet e tyre mund të realizohen vetëm me politikë paqësore e kursesi me luftë.

Edhe shqiptarët nga diaspora përshpejtojnë dhe shpreshtojnë kërkesat për një lëvizje ndryshe. Për vite të tëra, në diasporë ishin krijuar grupe ndryshme, të cilat, në fazën e parë të shpërbërjes së Jugosllavisë, u rreshtuan në linjën e filluar nga dr. Rugova. Këto grupe, varësisht nga vendi dhe “KOHA” që ishin krijuar, ishin mjaft të ideologjizuara dhe njiheshin si grupe marksiste-leniniste. Ato i bënë shumë aktive kërkesat e tyre që të dinamizoheshin lëvizjet në Kosovë dhe të përkrahin opcionet e luftës. Marrëveshja e Dayton-it, përfundimisht edhe zyrtarisht e bëri të qartë se poqëse vertet Kosova deshiron të bëhet e pavarur duhet të luftoi për këtë synim. Dhe çka ishte më problematike dhe më komplekse për t’u kuptuar, bashkësia ndërkombëtare edhe pas qindra mijëra vrasjeve të iniciuara dhe zbatuara nga politike millosheviqiane, me miliona njerëz të ikur nga vatrat e luftës anëkend botës, me dhjetra mijëra gra të përdhunuara, Slllobodan Millosheviqi konsiderohej dhe trajtohej nga ta, si “paqebërës dhe garantues i Marrëveshjes së Dayton”⁹⁹

⁹⁹ Abazi, Enika. *Çështja e Kosovës dhe diplomacia ndërkombëtare 1990-1999: Një konflikt i parashikueshëm*. Qendra e studimeve albanologjike-Instituti i histories. Tiranë, 2013. Fq.202.

3.4. Kosova dhe diplomacia ndërkombëtare

Kriza e Kosovës ka nxitur shqetimin ndërkombëtar vetëm në fushën e sigurimit të drejtave qytetare dhe politike brenda shtetit të Serbisë që e përkufizofshin si vetëvendosje e brendshme për të gjitha pakicat në shtetet e reja të krijuara nga shpërbërja e ish Jugosllavisë.

Faktori ndërkombëtar ka pasur një përcaktim të qartë dhe të qëndrueshëm për një kohë të gjatë përkitazi me këtë problematikë, Kosova, është pjesë e RSFJ-së më pastaj e RFJ-së dhe e Serbisë..

Me zhvillimin e krizës së Kosovës, kanë filluar edhe këndvështrimet dhe çasjet e ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare. Veprimi ndërkombëtar, në raport me Kosovën, ka nxitur debat të ashpër ndërmjet qeverive dhe analistëve të politikës ndërkombëtare. Përderisa disa do të mund të shikonin reagimin ndërkombëtar ndaj Kosovës si shembull të kthimit të politikës klasike nga shekulli XIX, disa të tjerë atë e konsideronin se po shfaqej një formë e re e shpartallimit të sistemit klasik, i dominuar nga politika e interesit vetjak të shteteve¹⁰⁰.

Kjo ndarje e perceptimit të problemit të Kosovës ka detyruar SHBA-të, si aleati kryesor i Kosovës, që ta vërë në funksion diplomacinë e vet shtetërore për të krijuar marrëdhënie të qëndrueshme ndërkombëtare, përkitazi me Kosovën, sipas vizionit amerikan. Ky angazhim i Amerikës ishte i vështirë, sepse Rusia zbatonte strategjinë e mbajtjes a të fuqizimit të ndikimit dhe të prestigjit në Kontinentin e Evropës, në përpjekje për t'u rikonsideruar si fuqi e madhe botërore, duke iu përmbajtur interesave të saj gjeopolitike, Moska me çdo kusht dëshironte të ruante dhe mbronte aleatin më besnik të saj, në mos edhe të vetëm në Evropën Qendrore, Serbinë.

Shtetet e tjera evropiane, posaçërisht ato kryesoret, Britania e Madhe dhe Franca, anonin nga aleancat e tyre historike, që nga Lufta e Dytë Botërore, me Serbinë¹⁰¹. Kjo simpati dhe përkrahje diplomatike ndaj Serbisë u zbeh vetëm atëherë kur përmasat e krimeve të bëra tejkaluan kufirin etik të fshehjes dhe tolerimin e krimeve humanitare dhe politike që po zbatonte Serbia, jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha republikat e tjera në ish- Jugosllavi, si në Kroaci, Bosnjë, Slloveni etj. Ky fakt rrezikonte që me injorimin e realitetit në Jugosllavi, faktori

¹⁰⁰ Marc, Weller, *Shtetësia e kontestuar*, SHB "KOHA", Prishtinë, 2009, fq. 33.

¹⁰¹ Marc, Weller, Vep. e cit., fq. 34.

ndërkombëtar, para historisë, me heshtjen dhe mos veprimin e saj, ta akuzohet si pjesëmarrëse indirekte në këto krime kundër njerëzimit.

Martti Ahtisaari në librin e tij “Detyra në Beograd” pasqyron dhe përkujton rrjedhën e ngjarjeve në kuadër të procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, Duke u rikthyer në të kaluarën, përkujton se në këto rrethana kemi arsye të kthehemi, për një çast, në historinë e ngjarjeve në Jugosllavi. Kur Jugosllavia filloi të shpërbehej dhe Serbia filloi ta kundërshtonte me forcë këtë proces, presidenti i Shteteve të Bashkuara, George Bush, e njoftoi udhëheqjen e Serbisë, në Krishtlindjet e vitit 1992, që Shtetet e Bashkuara, madje edhe të vetme, ishin të gatshme të ndërmerrnin veprime ushtarake kundër Serbisë, nëse ajo do të shkaktonte konflikt edhe në Kosovë¹⁰². Kjo e formësoi politikën e Shteteve të Bashkuara ndaj çështjes së Kosovës gjatë viteve të 90-ta, sepse edhe presidenti pasues i SHBA-së, Bill Clinton e perseriste paralajmërimin e SHBA-ve derguar Serbisë që të mos ndërmerr veprime ushtarake në Kosovë se do të ndëshkohet edhe ushtarakisht nga SHBA-të, e cila potenconte se “nuk do të pranonte ndërrime në pozitën e Kosovës si rajon autonom i Serbisë”¹⁰³, edhe pse këtë autonomi që pretendonin SHBA t’ia mbroj Kosovës, Slobodan Millosheviqi gjegjësisht Serbia i’a kishte suprimuar me dhunë e tanksa që në vitin 1989...Pa marrë parasysh të gjitha veprimet e dhunshme që ndërmerrte Serbia për mbizotërimin në Jugosllavi, diplomacia amerikane, për shkak të ruajtjes së një stabiliteti të marrëdhënieve ndërkombëtare, angazhohej, por me një intensitetet më të vogël, për ruajtjen e RSFJ-së. Kjo, shihet edhe me veprimin e ish-ambasadorit të fundit amerikan në RSFJ, z. Warren Zimmermann, i cili në vizitën e parë që ia bëri Kosovës, në qershor të vitit 1989, me vete kishte bartur përcaktimin e tejkaluar politiko-diplomatik të SHBA-së se politika e SHBA-ve nuk e vinte në dyshim sovranitetin e serbëve mbi Kosovën¹⁰⁴. Në këtë vizitë, kreu i diplomacisë amerikane kishte tentuar që të bindë udhëheqësin politik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovën, që të dalë në zgjedhjet serbe të vitit 1990, duke e arsyetuar këtë propozim, “kërcënim” të tij me fjalët se përndryshe hedhja poshtë e zgjedhjeve serbe nuk do ta ndihmonte besueshmërinë e tij si demokrat, dhe me këtë rast ia kishte përmendur përvojat e irlandezëve në shekullin XIX në Dhomën e Komunave të Britanisë dhe të algjerianëve në Dhomën e Deputetëve të Francës në vitin 1950.

¹⁰² Ahtisaari, Martti. *Detyra në Beograd*. Trend, Prishtinë, 2008. Fq.24

¹⁰³ Po aty. Fq. 24

¹⁰⁴ Zimmermann, Warren, *Burimet e një katastrofe*, SHB “Besa”, Tiranë, 1996, fq. 78.

Në librin e tij të cituar në këtë punim, ambasadori amerikan, Warren Zimmermann, shkruan se si Ibrahim Rugova në këtë propozim të tij vetëm buzëqeshi me ngrohtësi, siç e kishte zakon dhe nuk lëshonte pe. Ai e bëri të qartë se nuk do të qëndronte as edhe një ditë si udhëheqës i shqiptarëve, nëse do të ndërmernte një hap të tillë. Rugova i tha ambasadorit amerikan se “shqiptarët e Kosovës, kurrë më nuk do të pranonin autoritetin serb¹⁰⁵”. Për Ibrahim Rugovën, ambasadori amerikan theksonte se është njëri ndër figurat politike më të shquara që kam takuar në Jugosllavi. Presione të këtilla, presidenti Rugova ka pasur pothuaj nga të gjitha shtetet evropiane, por ai në këtë drejtim deri në fund ka qëndruar konsekuent dhe i palëkundur, me çka i’u ka treguar bashkësisë ndërkombëtare se me këtë çasje dhe këndvështrim të zgjidhje Kosova do të mbetete gjithmonë problem i pazgjidhur ndërkombëtar. Problemi më i madh i Kosovës qëndronte në faktin se e tërë Levizja politike e Kosovës, besimi i popullit të Kosovës varej dhe mbështetej në personalitetin, kultin e krijuar mbi figurën e presidentit Rugova, të tjerët humbnin nën hijen e tij. Këtë mund ta argumentoj edhe me përvojën time në proceset politike të asaj kohe, si njëri nga anëtarët themeltar të Këshillit Koordinues të Partive Politike të Kosovës, që kam qenë pjesëmarrës në shumë takime të delegacioneve të ndryshme ndërkombëtare me rastin e vizitave që ia bënin Kosovës, gjegjësisht alternativës politike kosovare, me në krye Dr. Ibrahim Rugovën dhe LDK-në. Politikanët kosovarë, pjesa dërrmuese e tyre, pos që ishin njerëz të mirë, kombëtarisht të përcaktuar drejt, ishin larg njohurive të sjelljeve protokollare politike mos të them diplomatike. Ky nocion, ndoshta ka qenë i njohur vetëm si term politik për dikë në atë kohë. Këtë e argumentoj me shumë raste, kur ndonjë delegacion nga jashtë vinte për bisedime me përfaqësuesit politikë të alternativës kosovare në selinë e tyre, apo me presidentin Rugova në Shoqatën e Shkrimtarëve në Prishtinë (viti 1990), shumë anëtarë të Kryesisë së LDK-së apo të stafit teknik që punonin në atë zyre, non-stop hapnin derën e sallësapo të zyres së presidentit të shtetit, ku mbahej mbledhja, rrinin për sa kohë donin para derës së hapur dhe shikonin dhe degjinin çfarë bisedohej dhe iknin, pas një kohe, prapë vinin e kështu me radhë. Ibrahim Rugova vetëm i shikonte dhe buzëqeshje. Të tjerët, nga delegacioni i huaj, shikonin Rugovën dhe kur e shihnin atë duke buzëqeshur me kuptim shumëdimensional, edhe ata buzëqeshnin dhe i vazhdonin bisedat.

Ky ishte realiteti politik i asaj kohe. Shumica prej veprimtarëve të asaj kohe, pa marrë parasysh nivelin e tyre arsimor dhe shkencor, nuk dispononin as njohuritë më elementare mbi

¹⁰⁵ Vep. e cit., 1996, fq. 80.

kulturën politike, mos të them diplomatike, edhe pse kjo, së paku për shqiptarët, duhej të ishte diçka e thjeshtë dhe pjesë përbërëse e identitetit të tyre, ngase pjesa më e madhe e kulturës politike ndërkombëtare mund t'i përshtatej traditave tradicionale të organizimit dhe mikpritjes shqiptare, të cilat gjëra mund të përgjithësohen me konstatimin se të gjithë në hierarkinë e familjeve shqiptare e dinë kush ku e ka vendin e vet dhe si duhet të sillen në raste të caktuara.

Se si të ndryshohen politikat e fuqive të mëdha rreth Kosovës dhe Jugosllavisë, këtë, në atë kohë, sipas mendimit tim, nuk e ka ditur dhe nuk i ka interesuar askujt, por këtë i'a lënin kohës dhe shpresës se ndryshimet do të jenë pro interesit të Kosovës. Të gjithë mendonim se fakti se ne kemi të drejtë mjafton që bota duhet të na dëgjojë dhe të na ndihmojë.

Tani kur i mendoj këto, më duket aq qesharake dhe naive, sa që falënderoj Zotin që në atë kohë ia kishte përcaktuar Kosovës një lider si Ibrahim Rugova, i cili i ka kuptuar interesat gjeostrategjike të fuqive të mëdha botërore në Ballkan, para rrënimit të Murit të Berlinit, më mirë se kushdo tjetër në Kosovë. Për këtë arsye, politika e tij në vitet e para të viteve '90 (1990-1993), ka qenë një politikë aq madhështore dhe e mençur, sa që ndoshta edhe shkenca politike, në të ardhmen do ta marrë si model se si në rrethanat e thyerjeve të mëdha dhe globale, shtetet ose vendet e vogla duhet t'i përshtaten rrethanave politike globale, dhe në terren dhe jo të marrin bajrakun e të udhëheqin politikën siç ka menduar pothuaj i tërë spektri politik i atëhershëm, e në kuadër të tij edhe unë si prijatar i kësaj ëndrre me anë të Partisë Republikane të Kosovës. Sepse, kjo është aq naive, sa që nga perspektiva e tanishme duket shumë qesharake. Tani, pas tërë asaj që ka ndodhur në Jugosllavi dhe rreth saj dhe pasi edhe unë kam një pasqyrë të asaj çfarë ka ndodhur dhe çfarë ka mundur të ndodhte, i jam mirënjohës vizionit dhe punës së presidentit Rugova, i cili me qëndrimet, vendosmërinë dhe besimin e fituar në bashkëbisedimin me faktorin ndërkombëtar, e ka avancuar aq shumë politikisht çështjen e Kosovës, sa që në asnjë mbledhje me rëndësi ndërkombëtare nuk ka mundur të mënjanojë a të minimizojë çështjen e Kosovës, si çelës i zgjidhjes së stabilitetit politik, jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë, edhe pse ato ishin vetëm në kontekst të mbrojtjes së drejtave të njeriut..

Lëvizjet politike dhe të tjera në Jugosllavi zhvilloheshin me një shpejtësi aq të shpejt, sa që pothuaj askush nuk mund t'i përcillte e mos të them t'i parashikonte, edhe pse të gjithë ata që donin ta dinin e kishin të qartë se shpërbërja e Jugosllavisë nuk ka të ndalur. . Prandaj, republikat në RSFJ-së filluan garat për fuqizimin e rolit të tyre në procesin e ndarjes a të

shkatërrimit të RSFJ-së, që tanimë ishte diç e paevitueshme. Diplomacia ndërkombëtare për çudi akoma tentonte që disi të ruajë tërësinë territoriale të kësaj kreature artificiale shtetërore, ndoshta për faktin se për to ishte më e lehtë të angazhohen në ruajtjen e Jugosllavisë se sa ballafaqimit me pasojat nga shpërbërja e saj.

Të vetëdijshëm për këtë, ishte imponim i kohës që në këtë valle të rrezikshme politike edhe Kosova të mos mbetej shikues i asaj se çka po ndodhë në Jugosllavi... Kryetari i LDK-së kishte vendosur të mos bënte hapa të ngutshëm dhe të rrezikshëm, pa u konsultuar paraprakisht me miqtë e lëvizjes paqësore dhe demokratike në Kosovë të SHBA-së, posaçërisht, pasi, më 04 prill 1990, ishte ftuar një delegacion i përfaqësuesve politikë të Kosovës për vizitë zyrtare Departamentit të Shtetit në SHBA. Gjatë asaj vizite, Amerika e trajtoi dr. Rugovën sipas protokollit shtetëror ndaj burrështetasve të huaj, me çka botës ia dërgoi mesazhin diplomatik se tani e tutje Amerika Ibrahim Rugovën e pranon si përfaqësues dhe lider të vetëm të shqiptarëve të Kosovës¹⁰⁶.

Kjo vizitë kishte për qëllim mbështetjen dhe promovimin e përcaktimit të shqiptarëve që në mënyrë paqësore dhe demokratike t'i arrijnë të drejtat e tyre, dhe të mos jen pjesë e konfekteve të armatosura.

Pas kthimit nga Washingtoni, filluan angazhimet që institucionet e Kosovës të avancojnë dhe të institucionalizojnë pozicionin e tyre në nivel të barabartë me të gjitha republikat në RSFJ, dhe, varësisht prej lëvizjeve të mëturshme politike në Jugosllavi, edhe Kosova të startojë e barabartë me të tjerët. Për këtë arsye, më 2 korrik 1990, 111 delegat të Kuvendit të Kosovës shpallën Deklaratën e Pavarësisë, pranë hyrjes së ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, për arsye se shërbimi policor serb e kishte okupuar institucionin e kuvendit dhe nuk lejonte hyrjen e delegatëve në sallë. Me miratimin e kësaj deklarate, Kosova u bë njësi e pavarur dhe e barabartë me republikat e tjera në Federatën jugosllave¹⁰⁷.

Mendoj se është më rëndësi të theksoj një vështrim timin, përkitazi me këtë periudhë kohore. Pas shpërndarjes së përbërjes së Kuvendit të Kosovës, i cili në rrethana shtetërore ndryshoi amendamentet në Kushtetutën e Kosovës, në vitin 1989, ish-Partia Komuniste e Jugosllavisë (LKP) u angazhua që në institucionet e tilla të vijnë njerëzit më të përcaktuar partiakisht, të cilët me sjelljet dhe punën e tyre të deriatëhershme kanë dëshmuar se janë anëtarë

¹⁰⁶ Buxhovi, Jusuf, *Kthesa Historike*, SHB "Faik Konica", Prishtinë, 2008, fq. 266.

¹⁰⁷ Këshilli i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, *Raportet ditore*, Prishtinë, 1990.

të devotshëm të Partisë Komuniste. Po këta njerëz, që paraprakisht kanë kaluar me dhjetëra verifikime të nduardurshme partiake dhe shtetërore, më 2 korrik aprovuan Deklaratën e Pavarësisë, Kushtetutën e Kosovës në Kaçanik, më 7 shtator etj. Këtë po e theksoj me qëllim të vlerësimit se me ndryshimin rrënjësor të rrethanave politike e shoqërore, ndryshoi edhe botëkuptimi, ideologjia dhe përcaktimi i individit, por edhe i komunitetit, në përgjithësi. Ndoshta, në fillim ky ndryshim tek shumica e këtyre individëve është i imponueshëm nga faktorë të ndryshëm, si p.sh. rrethi familjar dhe ai shoqëror, por me rëndësi është konstatimi se për çdo proces me interes të përgjithshëm duhej krijuar parakushtet e domosdoshme shoqërore, që një çështje a lëvizje të ketë sukses, në të kundërtën, ato dështojnë. Në historinë tonë ka shumë raste të tilla që këtë konstatim e argumentojnë dhe e dëshmojnë.

Duke u mbështetur në Deklaratën e Pavarësisë së 2 korrikut 1990¹⁰⁸, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 7 shtator 1990, në Kaçanik nxori Kushtetutën e Kosovës¹⁰⁹, të njohur në popull si Kushtetuta e Kaçanikut. Në nenin 1 të saj, përkufizohej se Republika e Kosovës është shtet demokratik i kombit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve të tjera dhe i pakicave kombëtare, të shtetasve të vet (serbëve, myslimanëve, malazezve, kroatëve, turqve, romëve e të tjerëve}, të cilët jetojnë në Kosovë.

Po ashtu, në janar të vitit 1990, gjendja u ndez sërish. Studentët e Universitetit të Prishtinës të udhëhequr nga Lëvizja e Pavarur Studentore e kohës, dolën në rrugë. Në këto rrethana, situata në Kosovë u ndez gjithandej, dhe pas 24 janarit, më askush s'mund ta vendoste nën kontroll. Populli ishte në kulmin e sfidave dhe të rezistencës së madhe. Kosova, s'kishte çfarë të humbte.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve politike, në shtator të vitit 1991 u formua Këshilli Koordinues Ndërpartiak i Kosovës, të cilin e përbënin: Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Fshatare e Kosovës, Partia Demokristiane e Kosovës, Partia

¹⁰⁸ Shih Deklaratën Kushtetuese të Kosovës. Deklarata u aprovua nga 114 delegat të Kuvendit të Kosovës, para dyerve të Kuvendit, sepse atyre kryetari i atëhershëm i Kuvendit, serbi Gjorgje Bozhoviq nuk u mundësonte zhvillime normale të punës së Kuvendit të Kosovës. Këtë ditë ishte paraparë mbledhje e kuvendit por Gjorgje Bozhoviq kishte urdhëruar policinë që të mbylleshin dyert e Parlamentit. Por deputetet ishin të vendosur të vazhdonin me mbledhje dhe ata në hyrje të ndertesës së kuvendit aprovuan Deklaratën e 2 Korrikut, me të cilën Kosova shpallej si njësi e barabartë në Federatën Jugosllave.

¹⁰⁹ Si pasojë e masave që kishte marrë pushteti serb dhe jugosllav, ishte pamundësuar mbledhja e Kuvendit të Kosovës, të cilët në një diskrecion të fortë në rrethana të një shtetrrëthimi ushtarako policor serbo/jugosllav u mblodhë dhe aprovuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Socialdemokrate dhe Partia Republikane e Kosovës. Kryetar i këtij ëshilli u zgjodh, dr. Ibrahim Rugova. Po atë vit u formua edhe Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare të Jugosllavisë (kryetar Dr. Ibrahim Rugova)¹¹⁰.

Nga mesi i vitit 1990 filloi iniciativa për organizimin e referendumit për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Iniciativa për këtë, së pari rrodhi nga Klubi Demokratik në Prishtinë, e cila kërkesë, në fillim u injorua nga LDK-ja, kurse pas një viti kjo ide u aktualizua, por tani si iniciativë dhe program i LDK-së. Pas shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe i pavarur, që Kuvendi i Republikës së Kosovës e bëri në bazë të rezultateve të Referendumit gjithë popullor (26-30 shtator 1991), më 18 tetor 1991, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Rezolutën për Kosovën si shtet sovran dhe i pavarur, kurse më 19 tetor 1991 zgjodhi Qeverinë e Përkohshme të Koalicionit, me kryetar dr. Bujar Bukoshi.

Organizimi i Këshillit Koordinues të partive politike në Kosovë dhe më vonë i partive politike të shqiptarëve në Jugosllavi kishte qëllime dhe objektiva shumë të qarta. Në Kosovë, vete Këshilli Koordinues jetës politike i jepte një kuptim pluralist. Më pastaj, duke e ditur të gjithë shqiptarët Jugosllavisë, po bëheshin përpjekje që jeta e shqiptarëve në Jugosllavi të merrte karakter të përbashkët. Është kjo kohë ku qartë po shihej se Jugosllavia po shpërbëhej ose së paku ajo nuk do të mund të ekzistonte në parimet në të cilat ishte ndërtuar. RSFJ-ja po bëhej pjesë e një të kaluarë dhe po bëhej krijesë që “KOHA” dhe orientimet e përbërësve të saj s’po e duronin si të tillë.

Në këtë kohë dalin propozimet dhe opsionet shqiptare përkitazi me të ardhmen e Kosovës dhe të shqiptarëve të Jugosllavisë. E shpërbërja e Jugosllavisë, shqiptarët do ti copëtonte sërish. Kështu dalin opsionet si: nëse mbetet Jugosllavia, Kosova do të bëhet republikë e barabartë me republikat e tjera; nëse Jugosllavia do të organizohet në baza konfederale, atëherë shqiptarët do të krijojnë republikën e tyre dhe kështu me radhë.

Me organizimin e zgjedhjeve të para plurale, të drejta dhe të lira në Kosovë, me 24 maj 1992, filloi një etapë e re e jetës politike në Kosovë. Kosova formoi Qeverinë e saj dhe instaloi jetën paralele politike, arsimore, kulturore e cila në një formë legalizoi daljen e Kosovës nga çfarëdo ri-rregullimi institucional apo shtetor me Serbinë, të cilën, tani më para opinionit vendor dhe ndërkombëtarë në mënyrë praktike e pasqyronte si okupator klasik.

¹¹⁰ Kujtime nga aktiviteti im në këto procese

Ky organizim i jetës në Kosovë, të organizuar dhe udhëhequr nga Ibrahim Rugova, përçonte mesazh tek të gjithë se Kosova ka kapacitete dhe mundësi që të ekzistoj dhe funksionoj si e pavarur, dhe se këtë tendencë të saj shekullore tenton ta arrij me mjete demokratike dhe paqësore. Në këtë mënyrë, në Kosovë filloi funksionimi i sistemit të pavarur të Kosovës¹¹¹ i cili financohej nga vet populli i saj e në veçanti nga diaspora shqiptare përmes “Fondit të tre përqindëshit”

¹¹¹ Buxhovi, Jusuf. *Kthesa historike – Vitet e Gjermanisë dhe vitet e LDK-së*. Faik Konica, Prishtinë, 2008. fq. 296-299

3.5. Paraqitja e UÇK-së – Rruga drejt të panjohurës

E gjithë kjo çasje ndërkombëtare dhe vendore ndaj çështjes së Kosovës, dëshmoi se nuk po sjell rezultate, të cila tme plot durim dhe flijime i shpresonte populli i Kosovës. Logjikisht, ky vakum ndërmjet fjalëve dhe veprimeve, u krijoi hapësirë forcave të tjera progresive, tanimë jo politike, por militare që përgjegjësinë dhe drejtimin e Kosovës ta marrin ato në duar të veta.

Kjo forcë u prezantua para opinionit si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Fillimi i organizimit të celulave të para të UÇK-së ishte tejet i vështirë dhe kishte edhe çmimin e vet, por rrita e saj nuk kishte të ndalur, prandaj bijtë dhe bijat e Kosovës dhe trojeve të tjera etnike i bashkoheshin asaj. Dhe, kështu nga një celulë guerile, UÇK-ja u ngrit në një forcë ushtarake, i cila do të mbrojë popullin nga gjenocidi serb.

Duke parë këtë, forcat serbe nisin një ofensivë të fuqishme në Drenicë, pikërisht në fshatin Vojnik, në familjen e komandantit Abedin Rexha-Sandokani. Forcat e UÇK-së, nën drejtimin e komandantit legjendar, Adem Jashari, me atë rast shpartalluan makinerinë ushtarake serbe, të cilët në mënyrë të turpshme u zbrapsën dhe ikën nga Drenica. Forcat serbe, gjatë tërheqjes, në shenjë hakmarrjeje, në Llaushë vrasin mësuesin, Halit Geci dhe plagosin rëndë një nxënës.

Në varrimin e mësuesit, Halit Geci, më 28.nëntor 1997, u paraqit për herë të parë publikisht UÇK-ja (Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi dhe Daut Haradinaj)¹¹². Këtë ditë, tre luftëtarë të maskuar të UÇK-së u shfaqën për herë të parë botërisht në varrimin e një mësuesi shqiptar të vrarë nga njësitet serbe, për të shpallur pretendimin e tyre se UÇK-ja ishte e vetmja forcë që luftonte për çlirimin dhe bashkimin kombëtar të Kosovës¹¹³.

Gjatë vitit 1997, UÇK-ja kontrollonte pjesë të rëndësishme të territorit të Kosovës. Kjo ishte e papranueshme për autoritetet serbe, prandaj Milosheviqi vendosi të dërgojë më shumë trupa në këtë regjion¹¹⁴, për të shkatërruar UÇK-në dhe “disiplinuar” popullatën.

Në shumë konfrontime të drejtpërdrejta të policisë dhe guirilës shqiptare që më vonë u shnëdrroa në Ushtrinë çlirimtare të Kosovës, policia serbe kishte pësuar disfata dhe komprometime nënçmuese e të pa shpjeguara për pushtetin dhe opinionin serb. Pas disfatave të

¹¹² Dreshaj, Sylë. *Lëv. e përgjth. e shqiptarëve në luftë për pavarësi në Kosovë*, SHB “Dukagjini”, Pejë, 2002, fq. 23.

¹¹³ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, *Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, “KOHA”, Prishtinë, 2002, fq. 87.

¹¹⁴ Boshkovich, Ivan, *Rambujesë Peace Conference; Road to the Conference and Results*, HIST 7602, Pierre Aselin, PhD, fq. 23.

policisë serbe që përjetuan me 30 dhjetor të vitit 1997 dhe të 22 janarit 1998, shteti i Serbisë kishte planifikuar të ndërmerr një aksion hakmarrës dhe të pasqyrimin të forcës së saj ushtarake duke vënë në lëvizje një makineri të shumtë ushtarake e policore me qëllim-vrasjen e komandantit të celulave të para të UÇK-së, Adem Jasharin, me vëllezër dhe shokë.

Ky sulm filloi në mëngjesin e hershëm të 5 marsit 1998¹¹⁵. Lufta për eliminimin e Jasharëve ishte e rreptë. Policia dhe ushtria serbe, Prekazin, gjegjësisht lagjen e familjes Jashari e kishte vendosur në rreth të hekurt dhe e sulmonte nga shumë anë, duke gjuajtur nga çdo lloj armatimi, por si herave tjera edhe më këtë rast u ballafaqua me vendosmerinë dhe rezistencën jashtëzakonisht të fortë, sikur të ishte duke luftuar me një ushtri të tërë profesionale, e jo vetëm me disa njerëz nga familja e Shaban, Hamëz e Adem Jashari.

Pas një rezistence të gjatë dhe heroike, armiku për shkak të formacioneve të shumta në njerëz të armatosur siq thuhet deri në dhëmb e të mbështetur edhe nga armatimi i rënd që i kishte angazhuar në këtë luftim, arriti të djegë e të shkatërrojë lagjen e Jasharëve e në kuadër të saj të vrasin fizikisht: Adem Jasharin, me vëllaun Hamzën, babain Shabanin dhe pjestarë tjerë të familjes, them fizikisht meqenëse pjesë e edukimit, traditës dhe identitetit të tyre kombëtar e njerëzore ishte përcaktimi se vdekja në luftë për liri e pavarësi nuk është vdekje, por është përjetësi.

Lufta e Adem Jasharit ishte thirrje e përgjithshme drejtuar popullit të Kosovës, se nuk mundet deri në pakufi t'i ikësh luftës, të cilën ta imponon një okupues i paskrupullt, siq ishte me këtë rast Serbia. Njëherësh, kjo luftë e familjes Jashari, ishte edhe mesazh drejtuar diplomacisë dhe opinionit ndërkombëtar se populli i Kosovës, ka ardh në atë gjendje nga përditshmëria e saj e dhunshme sa që është e gatshme të paguajë çdo çmim për t'u çliruar nga Serbia. Një mesazh të këtillë të komandantit të vet e pranoi pothuaj i gjithë populli i Kosovës, por për fat të keq këtë nuk e kuptuan me kohë edhe faktori ndërkombëtar, i cili akoma vlerësonte se Kosova duhet të mbesë pjesë e ndonjë creature të re, e cila do të vazhdonte kontinuitetin e Jugosllavisë.

Paraqitja e UÇK-së detyroi faktorin ndërkombëtar që të kuptojë se problemi i Kosovës nuk është vetëm problem i të drejtave dhe i lirive të njeriut, por është problem shumë më serioz, i cili mund të destabilizojë tërë Ballkanin, fakt ky që po frikësonte shumë edhe Evropën.

¹¹⁵ Dreshaj, Sylë, Vep. e cit., fq. 32.

Masakra e Prekazit, siç theksonte edhe vetë sekretarja e Shtetit të SHBA-ve, Zonja Madeleine Albright, ia shtuan vendosmërinë për ta luftuar fashizmin Milosheviqian¹¹⁶.

Shfaqja e UÇK-së dhe frika për një shkallëzim të dhunës në Kosovë, thirrën së fundi në skenë bashkësinë ndërkombëtare, e cila u detyrua për të vepruar me vendosmëri. Çfarë nuk qe e mundur të arrihej për vite të tëra me protesta paqësore dhe mosbindje qytetare, u arrit brenda pak muajve me anë të dhunës¹¹⁷.

Të mërkurën, më 24 qershor 1989, ambasadorët Holbrook dhe Hill, të shoqëruar nga prof. Fehmi Agani, Veton Surroj, Blerim Shala, dhe dhjetëra gazetarë ndërkombëtarë, vizituan rajonet e përfshira në luftë. Meqenëse rruga ishte mjaft e gjatë, kuptohet, ambasadorët Holbrook dhe Hill, bisedonin me përfaqësuesit shqiptarë që i shoqëronin se si mendonin ata, çka propozonin konkretisht për mbajtjen e një konference politike për njësimin politik shqiptar. Holbrooke kërkonte nga ne propozime konkrete, duke pasur pikënisje domosdoshmërinë e kryerjes së shpejtë të këtij procesi¹¹⁸... Prof. Agani, përfaqësues i LDK-së, insistonte që së pari të mbahet mbledhja e Kuvendit të Kosovës, por ambasadori Holbrook mendonte se kjo është gabim, dhe thoshte: “Më duket se ideja për mbledhjen e Kuvendit të Kosovës nuk është fort e qëlluar. E di se zgjedhjet e kaluara në Kosovë nuk i ka pranuar UÇK-ja dhe disa parti të afërta me të, atëherë duket se duhet krijuar një strukturë, e cila do t’u bashkojë, për t’i marrë kështu mbi vete obligimet dhe përgjegjësitë tuaja”¹¹⁹.

Diplomacia amerikane ende nuk e dinte se kush ishin ata ose ai njeri që mund të përfaqësonte UÇK-në. Për këtë qëllim, ambasadori Holbrook, së bashku me bashkudhëtarët vizituan Junikun, ku u pritën shumë mirë. Ata hynë në odë(dhomë e madhe ku qendronin apo u mbledhnin burrat), ku u takuan me strukturat lokale të UÇK-së, të cilat përfaqësoheshin nga Hajdin Abazi (Lum Haxhiu), i cili njëherësh ishte edhe njëri ndër zëdhënësit të luftës nga ato anë, si dhe nga Gani Shehu, kryetar i LDK-së në Junik. Lumi ishte i veshur në uniformë ushtarake, produkt gjerman. Kishte një AK-47 kinezo-shqiptar dhe ishte i mbathur me çizme ushtarake. Ai u ul pranë Holbrookut, pa hequr për asnjë të vetmin çast armën prej dorës dhe, kjo fotografi, do të kapërthejë mbarë botën atë ditë. Ishte hera e parë që, zyrtarisht një diplomat i lartë amerikan

¹¹⁶ Malcolm, Noel, *Kosova një histori e shkurtër*, SHB“KOHA”, Prishtinë & Shtetpiace Librit, Tiranë, 2001. fq. 303, 304.

¹¹⁷ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, Vep., e cit., fq. 89.

¹¹⁸ Shala, Blerim, Vep. e cit., fq. 91.

¹¹⁹ Vep. e cit., fq. 92.

takohej me uniformën e UÇK-së¹²⁰. Ky takim i ambasadorëve-diplomatëve amerikanë me përfaqësuesit dhe ushtarët e UÇK-së në Junik, publikisht diplomacisë ndërkombëtare dhe opinionit të gjerë do t'i dëshmojë dhe do t'i përcjellë një mesazh për ri, pozicionimin amerikan karshi skenës politike kosovare dhe përcaktimin e vijës, e cila e dëshmonte se është i pashmangshëm pranimi dhe inkuadrimi i UÇK-së në procesin politik të zgjidhjes të çështjes së Kosovës, në të kundërtën nuk ka negociata. Me këtë takim, ish-deklarata e diplomatit Talbot për UÇK-në do të shndërrohej në histori të parëndësishme.

Në këtë kontekst vazhduan edhe reagimet e diplomacisë ndërkombëtare, në radhë të parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë drejtim, edhe zonja Ollbrajt theksonte se në atë kohë, duke pasur frikën e një krize, vazhdimisht bënim presion tek udhëheqësit serbë që të mos ndërmarrin ndonjë valë të re represioni ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, duke i kujtuar përsëri paralajmërimin e Krishtlindjeve (mos të sulmojnë ushtarakisht Kosovën se Amerika do t'iu kundërpërgjigjet)¹²¹.

Ne kërkonim të bindim shqiptarët e moderuar, duke nxitur dialogun me Beogradin, që kishte për qëllim rivendosjen e autonomisë së Kosovës¹²². Ndoshta, edhe për këtë qëllim, kryebashkëbiseduesi amerikan në Ballkan, ambasadori Robert Gelbart, e denoncoi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si grup terrorist¹²³ me 23 shkurt 1998. Një botëkuptim të tillë lidhur me UÇK-në e kishte edhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së, i cili me Rezolutën e saj numër 1160 denonte “përdorimin e tepërt të forcës së policisë serbe kundër civilëve dhe protestuesve në Kosovë” dhe një kohësisht i denonte edhe veprimet “terroriste të UÇK-së”¹²⁴. Rezoluta poashtu i kërkonte palëve që të fillojnë menjëherë një dialog pa kushte paraprake dhe të gjejnë zgjidhje politike lidhur me problemet që i konfrontojnë palët në konflikt.

Disa muaj më vonë, në qershor të vitit 1998, Departamenti i Shtetit të SHBA-së deklaroi përmes zëdhënësit, James Rubin se amerikanët as nuk e kishin konsideruar dhe as nuk e konsideronin UÇK-në si terroriste¹²⁵. Kjo deklaratë, për ata që e përcillnin politikën e shtetit më të fuqishëm në botë, ishte një sinjal se diçka mund të ndryshonte pozitivisht dhe kjo ishte shpresëdhënëse, në drejtim pozitiv për një zgjidhje ndryshe të çështjes së Kosovës, nga ato deri

¹²⁰ Shala, Blerim, Vep. e cit., fq. 94.

¹²¹ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare*, SHB “Dudaj”, Tiranë, fq. 444.

¹²² Vep e cit., fq. 443.

¹²³ Malcolm, Noel, Vep. e cit., fq. 303 e 304.

¹²⁴ Për më tepër shiko Rezolutën 1160 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (31 mars 1998)

¹²⁵ Milo, Paskal, *Ditari i një ministri të Jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2000*, SHB “Toena”, Tiranë, fq. 74.

atëherë të proklamuar nga bashkësia ndërkombëtare. Për shkak të intensifikimit të dhunës dhe terrorit të forcave, ushtarake, policore dhe paramilitare serbe ndaj popullatës në Kosovë, nxiten një valë të madhe të debimeve-ikjëve të popullatës civile shqiptare drejt shteteve fqinje e nga aty anëkend Europës e botës. Nga ana tjetër UÇK filloi armatimin e njësiteve të saj të cilat për një periudhë kohore disa mujore prej paraqitjes së saj publike numëronte me mijëra pjestarë

Në po këtë kohë, më 21 prill 1998, senatorët Mitch McConnell dhe Joseph Lieberman, kërkojnë që administrata e SHBA-ve të financojë 25 milionë dollarë për armë për rreth 10.000 anëtarë të UÇK-së¹²⁶. Në diplomacinë amerikane po hapej një dritare e vogël, nga e cila po shihej se zgjidhja përfundimtare e statusit të Kosovës mund të jetë më ndryshe, sesa që ishte e proklamuar deri atë ditë.

Me 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, miratoi edhe një Rezolutë tjetër për Kosovën, Rezolutën 1199m me anë të së cilës kërkohej armëpushimi nga të dy palët dhe kthimi i refugjatëve në shtëpitë e tyre. Mbeshtetur në këtë rezolutë filluan edhe bisedimet Millosheviq – Hollbruk si të dërguarin special i SHBA-së. Të dy këto rezoluta dhe shumë të tjera para dhe pas tyre Kosovën e konsideronin si pjesë e pandashme e Serbisë dhe në kuadër të këtij botëkuptimi duhen gjetur zgjidhjet adekuate dhe të pranueshme për të dy palët e konfrontuara, që noshta ishte diqka e mundur në aspektin teorik se në atë praktik ishte diqka e pamundur dhe e pa qëndrueshme..

Kosova, për një kohë të gjatë, mbetet vatër krize, me mundësi shpërthimi. Vërtet në Kosovë filloi konflikti dhe besohej se do të shpërthente një luftë e armatosur. Por, megjithatë pavarësisht krizës, vrasjeve, plagosjeve, burgosjeve, shtypjes, represionit, debimit të qytetarëve e masave nga më të ndryshmet kundër popullatës shumicë, aty konflikti i armatosur me përmasa më shqetësuese ende nuk po shpërthente, në rradhë të parë për shkak të pritjeve në ndihmen dhe besimit të jashtëzakonshëm që e kishte populli i Kosovës në SHBA-në dhe shtetet tjera perendimore që do të ndërhyjnë në zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës.

Interesi amerikan për shqiptarët dhe për Kosovën daton moti në histori. Ky interes shihet si interes amerikan për Shqipërinë dhe për shqiptarët dhe buron nga parimet civilizuese të vlerave që SHBA-të përfaqësojnë¹²⁷. Për më tepër, nuk bën të mos përmend rolin e presidentit Wilson, i

¹²⁶ Boshkovich, Ivan, Vep. e cit., fq. 27.

¹²⁷ Bytyçi, Enver, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Evropës Juglindore, Tiranë, 2012, fq. 371.

cili qysh në vitin 1918 propozoi **Katërmëdhjet Pikat** e njohura, në bazë të të cilave do të ndërtohej rendi i ri botëror. Në pikën e parë të këtij programi thuhej se duhet të vendosim një drejtësi, e cila nuk duhet të ketë asnjë favorizim dhe diferencim, por të njohë të drejtën e barabartë të kombeve¹²⁸. Dhe e vërteta është se politika amerikane, pavarësisht ndryshimeve në etapa të ndryshme kohore gjatë historisë, megjithatë përherë ka qenë e favorshme për shqiptarët dhe për Kosovën gjithashtu. Edhe një moment që duhet potencuar pikërisht pse i takon presidentit Wilson, dhe kjo është: Në janar të viti 1919, Wilson deklaroi se Qeveria amerikane kundërshton në mënyrë të vendosur copëtimin e trefishtë të Shqipërisë (midis Italisë, Greqisë dhe Serbisë), duke denoncuar Traktatin e Fshehtë të Londrës të vitit 1915, traktat i cili u paraqit si zgjidhje në Versajë¹²⁹.

Kontradiktat në përpjekjet për të zhvilluar një politikë të jashtme të Kongresit Amerikan nëpërmjet rezolutave dhe amendamenteve arriti kulmin me të ashtuquajturin Amendamenti i Niklesit, i cili u miratua në nëntor të vitit 1990 dhe hyri në fuqi pas gjashtë muajsh, dhe kështu, Amendamenti i tij që u bë Ligj me gjithë kundërshtimin e Administratës së Bushit, e ndalonte ndihmën ekonomike Jugosllavisë deri sa Serbia të pushonte shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë”.¹³⁰ Ambasadori amerikan në Beograd, Warren Zimmermann, gjithashtu mendonte se kjo qasje e senatorëve amerikanë rreth çështjes së Kosovës ndërlikon mundësinë për të gjetur një rrugëdalje paqësore dhe demokratike për krizën e Kosovës... Për këtë arsye, ai disa herë kishte provuar që përmes bisedave telefonike, senatorëve të lartpërmendur që mbështetnin Kosovën, posaçërisht, Robert Dollin dhe Niklesin, tu shpjegojë përse angazhimi i tyre do të sillte rezultate të kundërta nga ato që ata shpresonin. Në tentimin për të biseduar me senatorin Doll, rreth kësaj problematike, një anëtar i personelit i kishte thënë se Senatori Doll po i thotë se pse “ky ambasador nuk po e ndërpret thirrjen e senatorëve në telefon dhe nuk merret me atë për të cilën paguhet”¹³¹.

Konkretisht, një delegacion i senatorit Doll vizitoi Kosovën në gusht të vitit 1990, i shoqëruar nga senatorët Alfons d’Amato, Don Niklesi, Ambasadori Zimmermann etj. Dhe, pas vërtetimit të drejtpërdrejtë për dhunën që e përjetonte populli shqiptar nga serbët e Serbia,

¹²⁸ Versailles zum Weltkrieg, *Përmbledhje dokumentesh*, Munchen, 1965, fq. 31, cit. nga Enver Bytyçi në „Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë”, Instituti i Studimeve të Evropës Juglindore, Tiranë, 2012, fq. 371.

¹²⁹ Bytyçi, Enver, Vep. e cit., fq. 371.

¹³⁰ Zimmermann Warren. “Burimet e një katastrofe” Shtëpia botuese Besa-Tiranë 1996. fq.129

¹³¹ Vep. e cituar. fq.132

senatori Robert Doll dhe të tjerët, ishin bindur se Kosova duhet të bëhej e pavarur, sepse Qeveria serbe shkelte të drejtat e shqiptarëve etnikë¹³². Presioni dhe lobimi i këtyre senatorëve amerikanë gradualisht po vetëdijesonte administratën amerikane për çështjen e Kosovës.

Më 21 qershor 1991, sekretari i Shtetit, Bejker, në emër të Konferencës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë, bëri përpjekje, njërën nga të fundit, për t'u shmangur dhuna, si pasojë e shkatërrimit të Jugosllavisë. Gjatë kësaj vizite, sekretari amerikan Bejker, për një ditë, pati nëntë takime të njëpasnjëshme me udhëheqësit shqiptarë nga Kosova, me udhëheqësit e republikave dhe dy takime me kryeministrin jugosllav, Markoviq, dhe me ministrin e Jashtëm Llonçar. Por, edhe në takimin e drejtpërdrejtë me Milosheviqin, Bejker potencoi qëndrimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës se ato nuk vënë në dyshim unitetin ose integritetin e Serbisë, por po ashtu i tha se ai (Milosheviqi) po ndizte tensionet etnike, duke shtypur të drejtat e shqiptarëve në Kosovë¹³³.

Që nga fillimi, kriza e Kosovës një çështje “sui generis”, siç u praktikua të prezantohej në fazën e fundit të procesit të pavarësimit të saj. Ishte e veçantë, sepse faktori ndërkombëtar këtë çështje në çdo formë tentonte ta minimizonte dhe në një mënyrë e injoronte. Kjo krizë ishte një sfidë shumë komplekse për diplomacinë stereotipe evropiane, pse jo edhe për diplomacinë amerikane, të cilat paragjykonin zgjidhjen e çështjes së Kosovës, duke lënë mënjanë pavarësinë saj si mundësi. Kosova është mësimi më i mirë për tërë diplomacinë moderne botërore, në përgjithësi, dhe për diplomacinë amerikane, në veçanti, se asnjë krizë serioze nuk mund të zgjidhet, po qe se paraprakisht injorohet cilado zgjidhje e mundshme e problemit.

Me fillimin e shkatërrimit të Jugosllavisë, për shkak se Serbia këmbëngulte të zotërojë mbi sistemin kushtetues të RSFJ-së, entiteteve tjera brenda tij detyrimisht u organizuan që të mbrohen. Logjikisht, Kroacia dhe Sllovenia kërkonin revidimin e Kushtetutës jugosllave të vitit 1974, në mënyrë që të forconin garancitë për pozitat e tyre¹³⁴.

Edhe Kosova kërkonte kthimin e pozitës së vet kushtetues, sidomos duke marrë parasysh abrogimin e njëanshëm të statusit të vet më 1988 dhe 1989. Më vonë kërkoi që t'i ngrihej statusi në republikë të plotë, si mjet parandalimi të situatave të ngjashme në të ardhmen¹³⁵. Po qe se këto kërkesa minimale dhe të domosdoshme dhe tejet të arsyeshme do të përkraheshin nga faktori

¹³² Warren, Zimmermann, Vep. e cit., fq. 130.

¹³³ Vep e cit., fq. 134,

¹³⁴ Marc, Weller, *Shtetësia e kontestuar*, SHB “KOHA”, Prishtinë, 2009, fq. 93.

¹³⁵ Vep. e cit., fq. 93.

ndërkombëtar, sigurisht se ish-krijesa RSFJ-së do të funksiononte edhe për një kohë të caktuar. Veprimi fillestar ndërkombëtar nuk ishte përqendruar në bindjen e udhëheqjes serbe për të kthyer konsensusin paraprak kushtetues ose për të negociuar një të ri. Në vend të kësaj, trysnia ndërkombëtare ishte drejtuar nga Kroacia dhe Sllovenia¹³⁶, të cilat ishin të detyruara të vepronin për të mbrojtur veten.

Diplomacia ndërkombëtare, pothuaj e tëra, përkrahte Serbinë, sepse, gjatë tërë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë, në skenën ndërkombëtare kishte arritur që këtë shtet ta identifikonte me Serbinë. Për këtë arsye, në vend që t'ia tërhiqnin vërejtjen apo ta kërcënonin Serbinë, që të ndërprejë tentimin që Jugosllavinë ta shndërrojë në “Serbi të Madhe”, ata dërguan emisarët e BE-së dhe sekretarin amerikan të Shtetit, Baker, të cilët Sllovenisë dhe Kroacisë ua përcollën mesazhin e përbashkët se i përkrahin kërkesat e tyre për autonomi më të gjerë, por lëvizjet në drejtim të pavarësisë nuk do të kishin mbështetje. Do të pasonte një konfrontim i kotë, ku, si Sllovenia ashtu edhe Kroacia, do të humbnin¹³⁷. Një mesazh të tillë, disa vite më vonë, iu përcoll edhe Kosovës, por edhe Kosova, si Sllovenia dhe Kroacia, këtë mesazh nuk e pranoi.

Por, si gjithnjë deri me rastin e Kosovës, në vitin 1999, diplomacia ndërkombëtare ishte jo unike dhe nuk i përmbahej interesave të përgjithshme, duke mbizotëruar gjithnjë interesat vetjake. Për këtë arsye, përmes të kanaleve të fshehta, Gjermania, Austria dhe disa shtete përkrahëse të Sllovenisë dhe Kroacisë, dërgonin sinjale se do ta përkrahnin pavarësinë e tyre, po që se vendosin që ato ta shpallin. Në këtë fazë të shkatërrimit të RSFJ-së, pothuajse Kosova nuk ekzistonte fare në agjendat e faktorit ndërkombëtar, pos disa kërkesave për ndërprerjen e shkeljeve të drejtave dhe lirive të njeriut.

Diplomacia ndërkombëtare lidhur me çështjen e Kosovës ishte stereotipe e ngadalshme dhe jo unike. Të gjithë e dinin se Serbia, nën udhëheqjen e Milosheviqit, po bënte terror me përmasa të gjenocidit ndaj popullit shqiptar në Kosovë, por, prapëseprapë, ngurrnin që këtë ta pranonin publikisht, sepse ishin të vetëdijshëm se po që se opinioni demokratik ndërkombëtar do të kuptonte të vërtetën se çfarë po ndodhë në Kosovë, do të kërkonte nga qeveritë e tyre që të ndërmarrin masat për parandalimin e kësaj tragjedie.

Në vizitën e 6 shkurtit të vitit 1998 në Shqipëri, ministrit i Jashtëm gjerman, z. Kinkel, për çështjen e Kosovës tha: “Jemi të shqetësuar dhe Milosheviqi duhet të kuptojë se situata atje

¹³⁶ Marc, Weller, Vep. e cit., fq. 93.

¹³⁷ Po aty.

po vëzhgohet nga afër, veçanërisht nga SHBA-ja dhe Gjermania. Një pakicë serbe në Kosovë nuk mund të sundojë 90 për qind të shqiptarëve atje. Do të kërkojmë zgjidhje politike, pasi e dimë që Beogradi bën mashtime politike¹³⁸. Por, po ashtu z. Kinkel, pas këtij takimi, në konferencën e tij të mbajtur me gazetarë, nuk ngurroi të proklamojë qëndrimet diplomatike rreth çështjes së Kosovës. Ai në këtë konferencë shtypi, theksoi: “Për çështjen e Kosovës kemi të njëjtin mendim që kemi edhe për çështjen e kurdëve, jo separatizëm. Pavarësinë e Kosovës nuk e mbështesim. Kosova, për fat të keq, nuk u përfshi në Marrëveshjen e Dejtonit, por do të përpiqemi të bëjmë diçka, por nuk mund të ndërhyjmë në punët e brendshme të Kosovës, por as nuk e përkrahim lëvizjen separatiste”¹³⁹.

Franca, formuloi qëndrimin: As status quo ekzistues, as pavarësi, por një autonomi substanciale. Ministri i Punëve të Jashtme të Francës, Hubert Vedrin, në takimin me homologun e tij shqiptar, Paskal Milo, të 6 marsit 1998 në Paris, kështu e shprehu pozicionin e diplomacisë franceze përkitazi me çështjen e Kosovës: “Dua ta konfirmoj këtu qëndrimin e Francës për Kosovën, i cili ka të bëjë me gjetjen e një formule të autonomisë, ashtu siç edhe ka ekzistuar, një autonomi me peshë të rëndësishme, por në asnjë mënyrë nuk duhet menduar për pavarësi”¹⁴⁰.

Qëndrim të çuditshëm rreth Kosovës kishte edhe kryeministri i Shqipërisë, zotëri Fatos Nano, i cili gjatë takimit në Crans Montana i dha një intervistë agjencisë “Reuter”, ku ka identifikuar UÇK-në me dhunën dhe kërkoi prej saj të ulë armët. Po ashtu është shprehur hapur edhe kundër pavarësisë së Kosovës, pa i kërkuar kush që të prononcohej¹⁴¹.

Shtetet perendimore, edhe pse parimisht ishin pro vazhdimin të ekzistimit të Jugosllavisë në fillimet e shpërbërjes së saj, ato ishin përcaktuar se nuk planifikonin përdorimin apo përkrahjen e forcës për mbrojtjen e ekzistimit të Jugosllavisë si etnitet i përbashkët¹⁴².

Analistët amerikanë, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të tyre i kishin bërë analiza për të ardhmën e Jugosllavisë pas kryetarit të saj historik më shumë se 35 vjet, Josip Broz Tito¹⁴³. Njëkohësisht, institucionet amerikane e vlerësonin se demonstratat e shqiptarëve të vitit 1981, kanë rëndësi strategjike¹⁴⁴.

¹³⁸ Milo, Paskal, *Ditari i një Ministri të Jashtëm-Konflikti i Kosovës 1997-2001*, SHB “Toena”, Tiranë, 2009, fq. 33.

¹³⁹ Po aty..

¹⁴⁰ Vepra e cituar, fq. 36.

¹⁴¹ Vep. e cit., fq. 75.

¹⁴² Ramet P Sabrina. *Ballkan Babel-The Disintegration of Yugoslavia from the death of Tito to the fall of Milosevic*. (Boulder Westview Press, 2002) fq.44-46

¹⁴³ Baev Jordan. *US Intelligence Community Estimates on Yugoslavia*. National Security and the future, 2000.

¹⁴⁴ NSDD - National Security Decision Directives (NSDD 133. March 14 “US Policy Toward Yugoslavia”

SHBA-të, fillimisht problemin e Jugosllavisë e konsideronin si problem i Bashkësisë Europiane

Që nga fillimi i trajtimit së çështjes së Kosovës si vetëm problem i të drejtave të njeriut Kongresi amerikan përmes debateve dhe rezolutave të saja kritikonte administratën shtetërore të SHBA-ve, për pasivitetin, hezitimet dhe çasjen joadekuate ndaj problemit të Kosovës. Në këtë drejtim më të zëshmit ishin: Xhozef Diogardi, përfaqësues i dhomës së ulët të Kongresit Amerikan dhe njëkohësisht drejtuës i lobit shqiptaro – amerikan, kolegu i tij demokrat Tom Lantosh, senatori republikan Bob Dol si dhe senatori Alfonso D’Amato kërkonin dhe insistonin tek administrata e Kryetarit të SHBA-ve, Xhorxh Bush që të ndërhynte tek regjimi i Beogradit dhe të kërkonte të ndërpritet dhuna ndaj demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.¹⁴⁵

Në raportin e senatorit Bob Dol lidhur me vizitën e delegacionit të Kongresit amerikan Kosovës, në gusht të vitit 1990, potencohet se qeveria e Serbisë e përkrahur edhe nga qeveria qendrore e RSFJ-së, po zbaton shtet policor. Senatori Dol, shprehet se SHBA-të, nuk guxon, nuk nundet që ende të mbesin anash këtij problemi dhe se kanë obligim moral që të vendosen në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, dhe kërkonin ndërhyrjen e vendosur në këtë drejtim nga Vashingtoni¹⁴⁶.

Shkelja e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë ka qenë shkas që kongresisti amerikan Don Nickles të paraqes para Kongresit draft ligjin për ndërprerjen e ndihmës ekonomike ndaj Jugosllavisë i cili në formë më të zbutur për shkak të ndërhyrjes së kongresistës proserbe Helen Deliq-Bentley, u aprovua në nëntor të vitit 1990 si “Amandmani Nickles&Bentley”. Amandmani në fjalë parashihte se SHBA-të do ta ndërpresin ndihmen ekonomike Jugosllavisë po që se nuk zhvillohen zgjedhjet e lira dhe demokratike në të gjitha republikat dhe nëse Serbia nuk e ndërpret shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë. Sekretari i shtetit të SHBA-ve James Baker me këtë rast shfrytëzoi të drejtën e tij të diskrecionit dhe nuk lejoi hyrjen në fuqi të këtij amandmani, meqenëse sipas vlerësimit të administratës amerikane, cak i saj nuk do të jet Millosheviqi por reformat e Kryeministrit jugosllav Ante Marković¹⁴⁷.

Me kërkesen dhe insistimin e Stejt Departamentit Amerikan dhe Shtëpisë së Bardhë gjatë viteve 1989 -1990, ja bllokuan një numër i konsiderueshëm i rezolutave në Kongresin amerikan, për çudi edhe ato më të përgjithësuarat, si p.sh. ”kërkesa drejtuar të gjitha palëve të përmbahen

¹⁴⁵ Warren, Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, SHB “Besa”, Tiranë, 1996, fq. 28.

¹⁴⁶ Vepra e cituar, fq. 106.

¹⁴⁷ Vepra e cituar, fq. 109.

nga dhuna” apo “denimi i përdorimit të dhunës’. Nivelet e larta të administratës së Xhorxh Bushit, jo rrallë kanë kundërshtuar kërkesat e senatorëve të partisë republikane që ishte në pushtet “që SHBA-të ta denojnë politikën e Slllobodan Millosheviqit”¹⁴⁸ ..

Në takimin e zëvendës sekretarit të SHBA-së, **Lawrence Sidney Eagleburger**, në shkurt të vitit 1990 gjatë vizitës së tij në Jugosllavi me përfaqësuesit e të gjitha partive opozitare ka potencuar se të drejtat e njeriut, ekonomia e lirë e tregut mund më së miri të zhvillohen po që se Jugosllavia mbetet unike, dhe se SHBA-së nuk do ta përkrah shpërbërjen e Federatës së Jugosllavisë, por po që se kjo ndodh SHBA-së nuk do tënë zgjedhje tjetër pos ta pranojnë një gjë të tillë¹⁴⁹ .

Vet zëvendës sekretari i shtetit të SHBA-së pas vizitës në Jugosllavi ka konstatuar se gjendja atje është e rënd dhe se shpërbërja e saj do të jet shumë më e vështir se sa është parashikuar e vlerësuar dhe nga ky vlerësim ka pasuar instruksioni dërguar të gjithë ambasadorëve të tyre në shtetet perendimore ku ata janë të akredituar që të përçojnë mesazhin amerikan “ SHBA-të, kërkojnë që të mbeshtetet uniteti i Jugosllavisë, dhe programi i reformave të kryeministrit Markoviq, me sugjerimin se shpërbërja e Jugosllavisë nuk është në interes të popullit sllav e as sigurisë së Europës, dhe se nga SHBA-të pritet se nga shtetet evropiane nuk do të ndërmerret asnjë veprim që mund të inkurajon ndarjen e Jugosllavisë”¹⁵⁰

Kjo qasje inerte për çështjen e Kosovës nga nivelet më përgjegjëse të Amerikës, e detyruan sekretaren e Shtetit, Madeleine Albright, që të veprojë dhe t’i bindë a të detyrojë varësitë e saj që ta diskutojnë urgjentisht mundësinë e bombardimeve. Mungesën e një paralajmërimi të qartë, Milosheviqi do ta interpretonte si një dritë të gjelbër për ushtrimin e represionit¹⁵¹.

Për këtë qëllim, më 23 prill 1998, Madeleine Albright, i ftoi, Bob Gelbard dhe Strob Talbott për të diskutuar këtë çështje me Bob Bergerin: “vura në dukje se hapat që po ndërmerrem, nuk ishin të mjaftueshëm. Kosova do të shkonte drejt një konfrontimi me përmasa

¹⁴⁸ Congressional Record, US House of Representative. Regarding Albanian Minorities in Yugoslavia, vol.136 , no.145, 22 October 1990, H11472. 1990 (marrë nga disertacioni i Ana D. Petkovic – Universiteti i Beogradit, Fakulteti Filozofik: *SHBA dhe shpërbërja e Jugosllavisë-Diplomacia Amerikane dhe konflikti Ballkanik 1989-1995*) fq.42.

¹⁴⁹ Warren, Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, SHB “Besa”, Tiranë, 1996, fq. 44.

¹⁵⁰ National Intelligence Estimate, NIE 15-90: Yugoslavia Transformed, Director of Central Intelligence, Langley, VA, 18 October 1990 (marrë nga disertacioni i Ana D. Petkovic – Universiteti i Beogradit, Fakulteti Filozofik: *SHBA dhe shpërbërja e Jugosllavisë-Diplomacia Amerikane dhe konflikti Ballkanik 1989-1995*) fq.45

¹⁵¹ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare*, SHB “Dudaj”, Tiranë, fq. 447.

të mëdha, po të mos arrihet një marrëveshje politike, gjë që nuk po ndodhë pa e bërë Milosheviqin të ndihet i kërcënuar dhe ai nuk do të ndihet i tillë pa shtruar për diskutim përdorimin e forcës.

Qëndrimi ynë në atë kohë ishte se asgjë nuk përjashtohet. Kjo deklaratë tingëllonte e dobët dhe ashtu ishte vërtetë”. Këto diskutime tentoj t’i ndërpres, Sandy Berger-i, i cili i inatosur pyeti: “Si mund të flisni për bombardime ndërmjet Evropës? Cilat janë objektivat që doni të qëlloni? Çdo të bëni të nesërmen? Është një veprim i papërgjegjshëm të vazhdohet me deklarata kërcënuese pa pasur një plan të arsyeshëm. Nga mënyra si flisni për bombardime ju të Departamentit të Shtetit, duket se paskeni luajtur mendsh! Sekretarja e shtetit Albright, me vendosmëri e kishte ndërprerë Bergerin, dhe tha: ”Nuk duroj dot më! Sa herë dikush flet për përdorimin e forcës, fillojnë sulmet personale. Para pesë vjetësh, kur propozova përdorimin e forcës në Bosnjë, Tony Lake nuk më la asnjëherë ta çoja deri në fund arsyetimin tim. E, po tani që jam sekretare e Shtetit, do të këmbëngul që kjo çështje të paktën të shtrohet për diskutim!”¹⁵².

Po ashtu, edhe në terren po shihej se politika amerikane ndaj Kosovës dëshironte të krijojë disa kontura të reja të diplomacisë së saj, por paqartësitë e spektrit politik dhe ushtarak në Kosovë detyruan diplomatët amerikanë që të qartësojnë këtë pozicion të secilit faktor vendimmarrës në Kosovë. Për këtë arsye, ambasadori amerikan në Shkup, zotëri Hill, më 19 qershor 1998, i ftoi për një bisedë disa përfaqësues të spektrit politik të Kosovës, me qëllim t’u tregoj se Amerika i sugjeron se në Kosovë duhet krijuar një strukturë të re politike kosovare, në të cilën do të inkuadroheshin, së pari, përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pastaj ata që ishin të afërt me UÇK-në, në radhë të parë Adem Demaçi dhe udhëheqësit e Lidhjes së Re Demokratike të Kosovës, si Rexhep Qosja, Hydajet Hyseni e Mehmet Hajrizi, si dhe personalitetet e pavarura, që mund të ishin të dobishëm në procesin negociator¹⁵³. Përfaqësuesit kosovar në këtë takim, prof. Fehmi Agani dhe Blerim Shala, përkrahen një iniciativë të këtillë. Planifikohej të organizohet një lloj tubimi politik, një lloj konference politike të partive politike shqiptare, ku do të emërohej kjo strukturë e re politike dhe grupi i ri negociator. Diplomacia amerikane që në javën në vijim filloi ta implementojë këtë plan të vetin.

Por, “KOHA” në vazhdim do të dëshmojë se sa është e vështirë, mos të them e pamundur, që partitë politike dhe jopolitike në Kosovë të bashkoheshin dhe të shprehin mirëkuptim ndërmjet

¹⁵² Madeleine, Albright, Vep. e cit., fq. 447.

¹⁵³ Shala, Blerim. *Vitet e Kosovës 1998-1999*, GAMA, Prishtinë, 2001. fq. 90.

vete pa një ndërhyrje dhe kërcënim direkt dhe të pakompromis nga një fuqi çfarë është Amerika. Këtë e dëshmon edhe takimi i ambasadorëve Holbrook dhe Hill me Ibrahim Rugovën, Fehmi Aganin, Veton Surroin dhe me Blerim Shalën, në zyrën e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ambasadori Holbrook, do të shfaqte haptazi pakënaqësitë e tij me nivelin organizativ të shqiptarëve të Kosovës. Ne nuk mund të ecim para pa pasur një partner serioz te ju. Duhet të organizoheni më mirë. Duhet t'i lini prapa meritë dhe inatet personale. Ta zëmë, ju zotëri president Rugova, kur e keni thirrur për herë të fundit Demaçin për të diskutuar me të problemet në Kosovë? Dr. Rugova iu përgjigj, siç e kishte zakon në këto raste: "Paj, e kam thirrur dhe do ta thërras. Por, ne këtu kemi një rend demokratik të krijuar në zgjedhje dhe duhet ta ruajmë atë. Hollbrooke, këtu iu drejtua bashkëpunëtorëve të tij, të cilëve, pos Hillit, iu lut ta lëshonin sallën ku bëhej takimi. Dhe vazhdoi: "Kemi bisedë shumë të rëndësishme me dr. Rugovën dhe me bashkëpunëtorët e tij", po u thoshte atyre ndërsa po dilnin nga salla. Pastaj, iu drejtua sërish Rugovës: "Shikoni, zotëri President! Unë ju çmoj si president, edhe pse e dini mirë se as ne, e as dikush tjetër në Perëndim, nuk ua ka njohur zgjedhjet. Këtu, më nuk kemi kohë për të humbur. Ju duhet të takoheni me zotin Demaçi, javën e ardhshme. Sa ditë ju nevojiten për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet dhe për të krijuar një trup të ri ekzekutiv? Tri ditë, pesë, gjashtë?"¹⁵⁴. Po t'i jepte afat edhe disa vite, prapë do të ishte e kotë.

Njëjtë ishte edhe tentimi me Demaçin, njëjtë ishte me Qosjen, Hydajet Hysenin, njëjtë do të ishte edhe me ndonjë tjetër nga UÇK-ja. Të gjithë ishin të gatshëm të bisedonin me Milosheviqin për çështjen e Kosovës, por të bisedonin dhe të bashkoheshin njëri me tjetrin për interes të Kosovës, asnjëri nuk pranonte. Egoja personale ishte dhe mbeti më e fortë dhe mbi interesin e Kosovës dhe popullit, në të cilin u përbetonin!!!

Është shumë simptomatike pasqyrimi i këtyre takimeve, siç e paraqesin autorët e ndryshëm pjesëmarrës të këtyre takimeve. Që për auditorin e gjerë të ketë një pasqyrim më përmbajtjesor të pozicionimit të spektrit tonë politik në Kosovë, do ta elaboroj me komentet e ambasadorit amerikan Holbrook, që njihet si arkitekt i Marrëveshjes së Dejtonit dhe njëri ndër diplomatët më të spikatur ndërkombëtarë përkitazi me takimet e tij me politikanët shqiptarë të Kosovës.

Në takimet veç e veç me përfaqësuesit shqiptarë, ai pothuaj çdo herë dilte taktit dhe nuk mund ta fshihte zemërimin e tij, kjo për një personalitet diplomatik të nivelit të tij është diçka e

¹⁵⁴ Shala, Blerim, Vep. e cit., fq. 96.

paimagjinueshme. Blerim Shala, si pjesëmarrës në ato takime, në librin e tij “Vitet e Kosovës 1998-1999”, paraqet një skenë nga këto takime. Holbrooke i drejtohet Blerim Shalës: “Merre me mend, Demaçi po na mëson neve se cili është interesi amerikan në Kosovë dhe me kë duhet të bashkëpunojmë ne e më kë jo. Më beso, kam pasur në karrierën time qindra takime shumë të vështira, me njerëz shumë të mbrapshtë dhe shumë kokëfortë, por kësi takimi kurrë nuk kam pasur”¹⁵⁵. Çka është edhe më shumë e çuditshme, Demaçi në një rast dhe publikisht ka kërkuar nga State Departamenti për të zëvendësuar Holbrookun dhe Hillin si ndërmjetës kryesor amerikan për çështjen e Kosovës.

Koha ka dëshmuar se pothuaj është e pamundur që partitë politike ose përfaqësuesit e ndryshëm politikë shqiptarë të bashkohen dhe të shprehin mirëkuptim ndërmjet vete, pa një ndërhyrje dhe kërcënim direkt dhe të pakompromis nga një fuqi çfarë është Amerika¹⁵⁶.

Paragjykimet personale dhe ideologjike dhe plot çështje të tjera të udhëheqësisë politike të Kosovës, të cilat, për fat të mirë, populli as në ëndrrat më të këqija nuk mund t’i paramendonte pasqyron realitetin tonë, në bazë të së cilit përfaqësuesit tanë në atë fazë kohore nuk kishin njohuri dhe kapacitet të nevojshëm diplomatik të shihnin problemin në koloritin diplomatik, por e shihnin vetëm bardhezi, si gjithmonë në të kaluarën, dhe çfarë ishte edhe më tragjike, sipas këndvështrimit individual veç e veç të çdo përfaqësuesi, i cili konsideronte se ai është përfaqësuesi i vetëm i popullit të Kosovës!!!

Të dhënat e shumta të publikuara në formë librash a dokumentesh të atyre periudhave, tregojnë se sa shumë varet fati, e ardhmja a e vërteta e një populli a e një vendi nga vendosmëria dhe humaniteti i një diplomati-njeri. Kosova ka pasur shumë fat që në fazën përfundimtare të zgjidhjes së çështjes së saj, në krye të diplomacisë së shtetit më të fuqishëm në botë ka qenë një sekretare që tragjedinë e popullit të Kosovës e ka përjetuar ndryshe nga diplomatët e tjerë, sigurisht edhe për faktin se i ka takuar një populli që i ka përjetuar të njëjtat tragjedi nga Hitleri, sikurse shqiptarët në Kosovë që po i përjetonin nga Milosheviqi.

Zonja Albright në librin e saj “Zonja Sekretare” argumenton: “Mungesa e gatishmërisë së Shteteve të Bashkuara për të miratuar pavarësinë e Kosovës nuk lidhej aq shumë me parimet sesa me vlerësimin praktik të qëndrimeve në rajon. Maqedonia dhe Greqia kundërshtonin me forcë pavarësinë e Kosovës, sepse kishin frikë se kjo mund të nxiste ambiciet separatiste të popullsive

¹⁵⁵ Shala, Blerim, Vep. e cit., fq. 105.

¹⁵⁶ Vep. e cit., fq. 149.

të tyre shqiptare etnike. Edhe vendet të tjera kishin pakica që ushqenin dëshira për pavarësi, si çeçenët e Rosisë, abkhazët e Gjeorgjisë, kurdët e Turqisë dhe baskët e Spanjës. Në një vështrim më të përgjithshëm, disa evropianë kishin frikë se një Kosovë e pavarur do të bëhej një vatër e nxehtë e ekstremizmit islamik dhe e krimit të organizuar. Pa mbështetjen e Evropës nuk mund t'i realizonim qëllimet tona në Kosovë dhe, nga ana tjetër, po të përkrahnim pavarësinë e Kosovës, nuk do të kishim mbështetjen e Evropës"¹⁵⁷ E gjithë kjo dëshmon se diplomacia evropiane deri në rastin e Kosovës, kryesisht është perceptuar nga interesat globale të shteteve me ndikim politik, ekonomik e ushtarak ndonjëherë edhe në kundërshtim me të drejtën dhe humanizmin e proklamuar publikisht.

Politika injoruese serbe ndaj faktorit ndërkombëtar, para së gjithash ndaj miqve dhe përkrahësve historikë të serbëve para opinionit ndërkombëtar, i ka detyruar shtetet evropiane, pa dëshirën e tyre, që ta zbusin përkrahjen ndaj Milosheviqit, ndoshta edhe nga frika të fuqizimit të tij të tepërt në skenën politike ndërkombëtare. Sllovenia dhe Kroacia ishin një mesazh drejtuar skenës politike shqiptare se pa luftë nuk do t'i realizonin kurrë synimet e tyre kombëtare. Ngase, Marrëveshja e Dejtonit nuk e përfshiu Kosovën dhe kjo do të dëshmohej si një gabim i madh¹⁵⁸. Sigurisht se për konceptin evropian, mospërfshirja e Kosovës në Marrëveshjen e Dejtonit ishte gabim dhe, sipas mendimit të tyre, do ta minimizonin hapësirën për luftën në Kosovë, por, nga ana tjetër, mospërfshirja e Kosovës në Marrëveshjen e Dejtonit është fat shumë i madh se sigurisht në ato kohëra dhe rrethana as që mund të paramendohej që Kosova të ketë ndonjë formulim që mund të jepte ndoshta në një kohë të largët mundësinë e pavarësisë së saj. Opsioni maksimal do të ishte autonomia e Kosovës me shumë finesa dykuptimore diplomatike, që popullin e saj për një kohë të gjatë do ta linin prapë nën tiraninë serbe.

Në janar të vitit 1996, Rudolph Perina, shef i misionit diplomatik të SHBA-ve në Beograd dhe pjesëmarrës në Konferencën Paqësore për Bosnjë-Hercegovinën, në mbledhjen e mbajtur me dyer të mbyllura me kryesinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, do të ballafaqohet me pyetjen: Pse në Dayton nuk u hap çështja e Kosovës. Perina, do të jetë i qartë dhe i drejtpërdrejt: "Në Dayton janë ftuar ata që kanë luftuar"¹⁵⁹. Kjo, në njëfarë mënyre, ishte një mesazh këshillëdhënës për ata që kuptojnë gjuhën diplomatike. "KOHA" dëshmoi se mesazhe të këtilla, ai rreth i LDK-së, nuk ka mundur ta kuptojë, e ndoshta as nuk ka dëshiruar ta kuptojë...

¹⁵⁷ Albright, Madeleine. Vep. e cit., fq. 449, fusnota 1.

¹⁵⁸ Fischer, Joschka. *Vitet kuq-gjelbër*, SHB "KOHA", Prishtinë, 2007, fq. 99.

¹⁵⁹ Shala, Blërim. Vep. e cit., fq. 22,

3.6. Unifikimi i imponuar i spektrit politik dhe ushtarak të Kosovës

Me insistimin e Ambasadës Amerikane në Beograd, më 18 mars 1998, në Prishtinë u emërua nga dr. Ibrahim Rugova, Grupi Negociator i Kosovës, i cili kishte për qëllim të tregohet vullneti negociues i Kosovës për zgjidhjen e çështjes së Kosovës me mjete politike. “Grupi Negociator i Kosovës, i njohur si G-15, ishte në këtë përbërje: Ibrahim Rugova, Adem Demaçi, Veton Surroi, Mahmut Bakalli, Hydajet Hyseni, Shkëlzen Maliqi, Bujar Dugolli, Blerim Shala, Rexhep Ismajli, Mark Krasniqi, Pajazit Nushi, Esat Stavileci, Fehmi Agani, Edita Tahiri dhe Bujar Bukoshi¹⁶⁰. Për fat të mirë, ky grup mbeti jofunksional, për shkak të rrjedhave tragjike në terren. U fillua të kuptohet nga bashkësia ndërkombëtare se me Serbinë nuk ka biseda të qëndrueshme dhe njëkohësisht pa marrë parasysh a po i pëlqente a jo faktorit ndërkombëtar, nuk mund të përjashtohet nga procesi eventual i bisedimeve një forcë e re, e emërtuar si Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që kishte një peshë dhe përkrahje nga populli që as nuk bën dhe as nuk lejohet të injorohet.

E drejta natyrore dhe fati në ato periudha përcaktuese ishte aleati më i madh dhe i vetmi i popullit të Kosovës.

Terrori serb ndaj shqiptarëve në Kosovë, që kishte elemente të shumta të gjenocidit, medoemos detyroi faktorin ndërkombëtar të mos i mbyllë sytë ndaj masakrave që forcat paramilitare dhe militare serbe po i ndërmerinin ndaj popullatës civile, sepse u kuptua, siç shkruan, Joschka Fisher, ish-Ministër i Punëve të Jashtme dhe zëvendëskancelar i Republikës së Gjermanisë, se këto ofensiva të ushtrisë, policisë dhe të njësive paramilitare serbe u udhëhoqën si luftë etnike, sipas modelit të luftërave në Bosnjë dhe në Kroaci. Me këtë rast, pati sulme brutale kundër popullatës shqiptare.

Si pasojë e këtyre ofensivave serbe, në bazë të të dhënave të OKB-së, në vjeshtën e vitit 1998, nga Kosova në arrati ishin 230 mijë njerëz, 50 mijë prej tyre (kryesisht gra, fëmijë dhe pleq (vër. e autorit), ishin të zhvendosur brenda Kosovës, të cilët me arritjen e muajve të dimrit do të ishin pa kurrfarë mbrojtje. Jo lufta kundër UÇK-së, por para së gjithash terrorizimi dhe dëbimi i popullatës shqiptare, ishin qëllimi i vërtetë i luftës¹⁶¹.

Edhe në këto rrethana, UÇK-ja ndërmori një ofensivë verore, që doli se ishte katastrofë e vërtetë, sidomos për popullatën civile, sepse, kundërofensiva serbe ishte e papërmbajtshme dhe e

¹⁶⁰ Shala, Blerim, Vep. e cit., fq. 37.

¹⁶¹ Fischer, Joschka, Vep. e cit., fq. 100.

vazhdueshme. Strategjia serbe kishte për qëllim që njërive guerile t'ua prishte rrugët e furnizimit, të kontrollonin rajonet përgjatë kufirit të krahinës me Shqipërinë dhe pastaj t'i dëbonin forcat kryengritëse nga çdo fshat pa përjashtim. Kjo çoi në një fushatë frikësimesh, dhe bëri që qindra mijëra civilë bashkë me luftëtarë të UÇK-së, të merrnin malet e bjeshkët¹⁶². Sipas vlerësimit të zonjës Albright, UÇK-ja me sulmet e tyre kishte për qëllim t'i nxitnin forcat serbe të kundërpërgjigjeshin në shkallë të gjerë, në mënyrë që të siguronin ndërhyrjen ndërkombëtare¹⁶³. Realiteti në terren i detyroi së pari amerikanët ta kuptojnë se në Kosovë po rrezikohet dhe masakrohet popullata civile dhe se nuk është në pyetje përkrahja a mos përkrahja e UÇK-së. Sepse, siç e cek në librin e saj “Zonja sekretare”, sekretarja e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Albright: “Guerilët po premtin se do të çlironin Kosovën nga Serbia pa bisedime dhe pa kompromise. Ata u zotuan gjithashtu të mbronin civilët në zonat që kishin “çliruar”. Por, kur serbët u hodhën në sulm, UÇK-ja ia mbathi. Fshatarët u trajtuan mizorisht nga forcat serbe dhe u zhgënjyen nga të ashtuquajturit “mbrojtjes të tyre”¹⁶⁴. E gjendja në terren përkeqësohet shumë. Sidomos gjendja e civilëve, të cilët shndërrohen refugjatë, duke u detyruar të ikin për të shpëtuar kokën.

Kështu, sipas një vlerësimi të UNCHR-së, më 29 shtator të vitit 1998 kishim si më poshtë: popullatë shqiptare të shpërngulur brenda territorit të Kosovës: 200.000 persona, të shpërngulur në Mal të Zi: 41.800 persona, të shpërngulur në pjesë të tjera të Serbisë : 20.000 veta, të shpërngulur në Bosnje dhe Hercegovinë: 6.800 persona dhe të shpërngulur në Shqipëri: 18.000 persona, në Turqi: 2000, në Slloveni poashtu 2000, ndërsa në FYROM (Maqedoni) 1000 persona. Vetëm, deri në shtator të vitit 1998 nga Kosova janë shpërngulur 291.600¹⁶⁵ persona, në periudhën në vijim deri në qershor të vitit 1999 janë shpërngulur me dhunë edhe disa qindra mijëra të tjerë.

¹⁶² Albright, Madeleine, Vep. e cit., fq. 451.

¹⁶³ Vep. e cit., fq. 450 .

¹⁶⁴ Vep. e cit., fq. 451.

¹⁶⁵ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, *Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, SHB “KOHA”, Prishtinë, 2002, fq. 119.

3.7. Masakrat ndaj popullatës civile në Kosovë, shkas i ndërhyrjes ndërkombëtare

Masakra e Reçakut është një ndër aktet më barbare të para në historinë moderne. Forcat serbe kishin vrarë e masakruar numër të madh shqiptarësh. Kjo masakër tmerroi gjithë botën demokratike dhe mobilizoi diplomacinë ndërkombëtare për të ndërrar kursin e angazhimit për zgjidhje e çështjes së Kosovës.

Më 16 janar 1999, anëtarët e Misionit Verifikues, në një hendeq jashtë fshatit Reçak gjetën 45 kufoma kryesisht civilë. të cilët ishin masakruar nga ushtria dhe njësia speciale serbe. Kësaj radhe, së bashku me përfaqësuesit e Misionit Verifikues ishin edhe përfaqësuesit e medieve ndërkombëtare dhe kështu pamjet e masakrës qarkulluan në gjithë botën.

“A po fillonte pas Bosnjës dhe Kroacisë, sërish loja e dyfishtë e përgjakshme e Milosheviqit me bashkësinë ndërkombëtare? Ishte kjo pyetja që ia parashtronin të gjitha ministritë e jashtme të botës perëndimore. Përgjigjja ishte: ”Deri këtu dhe asnjë centimetër më tutje¹⁶⁶. Këtë masakër, zonja Albright e përshkruan në librin e saj kështu: “Disa njerëz zgjohen në mëngjes me këngën e këndesit, zilen e orës a gurgullimën e kafesë që zien.

Si banore e Uashingtonit unë zgjohem me lajmet e radios. Meqenëse ishte e shtunë, 16 janar 1999, radion e hapa pak më vonë se ditëve të tjera, gjithsesi para agimit. Dëgjova folësin që po kumtonte për një masakër që kishte ndodhur pesë mijë milje larg. Hollësitë nuk vonuan të mbërrinin. “Aty ka shumë trupa të pajetë, - u deklaronte ambasadori Bill Walker gazetarëve, - njerëz që janë qëlluar në mënyra të ndryshme, por shumica e tyre janë vrarë nga fare afër”.

Në qytetin e Reçakut (në fshatin Reçak, vër. e autorit), në Kosovë, ishin gjetur trupat e dyzetë e pesë njerëzve. Walker i kishte parë trupat me sytë e tij, shumë prej të cilëve ishin të shpërndarë në një shpat mali e të mbuluar me borë, të tjerët të hedhur njëri mbi tjetrin, secili prej tyre me plagë të llahtarshme, të gjithë të veshur civilë, njëri me kokë të prerë. I pyetur se kush ishte përgjegjës për atë masakër, Walkeri nuk ngurroi të përgjigjej: “Policia serbe”¹⁶⁷. Walker, menjëherë pas vizitës në fshat deklaroi: ”Pasi mbërrita në Raçak, banorët e tij më çuan në vendin, ku me tmerr të madh pashë kufomat e 20 njerëzve, të cilat, me sa duket, kishin mbetur atje ku ishin ekzekutuar. Megjithëse unë pashë vetëm 20 kufoma, kryesisht pleq, të vrarë nga afër me të

¹⁶⁶ Fischer, Joschka, *Vitet kuq – gjelber*, SHB „KOHA“, Prishtinë, 2007., fq. 118.

¹⁶⁷ Madeleine, Albright, *Zonja Sekretare*, SHB “Dudaj”, Tiranë, fq. 458.

shtëna në ballë, në zverk ose në kokë – vëzhgues të tjerë kanë gjetur kufoma të tjera. Edhe pse nuk jam jurist, ajo që pashë më bën ta përcaktoj pa nguriim këtë rast si masakër, si krim kundër njerëzimit¹⁶⁸.

Kjo masakër shtyri sekretaren e Shtetit të SHBA-së që atë ditë, siç e potencon edhe vetë, të flasë me telefon me gjysmën e botës: “Thira Sandy Berger-in dhe i thashë e trishtuar: Duket sikur këtë vit pranvera në Kosovë ka ardhur më heret¹⁶⁹. Kjo masakër detyroi SHBA-të që të ndërmarrin veprimet para se të fillonte sulmi i NATO-s ndaj caqeve ushtarake serbe: “Kërkuam nga gjenerali Wesley Clark, komandant suprem të NATO-së, dhe gjeneralit Klauss Naumann, kryetar i Komitetit Ushtarak të Aleancës, të shkonin në Beograd dhe të paralajmëronin Milosheviqin që të mos ndërmernte shkelje të tjera të këtij lloji, të kërkonin që Gjykata për Krimet e Luftës të lejohej të hetonte ngjarjet e Raçakut dhe t’i kujtonin atij se kërcënimi i NATO-s për përdorimin e forcës vazhdonte të mbetej ende në fuqi. Thirra në një takim ministrit e Jashtëm të vendeve të NATO-së, dhe u propozova që Aleanca të rishikonte dhe modernizonte planet për fillimin e goditjeve ushtarake. Mblodha gjithashtu këshilltarët e mi më të lartë, duke u kërkuar një strategji që do të gërshetonte forcën dhe diplomacinë për të ndaluar veprimet e Milosheviqit, në mënyrë që Kosova të mos kalonte nën gueriljet e UÇK-së”¹⁷⁰.

Masakra e Recakut shënon kulmin e dhunës dhe terrorit, i cili po merrte përmasa shfarosjeje, ndërkohë që gjendja ishte acaruar tashmë që më parë. Në datën e ndërrimit të viteve 1998-1999, UNHCR-ja e vlerësonte numrin e të dëbuarve të ishte në gati 180.000, luftimet e janarit shtrënguan edhe rreth 30.000 veta të braktisnin shtëpitë. Megjithëse pas përleshjeve lokale, vinin faza përmirësimi në dukje, kur shumë njerëz ktheheshin në shtëpitë e tyre, gjendja e përgjithshme mbetej jashtëzakonisht kritike. Racaku, pra, nuk mund të gjykohej i shkëputur nga keqësimi i përgjithshëm i gjendjes në krahinë, por me të u mbush kupa dhe forcat politike të bashkësisë ndërkombëtare u shtrënguan të gjenin zgjidhje me çdo mjet¹⁷¹. Dhe, mobilizimi i bashkësisë ndërkombëtare solli veprimet konkrete.

Filluan me urgjencë përgatitjet për organizimin e një konference, ku do të duhej të gjindej zgjidhje për Kosovën, sepse “KOHA” s’priste më. Kështu në takimin e datës 22 janar 1999 të Grupit të Kontaktit, elementet bazë të hartuar nga Petrici, të cilat në thelb përbëheshin nga

¹⁶⁸ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, Vep. e cit., fq. 155.

¹⁶⁹ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare*, SHB “Dudaj”, Tiranë fq. 459.

¹⁷⁰ Po aty.

¹⁷¹ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, Vep. e cit., fq. 161.

formulimet e 11 pikave të Marrëveshjes Hollbruk – Milosheviq, qëndrimet e shqiptarëve të Kosovës dhe qëndrimet e Grupit të Kontaktit, u pranuan, me gjithë skepticizmin e SHBA-së, si bazë e padiskutueshme për bisedimet (non negotiable principles). Më tej u vendos që palët, duke pranuar të merrnin pjesë në bisedime, të shprehnin gatishmërinë e tyre për të pranuar parimet e këtij katalogu¹⁷². Dhe, konferenca përgatitet me shpejtësi, e cila do të mbahet në Rambuje.

3.8. Konferenca ndërkombëtare në Rambuje për zgjidhjen e statusit të Kosovës

Me 6 shkurt 1999 në Rambuje të Francës, filluan negociatat nën organizimin ndërkombëtar në mes udhëheqjes serbe dhe udhëheqjes shqiptare, duke përfshirë edhe përfaqësuesit të UÇK-së për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Konferenca filloi me përshëndetjen e kryetarit të Francës, Jacques Chirak, i cili në fjalën e tij në mes tjerash theksonte: “Ka momente të rralla, kur historia është në duar të disa njerëzve. Një rast i tillë është edhe sot për ju që merrni vendime në tavolinën e bisedimeve. Korniza e këtyre bisedimeve është definuar qartë nga Grupi i Kontaktit-parimet e një autonomie substanciale. E kemi zgjidhjen midis vazhdimit të tragjedisë, të së kaluarës dhe shpresës për të ardhmen. Ne nuk pranojmë që cikli i dhunës të kërcënojë shumë e më shumë tërë stabilitetin e Evropës Juglindore”¹⁷³.

Fillimi i bisedimeve, në javën e parë pothuaj, ishte i kotë, sepse, delegacioni serb nuk i merrte seriozisht bisedimet, dhe sigurisht kishte pranuar të marrë pjesë vetëm për arsye të trysnisë dhe kërcënimeve konkrete ndërkombëtare. Ndërsa, shqiptarët këmbëngulnin për të drejtën e tyre, për të zhvilluar një referendum përfundimtar, përkitazi me pavarësinë, të cilët ishin kokëfortë si mushka¹⁷⁴.

Në fillim ishte edhe një atmosferë e zymtë në mesin e delegacionit shqiptar, sepse, për befasi të shumë diplomatëve, delegacioni shqiptar, papritmas, kryetar të delegacionit të tyre zgjodhi një komandant të UÇK-së, 29-vjeçar, Hashim Thaçi¹⁷⁵. E vërteta është se edhe në Kosovë brenda spektrit politik shqiptar, në radhë të parë dhe pastaj edhe ndërmjet spektrit

¹⁷² Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, *Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, SHB “KOHA”, Prishtinë, 2002, fq. 163.

¹⁷³ Gjeloshi, Nikë, *Kosova 1999, as republikë e proklamuar, as autonomi e imponuar*. Tiranë, 2002, fq. 274.

¹⁷⁴ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare*, SHB “Dudaj”, Tiranë, fq. 462- 464.

¹⁷⁵ Po aty.

politik dhe ushtarak shqiptar, kishte mospërputhje qëndrimesh. Delegacioni shqiptar ishte i përbërë prej tri grupe, të cilat, në momente të caktuara, as që kanë pasur komunikim të ndërsjellë.

Përçarja në spektrin politik shqiptar kishte ndodhur qysh herët. Në fakt ishte Konferenca e Daytonit që nisi të zbehë autoritetin e pakontestueshëm të liderit të LDK-së, Ibrahim Rugova, i cili kishte kaluar nëpër procesin e zgjedhjeve, të cilat nga pushteti serb (jugosllav) konsiderheshin ilegale. Ai ishte zgjedhur president dy herë përmes proceseve zgjedhore, ndërkohë që zgjedhjet e dyta, të cilat ishin organizuar gjatë kohës kur në shumë zona të Kosovës kishte konflikte të armatosura, ishin kontestuar mjaft shumë.

Rugova bënte përpjekje që kushtimisht të mbante monopolin e LDK-së në jetën politike të Kosovës, ndërkohë që situata në terren diktonte diçka me shumë se politikbërje, e cila jo rrallë herë dukej improvizim pa rezultat. Nga ana tjetër faktori ushtarak dhe përkrahësit e saj në Kosovë, kërkonin mbisundimin e tyre në raportet politike, diplomatike rreth çështjes së Kosovës dhe njëkohësisht nuk pranonin anashkalimin dhe nënçmimin e forcës së tyre., që në fakt ishte jo vetëm e pamundshme, por edhe shumë problematike. Prandaj, fillimisht, Grupi i Kontaktit¹⁷⁶ kishte rënë dakord për përfshirjen në bisedime të krahut politik të UÇK-së, të gatshëm për kompromis, të kryesuar nga Hashim Thaçi. Por zgjidhja u gjet pak përpara fillimit të koferencës¹⁷⁷.

Krahas faktorit ushtarak, tashmë që u bë faktor i pashmangshëm, kishte edhe pjesë të tjera të spektrit politik shqiptar që nuk mund të lesheshin anash. Në këtë konteskt, më 1 shkurt 1999, Petrisch dhe Hill ua dorëzuan kryesuesve të Lëvizjes Demokratike të Kosovës (LDK) Rexhep Qosjes, Hydajet Hysenit, Mehmet Hajrizit dhe Bajram Kosumit ftesën zyrtare për të marrë pjesë në Konferencë. Përfaqësuesit e LDK-së pranuan pjesëmarrjen në konferencë, sipas kushteve të hartuara nga Grupi i Kontaktit¹⁷⁸.

Adem Demaçi, një ish-i burgosur politik, i cili ishte përfaqësues i UÇK-së, refuzoi pjesëmarrjen në konferencë, kurse Veton Surroi e Blerim Shala bëhen pjesëmarrës të konferencës pa qenë anëtarë të asnjërit nga grupet e delegacionit, por që, sipas raporteve nga konferencam, bëhen kontribues të jashtëzakonshëm të suksesit të koferencës, në kuptim të kontributit të palës shqiptare.

¹⁷⁶ Grupi i Kontaktit, i themeluar më 1994, përbëhet nga vendet kryesore të interesuara për Ballkanin: Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia.

¹⁷⁷ Petrisch, Wolfgang & Pichler, Robert, *Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe bashkësia ndw kombëtare 1989-1999*, SHB "KOHA", Prishtinë, 2002, fq. 62.

¹⁷⁸ Petrisch, Wolfgang & Pichler, Robert, Vep. e cit., fq. 169.

Që të largohej nga një latërgji e këtillë, diplomati amerikan, Christopher Hill, njoftoi dhe e ftoi sekretaren e Shtetit të SHBA-së të vijë në Francë dhe të ndikojë te delegacionet që bisedat t'i merrnin seriozisht.

Zonja Albright, së pari bisedoi me kryetarin e Serbisë, Milan Milutinoviçin. Siç shkruan ajo në librin e vet, presidentit serb i kishte thënë: “Zgjidhja politike që kishim paraqitur, ishte e mirë për vendin e tij. Ajo do të çarmatoste UÇK-në, do ta mbante Kosovën brenda Jugosllavisë dhe do t'i jepte mundësinë ushtrisë së saj të vazhdonte të patrullonte kufirin. Prania e forcës paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO-ja do ta ndihmonte e nuk do të dëmtonte, sepse do të ruante edhe të drejtat e njeriut të pakicës etnike serbe në Kosovë. Ndryshe, i thashë do të krijohej një Çeçeni brenda kufijve tuaj. Njëkohësisht do të gjendeni në një situatë edhe më të vështirë përballë bashkësisë ndërkombëtare dhe NATO-së. Kjo nuk duhet të ndodhë. Duke shfrytëzuar rastin që po u jepet për paqe, keni mundësinë të hyni në Evropë dhe në Perëndim”¹⁷⁹.

Teksti parë i marrëveshjes që i'u dorëzua negociatorëve përbënte pesë pika: ndalimin e menjëhershme të dhunës; tërheqjen nga Kosova të ushtrisë, policisë dhe forcave paraushtarake serbe.; vendosjen e një force ushtarakendërkombëtare të udhëhequr nga NATO; rikthimi i sigurt i refugjatëve dhe të shpërngulurëve të tjerë në shtëpitë e tyre dhe pika pesë përcaktonte një zgjidhje politike për autonomi të zgjeruar të Kosovës brenda Serbisë. Edhe pala serbe edhe ajo shqiptare e kundërshtuan një tekst të tillë të marrëveshjes. Delegacioni shqiptarë kundërshtuan propozimin për një autonomi të zgjeruar të cilin vetëm e kishin pasur me Kushtetutën e vitit 1974 të Jugosllavisë dhe të asaj të Kosovës. Ndërsa pala serbe e kundërshtonte marrëveshjen e ofruar për shkak se nuk pranonin prezencën e trupave ndërkombëtare siq e quanin ata në territorin e tyre, sepse Kosovën e konsideronin dhe e trajtonin edhe në këtë konferencë si pjesë e pandashme e Serbisë, dhe problemin e negociuar këtu në Rambuje e pranonin vetëm si problem të brendshëm të saj e jo ndërkombëtar.

Këtu dokumentohej se diplomacia ndërkombëtare, ende vazhdonte ta konsideronte Kosovën si pjesë të pandashme të Jugosllavisë dhe vetëm insistonte një qeverisje më të gjerë të institucioneve të Kosovës, të cilën e emërtonin si autonomi substanciale

¹⁷⁹ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare*, SHB “Dudaj”, Tiranë fq. 462-464.

Po ashtu, edhe takimet e zonjës Albright me delegacionin shqiptar ishin të vështira, por me këtë rast, delegacioni shqiptar kishte të drejtë, sepse marrëveshja nuk ishte po aq e favorshme për popullin e tyre, po qe se do të nënshkruhej dhe pranohej nga të dyja palët. Nuk garantonte, mos të them, nuk përkufizonte arritjen e synimit kryesor të Kosovës, arritjen e pavarësisë së saj.

Zonja Albright kështu e përshkruante delegacionin shqiptar dhe takimet me ta: “Termi “i ndryshëm” mund të ishte shpikur shumë mirë për këtë grup, i cili përbëhej që nga enigmatiku Rugova, e deri tek pragmatiku, Surroi dhe problematiku, Thaçi. Askush prej tyre nuk kishte marrë ndonjëherë pjesë në bisedime të koklavitura, sigurisht jo në shkallë botërore. Përveç kësaj, vazhdonin të kishin ende shumë mosmarrëveshje ndërmjet tyre.

Mesazhi im për shqiptarët përmbante të njëjtat argumente, të cilat që ua kisha paraqitur edhe serbëve: “Ju jeni udhëheqës. Jeni zgjedhur për të përfaqësuar popullin tuaj. Mendohuni mirë përpara se t’i dënoni ata me një të ardhme me luftë. Marrëveshja që kemi propozuar ne, do t’u japë vetëqeverisjen, mbrojtjen e NATO-s, ndihmë ekonomike, të drejtën për të arsimuar fëmijët tuaj në gjuhën amtare, si dhe mundësinë për të ushtruar kontroll mbi jetën tuaj. Nëse e pranoni atë, do të shkoni drejt një të ardhmeje të begatë, demokracisë dhe integritetit në Evropë. Po e hodhët poshtë atë, për pasojë do të përfshiheni në një luftë që ju do ta humbisni, e bashkë me të edhe mbështetjen ndërkombëtare¹⁸⁰.

Me fjalë të tjera, delegacionit shqiptar iu paraqit në formë të butë një ultimatum me këtë përmbajtje: “Nëse ju e nënshkruani marrëveshjen, ne do të jemi me ju, ndërsa po e refuzuat atë, ju do të mbeten vetëm”¹⁸¹. Nga këto dy biseda që i bëri sekretarja e Shtetit të SHBA-së, shihet se nuk përmbanin të njëjtat argumente të shprehura delegacionit serb dhe atij shqiptar, edhe pse ajo kështu i ka konsideruar? Derisa presidentit serb i kishte thënë se marrëveshja do ta çarmatoste UÇK-në, do ta mbante Kosovën brenda Jugosllavisë, do t’ia mundësonte ushtrisë serbe të vazhdojë të patrullonte, që nënkupton kontrollon kufirin etj. Ndërsa, delegacionit shqiptar i ofronin arsimimin e fëmijëve në gjuhën amtare, ndihmë ekonomike, mbrojtjen e NATO-së dhe kontrollin mbi jetën, por jo edhe mbi kufijtë e Kosovës etj. Të gjitha këto që ofronte në fillim marrëveshja, ishte mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, sipas normave ndërkombëtare.

¹⁸⁰ Albright, Madeleine, Vep. e cit., fq. 462-465.

¹⁸¹ Milo, Paskal, *Ditari i një Ministri të Jashtëm. Konflikti i Kosovës 1997-2001*, SHB “Toena”, Tiranë, 2009, fq. 149.

Konferenca e Rambujesë ishte një shembull zyrtë i diplomacisë shtrënguese-intervenimi ushtarak ishte kërcënim për Serbinë, nëse ajo nuk do të pranonte kërkesat e organizatorëve të Konferencës së Rambujesë. Dhe, për më tepër, më shumë se kushdo tjetër diplomat, Albright avokonte përdorimin e forcës për zgjidhjen e problemit të Kosovës¹⁸².

E vërteta është se gjendja në Kosovë nuk priste dhe se duhej gjetur zgjidhje, qoftë edhe të imponuar. Situata në Kosovë po shkonte drejt katastrofës humanitare, në një anë, dhe drejt mundësive për përhapje të konfliktit në gjithë Ballkanin, në anën tjetër. Bashkësia Ndërkombëtare nuk ishte e gatshme që këtë ta lejonte. Pastaj lufta e Bosnjës-Hercegovinës ishte shembull se vonesa në veprim shkonte në favor të tragjediave edhe më të mëdha. Këtë nuk do ta lejonte në ansjë mënyrë SHBA-ja. Tash kishte ardhur “KOHA” që zgjidhja duhej gjetur dhe duhej pranuar. Duhej edhe imponuar nëse nuk pranohej.

Kur Albright për herë të parë arrin në Rambuje, zëdhënësi i saj nënvizon: “Ajo nuk është këtu të negociojë, ajo është këtu të demonstrojë se ne jemi gati të kthejmë diplomacinë me forcë, duke marrë pjesë në vendsjen e paqes, nëse do të kemi marrëveshje ose duke treguar kërcënimet e NATO-s për sulme ndaj caqeve serbe, nëse serbët janë shkaktarë të dështimit të bisedimeve”¹⁸³.

Është e kuptueshme se delegacioni ynë ishte para një sfide shumë të vështirë dhe komplekse dhe më të drejtë ishte në dilemë se çfarë të vendosë.

Nga njëra anë, ishte para një përgjegjësie morale, sepse, po qe se nuk e nënshkruante Marrëveshjen e këtë do ta bënte delegacioni serb, atëherë tragjedia e popullit të Kosovës do të hynte në një fazë edhe më tragjike se deri atëherë.

Po qe se e nënshkruan Marrëveshjen e këtë e bën edhe delegacioni serb, atëherë mund të etiketoheshin si tradhtarë dhe shitës të Kosovës. Askush nuk guxonte të besonte se Serbia nuk do të nënshkruajë Marrëveshjen, edhe pse kishte shumë paralajmërime nga institucionet dhe mediet e tyre.

Konferenca e Rambujesë në kuadër të bisedimeve të Kosovës me Serbinë nën lehtësimin e bashkësisë ndërkombëtare kishte edhe “Parimet e Panegociushme/Elementet bazike”¹⁸⁴, mbi të

¹⁸² http://www.wwnorton.com/college/polisci/lenses/protect/print/cs_ks_albright_dip.htm (qasur mw 10. 1. 2015).

¹⁸³ Albright arrives in Paris with direct message for Kosovo negotiators," International News Section, *Agence France Presse*, 14 February 1999.

¹⁸⁴ Shala, Blerim. *Vitet e Kosovës 1998-1999*. Gama. Prishtinë, 2001. fq. 213

cilat duhej të ndërtohej Marrëveshja Kalimtare për Kosovën, e të cilat ishin përcaktuar në takimin e Grupit të Kontaktit në nivel ministror, në Londër me 29 janar 1999.

Në “Elementet e Përgjithshme” të këtyre parimeve të panegoceushm përcaktohej paraprakisht se ndalja e menjëhershme e dhunës dhe respektimi i armëpushimit, nuk është çështje e negociatave ajo duhet të implementohet menjëherë. Poashtu, këto parime nënkuptonin karakterin kalimtar të Marrëveshjes, krijimin e mekanizmave politikë pas një periudhe tre vjeçare, zgjidhjen paqësore me anë të dialogut, mosndryshimin unilateral të statusit kalimtar, pranimin e integritetit territorial të RFJ-së dhe vendeve fqinje, parashihnin pajtimin për hyrjen ndërkombëtare në Kosovë, qeverisjen në Kosovë ku Kosova do ta ketë një pushtet të plotë ligjëvenës (Kuvendin), ekzekutiv (Presidentin e Kosovës, qeverinë, organet e administratës shtetërore), dhe gjyqësor, që nënkuptonte sistemin e plotë dhe të pavarur gjyqësor. Këto parime potenconin faktin se asnjëra palë ndërluftuese nuk do të ndjekë penalisht dikë për krime lufte (përveç krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera serioze të së drejtës ndërkombëtare, amnistinë dhe lirimin e të burgosurëve politikë dhe pjesëmarrja ndërkombëtare dhe bashkëpunimi i plotë i të gjitha palëve në implementimin e kësaj Marrëveshjeje¹⁸⁵. Krahas kësaj propozohen edhe aspekte të qeverisjes në Kosovë, si në vijim: Populli i Kosovës do të qeveriset nga institucionet e saj të zgjedhura në mënyrë demokratike etj. Dhe njëkohësisht janë propozuar edhe aspektet e qeverisjes në Kosovë, siq është: Kosova, do të ketë shkallë të lartë të vetëqeverisjes, që do të realizohet nga organet e saj legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të cilat kanë autoritet, veç të tjerash edhe mbi taksat, financat, policinë, zhvillimin ekonomik, sistemin gjyqësor, përkujdesjen shëndetësore, arsimin dhe kulturën, pastaj të bashkësive nacionale, përcaktimin e qartë të kompetencave lokale, përfaqësimin e barabartë të të gjitha bashkësive kombëtare në nivelet e administratës dhe qeverisë lokale. Parimet përcaktonin se policia lokale në përbërjen e saj do të përfaqësoj përbërjen etnike, kuadri ligjor serb dhe federal (RFJ) domosdoshmërisht duhet të përputhen me Marrëveshjen kalimtare të Kosovës, dhe një aspekt shumë i rëndësishëm i këtyre parimeve ishte parimi se nga Kosova duhet të kërkohet pëlqimi, veç të tjerash, për ndryshimin e kufijve të Kosovës dhe për shpalljen e ligjit të luftës.

Në këto parime janë paraparë edhe të drejtat e njeriut, nga mbrojtja juridike e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pjestarëve të bashkësive kombëtare sipas marrëveshjeve ndërkombëtare,

¹⁸⁵ Buja, Ramë, *Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë*, Univerziteti AAB-Prishtinë 2007. fq. 320.

zgjedhja e ombudspersonit me këshillin kombëtar dhe roli i OSBE-së dhe i organizatave tjera ndërkombëtare.

Sipas këtyre elementeve të përgjithëshme të parimeve të panegociushme, zbatimi i marrëveshjes do të bëhet përmes një mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Komisionit të përbashkët për mbikëqyrjen e zbatimit dhe OSBE-së dhe organizatave tjera ndërkombëtare sipas nevojës¹⁸⁶.

Këto parime të panegociushme më së miri pasqyrojnë përcaktimin e diplomacisë ndërkombëtare për të ardhmen e Kosovës, e cila edhe me këtë rast shihej në kuadër të RFJ-së! Por, më në fund, fati, të mos them, Zoti, bekoj delegacionin shqiptar që të rrezikojë dhe të nënshkruajnë “Marrëveshjen e Rambujës” (18 mars 1999), edhe pse ishte jo aq shumë në favor të tyre. Kurse, në anën tjetër, Zoti, kishte përcaktuar që delegacioni serb të mos e nënshkruajë këtë marrëveshje, e cila edhe për një periudhë të gjatë do ta mbante Kosovën në kuadër të RFJ-së dhe Serbisë.

Ecuria e Konferencës vuri në pah tërë injorancën dhe provokimin e Serbisë ndaj botës dhe vetëdijesoi faktorin ndërkombëtar se nuk kishte rrugëdalje tjetër pos ta shpallë Serbinë si fajtorë për dështimin e arritjes së paqes së palëve në konflikt dhe të ndërmarrë masat e parapara me Deklaratën tetëpikëshe të Grupit të Kontaktit, të datës 29 janar 1999.

Por, edhe implementimi i kësaj deklarate të njohur si “Deklarata e Ultimatumit”, ishte shumë e vështirë, sidomos për aleatin kryesor të Kosovës, SHBA-të, ku kishte shumë personalitete me ndikim që hezitnin që këtë ultimatum ndërkombëtar ta jetësonin në praktikë.

Por, këmbëngulësia e sekretares së Shtetit të SHBA-së dhe përkrahja e vizionit të saj nga senatorët e fuqishëm, siç ishin, Joe Bideni dhe Richard Lugar dhe të tjerët, dhe pas ditëve të tëra me seanca dëgjimore, takime, informime dhe thirrje e biseda telefonike, përfundimisht ia dolëm mbanë. E gjithë Marrëveshja që u nënshkrua vetëm nga shqiptarët ishte 82-faqesh, të cilën shqiptarët zyrtarisht nënshkruan në një ceremoni pesëminutëshe, kurse ajo u bojkotua nga delegacioni i RFJ dhe negociatori rus¹⁸⁷.

Fare pak kohë përpara ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes së Rambujesë, ndërmjet muajit mars, Dhoma e Përfaqësuesve votoi 219 më 191 në mbështetje të planit të Presidentit për dërgimin e trupave për zbatimin e një marrëveshjeje paqeje, në rast se një gjë e

¹⁸⁶ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, *Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe Bashkësia ndërkombëtare, 1989-1999*, SHB “KOHA”, Prishtinë, 2002, fq. 164-165.

¹⁸⁷ Albright, Madeleine, *Madam Secretary: A Memoir* (New York: Easton Press, 2003), fq. 405.

tillë do të arrihej. Ndonëse ky votim parashikohej të kishte karakter partiak, patëm mbështetjen e kryetarit të Dhomës, Denis Haster dhe të republikanëve të tjerë të respektuar, siç ishte përfaqësuesi i Ilinoisit, Henry Hyde. Ndërkohë që po përfundonte afati kohor për ndjekjen e rrugës diplomatike, Senati votoi 58 më 41 për të autorizuar Presidentin të mbështesë bombardimet e NATO-s. Të paktë ishin ligjvënësit që besonin në këtë perspektivë, por shumica ishte dakord në atë që mundësitë e tjera ishin shumë më pak të pranueshme¹⁸⁸.

Vendimi ishte marrë tani, pritej reagimi i Milosheviqit. Ai vazhdimisht paralajmërohej që të mos ndërmerre ndonjë veprim ushtarak në Kosovë, por çmenduria e Milosheviqit dhe e këshilltarëve e përkrahësve të tij, nuk e lejuan të vetëdijesohen, por, përkundrazi, duke u mashtruar se kërcënimet e diplomacisë ndërkombëtare janë një bluf politik e diplomatik, besonte se ata nuk do të guxonin të ndërmerrnin ndonjë veprim ushtarak kundër një shteti sovran siç ishte Serbia, e cila, pos shumë miqve historikë, e kishte edhe vëllanë e madh Rusinë, e cila çdo masakër dhe krim të Serbisë e minimizonte ose e amortizonte në institucionet ndërkombëtare, dhe njëkohësisht besonin se Rusia, Kina e ndonjë shtet tjetër pro Serbisë nuk do të votonin ndërhyrjen ndërkombëtare në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke vlerësuar gabimisht se pa një rezolutë të tillë SHBA dhe shtetet tjera perendimore nuk do të ndërmerrnin një vendim të tillë jashtë Këshillit të Sigurimit të OKB-së

Fundi i Takimit në Rambuje dhe mospranimi serb i Marrëveshjes bëri që NATO-ja të fillojë të ngrohë avionët, UÇK-ja të vazhdojë luftë guerile, ndërkohë që serbët shpallën gjendjen e jashtëzakonshme¹⁸⁹.

Milosheviqi kishte dyfishuar forcat e tij ushtarake dhe paramilitare në Kosovë, duke u bërë më i fuqishëm sesa në sulmet e vitit 1998. Më 19 mars 1999, në mbledhjen e ekipit të politikës së jashtme të SHBA-së me presidentin amerikan, Bill Clinton, George Tenet raportoi se ofensiva serbe kishte filluar në Kosovë dhe se kishte bërë të tërhiqeshin disa njësi të UÇK-së. Numri i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur po rritej me shpejtësi. Vlerësimi ushtarak ishte gjithashtu i zyrtë. Civilët në Kosovë ishin fare të pambrojtur ndaj sulmeve serbe. Të paktën në fillim, sulmet ajrore të NATO-s nuk kishin si t'i ndihmonin. Ishte rrezik që shumë njerëz të pafajshëm ose të vriteshin ose të plagoseshin¹⁹⁰.

Qëllimi i përdorimit të forcës, sipas sekretares së Shtetit, të shprehur në këtë mbledhje

¹⁸⁸ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare*, SHB "Dudaj", Tiranë, fq. 473.

¹⁸⁹ Boshkovich, Ivan, Vep. e cit., fq. 70.

¹⁹⁰ Albright, Madeleine, Vep. e cit., fq. 474,

ishite, si thoshte ajo që t'i japim një herë e përgjithmonë fund maskarallëkut të tipit të Milosheviqit. Nuk ka garanci që do të triumfojmë, por zgjidhjet e tjera janë më të këqija. Nëse nuk veprojmë tani, do të na duhet të veprojmë më vonë, ndoshta në Maqedoni, ndoshta në Bosnjë, Milosheviqi ka zgjedhur luftën. Nuk mund ta lëmë të fitojë¹⁹¹.

Komandanti i forcave të NATO-s, gjenerali Vesli Klark, kishte pasur shumë takime me presidentin serb Milosheviq dhe, në bazë të atyre takimeve, ai e kishte kuptuar se ai njeri ishte shumë problematik dhe i rrezikshëm për paqen në Ballkan dhe në Evropë dhe me të drejtë vlerësonte se forca është gjuha e vetme që ky njeri (Milosheviqi, (vër, e autorit) e kuptojë¹⁹².

Por, shumëkush nga diplomatët ndërkombëtarë ishin skeptikë se presidenti Clinton do të marrë vendimin për sulmet ajrore në Serbi. Të tillë kishte edhe nga vetë diplomatët amerikanë. Morton Abramoëitz, ish-ndihmëssekretar i Shtetit, një mik i madh yni dhe i zonjës Albright, vazhdimisht ishte skeptik, për sa i përket guximit të Bill Clintonit, kryetarit të SHBA-ve, për të urdhëruar sulmet. Tani, gjithçka varet prej tij. Pa Clintonin nuk lëviz dot Amerika. Pa Amerikën, Evropa nuk e kallte luftën kundër RFJ-së¹⁹³. E Clintoni kishte premtuar dhe këtë, në fund të fundit, po e përmbushte, sepse po detyrohej nga situata e krijuar e që s'mund të tolerohej. Ai në vitin 1993, përkiazi me intervenimet e NATO-s kishte deklaruar: "Me Kombet e Bashkuara, nëse është e mundur, e nëse është e domosdoshme edhe pa to. NATO është kriter i vendimmarrjes për OKB dhe jo e kundërta"¹⁹⁴.

3.9. Sulmet e NATO-së dhe përfundimi i luftës

Me qëllim të ndërprerjes së luftës në Kosovë, faktori ndërkombëtar, vetë Amerika së bashku me 18 shtete të tjera, përmes NATO-s ndërhyri ushtarakisht për të ndërprerë luftën në Kosovë. Ndërhyrja ushtarake do të ndodhë pasi nuk mbeten rrugë të tjera diplomatike. Dështimi i Serbisë për të pranuar Marrëveshjen e Rambujesë, nuk la më mundësi për çfarëdo aktiviteti tjetër. Në fakt, edhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes nga pala shqiptare, diplomacia ndërkombëtare provoi që të ndërmarrë edhe disa hapa, duke u përpjekur në mos Milosheviqi do të bindej dhe në mos në minutat e fundit Serbia do të pranonte dhe kështu do të shpëtonte nga bombat. Një ditë

¹⁹¹ Albright, Madeleine, Vep. e cit., po aty.

¹⁹² Buja, Ramë, *Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë*, Univerziteti AAB, Prishtinë, 2007, fq. 421.

¹⁹³ Shala, Blerim, *Vitet e Kosovës 1998-1999*, GAMA, Prishtinë, 2001, fq. 335.

¹⁹⁴ Sumner, Rebecca, *New World Order*, *London Daily Online*, <http://www.london-daily.com/art/ldrebec.htm> (qasur më 13. 1. 2015).

përpara përfundimit të Konferencës në Rambuje (ajo do të vazhdojë pas ndërprerjes disaditëshe në Paris), Joschka Fischer, në emër të kryesuesit të BE-së, i drejtoi një thirrje të fundit Milosheviqit, përmes një letre të cilën i'a dergoi një ditë para se të përfundon Konferenca në Rambuje, i'a përkujton z. Millosheviqit se ***“Republika Federative e Jugosllavisë ndodhet përpara një vendimi, pasojat e të cilit do të kenë ndikim tepër të madh për të ardhmen e vendit tuaj. Zgjedhja që do të bëjë Republika Federative e Jugosllavisë është midis paqes ose kaosit të brendshëm dhe izolimit ndërkombëtar”***. Poashtu në këtë letër z. Fischer, e ftom Millosheviqin që ta nënshkruar Marrëveshjen e propozuar dhe ta shfrytëzoi këtë mundësi të fundit për pranimin e propozimit të zgjidhjes paqësore të çështjes së Kosovës brenda afatit të përcaktuar në të kundërtën çmimi që Jugosllavia do të paguajë në rast dështimit, do të jetë tepër i lartë.

Çka është edhe më rëndësi për këtë studim, Bashkësia Europiane edhe përmes kësaj letre riktheson dhe i garanton Millosheviqit se “ruajtja e sovranitetit dhe e tërësisë tokësore të RFJ-së janë bazë e padiskutueshme e procesit politik për zgjidhjen paqësore të këtij konflikti”¹⁹⁵.

Pas kësaj letre, delegacioni serb do të bëjë përpjekje që edhe më tutje të zvarrisë çështjen, duke bërë akrobacione politiko-diplomatike, me qëllim që së paku të zvarritet procesi. Kështu, ai do të dërgojë disa letra, duke kërkuar revidim të Marrëveshjes dhe duke bërë disa propozime, të cilat nuk mund të merreshin në kosnideratë.

Grupi i Kontaktit, duke respektuar këshillën e tre ndërmjetësueve, vendos të ndërprejë bisedimet në Rambuje, deri më 15 mars. Edhe kjo ishte sërish përpjekje për të bindur Serbinë të pranojë Marrëveshjen, ndërkohë që situata në terren ishte tepër e acaruar dhe kishte shkuar tej çdo parashikimi. E, Serbia kishte ndërmarrë një ofansivë të fortë ushtarake në Kosovë. Javier Solana, sekretar i Përgjithshëm i NATO-s paralajmëroi presidentin jugosllav Milosheviq, që të mos e shfrytëzonte pauzën e bisedimeve të paqes për të filluar ofensivën e re kundër UÇK-së në Kosovë¹⁹⁶.

Në këtë vazhdë të përgatitjeve për vendosjen e mundshme të forcës ushtarake në Kosovë, disa qeveri u përcaktuan qartë për numrin e ushtarëve që do të vënin në dispozicion, nëse marrëveshja do të arrihej. Por, gjithsesi opcioni i sulmeve ushtarake rrinte si opcion serioz. Diplomacia përendimore, Grupi i Kontaktit por edhe Rusia, në kohën kur u ndërpreu bisedimet,

¹⁹⁵ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, *Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe Bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, SHB “KOHA”, Prishtinë, 2002, fq. 211 e 212.

¹⁹⁶ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, Vep. e cit., fq. 223.

bënë përpjekje që të bindin Serbinë (RFJ-në) për favoret që i sillte Marrëveshja paqësore, por përpjekjet e tyre ishin të kota dhe të pa përfillshme nga pushteti i Serbisë i identifikuar me figurën dhe personalitetin e Slobodan Millosheviqit.

Konferenca, do të vazhdojë më 15 mars 1999 dhe tash jo në Rambuje, por në Paris. Delegacioni kosovar në Paris shkoi me përmbajtje të njëjtë, sikundër që edhe ekipi i ndërmjetësuesve. Ekipi kosovar tashmë kishte ardhur me qëndrim të qartë dhe të prerë që të pranojë Marrëveshjen. Kurse, delegacioni serb sërish me sjellje të njëjtë, madje me një stil, i cili, brenda një kohe të shkurtër, para çdo stil diplomatik bisedimesh të humbte vlerën e vet¹⁹⁷.

Presidenti i Serbisë Milutinović tash kishte marrë rolin e një spikeri të gjithëdijshëm, i cili nuk ngurron të mbajë ligjërata për politikë, diplomaci, për të drejtë ndërkombëtare, moral dhe për çka jo tjetër. Kështu, komentet e Milutinovićit, nga një ligësi, karakterizoheshin me cinizëm dhe arrogancë, të cilat çdo diskutim konkret që në fillim e bënin të pamundur. Ishte e qartë se ai kishte ardhur në Paris me synimin për të rënë ndesh me çdo propozim të ndërmjetësuesve ndërkombëtarë dhe për t'i treguar botës se Serbia gjatë bisedimeve nuk kishte menduar asnjëherë dhe aspak të ulte kokën¹⁹⁸.

Delegacioni kosovar, të cilin e kryesonte Hashim Thaçi, ishte, siq është vënë re, i gatshëm të pranonte Marrëveshjen e ofruar ndërkombëtare. Kryesuesi i delegacionit të Kosovës Hashim Thaçi, në letrat dërguar kryesuesit të Këshillit të BE-së z. Joscha Fischer dhe të dërguarit të posaçëm të BE-së, z. Petrisch, në mes tjerash, potenconte se “*Pas diskutimit të delegacionit të Kosovës me forcat politike dhe ushtarake dhe me popullin e Kosovës për Marrëveshjen e Rambujesë të 23 shkurtit 1999 për paqe dhe vetëqeverisje, ky delegacion dhe unë personalisht i përgjigjemi me “po” kësaj marrëveshje*”¹⁹⁹.

Zonja Albright, në librin e saj “Zonja Serkretare”, ka kujtuar këtë kohë të madhe për Kosovën dhe shqiptarët: “Më 23 mars, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, urdhëroi komandantin e NATO-s për Evropë, gjeneralin Vesli Klark të niste operacionin e goditjeve ajrore. Kishte kaluar mesnata. Isha kthyer në shtëpi e këputur nga lodhja, por rrija deri vonë para televizorit për të parë emisionin e lajmeve. Pothuaj më kishte zënë gjumi, kur ra telefoni. Ishte Presidenti. Ai tha: “Po bëjmë atë që duhet. Do të kemi një rrugë të gjatë dhe është diçka që nuk do të mbarojë shpejt, por mendoj se i kemi parë të gjitha alternativat. Së bashku

¹⁹⁷ Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, Vep, e cit., fq. 237.

¹⁹⁸ Po aty.

¹⁹⁹ Vep. e cit., fq. 238 e 239.

nisëm të radhitnim të gjitha përpjekjet që kishim bërë, për të gjetur një zgjidhje diplomatike, përfshirë edhe pesëmbëdhjetë udhëtimet që kisha bërë për t'u këshilluar me aleatët gjatë një viti më parë. Folëm për përgjegjësinë që kishim ndaj kosovarëve dhe veçanërisht ndaj forcave tona të armatosura. Dërgimi i të rinjve dhe i të rejave në luftë është vendimi më i vështirë që mund të marrë një president. Asnjë udhëheqës amerikan nuk mund të angazhojë trupat në një ndërmarrje ushtarake pa i peshuar mirë e mirë të gjitha kostot. Në këtë rast, ne i kishim bërë këtë. Presidenti tha përsëri: "Mendoj se po bëjmë atë që duhet." – "Po, zoti President, - i thashë. - Po bëjmë atë që duhet"²⁰⁰.

Kjo bisedë e dy personaliteteve kryesore që vendosën marrjen e masave ndëshkuese ndaj një agresori dhe shteti luftënxitës, çfarë ishte Serbia, pasqyron se sa vështirë është të merret një vendim i tillë. Rreziku dhe çmimi për një veprim të këtillë është shumë i lartë në të gjitha fushat, por posaçërisht në fushën diplomatike ndërkombëtare dhe atë të brendshme politike. Por, rasti i Kosovës ishte një rast sui generis edhe atëherë, i tillë mbeti edhe në të ardhmen. Është shumë domethënëse uniteti i Aleancës Veriatlantike për veprim ndëshkues kundër një shteti, çfarë ishte Serbia me miq dhe përkrahës të shumtë me ndikim në botë. Sulmet filluan më 24 mars 1999. Të gjithë pritnin që sulmet ajrore do të zgjatin vetëm disa ditë dhe Serbia do të dorëzohej, por gabuan, sepse Milosheviqi, me përkrahësit e tij luante letrën "të gjitha ose asgjë", me shpresë se aleanca ndërkombëtare do të përçahej dhe rezistenca serbe do t'ia mundësonte miqve të tyre, sidomos Ruisë, që të detyronte diplomacinë ndërkombëtare që të ndërpriten sulmet dhe të rifillohen bisedime të tjera me pozicionimin më të mirë të Serbisë. Sepse, situata në terren kishte ndryshuar.

Paramilitarët dhe forcat e armatosura serbe kishin arritur që me krimet e tyre mizore t'i dëbojnë afro një milion shqiptarë nga shtëpitë e tyre, njëkohësisht kishin djegur dhe plaçkitur më shumë se 70 për qind të shtëpive në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Drenicë dhe, duke u bazuar në përvojat e tyre të kaluara historike, serbët prapë shpresonin se do të organizohet një konferencë ndërkombëtare dhe diplomacia ndërkombëtare do të detyrohet të pranonte kushtet serbe për Kosovën, në bazë të realitetit të ri në terren. Territori nuk mund të okupohej më me krime dhe masakra ndaj popullit të pambrojtur civil. Përkundrazi, tani ato dënoheshin dhe nuk mund të përkraheshin. Evropa kishte ndryshuar, ndoshta edhe për shkak të këmbëngulësisë së qasjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes së Kosovës.

²⁰⁰ Albright, Madeleine, Vep. e cit., fq. 475.

Aleanca Veriatlantike, edhe pse kishte marrë vendimin për sulme ajrore mbi Serbinë, prapëseprapë ishte e kujdesshme dhe vepronte me një potencial shumë të kufizuar ushtarak. Për shkak të përgatitjes së dobët, bombardimi fillonte gradualisht dhe nuk shkaktonte dëme të mëdha as në Serbi, as tjetërkund në Jugosllavi. Le të përmendet, si krahasim, se në luftën e Gjirit Persik, aeroplanët e aleatëve ndërmerrnin 2.500 fluturime në ditë, ndërsa në ditët e para të operacionit të Kosovës, numri i tyre ishte rreth 150.²⁰¹

Për këtë arsye, “Komandanti i NATO-s për Evropë, gjenerali Clark, kërkoi të shtohet numri i aeroplanëve dhe të zgjerohet lista e objektivave që do të goditeshin për ta çuar luftën më pranë Milosheviqit dhe për të ushtruar presion mbi forcat e tij të sigurimit. Thoshte të ketë punuar ditë e natë për të bërë çmos që përdorimi i forcës të mbështetej nga e gjithë Aleanca²⁰²”.

Sulmet e NATO-s çdo ditë e më tepër po ashpërsoheshin dhe dihej se Serbia nuk do të shkonte edhe shumë ditë dhe do të dorëzohej. E tërë bota e dinte se Amerika dhe aleati i saj kryesor, Britania e Madhe, ishin të vendosur që të shkojnë deri në fund. Por, njëkohësisht të vetëdijshëm për këtë fund, duhej të mendonin edhe për statusin e Kosovës pas përfundimit të “luftës” me Serbinë. Shumica e qarqeve diplomatike dhe politike, formulën e Rambujesë e quajnë të kapërcyer.

Tri alternativa po diskutoheshin hapur: pavarësi, protektorat ndërkombëtar ose ndarje e Kosovës. Kjo e fundit zuri vend dhe në qarqe diplomatiko-politike në zë, veçanërisht në qarqe evropiane. Kryediplomati shqiptar Paskal Milo besonte se amerikanët dhe anglezët janë kundër kësaj ideje. Ka shtuar se Tony Blair, mbrëmë, (disa netë pasi filluan bombardimet, vër, e autorit), deklaroi se autonomia tani është e pamjaftueshme për Kosovën, ndërkohë që Robin Kuk, duke mos hedhur poshtë parimet e Rambujesë, foli se në këto marrëveshje duhen ndryshuar disa gjëra. Mendoj se shumica po priren nga ideja e protektoratit²⁰³.

Milosheviqit, megjithatë, nuk i bëri syri vër nga sovraniteti i mundshëm i Kosovës, ndërkohë që NATO-ja anashkaloi OKB-në, për arsye se Këshilli i Sigurimit nuk do t'i kishte miratuar veprimet e planifikuara nga NATO-ja. Për herë të parë, në OKB nuk u mor në konsideratë sovraniteti dhe parimi i konsensusit të shteteve të mëdha: SHBA, Rusi, Francë, Britani e Madhe dhe Kinë. Amerikanët mendonin se Milosheviqi përbënte një rrezik të vazhdueshëm për rajonin. Ai kishte shkelur shumë rregulla të drejtësisë ndërkombëtare. Kishte

²⁰¹ Martti Ahtisaari, “Detyra në Beograd”, Prishtinë, 2008. fq. 22

²⁰² Albright, Madeleine, Vep. e cit., fq. 477.

²⁰³ Milo, Paskal, Vep. e cit., fq. 195.

sulmuar Slloveninë e pavarur, Bosnjën dhe Kroacinë dhe i kishte anuluar garancitë për autonominë e Kosovës. Duke folur për të ardhmen e Serbisë, amerikanët përdornin shkurtesën ABM, d.m.th. Anybody but Milosheviq.²⁰⁴ Se sulmet kundër RFJ/Serbisë nuk mund të shmangeshin kjo ishte shumë e qartë.

Sidomos pas Dayton-it, kur pjesmarrëja e Kosovës në këtë takim u injorua. Që nga aty situata në Kosovë ndryshon dhe spektri politik përfundimisht përcahet. Disa nga liderët kryesor shqiptar pas nënshkrimit të marrëveshjes së Dayton-it (1995) u zhgënjyen me që aty nuk u përmend Kosova. Krahas kësaj disa të tjerë kërkojnë metoda radikale për ta obliguar bashkësinë ndërkombëtare që çeshtjen e Kosovës ta trajton më seriozisht. Kjo më së miri pasqyrohet me fjalët e Veton Surroit se “kujdesi i bashkësisë ndërkombëtare mund të tërheqet vetëm me luftë”.²⁰⁵

Bashkësia ndërkombëtare, duke mos dashur të rrezikojë një situatë si në Bosnie dhe Hercegovin do të mendojë shumë më mirë se cka dhe si duhet bërë. Duhej siguruar edhe një bazë legale për fillimin e sulmeve. Kështu, që në mars të vitit 1998, Këshilli i Sigurimit, duke vepruar në bazë të kapitullit VII të Kartës së OKB, por edhe pa u konstatuar ekzistimi i kërcënimit të paqes dhe sigurisë, nxjerrë Rezolutën 1160 me të cilën kërkon nga të dyja palët ndërprejen e dhunës.²⁰⁶

Shkaku i intervenimit ushtarak krahas shumë të tjerave, e që nuk janë objekt i këtij studimi mund të gjinden dhe studiohen me punime tjera, por këtu në interes të studimit duhet përmendur edhe një çështje që debatohet shumë në rastet e intervenimeve ndërkombëtare. Sidomos kur intervenimi ka karakter humanitar.

E kur të jemi te intervenimi humanitar, vetëm për sqarim do të japim një ose dy definicione të përafërta.

Sipas një definicioni, intervenimi humanitar në kuptim të ngushtë, nënkupton vetëm përdorimin e forcës së armatosur me qëllim të mbrojtjes së shtetasve kundër çkaje intervenohet

²⁰⁴ Martti Ahtisaari, “Detyra në Beograd”, Prishtinë, 2008, fq. 33

²⁰⁵ Independent International Commission on Kosovo, fq. 50

²⁰⁶ UN Security Council Resolution 1160, 31 March 1998. Kjo rezolutë është nxjerrë pa asnjë votë kundër por që Rusia dhe Kina janë përmbajtur nga votimi. Përmbajtjen e tyre në votim këto shtete e kanë sqaruar me atë se rezoluta është përzjerje në punët e brendshme të RFJ; Wheeler N.J.: Saving Strangers: Humanitarian Intervention in International Society, Oxford-New York, 2000, fq. 259

dhe kjo vetëm nëse intervenimi bëhet pa pëlqimin e OKB-së.²⁰⁷ Gjithnjë në këtë kontekst, po japim edhe një kuptim/definim sipas të cilit: "sipas kuptimeve të gjëra, me të drejtën humanitare nënkuptohet veprimi i ofrimit të ndihmës humanitare personave jeta e të cilëve varet nga kjo ndihmë".²⁰⁸

U përmendën këto definicione, për të pasqyruar laryshinë e shkaqeve dhe bazave, në të cilat u vendos që RFJ të sulmohej. Natyrisht e kemi potencuar disa herë se e Drejta Ndërkombëtare Publike ka ndryshuar në kuptim të çështjes së sovranitetit rigid i cili dikur nuk ka mundësuar sulme, në kuptim dhe në arsyetim të sovranitetit, që edhe kur e drejta humanitare do duhej vënë në zbatim, pengesë do dilte sovraniteti dhe mosndërhyrja në punët e brendshme.

3.10, "Marrëveshja ushtarake-teknike e Kumanovës", midis Armatës Jugosllave dhe NATO-s,

Sulmet ajrore 78-ditësh morën fund. Serbia pranoi kapitullimin në luftë, prandaj më 9 qershor 1999 nënshkroi të ashtuquajturën "Marrëveshje ushtarake-teknike të Kumanovës". Nënshkrimi i marrëveshjes teknike midis Armatës Jugosllave dhe NATO-s, e cila përfaqësohej nga gjenerali Mike Jackson shënon fundin e bombardimeve të NATO-s dhe pranimin e kushteve të dhëna Serbisë për njohje të kapitullimit dhe për tërheqjen e forcave nga territori i Kosovës.

Mbi arritjen e kësaj marrëveshjeje, partitë politike dhe forcat ushtarake të shqiptarëve të Kosovës nuk u konsultuan²⁰⁹.

Pas 79 ditë bombardimesh, autoritetet serbe pranojnë tërheqjen e trupave të tyre nga Kosova dhe lejojnë praninë ushtarake ndërkombëtare në pjesë të territorit të tyre dhe

²⁰⁷ Si shembull, mund të specifikohet definicioni i cili përkufizimin e ndërhyrjes humanitare e nënkupton si "kërcënim apo përdorim i forcës individuale apo kolektive nga ana e shtetit apo shteteve jashtë vendit, me qëllim të vetëm për të parandaluar ose ndërprerë shkeljet të rënda të të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht të drejtën për jetë, në situata të cilat i përkasin ose i ngjajnë gjenocidit, pa marrë parasysh kombësinë e personave në ankth, dhe kur veprimi i tillë ndërmerret pa miratimin e organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara dhe pa lejen e marrë nga qeveria legjitime e shtetit ndaj të cilit veprimi është ndërmarr

Verwey W.D: Humanitarian Intervention in the 1990s and Beyond: An International Law Perspective, in: Pieterse J.N: World Orders in the Making - Humanitarian Intervention and Beyond, The Hague, 1998, fq. 190

²⁰⁸ Scheffer, krahas aktiviteteve të tjera, koncepti ndërhyrje humanitare përfshin edhe "ndalimin e migrimit masiv të njerëzve, kthimin e një numri të madh të personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre të legjitime, riadhesimi i një numëri të madh të refugjatëve dhe migrantëve të tjera ose mbrojtjen e refugjatëve dhe emigrantëve nga rrethanat kërcënuese për jetë. Scheffer D: Toward a Modern Doctrine of Humanitarian Intervention, University of Toledo Law Review, vol. 23, 1992, no. 2, p. 267., marrë nga: Nebojsa Raicevic, Humanitarna Intervencija u Medjunarodnom Javnom Pravu, Doktorska Disertacija, Universitet u Nis-u.

²⁰⁹ Sherifi, Isak, *The International Community Role and NATO Intervention in Kosovo-Kumanovo Agreement*, Mediterranean Journal of Social Sciences, MCSER Publishing, Rome-Italy, 2004, ISSN 2039-2117 (online)

administrimin civil ndërkombëtar. Kjo marrëveshje bëhet me 09 qershor 1999 me nënshkrimin e Marrëveshjes Teknike Ushtarake në mes të forcave të sigurisë ndërkombëtare (KFOR) dhe qeverisë së RFJ-së dhe Republikës së Serbisë (Marrëveshja e Kumanovës).

Një ditë pas kësaj marrëveshjeje Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka aprovuar Rezolutën 1244 me anë të cilës në parim është vërtetuar përmbajtja e Marrëveshjes së Kumanovës dhe janë marr disa pjesë të propozimit të Rambouillet.²¹⁰

Marrëveshja Ushtarake Teknike e njohur si “Marrëveshja e Kumanovës edhe pse i ka vetëm 6 nene është mjaft koncize dhe përmbajtësore.” Kjo marrëveshje, për palët ndërluftuese dhe misionin ndërkombëtar, parashihte këto obligime: Në nenin I pika 1- Obligimet e përgjithshme: Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje riafirmojnë dokumentin e prezantuar nga kryetari Ahtisaari dhe kryetari i RFJ-së Millosheviq e të miratuar nga Parlamenti i Serbisë dhe Qeveria Federale e RFJ-së, me 3 qershor 1999, për lejimin e hyrjes dhe dislokimit të efektivave civile dhe të sigurisë ndërkombëtare në territorin e Kosovës dhe më gjërë. Ky dislokim do të bëhet nën përgjegjësinë dhembikëqyrjen e OKB-së... pika 2. Autoritetet shtetërore qeveritare të RFJ-së dhe të asaj të Serbisë pajtohen që KFOR-i do të operoj pa pengesa brenda Kosovës dhe është i autorizuar të ndërmarr çdo veprim të nevojshëm për të realizuar misionin e vet të paraparë.

Kjo Marrëveshje, poashtu në nenin II të saj ka paraparë se forcat e RFJ-së duhet të përmbahen nga ndërmarrja, inkurajimi, organizimi apo mbështetja e çfarëdo akti armiqësor apo provokimi në Kosovë si dhe tërheqjen në faza dhe afate të forcave të RFJ-së nga Kosova. Në nenin III parasheh njoftimin e menjëhershëm e të gjitha forcave të RFJ-së me këtë marrëveshje. Neni IV. i saj obligon palët e krijimit të një Komisioni të Përbashkët Implementuës (JIC). Neni V. Përcakton Komandantin e Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë – KFOR-in si autoritetin final të interpretimit dhe implementimit të kësaj marrëveshje. Dhe kuptohet, në nenin VI, përcaktohet se kjo marrëveshje hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Komandanti i KFOR-it LT Gjeneral Mike Jackson dhe përfaqësuesi i RFJ-së –Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave: Gjeneral Kolonel Svetozar Marojeviq dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë:Gjeneral Obrad Stevanoviq.

²¹⁰ Nebojsa Raicevic, Humanitarna Intervencija u Medjunarodnom Javnom Pravu, Doktorska Dizertacija, Universitet u Nis-u.

Marrëveshja Ushtarake Teknike e njohur si Marrëveshja e Kumanovës së 9 qershorit të vitit 1999 ka pasur edhe shtojcat e saja për implementim.²¹¹

3.11. Rezoluta 1244

Bazuar në “Marrëveshjen e Kumanovës”, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, mbështetur në parimet dhe qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë përgjegjësinë parësore të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, në mbledhjen e vet të 4011-të, më 10 qershor 1999, ka miratuar Rezolutën 1244, e cila vendosi misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të njohur si misioni i UNMIK-ut.

Ambiciet nacionaliste të Slobodan Milosheviqit u përplasën me një konflikt të gjatë, i cili dërgoi tek intervenimi ushtarak i NATO-s, tek tërheqja subsekuente të forcave Serbe dhe tek aprovimi i Rezolutës 1244 (1999), e cila e vendosi territorin e Kosovës nën administrim të përkohshëm civil ndërkombëtar të prirë nga OKB dhe tek mbrojtja ushtarake e Kosovës, prirë nga forcat e NATO-s në Kosovë²¹².

Gjuha e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit u përpunua nga ministrat e jashtëm të G8 në Gjermani, më 7 dhe 8 qershor, pas dymbëdhjetë orë bisedimesh.

Rezoluta 1244, potencon dhe përkujton se kjo rezolutë, është rezultat dhe domosdoshmëri që impunohet për miratim për shkak të mos përmbushjes së kërkesave të parashtruara përmes rezolutave: 1160 të datës, 31 mars 1998, rezolutës 1199 të datës, 23 shtator 1998, rezolutës 1203 asaj të datës, 24 tetor 1998 dhe të rezolutës 1239 të datës 14 maj 1999,

Përmes Rezolutës 1244, Këshilli i Sigurimit të OKB-së potencon se duke pasur parasysht qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe përgjegjësinë primare të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, shpreh vendosmërinë për ta zgjidhur situatën e rëndë humanitare në Kosovë, të cilën e konsideron se është në kuadër të Republikës Federale e Jugosllavisë, dhe për ta siguruar kthimin e lirë dhe të sigurtë të të gjithë refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre,

²¹¹ Për më shumë, shiko: *Marrëveshja Ushtarake Teknike e njohur si Marrëveshja e Kumanovës* të datës 09 qershor 1999

²¹² http://fride.org/uploads/Cap5_Kosovo_ENG_oct9.pdf,fq.121

¹⁸³ Weller Marc, *Shtetësia e kontestuar*, “KOHA”, Prishtinë 2009. fq. 299

Rezoluta 1244, poashtu parasheh krijimin e një pranie civile ndërkombëtare në Kosovë me qëllim të vendosjes të një administrate të përkohshme ndërkombëtare për Kosovën nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë autonomi përmbytësore në kuadër të RFJ-së, dhe e cila do të sigurojë administrim kalimtar gjersa themelon dhe mbikëqyr zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Në këtë Rezolutë, theksohet nevoja për operacione të koordinuara të ndihmave humanitare, dhe që RFJ-ja të lejojë hyrjen e papenguar në Kosovë të organizatave për ndihma humanitare si dhe të bashkëpunojë me organizata të tilla në mënyrë që të sigurohet shpërndarja e shpejtë dhe efektive e ndihmave ndërkombëtare.

Në bazë të Rezolutës 1244, parashihej se prania civile ndërkombëtare dhe e sigurisë, fillimisht është themeluar për një periudhë fillestare prej 12 muajsh, me të drejtë të vazhdim të funksionimit të saj deri sa Këshilli i Sigurimit të OKB-së vendosë ndryshe.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, miratoi Rezolutën 1244, e cila finalizon tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova, kërkoi demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kthimin e të gjithë të zhvendosurve në Kosovë.

Rezoluta 1244, poashtu parashihte vendosjen e administratës civile të OKB-së në Kosovë të njohur si UNMIK si dhe misionin ushtarak të NATO-s me qëllim të vendosjes së paqes, rendit dhe të sigurisë në Kosovë.

Përfaqësuesi i Rusisë në OKB, z. Ivanov u angazhonte që nga në Rezolutos të përmbyjë të referencat mbi bashkëpunimin me Gjykatën për Krimet e Luftës dhe sugjeroi që të lejoheshin disa forca serbe të sigurimit të qëndronin në Kosovë²¹³, por, ndonëse asnjë nga të gjithë pjesëmarrësit nuk i pranuan ato kërkesa, Ivanovi u detyrua që përfundimisht të dorëzohet dhe të pranojë Rezolutën, ashtu siç u propozua nga të tjerët.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 u miratua me katërmëdhjetë vota pro dhe asnjë kundër (Kina abstenoj.)

I gjithë teksti i Rezolutës iu nënshtrua Kapitullit VII të Kartës së OKB-së. Paragrafi 10 i preambulës rivërtetoi përkushtimin e të gjitha shteteve që të respektonin sovranitetin dhe

integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të shteteve të tjera në rajon. Ky lloj administrimi ndërkombëtar qoftë për nga përmasat, qoftë për nga kompetencat, nuk është provuar ndonjë herë në ndonjë shtet në botë.

Mund të diskutohet nga këndvështrime të ndryshme, nëse ky administrim ishte protektorat ndërkombëtar, mbikëqyrje, kujdestari a një eksperiment që po provohej për herë të parë në Kosovë. Por, çfarëdo konkluzioni që do të nxjerrim, një është shume e sigurt: Rezoluta 1244 është i vetmi dokument që në një mënyrë diktoi kompromisin për zgjidhjen e një konflikti, të cilit vështirë i gjendej fundi dhe të cilit vështirë mund t'i parashikoheshin pasojat. Sigurisht se kompromisi krijoi paqartësitë, të cilat do të dalin si vështirësi në fazat e mëvonshme, sidomos në kuptim të definimit të statusit final të Kosovës, për të cilin do të flasim në një ndër kapitujt.

Në kuadër të Rezolutës 1244, përcaktohen përgjegjësitë dhe kompetencat themelore të të Misionit të OKB-së në Kosovë e në kuadër të këtij misioni edhe kompetencat dhe përgjegjësitë e KFOR-it dhe UNMIK-ut në Kosovë:

KFOR²¹⁴-i ishte përgjegjës për siguri në Kosovë gjegjësisht të vendosë dhe të mirëmbajë paqën dhe armëpushimin. Të sigurojë tërheqjen dhe të mos lejoj kthimin e forcave serbe, me përjashtim të atyre që lejohen si ndërlidhëse me prezencën ndërkombëtare për të treguar, shënjuar dhe pastruar fushat e minuara, të demilitarizojë UÇK²¹⁵-në dhe grupet e armatosura shqiptare. Të sigurojë dhe ndërtojë ambient të sigurt për të shpërngulurit dhe të zhvendosurit për kthim të sigurtë, të siguroj shpërndarjen e ndihmave humanitare dhe operimin e prezencës civile ndërkombëtare, monitorimin ditor të kufirit të Kosovës, sigurimin dhe mbrojtjen dhe liri të qarkullimit për organizata ndërkombëtare dhe të sigurojë siguri publike dhe rend dhe të mbikëqyrë deminimin, deri sa prezenca civile ndërkombëtare të marrë këtë përgjegjësi.

Ndërsa sipas Rezolutës 1244, UNMIK²¹⁶-u kishte këto përgjegjësi: Të përformojë funksione bazike civile administrative për aq gjatë sa është e nevojshme, të mirëmbajë rendin dhe ligjin, përfshirë edhe krijimin e forcave lokale të policisë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e njeriut dhe të sigurojë kthim të sigurt të të zhvendosurve në shtëpitë e tyre, të mbështetë ndihmën humanitare dhe rindërtimin të infrastrukturës kyçe dhe infrastrukturës ekonomike, të

²¹⁴ United Nations Security Council resolution 1244, op. cit., para. 9.

²¹⁵ Demilitarisation, demobilisation and further reintegration of the KLA took place mainly through the relocation of its membership in the Kosovo Police Service (KPS) and — most of them — in the Kosovo Protection Corps (KPC). The KPC would gather around 5,000 of these demobilised KLA members to perform civil protection functions within the provisional institutions established, the organisation and competences of which were to be under KFOR's and UNMIK's oversight.

²¹⁶ United Nations Security Council resolution 1244, op. cit., para. 11.

krijojë dhe mbikqyrë zhvillimin, konsolidimin dhe transferimin e shpejtë të kompetencave dhe përgjegjësi tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes; të facilitojë procesin politik drejt statusit, në përputhje të plotë me parimet e Ankesit 2 të institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes; të facilitojë procesin politik drejt statusit final të Kosovës, në përputhje të plotë me parimet e Ankesit 2 të Rezolutës 1244 (1999) dhe dokumentit të Rambujesë²¹⁷ dhe në një periudhë finale të mbikqyrë dhe të transferojë pushtetin nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes tek institucionet e dala sipas marrëveshjes politike.

Kjo rezolutë, lehtësoi popullit të dëbuar të kthehen në vatrën e tyre. Ky kthim hyri në analet e historisë botërore si kthimi më i shpejtë dhe më i vendosur ndonjëherë i parë në botë.

Të gjitha periudhat dhe ngjarjet të cekura më lart, pasqyrojnë rrugën që e ka kaluar Kosova populli, për të arritur paqen, lirinë dhe pavarësinë.²¹⁸

²¹⁷ S/1999/648 of 7 June.

²¹⁸ Për më shumë, shiko Rezolutën 1244 të OKB-së

IV. KAPITULLI I KATËRT.

4.1. Administrimi ndërkombëtar në Kosovë : UNMIK –u

Rezoluta 1244 vendosi bazat juridike për ndërtimin e një sistemi të administrimit civil ndërkombëtar, të siguruar gjithashtu nga forcat ushtarake ndërkombëtare, nën udhëheqjen e NATO-s. Në aspektin juridik, kjo rezolutë paraqet akt konstitutiv të vendosjes së Kosovës nën administrimin e OKB-së, duke vendosur një presence civile ushtarake ndërkombëtare²¹⁹. Rezoluta u miratua në bazë të një konsensusi ndërkombëtar, që vlerësohej si shumë i rëndësishëm në kohën kur po nxjerrej.

Gjithsesi, kjo rezolutë paraqet një akt të rëndësishëm për zhvillimet e mëtejme në Kosovë, sado që kjo rezolutë është marrë shumë më shumë me pasoja të asaj që kishte ndodhur. Megjithëse, rezoluta promocon konceptin e vetëqeverisjes për Kosovën, kompetencat substanciale të karakterit shtetëror, rezervohet dhe ushtrohet nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili ishte autoriteti përfundimtar, në funksionimin e pushtetit në Kosovë në tri trajtat e tij: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor²²⁰. Jetësimi i kësaj rezolute ka kaluar nëpër një process që mund të ndahet nëpër disa faza.

Tre fazat kryesore të administrimit ndërkombëtar në Kosovë, të cilat njëkohësisht paraqesin fazat e implementimit të Rezolutës 1244, janë:

1. **Faza e parë**, e cila përfshin periudhën nga miratimi i Rezolutës 1244 më 10 qershor 1999, deri në zgjedhjet lokale, në nëntor të vitit 2000, përkatësisht në zgjedhjet e para parlamentare, në Tetor të vitit 2001. Fazë kjo që shënoi vendosjen e prezencës civile ndërkombëtare – UNMIK dhe asaj ushtarake (siguria NATO-s me misionin e saj KFOR).

2. **Faza e dytë**, e cila fillon pas ndërtimit të institucioneve vendore demokratike, fazë kjo e cila karakterizohet nga bartja e kompetencave nga administrata ndërkombëtare tek institucionet vendore dhe

3. **Faza e tretë**, e cila përbën njëkohësisht fazën e fundit të implementimit të Rezolutës 1244, është marrë me përcaktimin e statusit final të Kosovës. Mirëpo në këtë fazë nuk u definua një mekanizëm i veçantë, i cili do të përcaktonte statusin final të Kosovës. Ky

²¹⁹ Bajrami, Arsim, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, 2011, Prishtinë, fq. 74.

²²⁰ Vep. e cit. fq. 75

mekanizëm do të sillte OKB-në para aktit të kryer, duke mos mundur të jetë faktori i vetëm legjitim për zgjidhjen e statusit të Kosovës, çka edhe u dëshmuua më vonë, gjatë negociatave për të ardhmen e statusit përfundimtar të Kosovës²²¹.

4.2 Sukseset dhe deshtimet e UNMIK-ut në Kosovë

Administrimi civil ndërkombëtar, i njohur si UN Mission in Kosovo, u krijuar në qershor të vitit 1999. Prezenca e tij ishte e paprecedan dhe mjaft komplekse. Ishte një pushtet, i cili, me formën dhe me tërësinë e tij, nuk ishte provuar asnjëherë. Ky pushtet, i dhënë nga Këshilli i Sigurimit, kishte të bënte me gjithë territorin e Kosovës dhe të popullit të saj, sikundër që ishte pushtet që në vete kishte legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin. Në fillimet e tija, UNMIK-u ndërtohet në katër shtylla, të cilat udhëheqen nga Kombet e Bashkuara. Gjithsesi, këto shtylla përfshinë edhe organizata dhe mekanizma të tjerë, të cilët mbetën këtu dhe zhvilluan aktivitetet e tyre nën Kombet e Bashkuara. Ata janë:

- Shtylla I: Ndihma humanitare e udhëhequr nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR);
- Shtylla II: Administrimi Civil nën Kombet e Bashkuara;
- Shtylla III: Demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve, udhëhequr nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe
- Shtylla IV: Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik, menaxhuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Siç shihet, përbërja e administrimit civil ndërkombëtar ishte mjaft heterogjene, ku prezente ishin edhe strukturat evropiane, kurse për çështjet e sigurisë mbetej të përkujdesej NATO me trupat emërtuar KFOR. Forca e Kosovës është një operacion i udhëhequr nga NATO fillimisht i përbërë nga 50.000 trupa nga shtetet anëtare, shtetet partnere dhe joanëtare nën komandë dhe kontroll unik brenda një kornize të njohur si NATO+ format²²².

Trupat e NATO-s, gjatë kalimit të kohës, do të pësojnë ndryshime në numër dhe në strukturë, por fillimisht KFOR-i ishte strukturuar në pesë brigada multinacionale, në pesë rajone, me seli qendrore në Prishtinë dhe me seli rear dhe me elemente përkrahje të gjerë nacionale në ish-Republikën e Maqedonisë. Komandanti i forcës (COMKFOR) i raporton komandantit të

²²¹ Zejnullahi, Veton, *Zgjidhja paqësore e konflikteve (temë e doktoraturës)*, Universiteti i Tiranës, 2003, fq. 98 e 99.

²²² Garcia, Debora-Orrico, *Kosovo*, fq. 17.

Forcave të Bashkuara në Napoli/Itali (COM JFCN) . Raporti direkt i tij me Këshillin e Sigurimit është i kufizuar me obligimet për të raportuar, me çka KFOR shkarkohet përmes Sekretarit të Përgjithshëm²²³.

Misioni i UNMIK-ut, i paraparë të realizohet brenda një kornize të caktuar kohore, nuk mund të jetësohej me lehtësi, pa pjesëmarrjen e popullatës vendore, e cila do të mund të ishte garanci më e mirë për suksesin. Por, pjesëmarrja e popullatës vendore në UNMIK dhe në strukturat e tij nuk ka qenë në nivel të nevojave dhe në nivel të mundësive ekzistuese. Kjo ka bërë që përgjegjësia e vendorëve të jetë e parëndësishme, kurse pushteti dhe strukturat e UNMIK-ut kur, është fjala për përgjegjësinë e tyre në Kosovë, as që mund të bëhet fjalë t.

Kosovarët, parimisht dhe së paku në fazat e hershme të vendosjes dhe jetësimit të pushtetit të UNMIK-ut, kanë përkrahur këtë pushtet. Shkaqet për këtë natyrshëm mund të sqarohen lehtë. Kosovës i duhej një pushtet, në një situatë të papushtet. Në një situatë ku gjithçka ishte e shkatërruar. Por, kjo gjendje duhej së paku supozuar se nuk do të mund të zgjaste pa masë dhe pa kufizim kohor. Kjo, sepse, ideja e udhëheqjes ndërkombëtare mbi një territor të huaj mund të jetë legjitime, vetëm nëse ajo udhëheqje ushtrohet në emër të popullatës lokale dhe për të mirë të saj²²⁴.

Se sa ky pushtet është ushtruar në emër të popullatës lokale, është fare e thjeshtë për t'u kuptuar. A mund të thuhet se ky pushtet u vendos në bazë të parimeve të demokracisë dhe të legjitimitetit përgjithësisht, kur ky pushtet nuk ishte vendosur si rezultat i procesit zgjedhor. Për më tepër, UNMIK-u ishte një substitut i shtetit dhe i gjithë pushteti ishte i koncentruar në duart e udhëheqësit të misionit²²⁵.

Detyrat e transferit të pushtetit nga UNMIK-u tek institucionet e përkohshme të Kosovës janë shoqëruar shumëherë me vështirësi. Pas zgjedhjeve të para parlamentare, pushteti i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë duhej ndarë në dy subjekte politike: PDK-së²²⁶ dhe LDK-së²²⁷. Ky formacion qeverisës ishte disi i imponuar. Dhe, madje edhe pas imponimit të këtij formacioni të qeverisjes kosovare dhe të Kuvendit të Kosovës, departamentet e UNMIK-ut transferuan funksione minore administrative dhe ekzekutive tek autoritetet e IPVQ

²²³ Garcia, Debora-Orrico, Vep. e cit., fq.17

²²⁴ Caplan f: 57-58 , marrë nga: KIPRED, *Administrimi dhe qeverisja në Kosovë* – Një projekt i koordinuar nga CASIN, 2005, Prishtinë-Gjenevë, fq. 6.

²²⁵ http://aix1.uottawa.ca/~czurcher/czurcher/Transitions_files/Final%20Report%20Kosovo.pdf,fq.2

²²⁶ Parti të cilës i printe Hashim Thaçi, që njihej si parti e krahut të luftës

²²⁷ Parti të cilës i printe Ibrahim Rugova e që ekzistonte që nga “KOHA” e paraluftës

dhe ministrinë. Në vend të transferit, UNMIK-u vazhdon të mbajë numër të madh pushtetesh të rezervuara për PSSP në fushat kyçe politike, si në polici dhe në gjyqësi, në përputhje me Kornizën Kushtetuese. PSSP-ja rregullisht përdorte veto për të bllokuar legjislacionin e Kuvendit të Kosovës, nëse ai legjislacion ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe mbante kontroll të gjerë ndaj pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, duke nxjerrë një numër të direktivave dhe të rregulloreve²²⁸.

Por se ky pushtet ka ushtruar funksionet e veta për të mirën e popullatës vendore, nuk mund të kontestohet krejtësisht, sepse, ç'është e vërteta, ky pushtet ka vepruar, fundifundit, për të mirën e popullatës vendore, parimisht. Në anën tjetër, një nga detyrat e UNMIK-ut, mund të thuhet më e rëndësishmja në planin afatgjatë, ka qenë që të sjellë territorin në një nivel, në të cilin çështjet që kanë të bëjnë me statusin e jashtëm, mund të mirren parasysht²²⁹.

Për më tepër, edhe në fillim të vendosjes së këtij misioni dhe gjatë gjithë kohës së ekzistimit të tij, vizioni politik i UNMIK-ut nuk ka qenë krejtësisht i qartë. E, asnjë administratë ndërkombëtare nuk mund të funksionojë pa pasur një vizion politik, të nënkuptuar ose të deklaruar për shoqërinë që e administron²³⁰.

Pushteti civil ndërkombëtar, më t'u vendosur në Kosovë, duhej të vepronte në bazë të një rregullative ligjore të caktuar. Baza themelore juridike për këtë pushtet ishte Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, por jetësimi i kësaj rezolute duhej bërë përmes një legjislacioni që duhet të kishte ngjyra edhe vendore, qofshin ato të trashëguara nga sistemi i kaluar i Federatës së shpërbërë jugosllave, qoftë edhe nga ajo që duhej krijuar, bazuar në nevojat dhe në rrethanat ekzistuese. Kështu, duke u mbështetur në rezolutë, Përfaqësuesi i Posaqëm i Sekretarit të Përgjithshëm (PPSP) në Kosovë në aktin e parë legjislativ të UNMIK-ut, Rregullorja nr. 1999/1 e 25 korrikut 1999, përcaktoi që të gjitha autorizimet legjislative dhe ekzekutive, në lidhje me Kosovën, përfshirë edhe administrimin e gjyqësisë, i jepen UNMIK-ut dhe ushtrohen nga PPSP-ja²³¹.

Me qëllim të pasjes së një "hiseje" lokale në qeverisje, më 15 dhjetor të vitit 1999, arrihet një marrëveshje për krijimin e Kosovë-UNMIK "Joint Interim Administrative Structure dhe

²²⁸ http://aix1.uottawa.ca/~czurcher/czurcher/Transitions_files/Final%20Report%20Kosovo.pdf, fq.32

²²⁹ KIPRED, Administrimi dhe qeverisja në Kosovë – Një projekt i koordinuar nga CASIN, 2005, Prishtinë-Gjenevë, fq. 3.

²³⁰ Caplan f: 76, marrw nga: KIPRED, Administrimi dhe qeverisja në Kosovë – Një projekt i koordinuar nga CASIN, 2005, Prishtinë-Gjenevë, fq. 3.

²³¹ Shih Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 1999/1, 25 qershor 1999, 1.1

Interim Administrative Council. Kjo arrihet në prezencë të PSSP Kushner. Kjo në një mënyrë bëhet edhe nga shkaku i zëvendësimit të strukturave paralele²³² administrative me struktura të përbashkëta administrative, të cilat shtrojnë rrugën për nxjerrjen e Rregullores për Vetëqeverisje Lokale, si të rregulloreve të tjera për shërbime publike dhe zhvillim institucional.

Nxjerrja e Kornizës Kushtetuese për Institucionete Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, në maj të vitit 2001, krijon një ndarje të re të pushtetit ndërmjet Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Pushtetit dhe UNMIK-ut. Kosova ishte në gjendje të mbajë zgjedhjet nacionale dhe të marrë përgjegjësi nga transferi i kompetencave. Megjithatë, pushteti i konsideruar ishte i rezervuar dhe mbeti te shefi i UNMIK-ut, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm²³³. Por, përkundër kësaj, UNMIKU duhej të vepronte që të kalojë a që të transferojë pushtet te vendorët. Dhe, kjo do të fillojë kur të krijohen institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. Në këtë kontekst, zgjedhjet e para u mbajtën në Kosovë më 17 nëntor 2001 dhe institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës i krijuan në mars të vitit 2002 (DG, 2004:47)²³⁴. Dhe, një ndër çështjet shumë të rëndësishme në këso situata, kur vendi gjindej nën administrim ndërkombëtar, është çështja e legjitimitetit. Një nga problemet qendrore në shoqëritë tranzicionale dhe në veçanti në protektorate, siç është Kosova, është çështja e legjitimitetit. Qeveritë lokale duhet t'i plotësojnë të dyja kërkesat: ato të imponuara nga bashkësia ndërkombëtare dhe ato të adresuara nga votuesit dhe kështu këtu mungon pushteti autoritativ. Kjo është shqetësim i rëndësishëm për procesin e shtetndërtimit, me qëllim të arritjes së qëllimit për teorinë liberale të paqes²³⁵.

Pushteti i PSSP-ve varej në shumë forma edhe nga personaliteti i bartësve të këtij funksioni. Kushner, p.sh., mbahet mend si mjaft dinamik dhe i vullnetshëm për bashkëpunim të ngushtë me vendorë, kurse Holkeri²³⁶ njihet si mjaft i ftohtë dhe rigjin. Kurse, me ardhjen e Petersenit, pas dorëheqjes së Holkerit, përshpejtoi transferin e pushtetit nga UNMIK-u tek IPQV, përmes krijimit të ministrive, të cilat deri atëherë i takonin sektorëve të pushtetit të rezervuar, siç janë

²³² Kosova e pasluftës karakterizohet edhe me dy qeveri shqiptare paralele karshi pushtetit të UNMIK-ut. Një qeveri ekzistonte për kohë të gjatë dhe veprimtarinë e vet e kishte ushtruar me vite në ekzil dhe kësaj i printe Bujar Bukoshi si kryeministër. Tjetra qeveri ishte e kohës së fazës së Rambujesë qv menjëherë pas luftës vendoset në Kosovë duke u quajtur si Qeveria e Përkohshme e Kosovës. Që të dy këto qeveri obligohen të shuhën.

²³³ Jolyon Nyagele, The Case of United Nations Mission in Kosovo, (pa vit botimi) fq.2

²³⁴ <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=1326136&fileId=1326137>, fq.16

²³⁵ <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=1326136&fileId=1326137>, fq.20

²³⁶ Në mandatin e tij ndodhin “Ngjarjet e marsit 2004”

policia dhe drejtësia, kontrolli kufitar dhe Trusti i Kosovës (që mbikqyrte procesin e privatizimit, të imponuar nga UNMIK-u të ndërmarrjeve shoqërore)²³⁷. Dhe, ky kryeadministrator shquhet edhe me shtyrjen dhe përshpejtimin e procesit të përcaktimit të statusit final për Kosovën.

Pas shpalljes së pavarësisë dhe në kohën e ndërtimit të institucioneve, sipas legjislacionit të ri, në Kosovë, sërish do të vendoset një mision ndërkombëtar. Por tashmë ky mision është i natyrës tjetër dhe me përbërje gjithashtu tjetër. Pra, tash misioni është i Bashkimit Evropian, i cili dallonte qenësisht nga administrimi i mëparshëm. Bashkimi Evropian kishte dy përparësi të mëdha, të cilat UNMIK-u nuk i kishte. Siç ishte rasti me Bosnjën SFOR, ku shumica e trupave të UNPROFOR thjesht ndryshuan kapelat nga blu në jeshile. Operacionet ushtarake dhe civile të Kombeve të Bashkuara mund të bëjnë në transfer të lehtë për vendosjen e forcave ushtarake dhe civile nën udhëheqje të BE. E dyta, UNMIK-u la një trashëgimi të rëndësishme të rregulloreve dhe të të dhënave (psh. kadastra, prona dhe regjistrat e votuesve), të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën kur UNMIK erdhi në Kosovë, në vitin 1999²³⁸.

Por, Bashkim Evropian ishte edhe pjesë e pushtetit të vendosur nga OKB-ja dhe luajti rol shumë të rëndësishëm. Kështu, nën pushtetin e shtyllës katër; BE ishte e ngarkuar të mbikqyrë reformën makroekonomike, të mbikëqyrë dhe të rregullojë sektorin banker me anë të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës. Ishte këshillëdhënie për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për çështjet e politikave makroekonomike, tatimet dhe për çështjet e buxhetit me anë të zyrës për punë fiskale. Pastaj mbështeste dhe implementonte programet e privatizimit dhe përforconte zbatueshmërisë të ndërmarrje në pronësi shoqërore dhe ndërmarrje publike me antë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit²³⁹.

Të kthehemi edhe një herë te baza juridike për nxjerrjen e Kornizës Kushtetuese, e cila është vetë Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit. Korniza Kushtetuese kishte karakter kalimtar mu sikurse Rezoluta 1244 dhe si akt pak i njohur në praktikë, kishte tri qëllime: Nën një, të krijojë bazën juridike për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare dhe për krijimin e institucioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në nivel të Kosovës, të bëjë praktike apo të qëndrueshme vetëqeverisjen e përkohshme për Kosovën brenda kornizës së përcaktuar me Rezolutën 1244 për periudhën e caktuar kalimtare dhe qëllimi i tretë ishte të përgatitë Kosovën

²³⁷ http://aix1.uottawa.ca/~czurcher/czurcher/Transitions_files/Final%20Report%20Kosovo.pdf, fq.33

²³⁸ Susan, L. Wood ward, *Does Kosovo's Status Matter? On the International management of Statehood*, Sudosteuropa, 55 (2007)1, S.1-25, fq. 17.

²³⁹ http://fride.org/download/BGR_Challenges_EU_Kosovo_ENG_may07.pdf (qasur mw 4. 4. 2015).

për zgjidhjen finale politike, proces ky që ishte për një fazë të mëvonshme, pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar, të përcaktuar me Rezolutën 1244²⁴⁰.

4.3. Definimi i statusit final të Kosovës

Ishte e qartë se administrimi civil ndërkombëtar nuk do të mund të mbetej përgjithmonë në Kosovë.

Në vitet e para të pasluftës, ky pushtet konsiderohej të ketë qenë shumë i doboshem dhe në masë të caktuar edhe efikas. Por, me kalimin e kohës, ky mekanizëm humbi përkrahjen e popullatës në Kosovë, e cila tashmë kërkonte diçka më shumë. Kjo “diçka më shumë” ishte aspiratë për shtetndërtimin e Kosovës dhe për përcaktimin e statusit final të saj. Por, për t’u futur në procesin e bisedimeve për përcaktimin e statusit final të Kosovës, bashkësia ndërkombëtare do të parashtrijë disa parakushte, të cilat duhej të plotësoheshin. Ishte kryeadministratori Steiner ai që do të propozojë të ashtuquajtura “standarde para statusit”²⁴¹, që do të shërbejë si dokument bazë dhe si njësi matëse, që pas vlerësimit nëse janë plotësuar ose jo, do të ndezë dritën e gjelbërt për të shkuar më tutje me bisedime për statusin final. Por, çështje si kjo dëgjohen edhe në Këshillin e Sigurimit, sepse Rezoluta 1244 ishte aprovuar duke mos pasur në vete ndonjë strategji dalëse.

Kofi Anan, sekretar i përgjithshëm i OKB-së, në fjalimin e tij të 24 prill 2002, ka kërkuar nga Steiner që të zhvillohen pika referimi, ku do të bëhej matja e progresit të arritur. Në bazë të kësaj kërkesë, z. Steiner (PSPP) i drejtohet Këshillit të Sigurimit me fjalët: ”Ju ofroj këtë si një strategji dalëse, që në realitet është një strategji hyrëse në procesin e integritit evropian”²⁴².

Pikat e referimit të Steinerit kishin të bënin me: sundimin e ligjit, lirinë e levizjës, respektimin e të drejtave për të gjithë për të jetuar apo kthyer në Kosovë, ekonominë e tregut, defenimin e qartë të pronës shoqërore, shtetërore e private dhe dialogun me Beogradin dhe reduktimin dhe transformimin e TMK-së²⁴³.

²⁴⁰ Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini 2011, Prishtinë, fq.76

²⁴¹ Steiner promovon hyrjen në diçka që shënon nismën e daljes nga status quo-ja që ishte bërë e padurueshme sidomos për shqiptarët e Kosovës që tashmë rrezikonin të shprehnin moskënaqësinë e tyre në mënyra tjera

²⁴² Steiner, Michael, *Fjalim para Këshillit të Sigurimit, 24 Prill 2002*, Press release SC/7375, 24 Prill 2002. Security Council.

²⁴³ Po aty.

Bazuar në këtë që u tha më lart, mund të nxjerrim një përfundim se dokumenti Standardet për Kosovën që u nënshkrua më 10 dhjetor 2003 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm Hari Holkeri dhe kryeministri i Kosovës Bajram Rexhepi, ishte një lloj strategjie dalëse, e cila hapte rrugën për dalje nga status quo që po mbretëronte në Kosovë. Në fakt, në Kosovë, më 17 mars 2004, ndodhi një protestë me përmasa të konsiderueshme, me ç'rast në mes tjerash u demoluan edhe disa objekte fetare serbe. Shkaqet e shpërthimit të kësaj pakënaqësie të një mase jo të vogël njerëzish ende nuk janë sqaruar, ndoshta edhe nga fakti se as tani nuk dihet kush qëndronte pas atyre protestave. Por dihen pasojat, meqenëse pikënisje e përmbajtjeve të shumë dokumenteve për Kosovën, bazën e kanë nga ato protesta që mirren si pasqyrimi i nevojës për siguri shtesë të komunitetit serb në Kosovë.

Brenda një periudhe jo të gjatë kohore, në muajin korrik 2004, Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara Kai Eide ka rekomanduar bartje të pushtetit tek institucionet e përkohshme vetëqeverisës dhe ka rekomanduar të fillohet me diskutime për statusin²⁴⁴.

Pak më vonë, do të kemi raportin e dytë të Kai Eides, me titull “Shqyrtim gjithëpërfshirës i situatës në Kosovë”, i cili do të jetë çelësi dhe udhëzuesi për nisjen e negociatave për statusin final të Kosovës. Ky raport ishte i datës 7 tetor 2005.

Ajo që duhet nënvizuar me këtë rast dhe që duhet vënë në tekst, është edhe Deklarata e Grupit të Kontaktit, përkitazi me raportin e Kai Eides, e cila shpjegohet, si në vijim: Grupi i kontaktit ka shqyrtuar letrën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportin e ambasadorit Kai Eide mbi shqyrtimin gjithëpërfshirës të gjendjes në Kosovë, që i janë paraqitur Këshillit të Sigurimit më 7 tetor 2005. Grupi i kontaktit mbështet rekomandimet e Sekretarit të Përgjithshëm të paraqitura para Këshillit të Sigurimit, të bazuara në këtë raport për të nisur procesin e përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Grupi mirëpriti qëllimin e Sekretarit të Përgjithshëm për caktimin e një emisari special, i cili do të udhëhiqte këtë proces.

Poashtu në këtë raport, potencohet se Grupi i Kontaktit me kënaqësi mbështeti përpjekjet e emisarit special dhe ekipin e tij, dhe se një zgjidhje negociuese duhej të ishte një prioritet ndërkombëtar dhe se procesi i filluar nuk mund të bllokohej, por duhej të përfundonte. Grupi i Kontaktit thirri palët që të angazhohen me besnikëri dhe në mënyrë konstruktive, që të

²⁴⁴ Shih Raportin Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr. 182, Prishtinë, (Beograd, New York), Brussels, 2007, fq.7.

përmbahen nga hapat e njëanshëm dhe të refuzojnë çdo formë të dhunës. Ata që përkrahin dhunën, nuk do të kenë asnjë rol. Emisari Special mund të ndërmarrë veprime të duhura në kuadër të mandatit të tij në Kombet e Bashkuara për të suspenduar apo përjashtuar çdo individ apo grup nëse mendon se veprimet e tyre nuk shpien drejt përparimit.

Grupi i kontaktit poashtu ftoi të gjitha palët që të themelojnë ekipet negociuese të unitetit dhe të pajtohen mbi pikëpamjet e përbashkëta.

Procesi duhet të sigurojë pjesëmarrjen efikase të serbëve të Kosovës dhe qytetarëve dhe komuniteteve tjera të Kosovës. Fqinjët rajonalë dhe palët e tjera të interesuara doemos duhet të konsultohen. Përparimi i procesit të statusit do të varet jo vetëm nga niveli i angazhimit të palëve, por edhe nga kushtet në terren. Zbatimi i standardeve të caktuara nga Kombet e Bashkuara duhet të vazhdojnë gjatë procesit të statusit dhe ato do të jenë faktor i përcaktimit të përparimit të bërë. Grupi i Kontaktit riafirmon rëndësinë që lidhet me dialog konstruktiv dhe të qëndrueshëm në të gjitha nivelet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Grupi i Kontaktit kërkon nga autoritetet në Beograd që në mënyrë aktive të nxisin serbët e Kosovës për të zënë vendet e tyre në institucionet e Kosovës. Këshilli i Sigurimit do të mbetet aktivisht i preokupuar me këtë çështje. Vendimi përfundimtar mbi statusin e Kosovës duhet të aprovohet nga Këshilli i Sigurimit. Prandaj, Grupi i Kontaktit informon të gjitha palët e kyçura se rezultati i procesit të statusit duhet të bazohet në parimet, si më poshtë:

Vendosja e çështjes së Kosovës duhet të jetë plotësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe të së drejtës ndërkombëtare dhe duhet të kontribuojë në sigurinë e rajonit, zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të jetë në përputhje me vlerat demokratike dhe standardet evropiane dhe duhet të kontribuojnë në realizimin e një Kosove me perspektivë evropiane, në veçanti në përparimin e Kosovës në procesin e stabilizim-asocimit, si dhe integrimin e rajonit të gjithmbarshëm në institucionet euroatlantike, zgjidhja duhet të sigurojë shumetnicitet të qëndrueshëm në Kosovë. Duhet të ofrojë garancinë efikase kushtetuese dhe mekanizma të përshtatshme për të siguruar zbatimin e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët në Kosovë dhe të drejtat e anëtarëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë të drejtat e refugjatëve dhe të personave të zhvendosur për t'u kthyer të sigurt në shtëpitë e tyre, zgjidhja duhet të ofrojë mekanizma për sigurimin e pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve kosovare në qeverisje, të nivelit qendror dhe lokal, zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të përfshijë kujdesin specifik të sigurimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe

religjioze në Kosovë. Kjo duhet të përfshijë cilësimin e statusit të institucioneve të Kishës Ortodokse serbe, vendndodhjeve dhe pronës në Kosovë, zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të konsolidojë sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Në këtë mënyrë, kjo do të sigurojë që Kosova të mos kthehet në gjendjen e para marsit të vitit 1999. Çdo zgjidhje që është e njëanshme ose që është rezultat i përdorimit të forcës, nuk do të jetë e pranueshme. Nuk do të ketë ndryshime të territorit të tanishëm të Kosovës, që do të thotë nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër a me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve rajonalë do të respektohet plotësisht, zgjidhja e statusit do t'i sigurojë Kosovës siguri. Kjo do të sigurojë gjithashtu që Kosova të mos paraqesë kërcënim ushtarak ose kërcënim të sigurisë për fqinjët e saj, zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të avancojë mekanizma efikas për të konsoliduar mundësitë e Kosovës për të zbatuar sundimin e ligjit, për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin dhe për të mbrojtur karakterin shumetnik të policisë dhe të gjyqësorit, zgjidhja duhet të sigurojë se Kosova mund të zhvillohet në një mënyrë të qëndrueshme ekonomikisht edhe politikisht dhe se ajo mund të bashkëpunojë në mënyrë efektive me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet ndërkombëtare financiare dhe për një kohë.

Sipas një vlerësimi në këtë raport, Kosova do të vazhdojë të ketë nevojë për një prani ndërkombëtare civile dhe ushtarake për të ushtruar mbikëqyrjen e duhur të përputhshmërisë së kushteve të parapara në zgjidhjen e statusit për ofrimin e sigurisë dhe, në veçanti, për të siguruar mbrojtjen e minoriteteve, si dhe të vëzhgojë dhe të mbështesë autoritetet në zbatimin e vazhdueshëm të standardeve²⁴⁵

Raporti i Kai Eides 'Shqyrtimi i përgjithshëm i implementimit të standardeve' ishte një hap përpara për ndërtimin e strategjisë dalëse të UNMIK-ut²⁴⁶. Këshilli i Sigurimit mirëpriti raportin e Kai Eides dhe gatishmërinë e Sekretarit të Përgjithshëm për të emëruar emisari special, i cili do të udhëhiqte procesin për statusin e ardhshëm²⁴⁷. Dhe, ky emisar do të jetë Marti Ahtisaari, i cili u bë Emisari Special i Sekretarit të Përgjithshëm që do të udhëheqë negociatat ndërmjet të Kosovës dhe Serbisë, përkthazi me statusin final të Kosovës.

²⁴⁵ Parimet udhëheqëse të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës:
http://www.unosek.org/docref/2005-10-07_-_Contact_Group_-_Ten_Guiding_principles_for_Ahtisaari_-_albanian-pdf.

²⁴⁶ Raporti, Fq. 34.

²⁴⁷ S/PRST/2005/51

Kështu, në nëntor të vitit 2005, Emisari Special dhe zëvendësi i tij zhvillojnë vizitën e parë në rajon. Ata vizitojnë Prishtinën dhe Beogradin, gjithashtu edhe Tiranën, Podgoricën dhe Shkupin. Më pastaj, Emisari Special, zëvendësi i tij dhe personeli teknik shumë herë vizituan rajonin për të realizuar negociatat dhe për të ndihmuar në çështje teknike të dialogut. Në kursin e vitit 2006, UNOSEK ka mbajtur 15 raunde të bisedimeve direkte me ekipet negociuese të Prishtinës dhe të Beogradit²⁴⁸.

Katërmëdhjetë nga këto raunde bisedimesh janë fokusuar në decentralizimin, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë, në çështje ekonomike dhe në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit.

Emisari Special udhëhoqi takimet direkte ndërmjet udhëheqësive serbe dhe shqiptare në Vjenë, më 24 korrik 2006. Presidenti Boris Tadić dhe kryeministri Vojislav Kostunica udhëheqnin delegacionin e Serbisë, ndërsa presidenti Fatmir Sejdiu ka udhëhequr Ekipin Kosovar të Unitetit²⁴⁹.

Takimi i jap mundësinë secilës palë që të paraqesë në nivelin më të lartë politik, të dy palëve negociuese pikëpamjet e tyre për të ardhmen e Kosovës, këtë mundësi e kishin edhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare nga UNOSEK, dhe nga monitoruesit si BE, NATO etj.

Në kuadër të kësaj game të bisedimeve, delegacionet e Kosovës dhe të Serbisë janë takuar me 24 korrik në Vjenë, kanë pasur tetë takime lidhur me decentralizim (20,21 shkurt, 17 mars, 3 prill,, 5 maj, 19 korrik, 7 gusht, dhe 15 shtator, tre takime i kanë pasur lidhur me trashëgiminë kulturore dhe fetare në Kosovë me theks të veçantë të asaj serbe. Këto takime janë mbajtur me 23 maj, 18 korrik dhe 8 shtator. Dy takime, me 8 gusht dhe 8 shtator të delegacioneve përkatës të Kosovës dhe Serbisë janë mbajtur lidhur me të drejtat e komuniteteve dhe një takim me 31 maj ku është biseduar për çështje ekonomike²⁵⁰.

Krahas këtyre takimeve direkte të palëve negociuese, që nga muaji janar të vitit 2006, 26 misione ekspertësh të UNOSEK-ut kanë vizituar Beogradin dhe Prishtinën, për të zhvilluar ndaras çështje të ndryshme. Ngjashëm që nga nëntori 2005, Emisari Special dhe zëvendësi i tij janë takuar shumë gjerësisht me të tjerë lojtarë kyçë të këtij procesi. Këto përfshinë edhe brifingjet në Këshill të Sigurimi (4 mars, 13 korrik dhe 22 shtator 2006); takime me ministra të

²⁴⁸ Shih UNOSEK

²⁴⁹ Ekipi i Unitetit ishte krijuar nga presidenti i ndjerë Ibrahim Rugova, i cili kishte bërë përpjekje që ky ekip të ishte një grup koheziv, ku të gjithë do të merrnin pjesë dhe në anën tjetër të gjithë do të merrnin përgjegjësi.

²⁵⁰ Shih UNOSEK.

jashtëm të BE dhe me akterë të tjerë ndërkombëtarë, përfshirë NATO-n dhe OSBE-në.

Më 25 janar 2007, Emisari Special takohet me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Ban Kimoon, në Paris, të cilit i raporton shkurtimisht për zhvillimet e fundit gjatë procesit të statusit dhe e ndan me te propozimin. Të nesërmen, Emisari Special takohet në Vjenë me anëtarët e Grupit të Kontaktit dhe paraqet përmbajtjen e propozimit si pjesë e konsultimeve të rregullta dhe të bashkëpunimit ndërmjet të UNOSEK-ut dhe Grupit të Kontaktit.

Më 2 shkurt, Emisari Special udhëtoi në Beograd dhe në Prishtinë, për të paraqitur draftpropozimin për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, tek të dyja palët. Në Beograd propozimi i dorëzohet presidentit Boris Tadiq, kurse në Prishtinë Emisari Special propozimin e vet ia paraqet presidentit Fatmir Sejdiu dhe Grupit të Unitetit. Emisari Special më pastaj thirri palët në Vjenë për një seri takimesh, përkitazi me draftpropozimin.

Gjatë raundit të parë të bisedimeve, në mes datave 22 shkurt - 2 mars, delegacionet shqyrtojnë dokumentin në tërësi.

UNOSEK-u pastaj përmirëson draftin fillestar dhe Emisari Special thirri përfaqësuesit më të lartë të të dyja palëve që të marrin pjesë në një takim niveli të lartë në Vjenë, më 10 mars.

Delegacioni i Beogradit udhëheqej nga presidenti Boris Tadiq dhe kryeministri Vojislav Kostunica, kurse Ekipi i Unitetit nga Prishtina udhëheqej nga presidenti Fatmir Sejdiu.

Përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit, të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s gjithashtu morën pjesë në mbledhje. Në fund të takimit të nivelit të lartë, Emisari Special vërejti se nuk ka vullnet të palëve për të lëvizur, ngjashëm me qëndrimet e deklaruara më parë.

Duke mos lënë mundësi se palët mund të lëvizin nga pozitat e tyre këmbëngulëse për statusin e Kosovës dhe si të tilla këto qëndrime të ngurta nuk lënin asnjë hapësirë të përbashkët për arritje të ndonjë marrëveshjeje dhe as se ndonjë raund të bisedave shtesë nuk do të ndihmonte përafrimin e qëndrimeve, Emisari Special konkludon se potenciali i negociatave ka shterur. Ai deklaroi se ka për qëllim që propozimin e tij ta finalizojë për ta dorëzuar në Këshillin e Sigurimit gjatë muajit mars.

Më 14 mars, zëvendësi i Emisarit Special Albert Rohan udhëton në New York për t'ia dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm Propozimin Gjithëpërfshirës Final për zgjidhjen e statusit të Kosovës, si dhe Raportin e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm përkitazi me statusin e ardhshëm. Që të dyja ishin përkthyer në gjuhët zyrtare të Kombeve të Bashkuara dhe dokumenti

i kompresuar me raportin dhe me propozimin e përgjithshëm dorëzohet zyrtarisht në Këshillin e Sigurimit më 26 mars.

Më 3 prill, Emisari Special raportoi në Këshill të Sigurimit përkitazi me procesin e statusit dhe shpjegoi propozimin. Anëtarët e Këshillit të Sigurimit pastaj filluan të ekzaminojnë propozimin. Bazuar në faktin se nuk mund të sigurohej rezoluta nga anëtarët e Këshillit të Sigurimit, anëtarët e Këshillit të Sigurimit që kishin ko-sponsorizuar një draft-rezolutë, atë zyrtarisht e paraqitën më 17 korrik.

Në deklaratë ko-sponsorët shprehin besimin e tyre se rekomandimet e Emisarit Special, të cilin Sekretari i Përgjithshëm e ka ngarkuar tërësisht, janë fer dhe të balancuara, prandaj japin zgjidhje më të mirë, e cila do të avansojë stabilitetin, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë në rajon. Ata treguan punët e tyre intezive dhe përpjekjet për të akomoduar shqetësimet dhe për t'i inkorporuar në propozim nga anëtarët e tjerë të Këshillit në një draft suksesiv dhe jozyrtar. Pastaj shprehën keqardhje se megjithatë ishte e pamundur të sigurohej një rezolutë nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Prandaj, ko-sponsorët deklaruan se do të mbajnë diskutimet për rezolutën dhe vendosën të rifillojnë diskutimet brenda Grupit të Kontaktit dhe me palët e tjera. Ata, gjithashtu, treguan mbështetjen e tyre për propozimin e Emisarit Special dhe besimin e tyre se ai duhet të jetë bazë për bisedime të mëtejme.

Ko-sponsorët shprehin besimin e tyre se “zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të arrihet sa më parë të jetë e mundur” dhe shpresën e tyre se këto diskutime do të çojnë tek marrëveshja ndërmjet palëve. Nëse jo, ata shtojnë se ne vazhdojmë të besojmë se Plani i Ahtisaarit është rruga më e mirë për ecje përpara.

Më 1 gusht, Sekretari i Përgjithshëm Ban Kimoon nxori një deklaratë përkitazi me periudhën e angazhimit në Kosovë. Në deklaratë, Sekretari i Përgjithshëm thotë se Grupi i Kontaktit ka raportuar përkitazi me marrëveshjen për modalitetet për negociata të mëtejme ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe nënvizon se këto përpjekje duhet udhëheq nga Trojka që përbëhet nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, Federatës Ruse dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sekretari i Përgjithshëm mirëpriti iniciativën e Grupit të Kontaktit dhe shpreh shpresën e vet se një periudhë e re angazhimi do të drejtojë kah arritja e marrëveshjes për statusin e ardhshëm të Kosovës, që mbetet prioritet i Kombeve të Bashkuara. Sekretari Gjeneral thotë se bashkësia ndërkombëtare duhet të gjejë një zgjidhje që është në kohë, që adreson shqetësimet e të

gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe që jep qartësi për statusin e Kosovës. Status quo nuk është i qëndrueshëm, ka shtuar ai. Sekretari i Përgjithshëm ka thënë se në zyrën e Kombeve të Bashkuara të Emisarti Special për Kosovën (UNOSEK) do të bëhet i ditur procesi, me gatshmëri që të ato do të informojnë dhe do të sqarojnë për ndonjë kërkesë. Ai ka shtuar se Kombet e Bashkuara do të vazhdojnë të luajnë rol konstruktiv në periudhën e re të angazhimit dhe do të luajnë rol kryesor në Kosovë.

Sekretari i Përgjithshëm ka deklaruar se Grupi i Kontaktit do të raportojë sërish tek ai me më 10 dhjetor²⁵¹.

Marti Ahtisaari, si diplomat dhe politikan me përvojë dhe si njohës i jashtëzakonshëm i rrethanave në Ballkan, në fakt e kishte bërë të qartë kur i kishte raportuar Sekretari i Përgjithshëm, duke theksuar se: Ri-integrimi i Kosovës në Serbi nuk është opsion i zbatueshëm, as vazhdimi i administrimit ndërkombëtar nuk është i zbatueshëm andaj sipas këtij raporti, pavarësia e mbikëqyrur ndërkombëtare është opsioni i vetëm i zbatueshëm²⁵².

Përvoja e bisedimeve me Serbinë, që ka pasur bashkësia ndërkombëtare, ka treguar se këto bisedime nuk do të janë të lehta dhe se rezultatet zakonisht ka qenë vështirë të parashiheshin.

Gjatë kohës së regjimit të Milosheviqit, ishte vërtetuar se për te, mjet i fundit mbetej kërcënimi me përdorimin e forcës. Pra, për të ekzistonte vetëm fryma e strategjisë refuzuese, e zvarritjes së proceseve dhe tendenca për të përçarë partnerët dhe ndërmjetësuesit. Prandaj, dështimet e Konferencës së Rambujesë nuk ishin të një kohë të largët.

4.4. Plani Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusti Final të Kosovës

Pakoja e Ahtisaarit

Plani Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusti Final të Kosovës, që ndryshe njihet si Pakoja Ahtisaari, dorëzuar nga Emisari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, ish-president i Finlandës, pas më shumë se një viti konsultimesh me të dyja palët, jep një pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën.

Ky dokument hapi rrugën drejt statusit final të Kosovës. Përkundër përpjekjeve të jashtëzakonshme të Emisarit Special dhe ekipit së tij, përkundër angazhimit të Grupit të

²⁵¹ Shih UNOSEK.

²⁵² Shih më tepër raportin e Marti Ahtisaari, përkitazi me propozimin e Planit të tij për statusin final të Kosovës.

Kontaktit, BE-së etj., Serbia nuk u bind që të pranojë këtë dokument. Në anën tjetër, Kosova, përkundër faktit se pakoja nuk ofronte atë që ishte dëshirë unanime e popullit shumicë të Kosovës, e pranoi. Kuvendi i Kosovës ishte deklaruar pro këtij plani²⁵³.

Ajo që qysh në fillim të këtij nënkapitulli duhet ta theksoj, është se ky dokument vjen si rezultat i një procesi negociator që Kipred e quan si “Arbitrimi i negociuar”, në formë të propozimit gjithëpërfshirës përcakton tri fusha kryesore. Së pari, vendos një kornizë të shtetit të ardhshëm të Kosovës, duke rekomanduar heshturazi një pavarësi të mbikëqyrur. Së dyti, qartazi përcakton një pozitë të veçantë për serbët dhe kishat ortodokse serbe në Kosovë, duke përfshirë edhe marrëdhëniet me Serbinë. Së treti, parashikon një kujdestari të ngushtë, por të theksuar ndërkombëtare për të mbikëqyrur zbatimin e dy të parave. Praktikisht, Kosova merr subjektivitet ndërkombëtar, edhe pse për një kohë mbetet e kufizuar në ushtrimin e përgjegjësive të veta sovrane²⁵⁴.

Pakoja Ahtisaari përcakton parimet, në bazë të të cilave do të ndërtohen kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Ky dokument merr karakteristika të një akti mbi kushtetutën e Kosovës, e cila parashihej të nxirrej pas afatit të caktuar. Kurse me këtë parashihej edhe se kush do të ketë autoritet të interpretojë këtë akt, e që ishte Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, që do t'i përgjigjej Grupit Drejtues Ndërkombëtar që përbëhej nga: Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian dhe NATO.

Dokumenti edhe pse nuk e specifikon statusin e Kosovës, ai megjithatë jep disa elemente që kanë të bëjnë vetëm me shtetin. Dhe, këto elemente janë: E drejta për të negociuar dhe përkitazi marrëveshje ndërkombëtare dhe e drejta për të kërkuar anëtarësim në organizatat ndërkombëtare (dispozitat e përgjithshme, nenet 1.5 dhe 2.1). Forca e sigurisë, duke pranuar mandatin e saj për kërcënimet e jashtme në një fazë më të vonshme (Aneksi IX, Neni 1.1. a), E drejta specifike për ratifikim të konventave ndërkombëtare (parimet e përgjithshme, Neni 2.1), Marrja e obligimit për borxhin ndërkombëtar (Aneksi VI), Pranimi që e gjithë prona publike brenda Kosovës kalon në pronësi të saj, Kontrolli i hapësirës ajrore (Aneksi VIII, Neni 7²⁵⁵

²⁵³ Deklarata e Kuvendit të Kosovës për pranimin e *Planit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusti Final të Kosovës* (Pakoja Ahtisaari)-Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë këtë Deklaratë më 5 prill 2007.

²⁵⁴ KIPRED, *Analizë e Planit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës*, 2007, Prishtinë, fq. 2.

²⁵⁵ Vepra e cituar, fq. 3

Por, këtyre veçorive do të mund t'u shtohen edhe një mori veçorish që domosdoshmërisht nuk do të konsiderohen si veçori të shtetit a të shtetësisë. Këtu mund të numërohen e drejta për të pasur simbole, e drejta e marrëdhënieve me jashtë etj.

Pakoja Ahtisaari është një dokument mjaft voluminoz, i cili në përbërjen e vet ka 12 anekse. Si akt juridik dhe si dokument obligativ për Kosovën, ka epërsi ndaj çdo akti juridik vendor. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Kushtetutës së Kosovës²⁵⁶, që do të nxirret më vonë dhe dispozitave të Pakos së Ahtisaarit, atëherë epërsi do të kanë dispozitat e pakos Ahtisaari²⁵⁷. Pakoja Ahtisaari, si një dokument i pranuar nga Kosova, jo rrallë është kontestuar dhe jo rrallë është kritikuar edhe brenda Kosovës, ndonëse është pranuar. Çështja është se ky dokument, kur kritikohet, thuhet për të të jetë përpiluar vetëm për komunitetet joshqiptare dhe nëse si i tëri është përpiluar për të vendosur një qetësi të përkohshme dhe për të kënaqur në masë të madhe apetitet serbe. Kundërshtarë më të zëshëm që gjithmonë e kanë kundërshtuar Planin Ahtisaari, është dëshmuar të jetë Lëvizja Vetëvendosje. Përbërja e vetë pakos, në dukje, krijon përshtypje se është përpiluar me qëllime të tilla. Por kur të analizohet teksti si dokument, atëherë del se në rrethanat kur është nxjerrë, qofshin ato të jashtme a të brendshme, kjo zgjidhje ka qenë zgjidhje më optimal që ka hapur rrugë për qëndrueshmëri të mëvonshme. Dokumenti është i natyrës së përkohshme dhe si i tillë, pavarësisht qindra kritikave, megjithatë nuk duhet marrë si diçka që a priori duhet refuzuar.

4.5. Përmbajtja dhe përkufizimi i Planit të Ahtisaarit

Fillimisht duhet potencuar se Pakoja e Ahtisaarit, nga të gjithë është kuptuar si kompromis, se edhe i tillë ishte, por edhe i domosdoshëm për pranimin e një pavarësie të ashtuquajtur të kushtëzuar për Kosovën.

Praktikisht në Pakon e Ahtisaarit, Kosova e fiton subjektivitetin ndërkombëtar, por në anën tjetër komplikon dhe sfidon funksionalitetin e shtetit të Kosovës me potencimet dhe garantimet e të drejtave dhe kompetencat e serbëve jo vetëm në aspektin e të drejtave të komunitetit të tyre por edhe kompetencave të tyre në rregullimin e sistemeve shtetërore.

²⁵⁶ Kushtetuta e Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, kurse është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 9 prill 2008.

²⁵⁷ Kapitulli XIII tek dispozitat përfundimtare të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 143 pika 2 shprehet se Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të dates 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.

Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës në përmbajtjen e saj ka dispozitat e përgjithshme dhe 12 anekse: Aneksi I – Dispozitat Kushtetuese; Aneksi II – Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Komuniteteve; Aneksi III – Decentralizimi; Shtojcë Aneksit III – Përkufizim i komunave të reja; Aneksi IV – Sistemi Gjyqësor; Aneksi V – Trashëgimia Fetare dhe Kulturore; Aneksi VI – Borxhi Ndërkombëtar; Aneksi VII – Prona dhe Arkivi; Aneksi VIII – Sektori i Sigurisë së Kosovës; Aneksi IX – Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar; Aneksi X – Misioni Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes; Aneksi XI – Prania Ushtarake Ndërkombëtare; Aneksi XII – Agjenda Legjislative. Në vazhdim do të pasqyroj disa nga elementet e përgjithshme të Pakos së Ahtisaarit.

Qeverisja - Një kushtetutë e re do të hartohet, e cila do të nënvizojë se Kosova do të bëhet një shtet demokratik i qeverisur, shoqëri multi etnike e bazuar në respektimin e ligjit, të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale. Kosova do të bëhet e aftë që të zhvillojë aktivitetet e veta paradiplomatike (ius tractate-të lidhë traktate me shtete tjera dhe ius legations – të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare). **Të drejtat e komuniteteve** - Do të mbrohen të drejtat nacionale, kulturore, linguistike dhe identiteti religjioz i të gjitha komuniteteve. Të gjitha komunitetet do të përfaqësohen dhe do të janë në gjendje të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes (edhe në parlamentin nacional). Kosova do të ketë simbolet e veta (psh. flamurin), kurse dy gjuhë do të bëhen zyrtare: shqipe dhe serbe. Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur nga Kosova do të kanë të drejtën e kthimit dhe të kërkojnë pronat dhe posedimin, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe vendore. **Decentralizimi** - Komunitat do të formojë njësitë themelore të tyre të vetëqeverisjes në Kosovë. Këto dispozita kanë për qëllim qeverisjen e mirë, efektivitetin dhe efikasitetin në shërbime publike. Në veçanti këto dispozita kanë për qëllim që komuniteti serb në Kosovë të gëzojë një shkallë të lartë kontrolli ndaj veprimtarisë së tyre. **Sistemi i drejtësisë** - Plani përpaket të sigurojë sistem juridik, i cili është i paanshëm dhe i pavarur e profesional dhe që reflekton karakterin multi-etnik të Kosovës.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare - Ahtisaari propozon autonomi dhe mbrojtje të të gjitha grupeve religjioze në vendbanimet e tyre brenda Kosovës. Kisha Ortodokse serbe do të jetë në gjendje të funksionojë përgjithësisht. **Përfaqësuesi civil ndërkombëtar** – Ky autoritet do të krijojë Këshillin Monitorues të Zbatimit për të monitoruar dhe lehtësuar zbatimin tërësisht dhe në veçanti zbatimin e aranzhmaneve të veçanta, të cilat kanë të bëjnë me Kishën Ortodokse serbe. NATO do të ofrojë mbrojtjetë veçantë për zona specifike, deri sa këto përgjegjësi të

transferohen te policia lokale. **Kthimi dhe mbrojtja e pronës** - Të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit kosovar do të kanë të drejtë të kthehen dhe të kërkojnë pronën dhe posedimin personal në bazë të vendimit të tyre. Zgjidhja riafirmon parimin se të zhvendosurit duhet të janë në gjendje të kthehen në një hapësirë sipas zgjedhjes së tyre dhe jo vetëm tek vendi i tyre origjinal i banimit. Zgjidhja thërret të dyja, Kosovën dhe Serbinë, të bashkëpunojnë në mënyrë të plotë dhe bashkë me Kryqin e Kuq të zgjidhin çështjen dhe fatin e personave të zhdukur.

Ekonomia - Këtu përfshihen dispozita specifike për të siguruar dhe promovuar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

Siguria – Sipas saj vepron një sektor profesional, multietnik dhe demokratik i sigurisë, duke inkurajuar një pronësi lokale në zhvillimin e sektorit, por duke pasur megjithatë një mbikëqyrje të nevojshme ndërkombëtare. Forca policore e Kosovës do të ketë një zinxhir komandues ndaj oficerëve lokalë të policisë i cili reflekton përbërjen etnike të komunës ku vepron. Në komunat me shumicë serbe, asambletë komunale do të kanë kompetencë për të zgjedhur komandantët lokalë. Një forcë e re profesionale kosovare e sigurisë do të ndërtohet brenda një viti, pas 120 ditë të periudhës së tranzicionit. Kjo forcë do të ketë maksimum 2500 anëtarë aktivë dhe 800 anëtarë rezervë.

Përfaqësuesi civil ndërkombëtar- Ky është një person në cilësi të dyfishë (raporton dhe vepron si përfaqësues special i BE). Ai do të nominohet nga Grupi Mbikëqyrës Ndërkombëtar dhe do të ketë autoritetin themelor mbikëqyrës të zbatimit të Planit. Përfaqësuesi civil ndërkombëtar nuk do të ketë rol direkt në administratën e Kosovës, por do të ketë forcë të madhe përmirësuese, me qëllim që të sigurojë zbatim të suksesshëm të Planit. Ai ka pushtet që të anulojë vendime dhe ligje të aprovuara nga autoritetet kosovare dhe të sanksionojë zyrtarët publikë, kur vlerëson se ata nuk janë konsistentë me Planin. Mandati do të vazhdojë derisa Grupi Ndërkombëtar Mbikëqyrës të mos përcaktojë nëse janë plotësuar kushtet e Planit.

ESDP misioni – Ky është misioni policor evropian i mbrojtjes dhe sigurisë, i cili do të monitorojë, do të mentorojë dhe do të këshillojë të gjitha fushat e sundimit të ligjit në Kosovë. Do të ketë të drejtë të ndjekë dhe të hetojë në mënyrë të pavarur krime sensitive si, krimin e organizuar, krimet ndëretnike, krimet financiare dhe krimet e luftës. Do të ketë edhe pushtet të kufizuar ekzekutiv për të siguruar sundim të ligjit të institucioneve, si dhe do të ketë pushtet efektiv e funksional (p.sh. kontrolli kufitar a kontrolli në trazira).

Prezenca ndërkombëtare ushtarake - Ky do të jetë mision i udhëhequr nga NATO. Do të vazhdojë me detyrat aktuale të forcave të Kosovës (KFOR) për të siguruar ambient të sigurt në Kosovë.

OSBE - Kjo organizatë, me një shtrirje të gjerë në terren, kërkohet të sigurojë asistencë për monitorim të nevojshëm, përkitazi me zbatimin e suksesshëm të Planit.

Implementimi - Pas hyrjes në fuqi, do të kemi një periudhë tranzicioni për 120 ditë, gjatë të cilit mandati ekzistues i UNMIK-ut do të mbetet i pandryshuar. Gjatë kohës së tranzicionit, Kuvedi i Kosovës në konsultime me përfaqësuesin civil ndërkombëtar do të jetë përgjegjës që të aprovojë kushtetutën dhe legjislacionin përcjellës. Kushtetuta dhe legjislacioni do të hyjnë në fuqi kur të ketë kaluar faza e tranzicionit. Pas fazës tranzitore, mandate i UNMIK-ut do të përfundojë dhe pushteti ekzekutiv dhe legjislativ do të transferohen en block tek autoritete kosovare, në pajtim me Planin. Në fund, Plani parasheh se zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale do të mbahen nëntë muaj, pasi Plani të ketë hyrë në fuqi²⁵⁸

Pas shumë raunde bisedimesh, të cilat rezultuan si të pamundshme për të dhënë rezultatin e duhur ishte e qartë se më nuk kishte kohë për t'u humbur. Situata në Kosovë mund të agravonte nga shkaku i status quo-s. Bisedimet e Vjenës dhe të gjitha bisedimet përkitazi me statusin final të Kosovës nga pala kosovare u pranuan, kurse sipas traditës tashmë të krijuar Serbia vazhdon të zvarrisë procesin duke u munduar që së paku të shtyejë sa të jetë e mundur përfundimin e suksesshëm të negociatave apo që dështimin e tyre t'ia mveshë Kosovës. Siç është vërejtur tashmë, përkushtimi i palës kosovare për të gjetur zgjidhje është shprehur në të gjitha raundet dhe së fundi Plani Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës apo siç njihet ndryshe Pakoja e Ahtisaarit, u pranua nga pala kosovare, pavarësisht faktit se ky plan nuk po përmbushte orientimet dhe pritjet e shumicës së popullatës së Kosovës.

Kur të gjitha përpjekjet për të bindur Serbinë që të pranonte Pakon Ahtisaari dështuan, në Kosovë filluan përgatitjet intensive për shpalljen e pavarësisë. Të gjitha përgatitjet për shpalljen e pavarësisë fillojnë të bëhen edhe në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare, në veçanti me shtetet më të forta të Perëndimit. Dhe, Deklarata e Pavarësisë së Kosovës përfundimisht shpallet nga Parlamenti i Kosovës, më 17 shkurt 2008. Në vazhdim po japim pjesë të tekstit të Deklaratës së Pavarësisë, e cila shërben për çdo lloj analize dhe argumenton se Kosova kishte të drejtë të shpallë pavarësinë vet.

²⁵⁸Shih më gjerësisht: <http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf>.

Në përmbajtjen e saj, Deklarata e Pavarësisë, koncepton arsyet e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Duke u nisur nga kërkesa dhe përcaktimi I popullit të Kosovës për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afirmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj, në Deklaratë poashtu potencohet zotimi për t'u përballur me të kaluarën e trishtuar jo të largët në frymë të pajtimit dhe të faljes, do t'i përkushtohen mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tone. Deklarata, pasqyron dëshirën e popullit të Kosovës për t'u integruar në familjen e shteteve demokratike dhe euro atlantike. Në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës shprehet mirënjohja ndaj ndihmës ndërkombëtare të ofruar në procesin e rrugëtimit të Kosovës në vitin 1999. Deklarata e Pavarësisë, i vlerëson rekomandimet e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara, Presidentit Marti Ahtisari, të pasqyruara në dokumentin e njohur si "Pako e Ahtisaarit", e cila vlerësohet si një kornizë gjithëpërfshirëse që garanton zhvillimin e Kosovës në të ardhmën, dhe seato përmbajnë standardet më të larta evropiane për të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mire. Duke u bazuar në përmbajtjen e Deklaratës së lartcekur, përfaqësuesit e popullit të Kosovës të zgjedhur në mënyrë demokratike, në Seancën e jashtëzakonshme solemne e plenare, më 17 shkurt 2008, shpallin Pavarësinë e Kosovës.

Deklarata e Pavarësisë, për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, u pranua unanimisht nga të gjithë deputetëve të pranishëm,. Dhe, nga ky moment, ndërron pozicioni politik i Kosovës. Kosova është: REPUBLIKË, SHTET I PAVARUR, DEMOKRATIK DHE SOVRAN²⁵⁹

Leximi me kujdes i gjithë tekstit të Deklaratës së Pavarësisë tregon qartë dhe i thyen të gjitha argumentet e atyre që kundërshtojnë të drejtën e Kosovës për vetëvendosje. Deklarata u hartua në një konfidencë të plotë dhe deri në momentin e fundit u harmonizua me faktorët ndërkombëtar²⁶⁰. Teksti i deklaratës tregon qartë se kjo shpallte nga të zgjedhurit e popullit, se Kosova është mirënjohëse për gjithë atë që ka bërë bashkësia ndërkombëtare, se Kosova tregon përkushtimin e saj për të përmbushur të gjitha obligimet që dalin nga dokumentet ndërkombëtare sikundër edhe të Planit të Ahtisaarit dhe kështu me radhë. Gjithnjë sipas analizës së tekstit, shohim se deklarata është rrjedhojë e përpjekjeve dhe aspiratave të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi dhe se nga teksti shihet se deklarata është edhe rrjedhojë e një koordinimi ndërkombëtar, duke mos u shkelur asnjë nga normat e së drejtës ndërkombëtare.

²⁵⁹ Transkript nga séance plenare e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Kosovës me rastin e shpalljes së Pavarësisë, të mbajtur me 17 shkurt 2008.

http://www.assemblykosova.org/common/docs/proc/trans_s_2008_02_17_al.pdf

²⁶⁰ Bajrami, Arsim, Vep. e cit., fq. 127 e 128.

Mbledhja e Parlamentit të Kosovës është bërë ditën e diel dhe krahas shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë, aty është bërë edhe aprovimi i flamurit të Kosovës, bashkë me himnin e saj.

Kërkesa për mbledhje ishte parashtruar nga Fatmir Sejdiu, president i Kosovës dhe nga Hashim Thaçi, kryeministër i Kosovës. Mbledhja filloi pas orës 15:00 dhe në të kanë marrë pjesë 109 deputetë. Mbledhjen e kanë bojkotuar 10 deputetë serbë dhe një deputet i komunitetit goran. Në mbledhje gjithashtu kanë marrë pjesë përfaqësues të zyrave të huaja sikundër edhe figura të njohura të Kosovës.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ka për bazë dokumentin themelor të së drejtës ndërkombëtare, në Kartën e Kombeve të Bashkuara, e cila në nenin 2 të saj shpreh qartë të drejtën e kombeve për vetëvendosje, parim ky i pranuar dhe i zbatueshëm, në disa raste, kur një komb pavarësohet nga sundimi okupatorial, lirohet nga okupimi, si dhe e drejta e popullatës shumicë që të mbajë pushtetin dhe jo e pakicës, ose liria nga aparteidi, parime këto që i japin legjitimitet ndërkombëtar aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt 2008²⁶¹. Deklarata e pavarësisë së Kosovës në pjesën hyrëse riafirmon dëshirën për integritet evroatlantike dhe thekson se Kosova është një rast sui generis që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe se nuk paraqet precedent për cilëndo situatë tjetër. Pjesa konstituive numëron disa parime, si përcaktimi i parë është ai historik dhe solemn dhe është bazuar në përvojën e Deklaratës së Pavarësisë së SHBA-ve. Përcaktimi i dytë definon Kosovën si një republikë demokratike, laike dhe multietnike të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Parimi vijues paraqet deklaratën kryesore të zotimit ndërkombëtar të Kosovës për të implementuar plotësisht obligimet e Kosovës të përmbajtura në Planin e Ahtisaarit. Përcaktimi tjetër vendos parimet kryesore të kushtetutës së ardhshme të Kosovës dhe zotimin për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të qytetarëve, ashtu siç definohen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut²⁶².

²⁶¹ Zejnullahi, Veton, Vep. e cit., fq. 108.

²⁶² Bajrami, Arsim, Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, SHB “Artini”, Prishtinë 2011, fq. 129 e 130.

4.6. Opinioni i GJND-së lidhur me shpalljen e Pavarsisë së Kosovës

Çështjen nëse Kosova kishte të drejtë të shpallte pavarësinë e vet, e ngriti Serbia. Me këtë kërkesë, Serbia përpqet të bëjë një manovër diplomatike, duke përpjekur që të ngadalësojë procesin e njohjes nga shtete të ndryshme dhe në anën tjetër duhet kuptuar edhe si një manovër politike për konsum të brendshëm në Serbi. Serbia çështjen e shpalljes së pavarësisë së Kosovës e ngriti para Kombeve të Bashkuara, më 15 gusht 2008, duke parashtruar kërkesën, e cila pranohet nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Asambleja e Përgjithshme kërkesën e Serbisë e aprovon në formë Rezolute²⁶³. Pas kësaj Sekretariati i OKB njofton Gjykatën Ndërkombëtare me dosjen që po përgatitej përkitazi, me kërkesën e Serbisë, përkitazi me çështjen e Kosovës.

Para se të shshqyrtojmë opinonet përkitazi me Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, të mësojmë pak se çka është kjo Gjykatë. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (ICJ) është organi kryesor i drejtësisë i Kombeve të Bashkuara. Është themeluar në qershor të vitit 1945 me Kartën e OKB dhe ka filluar me punën në prill të vitit 1946. Selia e Gjykatës është në Pallatin e Paqes në Hagë (Holandë). Nga gjashtë organet kryesore të OKB, është i vetmi organ që nuk është i vendosur në New York (SHBA). Roli i gjykatës është të zgjidhë mosmarrëveshjet legale, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare të paraqitura në Gjykatë dhe të japë opinione këshillëdhënëse për çështje juridike të referuara e të autorizuar nga OKB dhe agjencitë e specializuara. Kjo gjykatë përbëhet nga 15 gjykatës që zgjedhen me mandate 9vjeçar nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga Këshilli i Sigurimit. Ndihmohet nga Regjistri si organ administrativ. Gjuhë zyrtare të gjykatës janë anglishtja dhe frëngjishtja²⁶⁴. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është themeluar bazuar në Kartën e OKB, e cila nxjerrë se të gjitha shtetet anëtare të OKB-së ipso facto janë palë të Statutit të kësaj Gjykate. Përbërja dhe funksionimi i kësaj gjykate janë të organizuar nga statuti dhe nga rregullat e Gjykatës që nxirren nga vetë Gjykata²⁶⁵. Gjykata ka rol të dyfishtë: të zgjidhë, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, kontestet juridike të paraqitura nga shtetet dhe të japë opinione këshillëdhënëse, përkitazi me çështje të referuara nga organe të autorizuar të OKB a të agjencive të specializuara. Në procedimet kontesteve, kur kontesti është paraqitur në gjykatë me një aplikacion unilateral të

²⁶³ Shih Rezolutën A/RES/63/3 e datës 30 shtator 2008.

²⁶⁴ Rrahmani, Bashkim, *Pozita juridiko-ndërkombëtare e Kosovës 1974-2011* (temë e doktoratës), UET.

²⁶⁵ <http://www.icj-cij.org/documents/index.php?p1=4>.

një shteti kundër shtetit tjetër, emrat e palëve në titullin zyrtar të çështjes janë të ndara me shkurtesën v. për Latin versus (psh. Cameroon v. Nigeria). Kur një kontest paraqitet në gjykatë në bazë të një marrëveshjeje të veçantë ndërmjet dy shteteve, emrat e palëve ndahen me vijë të pjerrët (psh. Indonesia/Malaysia). Rasti i parë që është futur në listën e përgjithshme të Gjykatës, është Kanali i Korfuzit (Britania e Madhe v. Shqipëria) është paraqitur më 22 maj 1947. Që nga 22 maji 1947 e deri më 21 mars 2015 janë 161, raste që kanë hyrë në Listën e Përgjithshme²⁶⁶. Gjykata ka jurisdiksion të dyfishtë, ndërkohë që ajo vepron si gjykatë botërore.

Siç u theksua më lart, Serbia i drejtohet me kërkesë OKB-së që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë opinion përkitazi me të drejtën e Kosovës për pavarësi. Konkretisht, më 8 tetor 2008, Asambleja e Përgjithshme, në Sesionin e vet të 33-të, aprovoi Rezolutën 63/3, me votimin e regjistruar 77 në favor dhe 6 vota kundër, kundrejt 74 abstenimeve. Teksti i plotë i rezolutës, që përbënte kërkesën, thotë: Asambleja e Përgjithshme e ndërgjegjshme nga qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, duke pasur parasysh funksionet e veta dhe pushtetin në Kartën e OKB-së, duke mbështetur faktin se Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës kanë shpallur pavarësinë e Kosovës nga Serbia, të bindur se ky akt është pranuar me reaksione të ndryshme nga anëtarë të Kombeve të Bashkuara, përkitazi me me kompatibilitetin me rendin ekzistues ndërkombëtar, vendos, duke u bazuar në nenin 96 të Kartës së Kombeve të Bashkuara të kërkojë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe bazuar në nenin 65 të Statutit të Gjykatës që të kërkojë një opinion këshillëdhënës, përkitazi me pyetjen: "A është deklarata unilaterale e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në pajtim me të drejtën ndërkombëtare"?²⁶⁷. Kërkesën në emër të Serbisë e kishte nënshkruar ministri i Jashtëm serb, Vuk Jeremiq.

Gjykata, sipas statutit dhe rregullave të veta, ka proceduar dhe ka përcaktuar afate brenda të cilave shtetet janë thirrur të dorëzojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre të shkruara, sikundër që ka vendosur që të caktojë datat e dëgjimeve publike në gjykatë. Kështu, bazuar në nenin 65, paragrafi 2 i statutit, më 30 janar 2009, Sekretari i Përgjithshëm i OKB i komunikoi gjykatës një dosje me dokumente, të cilat pretendonin të hedhin dritë përkitazi me pyetjen e ngritur. Dosja rrjedhimisht postohet në ueb faqen e gjykatës²⁶⁸. Brenda afatit të caktuar nga gjykata, deklarata të shkruara deponohen sipas rendit që janë pranuar nga: Czech Republic, France, Cyprus, China,

²⁶⁶ Rrahmani, Bashkim, Vep. e cit.

²⁶⁷ <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15022.pdf>.

²⁶⁸ Shih dokumentin zyrtar "Opinion i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë" të datës 10 korrik 2010.

Switzerland, Romania, Albania, Austria, Egypt, Germany, Slovakia, Russian Federation, Finland, Poland, Luxembourg, Libyan Arab Jamahiriya, United Kingdom, United States of America, Serbia, Spain, Islamic Republic of Iran, Estonia, Norway, Netherlands, Slovenia, Latvia, Japan, Brazil, Ireland, Denmark, Argentina, Azerbaijan, Maldives, Sierra Leone and Bolivia.

Autorët e deklaratës unilaterale të pavarësisë deponojnë kontributin e tyre në formë të shkruar. Më 21 prill 2009, Regjistri i gjykatës komunikoi kopjet e deklaratave të shkruara të të gjitha shtetave që kanë dorëzuar deklarata të shkruara sikundër edhe tek autorët e deklaratës unilaterale të pavarësisë²⁶⁹. Gjykata do të veprojë brenda afateve të caktuara dhe sipas statutit dhe rregullave të veta duke komunikuar me palët dhe duke komunikuar komentet e shkruara, të cilat i janë dërguar me rregull Serbisë si iniciatore dhe Kosovës si palë që ka shpallur në mënyrë unilaterale deklaratën e pavarësisë (kjo është terminologji e gjykatës). Kështu, më 21 prill 2009 GJND njoftoi se 35 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara kishin deponuar deklaratat me shkrim, brenda afatit kohor të caktuar nga gjykata (17 prill 2009) për çështjen e ligjshmërisë së shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës²⁷⁰.

Bazuar në këto procedura, gjykata ka caktuar edhe datat për dëgjime publike të palvë, ndërsa në këtë punim po japim vetëm datat e dëgjimit publik dhe emrat e delegacioneve kosovare, shqiptare dhe serbe. Për palëm serbe në dëgjimet publike që u mbajtën nga 1.12. deri më 11. 12. 2009, morën pjesë: Dusan Tabakovic, Vladimir Djerić, Mikijelj Janković & Bogdanovic, Andreas Zimmerman, Malcolm M. Shaw, Marcelo Kohen dhe Sasa Obradovic. Siç mund të shihet nga emrat, Serbia i ka kushtuar rëndësi të madhe dëgjimit publik duke dërguar emra të njohur, sidomos të fushës së të drejtës ndërkombëtare. Delegacioni i Prishtinës në dëgjime kishte këtë përbërje: Skënder Hyseni, Michael Wood, Daniel Muller, Sean D. Murphy dhe Patricia Roberts Harris. Për Shqipërinë janë: Gazmend Barbullushi, Jochen A. Frowein dhe Terry D. Gill.

Gjykata sigurisht së pari është dashur të vendosë nëse ka kompetencë që të vendosë përkitazi me dhënien e opinionit rreth pyetjes së parashtruar dhe vetëm pastaj do të vazhdojë me çështjen. Dhe në fakt kështu edhe ka ndodhur. Pa dashur japin hollësi të tjera, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, pas zhvillimit të të gjitha procedurave sipas Kartës së OKB-së,

²⁶⁹ Po aty.

²⁷⁰ Bajrami, Arsim, Vep. e cit., 2011, fq. 137.

Statutit dhe rregullave të veta, ka vendosur me votimin, si vijon, përkitazi me atë nëse shpallja e deklaratës së pavarësisë ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Së pari, gjykata me votim unanim ka vendosur se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është kompetente për të dhënë opinion përkitazi me çështjen. Së dyti, me nëntë vota për dhe një kundër vendosi të japë opinion përkitazi me çështjen e ngritur dhe, së treti, opinionin se deklarata e pavarësisë së Kosovës e aprovuar më 17 shkurt 2008 NUK ka shkelur të drejtën ndërkombëtare.

PËR këtë opinion kanë votuar: Presidenti Owada ; Gjyqtarët Al-Khasaëneh, Buergenthal, Simma, Abraham, Keith, Sepúlveda-Amor, Cançado Trindade, Yusuf, Greenwood ; **KUNDËR** : Vice-President Tomka; Judges Koroma, Bennouna, Skotnikov ²⁷¹ . Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ka vërtetuar të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe rëndësia e këtij dokumenti ka vlerë të paçmuar për të ardhmen e Kosovës.

Ky dokument tregon se e drejta ndërkombëtare nuk është një e drejtë statike dhe nuk është e drejtë që i takon vetëm procesit të shkolonizimit. Në anën tjetër, rëndësi të veçantë ka edhe nga një aspekt, i cili mund të konsiderohet edhe simbolik. Këtë opinion e kërkoi Serbia duke bërë përpjekje me manovër diplomatike dhe duke shpresuar se me këtë process, së paku, do të ngadalësonte procesin e njohjes së shtetit të Kosovës nga shtete, të cilat këtë opinion edhe po prisnin. Sidoqoftë, opinionin doli të jetë në favor të së drejtës dhe të drejtësisë dhe ka kontribuar në shtimin e numrit të shteteve që të njohin shtetin e Kosovës.

Njohësi i shquar i të drejtës kushtetuese, profesor Arsim Bajrami, duke analizuar parimet, në bazë të të cilave Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka vendosur të mbrojë pavarësinë e Kosovës, ka theksuar se Gjykata ka mbështetur: Legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës për shkak se ajo është shpallur nga përfaqësuesit legjitim të zgjedhur të popullit. Pavarësia e Kosovës ka qenë rrjedhojë logjike e shkatërrimit të Jugosllavisë dhe vetëvendosjes së popujve. Poashtu, edhe e drejta e vetëvendosjes sipas GJND-së, bazohet në parimin *jus cogens* të aplikuar në rastin e Timorit Lindor dhe që ka zbatim jo vetëm në rastet dekoloniale, por paraqet një të drejtë universale të popujve në vetëvendosje.

Sipas, analizës së prof. Bajramit, Pavarësia e Kosovës nuk është akt secesionist, por rast i koordinimit ndërkombëtarë për zgjidhjen e konfliktit territorial ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, Pavarësia e Kosovës është veprim logjik zinxhiror në relacionin Rambuje, Rezoluta 1244, Korniza Kushtetuese 2001, Pakoja e Ahtisarit deri te Deklarata e Pavarësisë,

²⁷¹ Shih dokumentin zyrtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të datës 10 korrik 2010

Shkatërrimi i Jugosllavisë e nxjerr Kosovën si një nga suksesorët e barabartë me të drejtën e vetëvendosjes, Pavarësia e Kosovës është storie e suksesit ndërkombëtar dhe si përfundim Pavarësia e Kosovës është rast sui generis dhe i papërseritshëm²⁷².

4.5. Njohja ndërkombëtare e Pavarësisë së Kosovës

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, shteti ka synuar anëtarësim sa më të shpejtë në organizata ndërkombëtare dhe ka aspiruar në integritime evropiane. Ky proces dhe këto përpjekje kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë sfida shumë e madhe dhe e vështirë për t'u tejkaluar.

Opinionin i qartë dhe pozitiv i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, ironikisht, më shumë i hapi rrugë Serbisë në integrimin e saj evropian, se sa që rezultoi me atë që prisnin kosovarët, konsolidimin përfundimtar të shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

E revoltuar nga qëndrimi i GJND-së, Serbia kishte shkruar një tekst të ashpër, me të cilin planifikonte të inicioje një rezolutë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për të sfiduar edhe një herë pavarësinë e Kosovës²⁷³. Por pavarësisht qëndrime të ashpra serbe kundër opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Kosova vazhdon me tendencat për fuqizimin e pozitës së saj në arenën ndërkombëtare. Rritja e numrit të njohjeve ndërkombëtare është shoqëruar edhe me vështirësitë e brendshme, të cilat kanë të bëjnë me mungesën e dijenive dhe shkathtësive për të zhvilluar aktivitete lobuese, në njërin anë, dhe me pengesat e ndërtimit të brendshëm dhe me paaftësinë për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në radhë të parë, në anën tjetër.

Konsolidimi i shtetit të Kosovës në skenën ndërkombëtare në një masë është në koherencë edhe me vetë kompleksitetin e formimit të shtetit të Kosovës.

Opinionin i shprehur i SHBA-ve, dorëzuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, këtij konkludimi i ndihmon. Aty thuhet: Deklarata e Pavarësisë së Kosovës është kontribut i tre proceseve të ndërprerë: Shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, krizës së lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovës dhe përgjigjes së Kombeve të Bashkuara²⁷⁴.

²⁷² Bajrami, Arsim, http://www.ashak.org/repository/docs/Ligjerata_Inaguruese_-_Arsim_Bajrami_36843.pdf (qasur më 14. 3. 2015),

²⁷³ Development group, fq. 6.

²⁷⁴ Shih më shumë kontributin e shkruar të SHBA-ve, dorëzuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë përkitazi me pavarësinë e Kosovës.

Që të gjithë, këta tre faktorë (të tjerë janë përmendur gjithandej nëpunim), tregojnë se konsolidimi i shtetit të ri të Kosovës varet edhe nga sanimi i gjendjes së trashëguar. Konsolidimi i shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare duhet parë nga këndvështrimi i anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare universal ose edhe rajonale.

Anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara është proces i gjatë dhe, përpos të tjerash, varet edhe nga numri i siguruar i njohjeve²⁷⁵. Kurse, sa i përket anëtarësimit në Bashkimin Evropian, kjo është çështje kushtesh dhe parimesh të tjera.

Kosova, që nga shpallja e pavarësisë është anëtarësuar në Bankën Botërore, në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në qershor të vitit 2009 dhe në Bankën Evropiane për Zhvillim.

Konsolidimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare nuk mund të pritët vetëm nga fakti i njohjeve dhe nga fakti i anëtarësimit në organizata dhe mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë dhe poashtu, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare nuk është kusht themelor për ekzistimin e një shteti.

Së këndejmi, ekzistimi i shtetit të Kosovës dhe shtetshmërisë nuk mund të kushtëzohet me anëtarësim në OKB a në organizata të tjera ndërkombëtare. Aktualisht, OKB-ja ka 191 vende anëtare, por vetëm në vitin 2002, Zvicrra u anëtarësua në të dhe nuk mund të vihet në dyshim që ajo ishte shtet edhe përpara anëtarësimit²⁷⁶. Në anën tjetër, ka raste kur ndonjë shtet i është pezulluar anëtarësia në organizata dhe ai ka mbetur shtet. Shih, për shembull pozicionin e Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi). kur ajo u pezullua nga anëtarësia në OKB në vitet 1992-2000²⁷⁷.

Sigurisht që anëtarësimi është shumë e rëndësishme, sepse, si thekson Martin Dixon, mënyra më e mirë për të analizuar rolin e anëtarësisë në OKB, si shenjë dalluese të të qenit shtet, është të thuhet që anëtarësia jep një veti pothuaj të padiskutueshme të të qenit shtet, ndërkohë që pezullimi nga të drejtat e anëtarësisë nuk e prek aspak gjendjen e të qenit shtet për te²⁷⁸.

Gjithsesi, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është i rëndësishëm së veçantë, pavarësisht diskutimeve teorike. Dhe, siç është vënë re, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare nganjëherë nuk është edhe punë e lehtë. Organizatat ndërkombëtare, në kuptimin e përgjithshëm,

²⁷⁵ Deri në momentin e shkrimit të këtij punimi, Kosovën e kanë njohur 116 shtete (Ministria e Jashtme e Kosovës, qasur më 16. 2. 2018).

²⁷⁶ Dixon, Martin, *E drejta ndërkombëtare*, AIIS (pa vit botimi), Tiranë, fq. 170.

²⁷⁷ Po aty.

²⁷⁸ Vep. e cit., fq. 171.

janë bashkime shtetesh sovrane që krijohen mbi bazën e marrëveshjes së arritur midis tyre për të realizuar qëllime të caktuara në fusha të ndryshme të jetës ndërkombëtare²⁷⁹.

Rëndësia e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare mund të shihet edhe nga ky këndvështrim: Në kohët tona, siç u tha, numri dhe roli i organizatave ndërkombëtare është shtuar së tepërmi²⁸⁰ dhe, disa prej tyre, siç janë OKB, Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, NATO, OSBE etj., shfaqen si protagoniste në zhvillimet ndërkombëtare në botë²⁸¹. E të qenurit protagonistë apo të qenurit pjesë e organizatës protagoniste ka rëndësinë e vet qoftë për brenda qoftë për jashtë. Kjo, sepse analiza e thjeshtë të çon tek përfundimi se ti si subjekt ke për të plotësuar kushte të caktuara, krahas marrjes së obligimeve për të qenë pjesë e asaj që po e quajmë protagonist. Anëtarësimi, parimisht dhe përgjithësisht, në organizata është i rezervuar për shtetet. Kjo rezulton edhe nga përmbajtja e Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve me të cilat, siç u përmend, shprehet me përdorimin e termit organizata ndërkombëtare “ndërqeveritare”²⁸².

Konsolidimi i pozitës ndërkombëtare të Kosovës nuk është mirë që të shikohet ndaras nga organizimi dhe konsolidimi i brendshëm i Kosovës. Në rrjedhat e përgjithshme të integriteteve dhe të anëtarësimeve ndikojnë në masën më të madhe vetë aftësitë dhe lëvizjet brenda përbrenda Kosovës.

Zhvillimi demokratik dhe ndërtimi i institucioneve funksionale dhe transparente dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe kundër korrupsionit, janë disa nga parakushtet themelore për avansimin e pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe, edhe në vetë shtimin e numrit të njohjeve për shtetin e Kosovës.

Nuk ka mundësi që një shtet, sado i fortë dhe mirë i ndërtuar dhe sado me traditë që të jetë, që në zhvillimet bashkëkohore të mos monitorohet dhe të mos plotësojë kushte, të cilat bashkësia e shteteve i ka caktuar. E bashkësia e shteteve mund të jetë në forma të ndryshme. Dhe, jo gjithmonë ka qëndrime të njëjta. Për të ilustruar, po japim komunikatën për konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian, një ditë pas Deklaratës së Pavarësisë:

²⁷⁹ Krisafi, Ksenofon, *E drejta e organizatave ndërkombëtare I*, SHB “Onufri”, Tiranë, 2015, fq. 151.

²⁸⁰ Për numrin e saktë të organizatave ndërkombëtare ka vlerësime të ndryshme. Thuhet se ekzistojnë rreth 66.000 organizata transnacionale të shoqërisë civile, të vendosura në rreth 300 vende dhe territore. Sipas botimit “The Yearbook of International Organizations Overview”, 2014-2015, A guide to Global Civils Society Netëorks”, (6 vols), “Edited by the Union of International Associations.

²⁸¹ Krisafi, Ksenofon, *E drejta e organizatave ndërkombëtare I*, SHB “Onufri”, Tiranë, 2015, 151.

²⁸² Vep. e cit., fq. 189.

Në konkluzionet e BE-së, theksohet se Kuvendi i Kosovës me 17 shkurt 2008 aprovoi një rezolutë e cila shpall Kosovën të pavarur. Këshilli, potencon me këtë rast se ajo e merr në shënim se rezoluta mbështet përkushtimin e Kosovës drejt parimeve të demokracisë dhe barazisë së të gjithë qytetarëve, mbrojtjen e serbëve dhe minoriteteve të tjera, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të mbikëqyrjes ndërkombëtare.

Në konkluzionet e Këshillit të BE-së me këtë rast, mirëpret praninë e vazhduar të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, bazuar në Rezolutë 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe konfirmon gatishmërinë e saj të vazhdojë të bashkëpunojë me Kombet e Bashkuara, me KFOR-in, me OSBE-në dhe me aktorë tjerë ndërkombëtar me qëllim të ruajtjes së paqes në rajon. Këshilli përsërit besnikërinë e BE-së drejt parimeve të Kartës së OKB dhe Aktit Final të Helsinkit, të parimeve të sovranitetit dhe integritetit territorial dhe të gjitha rezolutat e Këshillit të Sigurimit. Këshilli nënvizon bindjen e tij që në pikëpamje të konfliktit të vitit 1990 dhe në periudhën e zgjatur të administrimit ndërkombëtar nën Rezolutën 1244, Kosova konstituon një rast “sui generis”, i cili nuk vë në dyshime këto parime dhe rezolutat²⁸³.

Kjo komunikatë e Këshillit jep informacion të bollshëm që i shërben analizës se si do të monitorohet Kosova, se si do të ndihmohet, si do të udhëzohet dhe kështu me radhë. Por, nga vetë komunikata kuptojmë edhe jounitetin brenda Bashkimit Evropian karshi shtetit të Kosovës. Aty shihet se nuk ka qëndrim të qartë dhe unik përkitazi me njohjen e shtetit të Kosovës dhe se aty shteteve u lihet të vendosin sipas të drejtës ndërkombëtare dhe traditës së vendeve veç e veç. Ky qëndrim në një mënyrë del edhe si pengesë, sepse janë pesë shtete të Bashkimit Evropian, të cilat akoma nuk kanë njohur shtetin e Kosovës. Kurse, Kosova, në anën tjetër, nga institucionet e Bashkimit Evropian monitorohet dhe merr obligime, të cilat do t'i respektojë brenda afateve të caktuara kohore dhe sipas kushteve të parapara saktë.

Raportet e Progresit të Komisionit Evropian japin dështimet e Qeverisë së Kosovës, të Parlamentit dhe të drejtësisë. Organizatat joqeveritare në Kosovë gjithashtu kanë analizuar këto trupa qeveritare. Këto analiza identifikojnë dhe pajtohen se ekziston një mungesë e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe të depolitizojnë drejtësinë dhe shërbimet publike në institucionet e Kosovës²⁸⁴.

²⁸³ Council of the European Union, Press Release 2851st Council meeting, General Affairs and External Relations, Brussels, 18 February, 2008 - 6496/08 (Presse41).

²⁸⁴ Forum 2015, Kosovo-EU Relations: The history of unfulfilled Aspirations? Kosovo Foundation for Open Society, Prishtina 2013, fq. 31.

E Kosovës i duhet të dëgjojë dhe i duhet anëtarësim në organizata ndërkombëtare, sigurisht. Kështu si parashihet me nenin 4 (1) të Kartës së OKB, "anëtarësimi në Kombet e Bashkuara është i hapur për të gjitha shtetet që duan paqen dhe që pranojnë obligimet ekzistuese të Kartës dhe që sipas gjykimit të organizatës janë të gjendje dhe duan që të përmbushin këto obligime.

Në frymën e plotësimit të kushteve, sipas Konventës së Montevideos për shtetshmëri dhe të dhëna për Kosovën, mund të thuhet se Kosova i plotëson kërkesat e nenit 4 (1) dhe kështu Kosova mund të kualifikohet për pranim në OKB²⁸⁵. Komisioni Evropian rregullisht i raporton Këshillit dhe Parlamentit Evropian për vendet e Ballkanit Përendimor dhe për obligimet që përmbushen në rrugën e integritimeve evropiane. Raporti për Kosovën ka një strukturë thuaja të ngjashme. Për ilustrim po marrim raportin e progresit për Kosovën të vitit 2011, kunë parathënie të tij thuhet:

Që prej marsit 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit mbi përparimin e arritur nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ky raport përgjithësisht ndjek të njëjtën strukturë si në vitet e kaluara. Raporti përshkruan shkurt marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit, analizon gjendjen politike në Kosovë në kuptimin e demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së pakicave dhe çështjeve rajonale, analizon gjendjen ekonomike në Kosovë, shqyrton kapacitetin e Kosovës në zbatim të standardeve evropiane, që do të thotë përafrimi gradual i legjislacionit dhe politikave të saj me *acquis*, në përputhje me Procesin e Stabilizim-Asocimit, si dhe prioritetet e Partneritetit Evropian²⁸⁶. Edhe ky citat tregon qartë se progresi i arritur brenda Kosovës jo vetëm që monitorohet, por ky progres edhe vlerësohet dhe paraqitet të jetë si parakusht shumë i rëndësishëm i avansimit të pozitës së Kosovës, por edhe si parakusht në rrugën drejt integritimeve evropiane. Pra, progresi matet në bazë të vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar, si dhe masave të zbatuara²⁸⁷.

²⁸⁵ On 24 September 2008, Albanian President Bamir Topi announced to the General Assembly at the 63rd annual debate of the UN General Assembly that Kosovo deserves to be a United Nations member State. President Topi also declared that such admission "would be a regressive move against foreign investments and progress which we need so direly". At present, Kosovo has not made a formal request to the UN for its future admission. Kosovo should become a UN member State – Albanian President (24/09/08) UN News Centre <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=28247&Cr=general+assembly&Cr1=debate> accessed 26/09/08

²⁸⁶ Shih: http://www.eas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf

²⁸⁷ Po aty.

Raporti i Progresit edhe sa i përket vetë raporteve ndërmjet Kosovës dhe të BE-së jep të dhëna të sakta dhe konkrete. Kështu, p.sh., në raportin e vitit 2011 përkitazi me raportin Kosovë – BE thuhet:” Kosova merr pjesë në Procesin e Stabilizim-Asocimit (PSA).

Cikli i takimeve brenda dialogut PSA (DPSA) në vitin 2011 është përmbushur në korrik. Gjatë periudhës së raportimit janë mbajtur shtatë takime sektoriale për këta sektorë: drejtësia, liria dhe siguria, bujqësia, ekonomia, statistikën dhe kontrolli financiar; tregu i brendshëm, konkurrenca, shëndeti dhe mbrojtja e konsumatorëve, pastaj transporti, mjedisi, energjia dhe zhvillimi rajonal, inovacioni, kapitali njerëzor, politikat sociale dhe shoqëria informative, si dhe tregtia, industria, doganat dhe tatimimi.

Më 30 qershor, Kosova ishte nikoqire e takimit të dytë për dialogun e DSPA-së me shoqërinë civile, të pasuar nga takimi plenar më 1 korrik. Kosova gjithashtu ishte nikoqire e një konference të nivelit të lartë për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në maj. Në promovim të dialogut ekonomik, ka vazhduar mekanizmi i mbikëqyrjes fiskale me Komisionin Evropian, me takime që mbahen dy herë në vit²⁸⁸.

Në aspektin e zhvillimit të Kosovës në kontekst të integriteteve evropiane, Kosova është në vazhdimësi e monitoruar. Dhe në këtë monitorim janë kryesisht dy mekanizma: STM bashkë me raportet vjetore të Progresit janë dy instrumentë kyç, të cilat i ka BE në terren për të monitoruar progresin në Kosovë dhe kanë përfshirë takime të rregullta ndërmjet zyrtarëve evropian dhe autoriteteve lokale²⁸⁹. Dhe në fakt monitorimi nuk është në fund të fundit karakteristikë vetëm për Kosovën. Edhe shtetet e tjera monitorohen dhe mbikëqyrën, sikundër maten të arriturat e tyre gjithnjë me qëllim të plotësimit të kushteve për integrim në BE, sidomos të atyre sipas kriterëve të Kopenhagës.

Siq e cekem disa herë në këtë studim, bashkësia ndërkombëtare prej vitit 1990 deri në vitin 1999, kur përfundoi lufta Serbi – Kosovë kundërshtonte të njëjtte apo pranonte të drejtën e Kosovës për vetëvendosje

Këtë konstatim po fillojmë ta elaborojmë me përcaktimet, qëndrimet e Konferencës së parë të Paqës mbi Jugosllavinë të mbajtur në vitin 1991, të kryesuar nga Lordi Karington ku në Deklaratën e Komunitetit European European rmbi Jugosllavinë të datës 3 shtator 1991, miratuar

²⁸⁸ Shih: http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf

²⁸⁹ http://fride.org/download/BGR_Challenges_EU_Kosovo_ENG_may07.pdf (qasu mw 4. 4. 2015).

në takimin e jashtëzakonshëm ministror në Hagë, nga Konferenca e Paqës, iu mundsohej ndarja e republikave të Jugosllavisë në mënyrë paqësore.

Nga kjo Konferencë rezultuan dy dokumente kryesore: *Deklarata* dhe *Udhëzuesi për Njohjen Ndërkombëtare*, të cilat përcaktuan rregulla strikte, ku parimin e vetëvendosjes ia pranuan vetëm Republikave të Jugosllavisë, duke ia mohuar këtë të drejtë Kosovës dhe Vojvodinës si krahina apo elemente konstituive të po asaj Jugosllavie, çka nënkuptonte se, shqiptarët mund të synonin të realizonin të drejtat e tyre qytetare dhe politike vetëm brenda shtetit serb, që ndryshe e emertuan si “ vetëvendosje e brendshme”.

Në këtë konferencë u vendos të themelohen: Misioni i Komunitetit Europian të Monitorimit dhe Komisioni i Arbitrazhit, i njohur ndryshe edhe si Komisioni i Badinterit, i cili ishte i autorizuar për t’i negociuar apo gjetur zgjidhjet e mundshme në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Komisioni u përcaktua që caktimi i kufijëve të reja të shteteve të krijuara nga shpërbërja e Jugosllavisë të jetë parimi *uti possidetis juris* (respektim i kufijve ekzistues në momentin e pavarësisë), ,

Ky komision nga data 20. 11. 1991 e deri me 4 korrik 1992 ka lëshuar 10 mendime, të cilat në një mënyrë kanë caktuar të ardhmen e Jugosllavisë (RSFJ-së).

Komisioni ka punuar në këtë përbërje: Robert Badinter, president i Këshillit Kushtetues të Francës, Roman Herzog, president i Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë, Aldo Corasaniti, president i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, Francisco Tomasy Valente, president i Gjykatës Kushtetuese të Spanjës dhe Irene Petry, president i Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës. Mendimi apo opinionin e parë i Komisionit të Badinterit, ndërlidhet me letren e datës 20 nëntor 1991, dërguar Kryetarit të Komisionit të Arbitrazhit z. Robert Badinter nga Lordi Karington-kryetarit të Konferencës së Paqës për Jugosllavi i cili kishte kërkuar nga komisioni këshillën juridike të parashtruar nga Serbia, e cila konsideron se republikat të cilat e kanë shpalluar apo planifikojnë ta shpallin pavarësinë dhe sovranitetin e tyre e kanë lëshuar apo së shpejti do të largohen nga RSFJ e cila pavarësisht kësaj do të vazhdoi të ekzistoi. Republikat tjera në dallim prej kësaj konsiderojnë se nuk është në pyetje shpërbërja por dezintegrimi dhe ndërprerja e ekzistimit të RSFJ-së, si rezultat i përbashkët e një numri të madh të republikave. Ato(republikat) konsiderojnë se 6 republikat duhet të jenë trashëgimtarë të barabartë të RSFJ-së, pa të drejt të cilës do nga to apo të ndonjë grupi të republikave që të pretendojnë të jenë vazhdues të saj. Do të

deshiroja që Komisioni i Arbitrazhit të shqyrtoi rastin dhe të formuloi mendimin ose rekomandimin i cili mund të konsiderohet i dobishëm”

Komisioni i Arbitrazhit, me 10 dhjetor 1991- në këtë kërkesë ka dhënë këtë mendim: Komisioni konstaton se përgjigja në pyetje duhet të bazohet në parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, të cilat shërbejnë për të përcaktuar kushtet në të cilat bëhet konstituimi i Shteteve; në këtë kontekst ekzistimi apo krijimi i shtetit, pranimi i tyre nga shtetet tjera është thjeshtë e natyrës deklarative.

Shteti duhet përcaktuar si një komunitet që përmbanë territorin dhe popullatën në vartësi të një autoritet politik të organizuar; se një shtet i tillë karakterizohet si sovranë; Për shkak të aplikimit të këtyre kriterëve formati dhe organizimi i brendshëm politik si dhe dispozitat kushtetuese janë fakte të plota, megjithëse është e nevojshme për t’u trajtuar në kuadër të rendit shoqëror që përcakton llojin e autoritetit mbi popullsinë dhe territorin, se në rastin e tipit federal të shtetit, i cili përmbanë komunitetet që kanë një shkallë të caktuar të autonomisë dhe pos saj kryejnë pushtetin në institucionet e përbashkëta federative, ekzistenca e shtetit prodhon faktin që organet federale përfaqësojnë të gjitha pjesët e federatës dhe zbatojnë pushtetin.

Në përputhje me përkufizimin e pranuar në të drejtën ndërkombëtare, paraqitja e "suksedimit të shtetit" nënkupton zëvendësimin e një shteti nga një tjetër në marrjen e përgjegjësi në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare lidhur me territorin e caktuar. Deri te kjo vjen në rastin e ndryshimit të territorit. Fenomeni i suksedimit të shteteve është e rregulluar me parimet e së drejtës ndërkombëtare, të cilat janë të bazuara në Konventën e Vjenës të 23 gusht 1978 dhe 8 Prill 1983. Në përputhje me këto parime rezultati i sekrecionit duhet të jetë i drejtë, shtetet përkatëse janë të lira të vendosin rregullat dhe kushtet e marrëveshjes. Për më shumë, normat e pamohueshme e së drejtës ndërkombëtare dhe posaqerisht respektimi i të drejtave themelore të individëve dhe të drejtat e popujve dhe pakicave janë të detyrueshme për të gjitha palët në suksesion.

Poashtu, Komisioni i Arbitrazhit, vë në dukje se RSFJ, edhe pse ka ruajtur subjektivitetin e saj ndërkombëtar, veçanarisht në organizatat ndërkombëtare, republikat kanë shprehur dëshirën e tyre për pavarësi. Sllovenia, dëshirën e saj drejt pavarësisë e ka shprehur me referendum në dhjetor të vitit 1990, e cila pasoi shpallja e pavarësisë më 25 qershor 1991. Pavarësia e saj u pezulluar për tre muaj por u konfirmua më 8 tetor 1991. Poashtu edhe Kroacia, në bazë të rezultateve të referendumit të mbajtur në maj të vitit 1991, më 25 qershor 1991, shpalli pavarësinë e saj, të cilën përkohësisht e ka i pezulluar për tre muaj por më 8 tetor 1991 e konfirmoi pavarësinë.

Maqedonia, me referendumin e mbajtur në shtator të vitit 1991, u deklarua për një Maqedoni sovranë dhe të pavarur në kuadër të asociacionit të shteteve jugosllave. Bosnja dhe

Hercegovina pavarësinë e saj e shpall përmes Rezolutës të miratuar në Parlamentin e saj me 14 tetorit 1991, vlefshmëria e së cilës është kontestuar nga komuniteti serb në BiH.

Përbërja aktuale dhe funksionimi i organeve kryesore të federatës jugosllave, pavarësisht a është: Kryesia federale, Dhoma Federale, Dhoma e republikave dhe krahinave, Këshilli Ekzekutiv Federal, Gjykata Kushtetuese ose Ushtria Federale, nuk i plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit adekuat në një shtet federal. Bazimi në forcë ka dërguar në një konflikt ushtarak midis pjesëve të ndryshme të federatës të cilat shkaktuan vdekjen e mijëra njerëzëve dhe çuan në shkatërrime masive brenda vetëm disa muajve. Autoritetet Federale dhe republikat janë treguar të pafuqishme për respektimin e marrëveshjeve të arritura me Bashkësinë Evropiane dhe OKB-në për ndërprerjen e luftimeve."

Duke u bazuar në e rrethanat ekzistuese, Komisioni Arbitrazhi është i mendimit: se RSFJ është në proces të shpërbërjes²⁹⁰. Në kompetencë të republikave është, që në përputhje me parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare, me vëmendje të veçantë ndaj të drejtave të njeriut dhe të drejtat e popujve dhe të pakicave, të zgjidhin problemet shtetërore të suksecionit të cilat mund të paraqiten, por njëkohësisht, është në kompetencë të republikave poqëse deshirojnë të krijojnë asociacion të përbashkët të ri shtetor të cilat do të kishin institucione demokratike sipas zgjedhjes së tyre

Kryetari i Komisionit të Arbitrazhit ka pranuar me 20 nëntor 1991, përmes letrës të kryetarit të Konferencës për Paqe në Jugosllavin, Lord Karington i cili i është drejtuar Komisionit për mendimin e saj lidhur me pyetjen e parashtruar nga Republika e Serbisë: "A gezon popullata serbe në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, si popull shtetformues të Jugosllavisë, të drejtën për vetëvendosje"? Komisioni, duke u bazuar në shqyrtimin dhe analizimin e memorandumet, vërejtjet dhe dokumentet të cilat u janë dorëzuar nga republika e : Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenia, Serbia. Kryesia RSFJ-së dhe "Kuvendi i ashtuquajtur i popullit serb nga Bosnja dhe Hercegovina", ka dhënë këtë mendim:. Komisioni konsideron që në fazën aktuale të zhvillimeve e drejta ndërkombëtare nuk precizon të gjitha pasojat e së drejtës në vetëvendosje. Megjithatë është konstatuar se pa marrë parasysh rrethanat ekzistuese, e drejta për vetëvendosje nuk mund të shpie te ndryshimi i kufijve të cilat ekzistojnë në momentin e pavarësimit (uti possidetis juris) përveç në rastin kur shtetet e interesuara bien dakord ndryshe.

...Popullatës serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kroaci i takojnë të gjitha të drejtat e pranura sipas së drejtës ndërkombëtare për minoritetet dhe grupet etnike, si dhe rregullave të

²⁹⁰ <http://ejil.org/pdfs/3/1/1175.pdf,fq5>

sipas Draftkonventës së Konferencës së Paqës për Jugosllavinë, të datës 4. 11. 1991, për zbatimin e së cilës janë obliguar republikat e Bosnjë- Hercegovina dhe Kroacisë. Kanë vendosë t'i japin fuqinë e aktit juridik dhe kështu Republikat duhet duhet të mundësojë të drejta për minoritete dhe grupe etnike sipas të drejtës së njohur ndërkombëtare përfshirë edhe të drejtën të zgjedhin nacionalitetin e tyre²⁹¹.

Komisionit i është kërkuar mendimi edhe lidhur me pyetjen e parashtruar se a mund të jenë kufijtë e republikave kufij shtetërorë, pastaj pyetje përkitazi me Kroacinë, Slloveninë, Maqedoninë dhe deri tek opinionin tetë. i cili konsideron se procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë ka përfunduar dhe opinionin dhjetë, sipas të cilit konsiderohet se Serbia dhe Mali i Zi duhet të trajtohen më shumë si shtete të reja, sesa si shtete trashëgimtare të RSFJ-së. Një shikim më i thellë në opinionet e dhëna nga Komisioni i Badinterit, na bën të nxjerrim përfundimin se ky komision nuk është marrë asnjëherë në mënyrë eksplicite me Kosovën. Komisioni kryesisht është marrë duke analizuar Kushtetutën e RSFJ, sipas së cilës krahinat autonome (siç formuloheshin Kosova dhe Vojvodina), nuk kishin të drejtën e vetëvendosjes.

Ka shumë debate që kanë menduar nëse ky komision ka vepruar drejt përkitazi me Kosovën, duke anuar kah Serbia, siç ka edhe debate se Komisioni ka interpretuar Kushtetutën e RSFJ, duke qenë i ndikuar nga situata dramatike në Jugosllavi. Debati për këtë çështje nga këndvështrimi i sotëm kohor mund të na japin komoditetin e të menduarit dhe të nxjerrjes së konkluzioneve, të cilat po ashtu mund të janë të gabuara. E vërteta është se Kosova, sipas Kushtetutës së vitit 1974, ka qenë element konstitutiv i federalizmit jugosllav dhe sipas një formulimi karakteristik të kohës, Kosova ka qenë edhe pjesë e sistemit kushtetues të Serbisë. Janë të shumtë argumentet se kushtetuta nuk e ka ndalura në mënyrë shprehimore të drejtën e Kosovës për vetëvendosje, sikundër që juristët kur kanë analizuar kushtetutën nuk kanë hequr dorë të së pasurit në sy edhe formulimin se Kosova ishte pjesë e sistemit kushtetues të Serbisë. Gjithsesi, siç do të shohim edhe më poshtë, e drejta e Kosovës për vetëvendosje në ansjë mënyrë nuk ka mundur të kontestohet dhe se nuk ka qenë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Është çështje tjetër, nëse çmimi i pavarësisë do të kishte qenë më i ulët sikur Komisioni i Badinterit të drejtën e Kosovës për vetëvendosja ta kishte njohur në mënyrë eksplicite.

²⁹¹ Po aty.

Mbas përcaktimit të parimeve mbi bazën e të cilave do të bëhej njohja ndërkombëtare e njësisë të eilat do të gëzonin sovranitet në kuadrin e Federatës Jugosllave në shpërbërje, Komisioni Badinter I kushtoi vëmendje mënyrës së përeaktimit të kufijve. U legjitimua parimi *uti possidetis juris* (respektim i kufijve ekzistues në momentin e pavarësisë).

Jo pak studius konsiderojnë se çasja dhe vendimet e Komisionit Badinter janë shkaktarë të tragjedive që pasuan në Jugosllavi²⁹²

Parimisht dhe deri vonë në të drejtën ndërkombëtare publike është konsideruar se shteti është subjekti kryesor i të drejtës ndërkombëtare publike. Kështu, e drejta ndërkombëtare u konceptua si një sistem normash që rregullonin marrëdhëniet e shteteve me njëri-tjetrin²⁹³.

Se pse ndodh njohja, kjo mund të ndodhë për arsye se një territor i dikurshëm kolonial ka fituar pavarësinë, siç ka ndodhur me një numër të madh vendesh të Komonuelthit, ose ngaqë një pjesë e një shteti ekzistues ka fituar pavarësinë nga autoritetet federal, si në rastin e Bangladeshit dhe të republikave të dikurshme të Bashkimit Sovjetik e të Jugosllavisë ose për shkak se një territor i diskutueshëm ka fituar pavarësinë me anë të vetëvendosjes, si në rastin e Timorit Lindor²⁹⁴. Këtu, në këtë pjesë nuk po analizojmë si është bërë dhe si është arritur pavarësia, sepse kemi folur më herët, por po flasim për ecurinë dhe aktivitetin e Kosovës për të siguruar njohje për të sqaruar edhe atë se çfarë lloje të njohjeve i janë bërë Kosovës, prej momentit të shpalljes së pavarësisë.

Një ndër aspiratat kryesore të një shteti të sapokrijuar, është anëtarësimi i atij shteti në mekanizmat ndërkombëtarë. Anëtarësimi do të jetë parakusht i fortë për shtetin që jo vetëm të përfitojë nga këto mekanizma, por që edhe të ngarkohet me përgjegjësi. E ajo që del të jetë e domosdoshme, është njohja ndërkombëtare e këtij subjekti që ka dalë si i ri në skenën ndërkombëtare. Kjo është çështja e njohjes ndërkombëtare të shtetit, çështje kjo që nuk ka qenë e lehtë për shtetin e Kosovës në momentin e shpalljes së pavarësisë, sikundër që kjo çështje ka vazhduar të jetë sfidë për institucionet dhe për strukturat qeveritare të Kosovës për të siguruar njohje ndërkombëtare dhe anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë.

Njohja ndërkombëtare për secilin shtet të ri është sfidë themelore, sepse nuk është lehtë të veprohet në këtë drejtim, kur dihet se kjo varet nga secili subjekt individual e që Ian Brownlie

²⁹² Abazi, Enika. *Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm*.

Archives – ouvertes.fr. Studime Historike, Institute of History, Tirana, 2012, 66 (3-4), pp.187-216. Tiranë, 2013

²⁹³ Dixon, Martin, *E drejta ndërkombëtare*, AIIS, (pa vit botimi) Tiranë, fq. 170.

²⁹⁴ Vepra e cituar. fq. 186.

thotë: “Njohja ndërkombëtare, si një veprim publik i shtetit, është një akt politik diskrecionar dhe për të nuk ka ndonjë detyrim juridik²⁹⁵. Njohja, pra, është akt diskrecioni i një shteti, i cili vendos të bëjë njohjen e shtetit të ri ose të refuzojë. E shtetet janë të shumta dhe jo të gjitha kanë qëllime dhe orientime të njëjta. Kështu akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës u bë në rrethana krejtësisht të reja dhe më të favorshme, porprapëseprapë jo të gjitha shtetet e botës ishin të gatshme të njohin Kosovën si shtet të pavarur. Por, gjithsesi gatishmëria e shteteve që të njohin Kosovën tash, në këto rrethana, ishte shumë më e madhe dhe menjëherë pas 17 shkurtit ose që atë ditë, mund të dallohen disa valë njohjes së shtetit të Kosovës.

Shtetet më të fuqishme të bashkësisë ndërkombëtare menjëherë filluan të njohin shtetin e Kosovës, duke filluar nga SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe kështu me radhë. Natyrisht kishte shtete që hezitonin të bënin njohjen, kurse disa nga ato vazhdojnë të refuzojnë njohjen e shtetit të Kosovës.

Shkaqet e refuzimit dhe shkaqet e hezitimit të njohjes janë të natyrave të ndryshme, nga të cilat po veçojmë ato të natyrës politike dhe ato të natyrës doktrinare. Të dytat më pak të rëndësishme, sepse koncepti mbi të drejten ndërkombëtare ka ndryshuar dukshëm në rrethanat bashkëkohore.

Shkaqet e natyrës politike i gjejmë te një grup i shteteve sic është Rusia dhe aleatët e saj, të cilat në vazhdimësi edhe ashtu kanë qenë kundër aspiratave të shqiptarëve për shtetin e tyre të pavarur të Kosovës.

Shkaqet e natyrës doktrinare i gjejmë në të kuptuarit tradicional të së drejtës mbi sovranitetin apo për vetëvendosje të popujve. Ata konsiderojnë se kjo e drejtë i takon kohës të çlirimit kolonial, por meqenëse kolonializmi është proces i përmbyllur dhe meqenëse Kosova nuk konsiderohet koloni e dikujt, atëherë, sipas tyre, kjo e drejtë nuk i takon Kosovës. Por a thua e drejta ndërkombëtare dhe e drejta e vetëvendosjes së popujve duhet shiquar nga këndvështrimi tradicional? Gjithsesi jo! Jo, sidomos pas procesit të shpërbërjes së dy federatave: ish-Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Komuniteti Evropian (Bashkimi Evropian i sotëm) në fazën e shpërbërjes së këtyre dy federatave nxori disa parakushte, të cilat duhet të plotësohen para njohjes së shteteve të reja.

²⁹⁵ Brownlie, Ian, *Principles of Public International Law*, VIII edition, Oxford University Press in UK and certain other countries, 2012t, f. 89.

Në këtë drejtim, Komuniteti Evropian, më 16 dhjetor të vitit 1991, ka nxjerrë një deklaratë të emërtuar „Udhëzuesi për njohjen e shteteve të reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik“. Kjo deklaratë ka aprovuar procesin e njohjes së shteteve të reja, duke parashtruar një mori kushtesh: nga ajo primarja, respektimi i dispozitave të Kartës së OKB, si dhe përkushtimin e përshkruar me Aktin Final të Helsinkit, si dhe në Kartën e Parisit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, garantimin e të drejtave të grupeve etnike, grupeve nacionale dhe pakicave në pajtim me përkushtimet përshkruar me kornizën e OSBE, respektimin e paprekshmërisë së të gjithë kufijve, të cilët mund të ndryshohen vetëm me mjete paqësore dhe me marrëveshje të përbashkët, pranimin e të gjitha përkushtimeve relevante përkitazi me çarmatimin dhe jo proliferimin nuklear si dhe sigurinë dhe stabilitetin regjional dhe zotimin për të zgjidhë me marrëveshje, përfshirë aty ku mundet burimet e arbitrazhit, të gjitha problemet përkitazi me suksedimin e shteteve si dhe mosmarrëveshjeve regjinale²⁹⁶.

Është me rëndësi të theksohet se këto parakushte Kosova i kishte plotësuar edhe në kohën kur Sllovenia dhe Kroacia kishin shpallur pavarësinë e tyre dhe në atë kohë edhe Kosova kishte shpallur Deklaratën e Pavarësisë²⁹⁷ dhe kishte nxjerrë Kushtetutën e Republikës së Kosovës²⁹⁸. Edhe atëherë Kosova kishte kërkuar njohje ndërkombëtare, por asnjë shtet, me përjashtim të Republikës së Shqipërisë, nuk kishte treguar gatishmëri të njihte shtetin e Kosovës.

Njohja ndërkombëtare ka rëndësi për shtetin e ri dhe shteti i ri është problem që i takon çështjes faktike. Vetëm pasi shteti të jetë krijuar ai i nënshtrohet procesit të njohjes ndërkombëtare. E kjo njohje mund të bëhet qoftë në mënyrë individuale, qoftë edhe nga shumë shtete bashkërisht apo edhe nga organizata të caktuara ndërkombëtare. Ka raste kur është toleruar kushti i sovranitetit, por është shtuar një kusht tjetër, domosdoshmëria e disponimit të njohjes ndërkombëtare. Në fakt, nëse shtetet anëtare të një organizate ndërkombëtare pranojnë aderimin e një shteti, në njëfarë kuptimi, njohin ose favorizojnë njohjen e tij në një nivel të lartë dhe rrjedhimisht edhe të sovranitetit, sepse njohja është hap i rëndësishëm drejt konfrimit të

²⁹⁶ Marrë nga Bashkim Rrahmani, Malcolm N. Shaw, International Law, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq. 374 e 375.

²⁹⁷ Shih tekstin e Deklaratës së Pavarësisë.

²⁹⁸ Kushtetuta e Kaçanikut e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, më 7 shtator 1992.

sovrانيتيت. Pranimit i Bosnjë-Hercegovinës në OKB i hapi asaj rrugën e afirmimit si shtet i mirëfilltë²⁹⁹.

Çfarë lloj njohjeje ndërkombëtare po fitonte Kosova pas shpalljes së Pavarësisë, më 17 shkurt 2008 dhe a po shkeleshin parimet e së drejtës ndërkombëtare përkitazi me njohjen? Kosova bën aktin e shpalljes së pavarësisë pas një procesi të gjatë dhe pas plotësimit të kushteve që një shtet duhet t'i plotësojë për të qenë pjesë e barabartë e bashkësisë së shteteve. Qysh nga viti 1933, me Konventën e Montevideos në bashkësinë ndërkombëtare janë pranuar kushtet themelore, të cilat një shtet duhet t'i plotësojë. Ato janë: a) një popullsi të përhershme, b) territori i definuar, c) qeveri dhe d) kapaciteti për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera³⁰⁰. Këto kushte në mënyrë të qartë Kosova i plotëson tërësisht edhe pse ka diskutime se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur të ushtrojë pushtetin e vet në tërë territorin e Kosovës³⁰¹. Sidoqoftë, hezitimet nëse kushtet e Konventës së përmendur janë plotësuar, nuk meritojnë debat, sepse ato janë plotësuar tërësisht. Për më tepër, shteti i Kosovës, si shteti më i ri në arenën ndërkombëtare, ka plotësuar edhe të gjitha kushtet, sipas të drejtës bashkëkohore ndërkombëtare.

Njohja ndërkombëtare është veprimi i ndërmarrë nga një shtet a nga një grup shtetesh, për të pranuar lindjen ose krijimin e një shteti të ri ose ardhjen në jetë të një qeverie nëpërmjet formave a mënyrave konstitucionale ose jo konstitucionale dhe për të vendosur e mbajtur me ta lidhje zyrtare në fusha me interes të ndërsjellë. Akti i njohjes në vetvete mund të shfaqet në forma të ndryshme. Ai mund të jetë një deklaram zyrtar, një letër zyrtare drejtuar entitetit të saponjohur, një deklaratë e bërë përpara një gjykate të brendshme ose mund të rrjedhë nga vendosja e marrëdhënieve të plota diplomatike.

Në përgjithësi, pjesëmarrja në një konferencë shumëpalëshe së bashku me një shtet të panjohur (ose me qeverinë e panjohur të një shteti tanimë ekzistues) nuk do të thotë akt njohjeje të tërthortë, megjithëse është patjetër dëshmi e faktit që entiteti në fjalë ka fituar në një farë mase subjektivitet juridiko-ndërkombëtar. Votimi në të mirë të pranimit të një shteti të ri në OKB, përbën një njohje të tërthortë, si në rastin e votimit të Mbretërisë së Bashkuar për pranimin e ish-Republikës jugosllave të Maqedonisë në OKB, më 8 prill 1993.

²⁹⁹ Krisafi, Ksenofon, *E drejta e organizatave ndërkombëtare I*, SHB "Onufri", Tiranë, 2015, fq. 191.

³⁰⁰ Shih: Montevideo Convention on the Rights and duties of States, 1933, available at:

<http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-40.html> Montevideo Convention on the Rights and duties of States, 1933, available at: <http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-40.html>

³⁰¹ Këtu gjithnjë flitet për Veriun e Kosovës me komunat: Zvecan, Leposavic, Stan-Tërg dhe Mitrovicë të Veriut, çështje kjo që meriton një studim tjetër të veçantë, por që vazhdon të jetë problem, i cili, në njëfarë mënyre, do të kushtëzojë të ardhmen e Kosovës e mund të ndodhë edhe ridefinimin e kufijve në Ballkan.

Njohja në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve përbën një parakusht të domosdoshëm për marrëdhënie dypalëshe plotësisht të vullnetshme, sikurse janë hapja e përfaqësive diplomatike dhe lidhja e marrëveshjeve. Nga ana tjetër, mungesa e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve mund të mos ketë kurrfarë lidhjeje me njohjen³⁰².

Njohjet e shtetit të Kosovës janë bërë në moment dhe rrethana të caktuara kohore dhe kur analizohen mënyrat e njohjes, mund të konkludohet se Kosova ka përjetuar shumicën e llojeve të njohjeve. Njohjen deklarative³⁰³ e kanë bërë numri më i madh i shteteve, të cilat kanë akorduar këtë njohje. Kjo është teori dhe një lloj njohjeje të shtetit, kur shteti që bën njohjen në mënyrë shprehimore me një akt formal, e bën të ditur publikisht se ka bërë njohjen e shtetit të ri pas gjendjes faktike të krijuar, sepse shteti së pari do të jetë gjendje a sitatë faktike. Ai është paraqitur si organizatë.

Njohja konstitutive apo teoria konstitutive³⁰⁴ është po ashtu një lloj njohjeje që bëhet për shtetet dhe sipas kësaj teorie dhe sipas këtij mendimi, shteti nuk mund të bëhet anëtar i komunitetit të shteteve, nëse nuk është njohur ndërkombëtarisht. Kjo, dmth. sipas kësaj teorie, shteti do të bëhet ekzistent vetëm pasi të ketë siguruar njohjen.

Njohja de facto dhe njohja de jure janë gjithashtu dy lloje të njohjes në teorinë dhe praktikën e të drejtës ndërkombëtare. E para është kur shteti pa bërë ndonjë akt formal juridik apo pa e bërë njohjen publike vendosë raporte faktive me shetin e ri: lidhë marrëveshje, shkëmben ambasadorë, zhvillon aktivitete diplomatike, ekonomike etj. E dyta ekziston kur megjithatë njohja është bërë përmes ndonjë akti të shprehur apo deklaruar juridik, përmes notës diplomatike dhe ngjashëm.

Njohja e qeverive, njohja e luftës, etj., janë gjithashtu akte të njohjes që pastaj i shërbejnë njohjes finale kur sheti të paraqitet faktikisht apo kur të çlirohet nga okupimi. Psh. Qeveria e Kosovës në ekzil ka ekzistuar për disa vite (në kohën e okupimit klasik serb të Kosovës). Kjo qeveri ka ushtruar funksione shtetërore të domosdoshme për mbajtjen e jetës në Kosovë dhe në një masë edhe për organizimin e luftës. Kjo qeveri ka gëzuar një lloj njohjeje faktike, sepse kryeministri në ekzil ka ushtruar funksionin e vet si kryeministër, ka zhvilluar aktivitete dhe ka komunikuar me shtet tjera duke kërkuar përkrahje dhe mbështetje për Kosovën. Fakti se kjo qeveri nuk është njohur formalisht, nuk do të thotë se kjo qeveri nuk ka gëzuar njohje faktike.

³⁰² Dikxon, Martin, Vep. e cit. *marrë nga* Ksenofon Krisafi në *Kumtesë për Institutin e Historisë*, 2012.

³⁰³ Shih Zejnulla Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*.

³⁰⁴ Po aty.

Njejtë është vepruar edhe me ushtrinë çlirimtare të Kosovës, me të cilën ushtri dhe qeveri të ndryshme kanë komunikuar dhe kjo do të thotë ajo është njohur faktikisht. Përkitazi me njohjen, në këtë kontekst është mirë të flisim për teorinë themeluese, sipas së cilës akti i njohjes shihet si një parakusht i domosdoshëm që një entitet të fitojë cilësinë e një shteti a të një qeverie.³⁰⁵ Sipas kësaj teorie del se nëse shteti nuk njihet atëherë ky shtet nuk do të ketë subjektivitet juridik. Por a duhet të bazohemi vetëm në këtë teori, mendoj se jo. Kjo përpos tjerash jo sepse kjo teori “krijon probleme teorike dhe praktike të pazgjidhshme. Së pari, është jashtë dyshimit që njohja është një akt politik, i udhëhequr vetëm pjesërisht në parime juridike. Për shembull, SHBA-ja nuk e njohu qeverinë sovjetike deri në vitin 1933, megjithëse kjo qeveri kishte drejtuar realisht vendin për së paku dhjetë vjet....Së dyti, duhet t'i bëjmë vetes pyetjen nëse është në përputhje me funksionimin e cilitdo system juridik fakti që subjektiviteti juridik sipas këtij sistemi duhet të varet nga pëlqimi subjektiv i dhënë nga palë të treta. Sigurisht subjektiviteti juridik ndërkombëtar duhet të jetë një fakt objektiv, i aftë të marrë vendime duke zbatuar norma ligjore”.³⁰⁶

Përgjithësisht dhe parimisht dominues është mendimi se njohja është një akt diskrecional politik, të cilin e ndërmerr një shtet i caktuar kundrejt shtetit i cili sapo është krijuar. Pra shteti që bën njohjen njeh një gjendje faktike të krijuar dhe kjo njohje ka ngjyra të një akti konkret politik. E se pse në momente të caktuara, shteti apo një numër i caktuar shtetesh, hezitojnë të njohin shtetin e ri është çështje që kërkon analizë tjetër politike apo gjeopolitike apo edhe tjetër. Kjo mund të bëhet edhe me rastin e Kosovës ku një numër i caktuar shtetesh akoma nuk ka bërë njohjen e shtetit të Kosovës.

Praktikisht deri më tani, shkurt 2016, Kosova është pranuar nga 111³⁰⁷ shtete, ndër to edhe nga shtetet më të fuqishme dhe më demokratike, siç janë: SHBA, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Kanada, Polonia, Belgjika, Zvicra, Austria, Holanda, Suedia, Norvegjia, Danimarka, Finlanda etj. Është me rëndësi të ceket se Kosova është pranuar edhe nga pothuaj të gjitha shtetet, me të cilat kufizohet (kuptohet përveç Serbisë): Malit të Zi, Maqedonisë dhe Shqipërisë. Vazhdon të mos pranohet nga 5 shtete të BE-së (Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qipro) si dhe disa shtete me ndikim në skenën politike dhe ekonomike botërore, për shkak të lidhjeve historike që i kanë ato shtete me Serbinë ose për shkak të problemeve të tyre të

³⁰⁵ Dixon, Martin, Vep. e cit., fq. 188.

³⁰⁶ Dixon, Martin, Vep. e cit., fq. 189.

³⁰⁷ Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës. <http://www.mfa-ks.net/?page=1,224>

brendshme, të cilat ata i perceptojnë si argument kundër njohjes së Kosovës, meqenëse ajo do të reflektonte negativisht në situatën e sigurisë brenda shtetit dhe në rajon. Nga këto shtete mund të veçojmë: Rusinë, Kinën, (e cila nuk e pranon Kosovën si të pavarur, por pranon pasaportat e saj), Vatikani etj.

4.8 . Dialog maratonik – pa rezultate të qendrueshme

Një ndër problemet kryesore që mbetet çështje kyçe dhe parakusht themelor në rrugën drejt integritetit evropian është dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dhe, ky dialog është inicuar dhe për te është biseduar nga shumë institucione dhe shtete me ndikim. Edhe vetë Kosova dhe Serbia këtë gjë e kanë të qartë dhe e dinë se rruga drejt integritetit të plotë evropian nuk mund të bëhet pa pasur rezultatin e duhur të dialogut Kosovë Serbi. Në të dyja shtetet ka forca që këtë dialog e refuzojnë ose, thënë më butë, e kushtëzojnë. Por, gjithsesi nuk ka zgjidhje pa dialog, e sloganet se nëse vihem në situatë për të zgjedhur Brukselin apo Kosovën, atëherë ne zgjedhim Kosovën³⁰⁸, shërbejnë vetëm sa për konsum të brendshëm.

Problemi serbo- shqiptar rreth Kosovës është shumë i vjetër dhe në Kosovë historia nuk është vërtet për të kaluarën, por për të ardhmen (Judah,2000:2)³⁰⁹. Dhe, edhe në kontekstin e sotëm kohor sikundër gjatë gjithë kohës së ekzistimit të këtij problem historia është e pashmangshme. Edhe kur veprohet, edhe kur flitet për të ardhmen historia është aty. Historia luan rol të rëndësishëm në marrëdhëniet e komplikuar ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. E kaluara ka qenë konfliktuale dhe bie mbi themelet e situatës së sotme në të dyja: përkitazi me pretendimet territoriale ashtu edhe në çështjet e statusit final³¹⁰.

Sinjalet dhe thirrjet për dialog ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të vijnë pareshtur nga të gjitha anët dhe këto thirrje megjithatë fillojë të kuptohen qartë, se si njëri, ashtu edhe tjetri shtet, janë të vogla për t'i kundërshtuar qëndrimet dhe udhëzimet e bashkësisë ndërkombëtare, të cilat në fund të fundit janë edhe orientime të vet popujve të këtyre dy shteteve.

³⁰⁸ Parullë e njohur nga nacionalistët serbë, sipas të cilëve Kosova mbetet slogan mesjetar i doktrave djep e çka jo tjetër serb.

³⁰⁹ <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=1326136&fileId=1326137>

³¹⁰ <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=1326136&fileId=1326137>

Shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë i ditur si fakt se nuk do të pranohet mirë në Serbi. Serbia në fakt në vazhdimësi këtë e ka bërë të ditur përmes të gjitha rrugëve të mundshme. Qëndrimi zyrtar i Serbisë, në raport me Kosovën, ka mbetur i njëjtë edhe pas opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të cilit vetë e kishte kërkuar. Por, është e qartë se ky qëndrim nuk do të mund të mbetet gjithmonë i njëjtë. Në Serbi një ditë gjërat do të ndryshojnë, nëse për asgjë tjetër, atëherë për shkak të rrethanave që i dikton terreni dhe për shkak të faktit se nuk do të mund të jetohet vetëm nga historia, e cila përkitazi me Kosovën rezulton të jetë shumë larg së vërtetës historike. Por, se Serbia do të provojë të përfitojë sa më shumë të jetë e mundur nga Kosova, kjo është pritur dhe pritet. Se Serbia do të ushtrojë presion dhe do të ndikojë në pakicën serbe në Kosovë, edhe kjo çështje është krejtësisht e qartë.

Për Kosovën, edhe për një kohë të gjatë, çështja e komunave serbe dhe çështja e veriut të Kosovës do të mbetet sfidë që vështirë do të zgjidhet pa konflikt, përmasat e së cilës do të varën nga ndërhyrja ndërkombëtare.

Në të vërtetë, në veriun e Kosovës, pushteti kosovar asnjëherë pas lufte nuk arriti të ushtrojë pushtetin e vet efektivisht. Zgjidhje në formë të propozimeve për çështjen e veriut të Kosovës janë gjetur dhe mund të gjinden në shumë raporte, analiza dhe deklarata politike diplomatike, por në terren për shkak të ndërhyrjes dhe ndikimit të Serbisë tek komuniteti serb, nuk mund të praktikohen.

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG) numëron tre opsione: Plani i Ahtisarit, autonomi e zgjeruar dhe shkëmbim terriroresh³¹¹.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian (BE), me ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), sipas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të shtatorit 2010, ka për qëllim promovimin e bashkëpunimit rajonal, avancimin në agjendën evropiane dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Rrjedhimisht, si rezultat i pjesëmarrjes në dialog, Serbia u shpërblye tek iu dha statusi i kandidatit për anëtarësim në BE, ndërsa Kosovës iu premtua studimi i fizibilitetit³¹².

³¹¹ International Crisis Group, Kosova dhe Serbia pas mendimit të GJND-së, Raporti për Evropë, nr. 206, i datës 26 gusht 2010, fq. 3.

³¹² Development Group, Dialogu Kosovë– Serbi, Larg qytetarit afër BE-së, Prishtinë, 2012, fq. 4.

Duhet vënë në pah dhe nënvizuar edhe një herë se qëllimet e dialogut, siç i përcakton Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, janë promovimi i bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, arritja e përparimit në rrugën drejt BE-së dhe përmirësimi i jetës së njerëzve³¹³.

Lidhur me fillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nga shumë organizata ndërkombëtare, institute por edhe nga individë me ndikim kanë dalë shumë ide, projekte, prospekte, propozime, etj. Është punuar në modalitete nga më të ndryshmet, por një gjë ka qenë e qartë: rolin kryesor në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet ta ketë BE, por gjithsesi duke pasur parasysh edhe angazhimin dhe ndikimin edhe të SHBA-ve në dialog.

Në këtë kontekst, ICG, në një raport të vitit 2010, propozoi për dy qeveritë në dialog, këto parime: Të pranohet ndërmjetësimi dhe qasja në bisedime si palë të barabarta, Të konsiderohet një zgjidhje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë këto elemente: njohja e Kosovës me kufijtë ekzistues dhe autonomi e zgjeruar për rajonin në veri të lumit Ibër në përputhje me integritetin territorial të Kosovës, duke përfshirë legjislativin dhe ekzekutivin rajonal, kontrollin mbi pjesën më të madhe të taksave dhe çështje të tjera, për të cilat do të ketë mirëputtim të dyanshëm dhe të garantohet status vetëqeverisës autonom për mjediset e Kishës Ortodokse serbe, duke përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të Planit të Ahtisarit, të cilave do t'u shtohet sigurimi i armatosur ndërkombëtar pas largimit të KFOR-it dhe të garantuar me një marrëveshje a rezolutë të Këshillit të Sigurimit. Nëse zgjidhja paraparë gjithëpërfshirëse nuk arrihet, përkrahni njëri-tjetrin në zbatimin e rendit dhe ligjit në veri dhe vendosni marrëdhënie të mira fqinjësore, duke përmbyllur marrëveshje në fushën e tregtisë, doganave, komunikimit, energjetikës dhe transportit, të cilat do t'ua lehtësonin jetën qytetarëve dhe njëkohësisht do ta forconin ekonominë e Kosovës dhe atë të Serbisë, Propozohet se të hapen me procedurë të shpejtë zyra përfaqësuese pa akreditim ambasadorial në Prishtinë dhe në Beograd dhe të bashkëpunohet për të mundësuar sigurinë dhe funksionimin e zyrës së Kosovës në Mitrovicën Veriore³¹⁴

Si shqiptarët në Kosovë, edhe serbët në Serbi synojnë jetë më të mirë dhe këtë jetë më të mirë që të dy popujt do të gjejnë në proceset integruuese dhe jo refuzuese dhe izoluese. E jeta më e mirë është imperative për të dyja palët, të cilat, për siç thuhet, me shekuj kanë jetuar me

³¹³ Development Group, *Dialogu Kosovë – Serbi, Larg qytetarit afër BE-së*, Prishtinë 2012, fq.9

³¹⁴ International Crisis Group, *Kosova dhe Serbia pas mendimit të GJND-së*, Raporti për Evropë, nr. 206 i datës 26 gusht 2010, fq. 5.

konfliktin. Këtu kemi të bëjmë me një territor, ku historia, politika dhe gjaku i dy popujve janë shfaqur me dhunë për disa shekuj³¹⁵.

Kështu, në dhjetor 2012, Këshilli i BE-së në konkluzionet e saja ka deklaruar se Kosova dhe Serbia duhet të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre, si një prej kritereve të rëndësishme në rrugën drejt integritimit në BE, duke mos bllokuar njëra-tjetrën në përpjekjet e tyre. Një pjesë e kësaj është edhe zbatimi në mirëbesim i të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialog³¹⁶.

Dialogu i filluar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nën moderimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Baroneshës Catherine Ashton, kishte filluar kohë më parë dhe ishin nënshkruar tashmë disa marrëveshje, të cilat duhej analizuar dhe rezultatet duhej matur. Por duhej nga ana tjetër që dialogu edhe të kushtëzohej. Këtë kushtëzim sigurisht më së miri do ta bëjnë vetë institucionet e Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst, Kushtëzimet e BE-së për rezultate në dialogun politik nënvizuan në konkluzionet e Këshillit të BE-së më 11 dhjetor 2012, ku nga Serbia u kërkua që: (1) të shpërbëjë institucionet e paligjshme gjyqësore dhe policore në veri të Kosovës, (2) t'i bëjë transparente fundet e sponsorimit të institucioneve të saj në Kosovë, dhe (3) nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me EULEX-in, të sigurojë se misioni i EULEX-it mund të zbatohet plotësisht mandatin e tij në veri, pa ndërhyrjen e Beogradit në synimet e EULEX-it drejt hapjes dhe funksionalizimit të Gjykatës së Mitrovicës.

Në anën tjetër, Kosovës i është garantuar që nëpër tërë territorin të ketë një përbërje të vetme institucionale dhe administrative, por Kosova gjithashtu pritet që të zhvillojë planin e shtrirjes në veriun e Kosovës dhe të adresojë “nevojat e veçanta” të populltës lokale serbe në Kosovën veriore³¹⁷. Brukseli me politikën e vet përdorë strategjinë e shkopit dhe karrotës, kurse Komisioni Evropian sikundër edhe Këshilli i BE vazhdimisht i bëjnë të ditur të dy palëve bashkëbiseduese, obligimet që kanë marrë për të realizuar marrëveshjet e nënshkruara.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri i Serbisë në periudhën 19 tetor 2012 – 21 qershor 2013, kanë zhvilluar trembëdhjetë raunde takimesh, nga të cilat kanë rezultuar gjashtë marrëveshje. Më poshtë po paraqesim shkurtimisht marrëveshjet,

³¹⁵ Louis Sell, *Kosovo The Key to Balkan Stability, Problems of post communism*, vol.49, January/February 2002 M.E.Sharpe, Inc., fq. 2.

³¹⁶ Kipred *Shih Konkluzionet e Këshillit rreth Procesit të Zgjerimit dhe Stabilizim- Asociimit*, 3210 Mbledhja e Këshillit të Punëve të Përgjithshme në Bruksel, tek http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/134234.pdf

³¹⁷ KIPRED, fq. 4 e 5.

sipas një studimi të KIPRED: Marrëveshja e parë ka të bëjë me formimin e një grupi punues për studimin e fizibilitetit për ndërtimin e magjstralës Prishtinë – Nish. Poashtu, është arritur marrëveshja për këmbimin e oficerëve për ndërlidhje që do të nënkuptonte krijimin e një njësi multi-etnikë të Policisë së Kosovës e cila do të ishte përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe. Ishte arritur edhe marrëveshja për krijimin e një fondi për pjesën veriore të Kosovës, e cila është e banuar me shumicë serbe. Në kuadër të kësaj pakoje të marrëveshjeve, janë edhe marrëveshja për parimet mbi normalizimin e marrëdhënieve Kosovë – Serbi dhe marrëveshja mbi planin e zbatimit të këtyre marrëveshjeve³¹⁸.

Është tepër e qartë se e ardhmja e përbashkët e Kosovës dhe e Serbisë qëndron në anëtarësimin eventual në Bashkimin Evropian. Ndërkohë, zhvillimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, siç është normal ndërmjet shteteve fqinje, duhet të procedojë bashkërisht me progresin drejt integritetit të përgjithshëm në institucione evropiane, përfshirë BE-në dhe Këshillin Evropës. Ky është një prospekt pozitiv dhe vetëm shiquar përpara dhe jot ë rrënjësuar në të kaluarën³¹⁹.

4.9. Procesi i shtetndërtimit në Kosovë

Ka diskutime dhe debate nga më të ndryshmet përkitazi me atë, nëse shtetndërtimi i Kosovës ka filluar të bëhet edhe para shpalljes së pavarësisë. Kjo do shtonim, varet nga këndvështrimi dhe nga qasja që dikush mund të ketë ndaj shtetit, elementeve, përbërësve, strukturave, etj., të shtetit. Por të japim një definicion të pranuar mbi shtetin para se të shtjellohet shkurtimisht procesi. Shteti është institucion i krijuar nga grupi për realizimin e disa qëllimeve, nga të cilat më e rëndësishmja është ruajtja e së drejtës dhe rendit brenda kufijve dhe ruajtja e pavarësisë së popullit në marrëdhënie me popujt tjerë³²⁰.

Procesi i shtetndërtimit, sipas një këndvështrimi thuhet të jetë si vijon: Misioni i shtetndërtimit në Kosovë është një tip intervenimi ndërkombëtar, që u paraqit në vitin 1990. Misione të ngjashme ka pasur ose po zhvillohen në vendet si Timori Lindor a në Afganistan. Përkushtim karakteristik i këtij lloji të intervenimit është aspekti ushtarak dhe civil (Bieber,

³¹⁸ Shih m gjerësisht KIPRED, fq. 6-15.

³¹⁹ Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, Further Written Contribution of the Republic of Kosovo, dërguar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, 17 korrik 2009, version anglisht (përkthim i autorit) fq.140

³²⁰ Svarlien, cituar nga: Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Furkan ISM-Shkup, 2007, fq. 69.

2003:2). Misioni i shtetëndërtimit i performuar në Kosovë si dhe nën autoritetin 4 të UNMIK-ut është quajtur operacion multidimensional i paqes apo operacion i gjeneratës së dytë të paqëruajtësve të Kombeve të Bashkuara (Pula, 2003:199)³²¹.

Ekzistojnë dy teori përmbajtësore lidhur me shtetndërtimin. Teoria e parë nga disa teoricienë shihet si një aktivitet i ndërmarrë nga faktorë të jashtëm (shtete të jashtme), duke bërë përpjekje për të ndërtuar apo rindërtuar institucionet e një shteti të dobët, e një shteti pas konflikti apo të një shteti të dështuar.

Kjo shkollë ekzogjene a shkollë e marrëdhënieve ndërkombëtare shtetndërtimin e sheh si aktivitet të një vendi në raport me tjetrin, zakonisht duke ndjekur një formë të intervenimit, siç është operacioni paqëruajtës i Kombeve të Bashkuara³²². Kjo teori i jep rëndësi më shumë faktorit të jashtëm dhe nëse do të përkrahim këtë teori, me rastin e shtetit të Kosovës, mund të konkludojmë se Kosova është krijuar dhe shtetndërtimi i Kosovës, shikuar si proces, është bërë kryesisht nga faktori i jashtëm. Teoria e dytë, ajo zhvillimore ndjek një serë parimesh të zhvilluara nga OECD në vitin 2007, në mbështetje të shteteve të prekura nga konfliktet, të cilat identifikojnë shtetndërtimin si një fushë për ndihmë në zhvillim. Rezultati ka parë punën komisionuar nga vendet donatore në definime, në dijeni dhe praktikë përkitazi me shtetndërtimin.. Kjo ka prodhuar definicionin, sipas të cilit shtetndërtimi është proces indigjen, nacional, i shtyrë nga raportet shtet-shoqëri. Sipas kësaj pikëpamjeje besohet se shtetet nuk mund të bëjnë shtetndërtimin jashtë kufijve të vet, ato munden vetëm të ndikojnë apo të pengojnë procese të tilla³²³.

Këto dy qasje për shtetndërtimin e Kosovës janë aplikuar bashkërisht. Por çështja nëse duhet ndalur vetëm në këto dy qasje, është çështje që meriton të diskutohet edhe nga shumë këndvështrime të tjera. Sepse, shtetndërtimi i Kosovës nuk është ide që ka dalë vetëm në vitin 1999, kur bashkësia ndërkombëtare intervenoi ushtarakisht.

Kosova, si ide dhe përpjekje për shtetndërtim nuk daton vetëm me Rambuje. Nuk ekziston vetëm gjatë procesit të shpërbërjes së federatës jugosllave. Ajo është shumë më e hershme dhe përpjekjet për krijimin e shtetit të Kosovës nuk mund t'ia atribuojmë vetëm një periudhe të caktuar kohore. Sigurisht se nuk mund të përjashtojmë asnjë nga çasjet që u përmenden. Sepse

³²¹ <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=1326136&fileId=1326137>

³²² <http://en.wikipedia.org/wiki/State-building> (qasur mw 22. 3. 2015)

³²³ Po aty.

edhe çasjen ekzogjene edhe çasjen zhvillimore e gjejmë në proceset e shtetndërtimit të Kosovës. Por, natyrisht ka edhe qasje të shumëta pesimiste, të cilat konsiderojnë se Kosova është një shembull tipik i shtetit të dështuar. Të tillët thonë se Kosova është një shembull i dilemave të shtetndërtimit.

Ballafaquar me nevojën për të marrë përgjegjësitë direkte në administratë publike të një territori, një përgjegjësi që është keq përgatitur nga misioni ndërkombëtar i UNMIK-ut, dhe me mungesë të stafit adekuat, organizata është dashur të adoptojë modalitete me fleksibile për zgjedhje dhe rekrutim të personelit. Vendimi për decentralizim të këtij funksioni në këtë fushë ishte një modalitet i tillë³²⁴.

Kosova aspiron drejt integritimeve evropiane dhe drejt anëtarësimit në organizata dhe iniciativa ndërkombëtare. E integritet evropiane megjithatë nuk janë të lehta: qoftë në aspekt të futjes në proces qoftë në kontekst të plotësimit të parakushteve që Kosova duhet t'i plotësojë. Në kuptim të të qenurit e barabartë me shtetet tjera që aspirojnë integritimin evropian, së pari duhet përmendur se Kosova si shtet, akoma nuk njihet nga pesë shtete të Bashkimit Evropian.

Janë, Spanja, Rumania, Greqia, Qipro dhe Sllovakia të cilat nuk kanë njohur shtetin e Kosovës, ndërkohë që Kosova është shprehur e përkushtuar të plotësojë të gjitha kushtet që kanë të bëjnë me integritime dhe edhe kushtet shtesë sipas asaj që njihen Kriteret e Kopenhagës. Kështu, për vendet që aspironin aderimin në BE nga bota e Evropës Qendrore dhe Lindore, Këshilli Evropian kishte vënë disa kriteret të njohura si kriteret e Kopenhagës. Në bazë të këtyre kriterëve, vendet kandidate që pretendojnë inkuadrimit në BE, duhet të kenë: Qëndrueshmëri të institucioneve, duke garantuar demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat njerëzore si dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve, ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale si edhe të aftë për t'iu përgjigjur presionit konkurrues dhe forcave të tregut të BE-së dhe aftësi për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshirë edhe ndjekjen dhe zbatimin e qëllimeve politike, ekonomike dhe monetare të bashkimit³²⁵.

Kosova, bazuar në rrugën specifike të ndërtimit të shtetit edhe në kontekst të plotësimit të kriterëve për integritim, nuk ka qenë e barabartë me shtetet e tjera të Ballkanit dhe të vetë shteteve që kanë dalë si rezultat i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

³²⁴ Po aty.

³²⁵ Dinan, Desmond, *Historia e integritit evropian*, AIIS për botimin shqip, Tiranë (pa vit të botimit), fq. 188.

Në kuadër të procesit të Paktit të Stabilitetit, duhet shtuar se për Kosovën u krijua një mekanizëm i veçantë, me emrin Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim-Asocimit. Ky mekanizëm ka hyrë në fuqi në vitin 2003.

Shteti dhe përpjekjet për ndërtimin e institucioneve shtetërore kërkojnë pjesëmarrje të qytetarëve. Republika e Kosovës do të mbjellë farën e dështimit nëse nuk arrin në mënyrë autentike atje tek ata që ndjehen të përjashtuar, të izoluar dhe deshtetëzuar.

Fuqizimi i gruas është gjithashtu kritik dhe pjesëmarrja e përgjithshme as imperative për zhvillimin e shoqërisë. Ahtisaari thoshte se unë dua të shoh anëtarët serbë të Kosovës sikundër edhe komunitetet e tjera duke marrë pjesë në rritjen e ardhshme të Kosovës. Plani im i përgjithshëm, potenconte Ahtisaari, është dedikuar për të siguruar hapësirë legjitime për komunitetin serb në Kosovën e re. Me të vërtetë, të ruaj të drejtat e të gjitha komuniteteve, por të nënvizuar nga struktura të forta të strukturave legale³²⁶.

Orientimet për shtetëndërtim janë aspiratë e kahmotshme e popullit të Kosovës. Por rreziqet për të kaluar nëpër ndonjë process të dështimit të shtetit nuk është se janë të vogla dhe larg mendjes në Kosovë. Korrupsioni, krimi i organizuar, pasurimi i pabazë i përfaqësuesve të elitave politike, riciklimi i personave me sfond jo të mirë, etj., kanë qenë prezentë në Kosovë në procesin e shtetëndërtimit. Nuk është se ideja e dështimit të shtetit ka prevaluar por përvojat nga vendet e tjera duhet pasur parasysh. Kështu, dështimi i shtetit në masën më të madhe bëhet nga njerëzit dhe kjo nuk është aksidentale.

Fragjiliteti institucional dhe rrjedhat strukturore i kontribuojnë dështimit, por këto deficiencia zakonisht godasin rëndë vendimet apo veprimet e burrave (rrallë grave). Kështu, janë gabimet e lidërshitit përgjatë historisë që kanë shkatërruar shtetet nga shkak i përfitimeve personale.

Në kohët moderne gabimet e lidërshitit vazhdojnë të gërryejnë politikën në Afrikë, Azi dhe Oqeani, të cilat veçse operojnë në cep të dështimit. Rregullat kleptokratike ekstraktuan në Maroc të Zairesë dhe nuk lanë gjë për masat e vartësve të tij nacional³²⁷. Dhe, në ç'masë fenomenet e korrupsionit dhe përfitimet personale të liderëve të papargjegjshëm janë prezente në Kosovë, është vështirë të saktësohet. Por, se këto fenomene janë prezente në Kosovën e pasluftës dhe gjatë gjithë kohën e shtetndërtimit, kjo nuk mund të kontestohet. Mjafton të shihen raportet e

³²⁶ Fjalimi i Martti Ahtisaarit i mbajtur në Kuvendin e Kosovës, më 15 qershor 2009.

³²⁷ ROBERT I. ROTBERG, *Failed States, Collapsed States, Weak States: Causes and Indicators*, brookings.edu/press/books/chapter_1/statefailureandstateweaknessinatimeoferror.pdf, fq. 22.

organizatave ndërkombëtare shtetëore apo joshtetëore dhe të gjeturave tyre janë mjaft shqetësuese.

Është shqetësuese fakti, kur prapa shumë bizneseve në mënyrë publike a gjysëm publike flitet se qëndron iks politikani. Ajo që e rëndon në një masë edhe më shumë situatën është fakti se Kosova që nga vitit 1999 nuk është qeverisur në mënyrë të pavarur nga vendorët.

Kosova është administruar nga ndërkombëtarët, pastaj ka pasur bashkëqeverisje dhe së fundi mbikëqyrje ndërkombëtare. Në të tria versionet e kësaj qeverisjeje askush nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia. Madje jo rrallë afera korruptive ka pasur në bashkëpunim të ngushtë ndërmjetvendorëve dhe ndërkombëtarëve. Dhe pikërisht në një mënyrë rreziku i ndërtimit të shtetit të dështuar është paraparë dhe përmendur edhe nga vet raporti i Kai Eides, ku ai thotë: "Bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjë gjithçka që të sigurohet çfarëdo që statusi do të jetë, që ai status të mos bëhet pastaj status i dështuar."Duke u futur në statusin e ardhshëm kjo nuk do të thotë se futemi në fazën e fundit, por po futemi në një fazë tjetër të pranisë ndërkombëtare³²⁸.

Duke qenë se stabiliteti i regjionit ka rëndësi të madhe për bashkësinë ndërkombëtare dhe duke qenë se raportet Kosovë Serbi mund të janë gjithnjë potencial shpërthimi, bashkësia ndërkombëtare në njëfarë mënyre ka bërë mbylljen e syve para disa fenomeneve, të cilat nuk do të ishin lejuar askund dhe në asnjë demokraci apo shtet. Kjo sepse për hir të negociatave me Serbinë tolerohej edhe një keqqeverisje në masë të caktuar, që të mos rrezikohej procesi i bisedimeve me Serbinë. "Një zyrtar i Komisionit pranon se për hirë të BE-së deh të stabilitetit në qeverisje, e cila është angazhuar në dialog, është toleruar në heshtje një kontroll i parlamentit nga qeveria. Zyrtari i Komisionit i tërheq vërejtjen Qeverisë së Kosovës, duke thënë se ju jeni ndër vendet e rralla ku qeveria kontrollon parlamentin, ndërkohë që parlamenti bojkohet kryesisht nga partia që është në pushtet³²⁹.

Pavarësisht faktit se Kosova ka Kushtetutën e saj dhe ka krijuar një infrastrukturë legale, kjo nuk do të thotë se është arritur të ndërtohet dhe të futet në jetë një demokraci liberale që do duhej të jetë qëllim mbi qëllime.

Është thënë dhe vazhdon të vlerësohet se Kosova ka problemet dhe sfidat brendshme dhe të jashtme. Korrupsioni në çdo raport mbetet një ndër sfidat themelore për zhvillimin e shtetit

³²⁸ Report on a Comprehensive Review, UN documents S/2005/635.

³²⁹ Forum 2015, Kosovo-EU Relations: The history of unfulfilled Aspirations? Kosovo Foundation for Open Society, Prishtina 2013,fq.31

dhe që në fakt e minon zhvillimin e shtetit. Kosova mbetet mbetet shtet i papërfunduar në shumë aspekte³³⁰. Respektimi i Kushtetutës dhe ligjit ose, thënë ndryshe, sundimi i ligjit, është problem mbi problemet. Kushtetuta e Kosovës është shkelur edhe nga vetë presidentët e Kosovës.

Nga katër presidentë sa ka pasur Kosova deri tash, dy janë detyruar të lëshojnë postin nga shkaku se kanë shkelur Kushtetutën³³¹. E kur shkelja e Kushtetutës bëhet nga presidentët, dyshimet shtohen. Ka edhe diçka që këtu mund dhe duhet thënë: Edhe presidentja aktuale është zgjedhur në mënyrë të çuditshme prandaj edhe në zhargonin politik të politikës ditore, ajo quhet “Presidentja e zarfit”. Por, megjithatë, problemet kryesore nga brenda mbesin zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, korrupsioni, shoqëria e dobët civile dhe demokratizimi i përgjithshëm në shoqëri. Sigurisht, si sfida e llojit të vet, mbetet edhe shtrirja e pushtetit në komunat e veriut të Kosovës, të dominuara me popullatë serbe.

Partitë politike, për kah organizimi i brendshëm, janë fragjile dhe të varura nga lideri i tyre, ndërkohë që liderët nuk janë mjaftueshëm të përgjegjshëm, duke qenë se shoqëria civile nuk është mjaftueshëm e zhvilluar që të kryejë një ndër funksionet themelore në shoqëri, atë të ruajtësit të demokracisë.

Përpjekjet për aktivizëm qytetar nuk kanë arritur rezultate të pritura dhe të dëshiruara. Kjo ngase ata nuk ndjejnë të janë pronarë të proceseve. Nuk janë pronarë të proceseve, sepse shumë gjëra u janë imponuar.

Kushtetuta e Kosovës në një mënyrë mund të konsiderohet si akt i imponuar nga jashtë sikundër që, siç u tha, presidentja aktuale del si e imponuar, sepse doli si rezultat i një marrëveshjeje të jozakonshme politike të liderëve politikë e të organizuar nga ambasadori i SHBA-ve, z. Christopher Dell, i cili në formë metaforike thuhet se emrin e presidentes e nxorri nga zarfi.

Kosova vazhdon të ketë numrin më të madh të ministrive në Evropë Juglindore, që në vete është problem i llojit të vet dhe ngarkesë e madhe financiare. Kjo bëhet vetëm nga shkaku i arritjes së marrëveshjeve jo rrallë të çuditshme për koalicione, të cilat pastaj duhet të kënaqin apetitet e partive në kurriz të taksapaguesve të vendit. Situata politike sot në Kosovë e pengon demokratizimin dhe sundimin e ligjit.

³³⁰ Deklaratë e Albin Kurtit, dhënë në një intervistë, mw 24 shkurt 2014

³³¹ Fatmir Sejdiu u detyrua të dorëhiqej, ngase mbajti dy funksione në të njëjtën kohë dhe dorëheqja ju imponua nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, kurse Behxhet Pacolli u zgjodh duke u shkelur kushtetuta, prandaj edhe ai u detyrua të dorëhiqej.

Politikanët në Kosovë në mënyrë të jashtëzakonshme janë të korruptuar. Lidhja e ngushtë e politikanëve dhe krimit të organizuar janë pengesë e madhe për demokratizim dhe zhvillim ekonomik sot³³². Partitë e shumta politike në Kosovë krijojnë një pluralizëm që nuk mund të quhet i thellë. Më shumë mund të konsiderohet si një pluralizëm sipërfaqësor dhe fare pak përmbajtësor. Në Kosovë asnjë herë nuk është dëgjuar të thuhet se jemi kundër ndihmës apo mbikëqyrjes ndërkombëtare. Por, në kontekst të asistencës ndërkombëtare, Kosova me të vërtetë ka nevojë për një formë e asistencës ndërkombëtare që ndërton, në vend se të zëvendësojë kapacitetet vendore³³³.

Sa i përket çështjeve sociale, Kosova është një ndër vendet më të varfëra në Evropë me EUR 2.800 për capita GDP në vitin 2012. Kjo bën të hyrat për kokë banori të jetë 1:10, mesatarisht për nivelin e BE-së.

Gjendja e varfërisë mbetet e lartë dhe varfëria ekstreme është e lartë sidomos në familjet rome, ashkalnje dhe egjiptiane³³⁴.

Këto ishin disa vështirësi, të cilat nga brenda dalin të janë sfida kryesore, por sfidat nuk mbarojnë vetëm nga brenda. Janë edhe sfidat nga jashtë, të cilat mbasin si barrë që kërkojnë zgjidhje.

Sfidë e madhe del të jetë çështja e mosnjohëjs së Kosovës nga dy shtete të forta anëtare të Këshillit të Sigurimit (Kina dhe Rusia) si dhe pesë shtete anëtare të BE-së. Është raportuar nga ICG se asnjë nga pesë shtete të BE që se kanë njohur Kosovën, madje as nuk kanë dhënë shenja të njohjes. Kështu që Brukseli nuk do të jetë në gjendje që të marrë një pozitë unike pro statusit të Kosovës. Është ngjashëm pozita e Kinës dhe Rusisë, të cilat do të vazhdojnë të bllokojnë anëtarësimin e Kosovës në Kombe të Bashkuara madje edhe nëse arrihet shumica e votave në Asamble të Përgjithshme³³⁵.

Janë shumë çështje që mund të përmenden krahas këtyre që u thanë e që paraqiten të janë sfida për të ardhmen e Kosovës, e cila përkundër vështirësive, megjithatë ka lëvizur përpara, por konstatimi qëndron se përderisa Kosova është krijuar si një projekt i përbashkët i kosovarëve dhe i bashkësië ndërkombëtare, si i tillë edhe mund të ecën përpara. Përndryshe sfidat në Ballkanin Perëndimor do të janë edhe më të mëdha, të cila mund të destabilizojnë gadishullin edhe me

³³² Ramet and Simkus, "The Roots of Instability and the Prerequisites of Stability in Kosovo:", p. 5

³³³ <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=1326136&fileId=1326137>, fq.24

³³⁴ The World Bank in Kosovo. *Country snapshot* (October 2013), fq. 6-7

³³⁵ International Crisis Group, "Kosovo and Serbia after the ICJ Opinion" in Europe Report, No.206 (26 August 2010), p. 1.

tendencë që ndryshojnë kufijtë. Në situatë të tillë hipotetike, edhe bashkimi kombëtar i shqiptarëve do të dalë si opsion i mundshëm,

Pas pavarësimit të Kosovës dhe pas krijimit dhe fuqizimit të institucioneve të veta dilemat nëse do të kemi stabilitet dhe shtet të qëndrueshëm të Kosovës, në kontekstin gjeografik, politik dhe gjeopolitik, kanë mbetur dilema. Dhe, këto dilema, me gjasë, do të mbesin aq gjatë përderisa sa faktorët e jashtëm, por edhe faktorët e brendshëm do të kanë qëndrime më transparente dhe më prerazi të shprehura.

Se Ballkani është territori i teorive të ndryshme konspirative, kjo është çështje e njohur për të gjithë dhe nuk ka nevojë për ndonjë studim të veçantë për këtë. Por, se janë disa procese, të cilat zhvillohen vetvetiu, edhe kjo nuk kontestohet. Fuqizimi i shtetit të Kosovës ose shtytjet drejt diskutimit për bashkim kombëtar, janë ide dhe tema që publikisht promovohen nga subjekte të ndryshme politike nga të dy anët e kufirit.. E para, fuqizimi i shtetit të Kosovës është synim ndërkombëtar dhe e përkrahur nga pjesa dërmuese e popullit. E dyta, bashkimi kombëtar si ide, por edhe si aspiratë nga të qenurit e mbyllur në ndërdije, por e shprehur në disa subjekte politike publikisht apo gjysëm publikisht, ka nisur kohët e fundit të dalë edhe më shumë në sipërfaqe.

Bashkimi në Evropë ose të bashkuar drejt Evropës, mbeten si sintagma që meritojnë diskutim, pavarësisht rrezeve për bllokada, kërcënime etj., lidhur me këto ide.

Bashkimi, nëse jo në formë të organizatës shtetërore a në forma të mekanizmave formal juridik, megjithatë po ndodh. Po ndodh në kuptimin fizik: autostradat, menaxhimi i përbashkët i kufijve dhe ngjashëm me këto. Po ndodh edhe në kuptimin kulturor, sepse në atë shpirtëror kjo tashmë është vërtetuar. E sa i përket vullnetit për bashkim kombëtar, kjo mund të ilustruhet me dy shembuj, shpallja e pavarësisë së Kosovës nëpër qytetet e Kosovës solli spontanisht qytetarë nga gjithë qytetet e Shqipërisë, që aktin e shpalljes së pavarësisë e pasuruan. Njëqindvjetori i shtetit shqiptar solli në Tiranë dhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhjetëra mijëra qytetarë nga të gjitha trojet. Që të dy këto manifestime në programet e tyre nuk kishin sjelljen e qytetarëve nga njëri vend në tjetrin. Asgjë nuk ishte organizuar. Kishte një lëvizje spontane që në një mënyrë po shprehte një vullnet qytetar për të festuar bashkërisht. Dhe në këtë festë apo në këto festa mund të shihej një referendum që tregonte qartë se çka në të vërtetë qytetarët shqiptarë nga të dyja shtetet po kërkonin. Ishte një vullnet shumë qartë i shprehur i qytetarëve. Dhe kështu tash më nuk ka pengesa në së paku komunikimin brendashqiptar,sepse dikur kishim:” „Për shkak të

kufizimeve të mediave dhe propagandës që zhvillonte ish regjimi i Hoxhës, shqiptarët në Shqipëri dinin më shumë së çfarë ndodhte p.sh. në Mozambik se në Kosovë...

Ndonëse Enver Hoxha u përpoq ta ndiqte çështjen kombëtare ndërmjet rezistencës gjatë kohës së luftës, në periudhën pas luftës ai në mënyrë të vazhdueshme e ka anashkaluar çështjen e bashkimit kombëtar në interes të stabilitetit të pushtetit të vet në Tiranë³³⁶.

Krijimi i shtetit të Kosovës është rezultat i ambicieve, aspiratave, përpjekjeve dhe luftës së popullit të Kosovës për liri e pavarësi. Por, krijimi i shtetit të Kosovës është edhe rezultat i këtyre përpjekjeve që krahas lirisë dhe pavarësisë të jetësojë edhe idetë e unitetit kombëtar dhe të krijimit të një shteti shqiptar. Këto ide dhe përpjekje kanë ekzistuar dhe gjinden gjatë gjithë lëvizjeve kombëtare për çlirim. Ato, në momente të caktuara, janë shprehur si ide. Në momente të caktuara janë shprehur edhe në praktikë dhe, në moment të caktuara, në nivele debatesh, janë dukur të janë edhe utopi. Megjithatë, është vështirë të zgjedhësh nëse Kosova duhet trajtuar në këtë kontekst si paradiplomatik-aktivitet i zhvilluar nga regjionet dhe jo nga qeveria qendrore. Kosova mund të studiohet gjithashtu edhe si shembull i shtyer i lëvizjes çlirimtare dhe proces i ndërtimit të shtetit nacional në Ballkan, duke ndjekur shembujt e fqinjëve (Greqi, Shqipëria, etj., të cilat fituan pavarësinë në shekullin XIX dhe fillim të shekullit XX). Apo, Kosova duhet studiuar si rast i çlirimit kolonial – një territor i okupuar nga forca të huaja përgjatë shekujve dhe tani duke kaluar përmes një faze të protektoratit ndërkombëtar (UNMIK mund të shikohet si shembull i vonë i aktiviteteve të besueshme të krijuara për të mbështetur shtetet koloni në Afrikë)³³⁷.

Çështja se a po shkohet drejt fuqizimit apo nëse po shkohet drejt unifikimit është çështje e debatueshme dhe e varur shumë nga rrethanat, në radhë të parë të jashtme dhe pastaj edhe në rrethanat e brendshme në Kosovë dhe në Shqipëri.

Kurse se Kosova është shtet dhe se i plotëson të gjitha kushtet, siç i përmend Konventa e Montevideos, kjo nuk duhet diskutuar. Realiteti është se Kosova ka territor të definuar qartë, ka popullsi të përhershme, ka qeveri tërësisht funksionale dhe efektive dhe po angazhohet aktivisht në emër të vet në marrëdhënie ndërkombëtare me shtete gjithandej nëpër botë (sikurse edhe

³³⁶ Vickers, Miranda & Pettifer, James, *Shqipëria-nga anarkia te një identitet ballkanik*, SHB “Toena”, Tiranë, 1998, fq. 143.

³³⁷ Dedushaj, Naim, *Paradiplomatic Relations between the United States and Kosova: A Friendship between an elephant and a mouse*, fq. 68.

brenda organizatave ndërkombëtare)³³⁸.

Shteti i Kosovës, përkundër vështirësive të natyrshme që janë të karakterit objektiv dhe subjektiv për proceset dhe për rrethanat, që kanë ekzistuar me rastin e krijimit të Kosovës, nuk është se nuk mund të ballafaqohet me rrezikun e dështimit. Dhe, ky rrezik i dështimit eventual është shumë më i vogël, krahasuar me ndonjë shtet të një rajon tjetër në botë. Kosova, në radhë të parë gjeografikisht gjindet në Evropë dhe është pak e mundur që rreziku i dështimit të jetë bindës. Pastaj krijimi i shtetit të Kosovës, fundifundit, është bërë në bazë të një projekti, i cili ka pasur përkrahje të madhe nga shtetet më të fuqishme dhe më demokratike të botës perëndimore. Ka edhe shumë faktorë që dështimin e shtetit të Kosovës nuk e mundësojnë.

Meritat e daljes së Kosovës nga ky konflikt (konflikti i ish-Jugosllavisë), i takojnë mungesës së ndonjë prove kredibile për implikimin e Kosovës në ndonjë aktivitet terrorist dhe faktit se institucionet e vetëqeverisjes ishin themeluar në Kosovë nën mbikqyrje ndërkombëtare³³⁹.

Megjithatë, vështirësitë përkitazi me mosnjohjen e Kosovës mund të janë edhe një shtysë që përshpejton dhe rrit tendencat për bashkim më të shpejtë kombëtar. Kjo sepse, veç të tjerash, kërkesat e Kosovës për shtetshmëri kontestohen. Kosova kështu e gjen veten në një pozitë të pazakonshme, ku ose nuk pranohet efektivisht ose nuk refuzohet nga bashkësia ndërkombëtare përgjithësisht³⁴⁰.

Çështja e ndërtimit të brendshëm të shtetit të Kosovës vazhdon të debatohet. Në shumë debate shumë është shtruar çështja e shtetit të dobët, por edhe çështja e dështimit të tij. Shtetet e dobëta a të të dështuara paraqesin problem dallues për promovim të demokracisë. Në këto shtete, sfida nuk është vetëm (apo në disa raste madje në tërësi) t'u bëjmë presion liderëve autoritarë shtetërorë të dorëzojnë pushtetin, por më shumë është të gjejmë se si të rigjenerojmë pushtetin legjitim, në vend të parë. Imperativ nuk është vetëm fuqizimi i qytetarëve dhe i organizatave të tyre që të financojë institucionet shtetërore sikundër edhe me burimet, trajnime, organizata dhe në një sens të misionit të përbashkët³⁴¹.

³³⁸ Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, Further Written Contribution of the Republic of Kosovo, dërguar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, 17 korrik 2009, version anglisht (përkthim i autorit), fq. 35

³³⁹ Martin, Bridgette, *Secession and Statehood, The International Legal Status of Kosovo*, Dunedin 2008, fq. 26.

³⁴⁰ Wilson, Gary, *Self-determination, recognition and the problem of Kosovo* in Netherlands International Law Review Vol. 56, no. 3, fg. 462.

³⁴¹ Promoting Democracy in Post-Conflict and failed states: Lessons and Challenges, Prepared for the National Policy Forum on Terrorism, Security, and America's Purpose, Larry Diamond, Washington, DC, e disponueshme nw: web.stanford.edu/~ldiamond/papers/Promoting Democracy 0905.htm

Ndërtimi i shtetit të Kosovës ka kaluar nëpër një process të gjatë dhe shteti është ndërtuar në një situatë dhe në rrethana postkonfliktuale, ku rol të madh ka luajtur edhe bashkësia ndërkombëtare. Për të sqaruar në një masë këtë aspekt po paraqesim atë që Larry Diamond ka paraqitur në *National Policy Forum for Terrorism, Security and America's purpose*. Aty, Diamond thotë: " Më përgjithësisht, ne mund të specifikojmë gjashtë sfida të dallueshme të rikonstruktimit politik në një zgjidhje postkonflikti: Rindërtimi i kapacitetit të shtetit të shkatërruar, përfshirë mjetet e tij për të siguruar rend dhe siguri (armatë, polici dhe inteligjenci), Sfida e kontrollimit dhe demobilizimit të burimeve alternative të dhunës nga duart e akterëve joshitetërorë, siç janë milicite religjioze dhe partiake, mbretërit e luftës dhe ushtritë e tjera private. Sfidë tjetër është reduktimi i iniciativave strukturore të dhunës, përmes dizajnit të institucioneve politike që japin pykë reale në sistem për secilin grup që dëshiron të luajë rol në garën demokratike.

Zhvillimi i institucioneve sociale dhe politike në demokraci, në shtet dhe shoqëri civile është sfidë permanente, dhe si sfida tjera janë Administrimi postkonfliktual i popullit (kombit) dhe Dizajnimi dhe implementim i një plani për tranzicion të një rendi të vetëqëndrueshëm politik dhe demokratik³⁴².

Për interes të studimit, po përmendim vetëm disa çështje, që kanë të bëjnë me ndërtimin e shtetit, kur ai shtet a territor është administruar ndërkombëtarisht dhe kur ky administrim në moment të caktuar nuk ia ka qëlluar. Esenca nuk qëndron vetëm te ndërtimi i institucioneve apo te transferi i pushtetit. Kjo ka rëndësinë e vet, por nëse nuk arrihet të ndërtohet dhe të zhvillohet demokracia, atëherë ne jemi në gjysmë të rrugës. E ndërtimi i demokracisë nuk është dhe nuk ka qenë proces i lehtë.

Gerald Knaus dhe Marcus Cox argumentojnë se misioni i Bashkimit Evropian në Bosnjë dhe misioni i UNMIK-ut në Kosovë kanë dështuar të ndërtojnë demokraci në këto dy vende, nga shkak se ato u qeverisën si protektorate përmes modelit "autoritar të shtetndërtimit". Përdërisa kjo ka arritur një shkallë stabilizimi, kjo nuk ka kultivuar instrument, incentive dhe kulturë demokratike të vetëqeverisjes dhe në vend të kësaj ka ndërtuar potkonj me maja mbi rezistencën

³⁴² Promoting Democracy in Post-Conflict and failed states: Lessons and Challenges, Prepared for the National Policy Forum on Terrorism, Security, and America's Purpose, Larry Diamond, Washington, DC, e disponueshme në: www.stanford.edu/~ldiamond/papers/PromotingDemocracy0905.htm.

lokale. Për dallim, duke punuar me shtete kandidate, Bashkimi Evropian ka punuar me institucione lokale, duke u dhënë kapacitet dhe incentive që të bëhen forca aktive për zhvillim³⁴³.

Është thënë se Kosova monitorohet nga sidomos Bashkimi Evropian dhe se progresi i arritur jo vetëm monitorohet, por edhe vlerësohet konkretisht.

Është sfidë e veçantë kur të flasim për vlerësimin dhe matjen e ndërtimit dhe të zhvillimit të demokracisë. Me cilin opcion të shkojmë më tutje dhe pse? Kush janë pengesat? Më shumë pengohemi nga jashtë apo më shumë pengohemi nga elitat politike të brendshme? Ka mundësi që këtyre pyetjeve t'u shtohen edhe shumë nënpyetje, e për çka përgjigjet nuk janë të lehta për t'u bërë.

Në fjalorin e përditshëm, të cilin e përdorin liderët politikë në Shqipëri dhe në Kosovë, dëgjojmë fraza, të cilat përafërsisht mund të përmbledhen kështu: "Ka ardhur koha e bashkimit kombëtar. Ne si komb po bashkohemi. Të gjithë më në fund do të bashkohemi në shtëpinë e madhe, në Bashkimin Evropian³⁴⁴.

Liderët opozitarë kanë, megjithatë, slogane dhe mendime të tjera përkitazi me idetë e bashkimit kombëtar dhe ata fajësojnë pozitën dhe liderët e pozitës në Shqipëri dhe në Kosovë se janë pengesë e bashkimit kombëtar.

³⁴³ Promoting Democracy in Post-Conflict and failed states: Lessons and Challenges, Prepared for the National Policy Forum on Terrorism, Security, and America's Purpose, Larry Diamond, Washington, DC, e disponueshme në: www.stanford.edu/~ldiamond/papers/PromotingDemocracy0905.htm

³⁴⁴ Këtë e hasim sidomos nga liderët e pozitës në Kosovë dhe në Shqipëri. Së fundi, p.sh. e përdori si slogan a si shprehje politike edhe kryeministri shqiptar Edi Rama, më 4 prill 2015 në Ulqin, kur po merrte titullin "Qytetar Nderi i Ulqinit".

Diskutime

Rruga drejt pavarësisë së Kosovës dhe shtetndërtimit, ka qenë një rrugë me shumë pengesa dhe vështirësi, të cilat në një moment të caktuar kohor me ndihmën politike, diplomatike, ushtarake, ekonomike dhe menaxhuese ndërkombëtare u tejkaluan, me çka u arrit realizimi i aspiratave shekullore të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Vështirësitë dhe pengesat ishin të nduarndurshme, për çfarë mund të janë të grupizuara dhe të klasifikuara në shumë grupime, por të gjitha këto kishin një emërtim të përbashkët e ajo është se: Serbia ka qenë gjithë kohën pengesa kryesore e synimeve historike të Kosovës. Njëkohësisht dhe politikat, edhe diplomacia ndërkombëtare nuk ishin në favorin tonë.

Serbia, që nga krijimi i Jugosllavisë, fillimisht si shteti i SKS (serbëve, kroatëve dhe i sllovenëve), në vitin 1918 ka qenë fuqia kryesore dhe vendimmarrëse e saj. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe gjer në shpërbërjen e Jugosllavisë, Serbia ishte republika me më së shumti ndikim dhe fuqi politike e ushtarake në Jugosllavi, edhe pse nga aspekti ekonomik qëndronte mjaft pas Sllovenisë e Kroacisë.

Për shkak të balansimit të këtyre raporteve ndërmjet republikave jugosllave në nivel federativ dhe për shkak të pasqyrimin permanent të një fryme politike kërcënuese nga ana e Serbisë, çështja e Kosovës gjithnjë është injoruar, është heshtur nga institucionet federative dhe nga republikat e tjera.

Edhe pse në momente të caktuara kohore ka pasur tendenca nga nivelet federative që të publikohet dhe të shqyrtohet dhuna e zbatuar në Kosovë nga Serbia, prapëseprapë këta zëra u ngulfatin nga vrazhdësia dhe kundërshtimet unifikuese të Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnjës-Hercegovinës.

Serbia, në të gjitha institucionet të nivelit federativ, ishte e fortë numërikisht, e fortë ushtarakisht, e forte ekonomikisht meqenëse e shfrytëzonte, e keqpërdorte buxhetin federativ, e fortë ishte në organizim politik e diplomatik, pasi në dallim prej pjesëve të tjera konstituive të Jugosllavisë kishte traditë shtetërore më të avansuar për çka kishte përkrahje të përgjithshme ndërkombëtare e nga disa shtete të fuqishme evropiane, siç ishin: Rusia, Franca, Greqia e shumë të tjera konceptoj se Jugosllavia në fakt është Serbia dhe si e tillë konsiderohej aleat tradicional i tyre e përmes tyre edhe e tërë bashkësisë ndërkombëtare. Në rrethana të tilla, detyrimisht shtrohej pyetja se si mund dhe si duhet të veprojë Kosova drejt realizimit të synimeve të veta.

Që nga pas Lufta e Dytë Botërore në Kosovë disa herë vendoset pushteti i plotë ushtarak. Situata e tillë fillon nga “koha” e para mbajtjes së Kuvendit të Prizrenit në vitin 1945 kur më 8 shkurt 1945, komandanti suprem i UNÇJ-së J.B.Tito me urdhër të veçantë nr.31 vendosi administrimin ushtarak në Kosovë. Këtë vendim e mori më 7 shkurt 1945 në Beograd, në një takim me ushtarakët serb: **Savo Dërleviqin, Gjuro Medenicën dhe Kërsto Filipoviqin**. Me këtë urdhër, i tërë pushteti në Kosovë i kalonte një grupi të caktuar ushtarakësh serbo-malazez, të cilët do të ushtronin pushtetin politik, ekzekutiv dhe atë gjyqësor. Në këto kushte të gjendjes ushtarake, ku aplikohesh dhuna e paparë ndaj popullatës shqiptare, pushteti i instaluar serb e malazias arriti që në mbledhjen e mbajtur të ashtuquajturit “Kuvendi Krahinor i Kosovës”, si organ më i lartë i pëfaqësuesve të popujve të Kosovës, në Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 8 - 10 korrik 1945, vendosi në formë të “Rezolutës për Aneksimin e Kosovës me Serbinë federale”. Në bazë të listës së pjesëmarrësve dhe mysafirëve të ftuar në Kuvendin e Prizrenit, kanë marrë pjesë 142 delegatë dhe mysafirë, prej të cilëve 109 ishin serbë e malazez. Po ashtu nga pushteti federativ gjendja ushtarake në Kosovë u vendos edhe gjatë kohës së demonstratave të vitit 1981 dhe së fundi në vitet 1989/1990, kur Kosovës iu mor autonomia e dhënë me Kushtetutën e vitit 1974.

Në bazë të këtyre fakteve, mund të nxjerrim një përfundim i përbashkët se në momentet kyçe kur tentohej të përcaktohej statusi ekzistues i Kosovës, ndodhte diçka. Sa herë që duhej imponuar dokumente kushtetuese – juridike, me të cilat sanksionohej një gjendje kundër vullnetit të popullit të Kosovës, në Kosovë vendosej shtetrrëthim dhe pushteti ushtarak jugosllavo - serb. Dhe, sa herë që vendosej pushteti ushtarak, rritej më shumë mobilizimi gjithëpopullor i shtetit dhe i pushtetit serb.

Procesi i ndërtimit të shtetit të Kosovës përmes rrugëve diplomatike dhe ushtarake, ka mundur të jetë më lehtë i arritshëm dhe më pak i kushtueshëm. Më lehtë i arritshëm, do të kishte qenë nëse korpusi nacional në Kosovë të kishte qenë më i përgatitur (realisht ka mundur të jetë), për t’u ballafaquar me sfidat e luftës për liri dhe pavarësi. Më pak i kushtueshëm, sikur të ishte investuar në mënyrë më të duhur në diplomaci. Ka edhe shumë çështje që mund të konsiderohen hipotetike e që ndërlidhen me “nëse...do të...” dhe kjo domosdoshmërisht të bën të hulumtosh, për të gjetur rrugë të qarta. Është i njohur parimi se sa më shumë pyetjet të janë të vështira, përgjigjet do të janë më të mira. E pyetjet e vështira rrallë po formulohen dhe rrallë po parashtrohen.

Në Kosovë, pas Luftës së Dytë Botërore, me dhunë u vendos një sistem i paqëndrueshëm dypolar. Në njëren anë, Kosova ishte njësi federative e barabartë me të gjitha republikat e tjera në Jugosllavi dhe, nga ana tjetër, ishte edhe pjesë e Republikës së Serbisë. Ky koralicion i mjegulluar i pozitës juridiko - kushtetuese të Kosovës, në dy nivele, i jepte ose i mohonte fuqinë juridike e politike, varësisht siç pranohej të interpretohet nga institucionet vendimmarrëse shtetore, e aty Serbia ishte e pakompromis. Për këtë arsye, një pozitë e tillë e Kosovës ofronte mundësi që ajo të trajtohej varësisht nga këndvështrimi i palës që këtë status e elaboronte. Për pjesën dërrmuese ishte status i autonomisë e për dikënd që dëshironte ta konceptojë Kosovën vetëm si element konstituiv të Federatës jugosllave, gjë që me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974 në të vërtetë edhe ishte, atëherë Kosovën e konceptonin edhe si republikë të njëjtë me republikat e tjera të Federatës jugosllave. E gjetur në këso situatash të mjegulluara juridike dhe politike dhe në gjendje kur popullata e saj i nënshtrohej një presioni të rëndë dhune e terrori, popullit të Kosovës iu imponua që të levizte para nga status quo ekzistuese, me qëllim të definimit të qartë të statusit të vet në RSFJ.

Po ashtu, gjatë tërë periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore e deri në fazën e shpërbërjes së Federatës jugosllave, Kosova thuaja tërësisht i kishte të shkëputura lidhjet me shtetin amë Shqipërinë, që është edhe një kapitull në vete, e cila imponon një studim tjetër, të veçantë. Gjatë tërë kësaj periudhe kohore 1945 – 1999, përjashtohe vetëm e konsolidimit të Universitetit të Prishtinës, kur pedagogë nga Tirana kishin ardhur për të mbajtur ligjërata në disa nga fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Ky bashkëpunim arsimor e kulturor nuk zgjati shumë kohë, sepse pas demonstratave të vitit 1981, sërish ndërmjet Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë u rikthye kufiri i hekurt.

Sa u përket diplomacisë dhe aktiviteteve diplomatike të Kosovës dhe rreth Kosovës ato deri në vitet, kur fillon shpërbërja e Jugosllavisë, ato janë kryer nga strukturat e pushtetit qendror jugosllav. Një element që duhet theksuar, përkitazi me strukturat diplomatike, është fakti se me Kushtetutën e vitit 1974 Kosova kishte organin që merrej me punë të jashtme. Në Kosovë sipas kësaj kushtetute ekzistonte Sekretariati për marrëdhënie me botën e jashtme që ishte një organ i ngjashëm me një ministri të jashtme të sotme. Por ky sekretariat realisht ishte simbolik dhe me kompetenca drastikisht të kufizuara, të cilat nuk i ofronin hapësirë dhe mundësi që përmbajtësisht të veprojnë, aq më pak të prodhojnë efekte dhe të realizojë rezultate, në frymën e përfaqësimit të Kosovës dhe të aspiratave të popullit të Kosovës.

Kur Serbia, si njësi federative e federatës jugosllave filloi haptas me aktivitetet për krijimin e “Serbisë së Madhe” fillimisht të kamufluar nën ombrellën e ruajtjes së Jugosllavisë, e bëri okupimin klasik të Kosovës, në Kosovë u imponua fillimi i një aktiviteti i ndryshëm politik të cilën disa personalitete e konceptonin si diplomaci.

Rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989 paralajmëronte një etapë të re në zhvillimin dhe perceptimin e diplomacisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në botë. Këtë risi, mundësi e kuptuan drejt dhe menjëherë shumë shtete të ndryshme që më parë ishin më deshirë apo pa deshirë pjesë përbërse në bashkësi të ndryshme shterore siq ishte rasti me shtetet në kuadër të BRSS-së (Bashkimit Sovjetik apo RSFJ-së (Federatës Jugosllave) etj. jo aq në mënyrë të planifikuar apo të paramenduar e shfrytëzuan 114 delegatët e Kuvendit Krahinor të Kosovës të cilët me 2 Korrik 1990 shpallën Deklaratën Kushtetuese me çka bënë hapin e parë drejt institucionalizimit të pavarësimit të Kosovës. Krahas përpjekjeve për pozicionimin me kërkesa për definim të qartë të pozitës së Kosovës në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë; krahas përpjekjeve të krijimit të strukturave shtetërore që do të merrnin përgjegjësinë për të mbajtur jetën në Kosovë; krahas përpjekjeve për ruajtjen fizike nga lufta që po trokiste në derë duhej menduar edhe për aktivitete diplomatike, pa të cilat nuk mund të arrihej diçka.

Viti 1990 është vit ku organet e dhunshme serbe, por edhe ato federative në masë të caktuar pamundësojnë ekzistimin dhe veprimtarinë e institucioneve të Kosovës, të cilat ishin formuar sipas Kushtetutës së vitit 1974. Puna e tyre ndalohej dhe bëhet e jashtëligjshme, sipas pushtetit serb. Në një situatë të tillë të jetës pa institucione ndodh diçka që ishte karakteristikë e krejt Evropës Juglindore: rënia e botës komuniste dhe kjo rënie e komunizmit bëri që Lidhja Komuniste e Kosovës të zhduket brenda një kohe shumë të shkurtër duke mundësuar kështu që në Kosovë të fillojë krijimi i partive të para demokratike, të cilat në fazën fillestare marrin karakteristika të një lëvizjeje kombëtare. Dhe, kjo lëvizje kombëtare do të provojë dhe do t’ia dalë në masë të madhe të organizojë jetë institucionale në rrethana të okupimit serb.

Në kontekst të aktiviteteve diplomatike, kjo së pari në këtë fazë do të zhvillohet nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe lideri i saj, dr.Ibrahim Rugova. Lidhja Demokratike e Kosovës, në fazën e parë, këto aktivitete diplomatike i ka ushtruar vetë dhe pas një kohe të shkurtër një pjesë e madhe e këtyre aktiviteteve do të kryhen edhe nga Qeveria e Kosovës e cila do të veprojë në ekzili. Ajo që duhet theksuar për LDK-në dhe aktivitetet e saj diplomatike, mund të quhen më shumë si aktivitete paradiplomatike, sepse nuk mund të thuhet se ekzistonin

struktura dhe madje nuk kishte mundësi që këto struktura të krijoheshin në kushte të okupimit. Në këtë kontekst dhe në kontekst të periudhës kohore, aktivitetet diplomatike mund të grupizohen dhe mund të ndahen në disa faza kohore, ku akterët e zhvillimit të diplomacisë kosovare dallojnë.

U tha se fillimisht gjithçka do të zhvillohet brenda Kosovës dhe kjo parimisht dhe kryesisht nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe liderit të saj Rugova. Kësaj partie politike apo lëvizjeje kombëtare, edhe në kuptim të aktiviteteve diplomatike, do t'i bashkëngjiten edhe partitë e tjera të vogla që vazhdojnë të krijohen në Kosovë. Krahas rol të rëndësishëm do të luajnë edhe disa organizata joqeveritare, si Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, shoqata "Nënë Tereza" dhe shoqata e tjera të cilat filluan të krijohen në Kosovë. Themi se kanë zhvilluar aktivitete diplomatike a paradiplomatike, për arsye se Kosova kishte nevojë për ndihmë, përkrahje dhe ajo çka është shumë e rëndësishme, Kosova kishte nevojë që të sensibilizojë opinionin ndërkombëtar për të mbështetur Kosovën. Kjo ishte një rrugë shumë e mire, në rrethana të tilla optimale, për të depërtuar me të vërtetën dhe me kërkesën për mbështetje të bashkësia ndërkombëtare, sepse pjesë e saj as që dinte, madje as që dëshironin të ndërmerre diçka për të përkrahur kërkesat e Kosovës për liri e pavarësi.

Në përgjithësi, ky punim ofron të dhëna të mjaftueshme për të pasur një pasqyrim më përmbajtësor të një procesi të diplomacisë ndërkombëtare për ta zgjedhur çështjen Jugosllave. Në bazë të shënimeve autobiografike të personave kyç të përfshirë në këtë proces, dokumenteve dhe shkrimeve tjera që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me këtë problematikë mund të vijmë deri tek një konkludim i përgjithshëm se diplomacia ndërkombëtare pa përjashtim pikësynim të vetin kishin që ta ruajnë tërësinë territoriale të RSFJ-së.

I gjithë ky kompleksitet i problemit të Kosovës dhe ky angazhim i nivelit më të lartë të diplomacisë ndërkombëtare, kishte një tendencë bazike si të evitohej nga procesi i zgjidhjes së mundshme-pavarësia e Kosovës. Duke u bazuar në këtë përcaktim unanim të faktorit ndërkombëtar lidhur me zgjidhjen e çështjes së Kosovës, vetvetiu parashtrohet pyetja se si arriti Kosova t'i realizonte synimet e veta, kur para vetes kishte një qëndrim të përbashkët ndërkombëtar anti pavarësi...

Në bazë të shtjellimit të kësaj problematike nga individ me ndikim në krijimin e politikave ndaj Kosovës, dhe pjesëmarrësve të drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, rezulton se faktori përcaktues që ka ndikuar dhe detyruar diplomacinë ndërkombëtare që të

evoluojë qëndrimin e saj primar mbi Kosovën, ka qenë: **Qëndrimi refuzues i Serbisë për bashkëpunim me faktorin me ndikim ndërkombëtar lidhur me zgjidhjen e çështjes së Kosovës .**

Nga ana tjetër, ky punim po ashtu elaboron në mënyrë të përgjithësuar edhe ndikimin që ka pasur çështja e Kosovës në evoluimin e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë edhe evoluimin e të menduarit klasik për të drejtat dhe liritë e njeriut, vetëvendosjen, mosndërhyrjen në punët e brendshme të një shteti dhe për përdorimin e forcës ndërkombëtare për çështje humanitare. Punimi, tërë këtë evoluim e paraqet në mënyrë kronologjike, me çka i mundëson të gjithëve ta kenë një pasqyrë reale që nga fillimi e deri në fund të këtij procesi.

Fokusi i prezantimit është përqendruar kryesisht në dilemat ndërkombëtare për mënyrën e qasjes ndaj krizës në Kosovë... Punimi mbulon në mënyrë të përgjithësuar dhe shumë të shkurtër problemin e Kosovës dhe të shqiptarëve nëpër shekuj që nga koha e Ilirëve e deri në vitet tetëdhjetë, ndërsa, vështrimin kritik dhe analitik ia ka përkushtuar periudhës 1989-1999 ku elaborohet periudha e reduktimit me forcë të autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë e deri tek vendosja nën protektorat ndërkombëtar të Kosovës.

Çështja e Kosovës, që nga fillimi ka qenë një problem i cili e ka rrezikuar ndarjen e bashkësisë ndërkombëtare për shkak të dallimeve ndërshtetërore lidhur me problemin e Kosovës, njëkohësisht edhe për shkak të lidhjeve tradicionale diplomatike në mes të shumë shteteve evropiane dhe atyre ndërkombëtare me Jugosllavinë. Mu për këtë, ndoshta edhe nuk është e pakuptueshme se si diplomacia ndërkombëtare në të gjitha fazat e shkatërrimit të Jugosllavisë, më së shumti e ka përkrahur dhe i ka ofruar zgjedhje të favorshme mu atij-Serbisë që ka qenë faktori kryesor i destabilizimit dhe i inicimit të katër luftërave të përgjakshme me pasoja katastrofale si në njerëz, me qindra mijëra të vrarë e të plagosur po ashtu edhe me shkatërtime masive dhe plaçkitje të pasurive individuale, familjare dhe shtetërore...

Në parim, historikisht diplomacia ndërkombëtare gjithnjë i ka ndihmuar atij që ka qenë me kërcënues për stabilitetin e rajonit ku ata kanë pasur interesa shtetërore, grupe apo individuale...

Një parim të tillë e kanë pasur që nga fillimi edhe rreth Jugosllavisë në përgjithësi e ndaj Kosovës në veçanti, por mos dëgjueshmëria, injoranca, provokimet nga njëra anë e mikut të tyre historik, Serbisë, dhe nga ana tjetër vendosmëria e SHBA-së që të mos lejohet që me veprime të dhunshme me përmasa të një gjenocidi, të okupohen territore të reja dhe të vriteshin civil të

pafajshëm sikur dikur më parë ndër shekuj, ka ndikuar që një koncept stereotip diplomatik ndërkombëtar: që realiteti i krijuar në terren pa marrë parasysh si është arritur ajo, të pranohet dhe zyrtarizohet ndërkombëtarisht të mos jetë përcaktues.

Ambasadori britanik në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ka pasqyruar të dhënë se nga fillimi i luftës e deri në muajin mars të vitit 1999 në Kosovë janë vrarë mbi 2000 civil dhe mbi 300.000 njerëz janë larguar nga shtëpitë e tyre. Nga kjo periudhë e posaqerisht pas fillimit të sulmeve të NATO-së nga formacionet ushtarake, paraushtarake, policore, paramilitare dhe nga vet grupet e civilëve serb janë vrarë edhe rreth 12.000 njerëz të tjerë si dhe janë detyruar të shpërngulen me dhunë edhe afro 700.000 qytetarë shqiptarë. Gjithsejtë gjatë luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, sipas Fondit për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd dhe Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë si degë e këtij asociacioni humanitarar janë vrarë ose zhdukur 13.535 njerëz prej tyre: 10.812 shqiptarë, 2.179 serb, 5526 romë ashkali, egjiptas, boshnjak, malazez gjegjësisht jo shqiptarë

Këtë herë, për çudi të të gjithëve, ky parim diplomatik ndërkombëtar në rastin e Kosovës nuk u përkrah dhe nuk u lejua pikësëpari nga SHBA-të, por njëherësh për shkak të mos gatishmërisë së shteteve evropiane që të konfrontohen me Amerikën për këtë çështje, ata në heshtje iu bashkangjitën zgjidhjes së krizës së Kosovës sipas modelit që e drejtonte dhe e impononte diplomacia amerikane.

Kryetari i SHBA Klinton (*Clinton*) një ditë para fillimit të intervenimit të NATO-së në Kosovë ka thënë se “bota ka qendruar anash kur Millosheviqi ka bërë gjenocid në zemër të Evropës kundër muslimanëve të Bosnjës kështu që SHBA-të nuk do të lejojnë që kjo të ndodh në Kosovë sepse bëhet fjalë për vlerat tona. Të nesermen në ditën e fillimit të sulmeve të NATO-së Presidenti Klinton me anë të një letre e ka njoftuar Kongresin e SHBA-së se qëllimi kryesor i intervenimit në Kosovës është ruajtja e stabilitetit në region dhe parandalimi i katastrofës humanitare për shkak të ofanzivës të Jugosllavisë kundër popullit të Kosovës.

Teorikisht, zgjidhja e çështjes së Kosovës, diplomacisë ndërkombëtare i ka ofruar një model të ri rreth zgjidhjes së konfrontimeve ndërshtetërore, etnike apo humanitare... Por, siç po shihet nga përvoja e Jugosllavisë dhe Kosovës, ky model nuk iu ka pëlqyer dhe nuk po iu pëlqen shumë shteteve me influencë të madhe në skenën politike botërore, me arsyetim se për shkak të principeve etike nuk janë të gatshëm të flijojnë interesat dhe marrëdhëniet ndërshtetërore,

sidomos në mes të shteteve të fuqishme, dhe për këtë arsye, çështja e Kosovës ka filluar si rast *sui-generis* dhe do të mbetet rast i tillë.

Këtë e fuqizojnë edhe deklaratat e personaliteteve kompetente dhe përgjegjëse të shteteve me ndikim. Me ç'rast po i pasqyroj vetëm disa nga ato: Sekretarja e Shtetit të SHBA-së Madeleine Albright ka dhënë në deklaratë pas perfundimit të intervenimit të NATO-së se në rastin e Kosovës bëhet fjalë për situatë të veçantë *sui generis* në regjionin e Ballkanit...

Poashtu edhe Ministratë e punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe Francës kanë potencuar që veprimi ndërkombëtar në SR Jugosllavi nuk paraqet precedent por vetëm rast të veçant.

Nga ana tjetër Belgjika dhe Holanda kanë konsideruar se intervenimi humanitar në Jugosllavi mund të shërbej edhe në të ardhmën si arsyetim për ndërhyrje ushtarake me qëllim të mbrojtjes të drejtave jetike të njeriut kur Këshilli i Sigurimit të OKB-së nuk është në gjendje ta lejoj një gjë të tillë.

Rasti i Kosovës e ka detyruar diplomacinë ndërkombëtare që t'iu shmangët në shumë raste rregullave dhe mekanizmeve ndërkombëtarë që ekzistojnë që pas Luftës së Dytë Botërore për t'iu qasur problemeve të këtilla apo të ngjashme çfarë ishte Kosova. Por, nga ana tjetër, "Rasti i Kosovës" shënon një formë të re dhe më të avancuar të politikës ndërkombëtare, dhe ky rast ofron një rregullim të ri ndërkombëtar... Në vend të atyre ekzistuese, siç ishin mosndërhyrja dhe konceptet një dimensionale të sovranitetit, Kosova ishte paralajmërim i një sistemi të ri ndërkombëtar, ku të drejtat e popullit janë burim i vërtetë i sovranitetit shtetëror.

Dhuna shtetërore ndaj popullatës, keqtrajtimet, zhvendosja apo dëbimi i dhunshëm i popullatës nga vatrata e tyre apo ekzekutimi dhe shfarosja e popullsisë nuk mund të mbulohen apo të arsyetohen me anë të doktrinës ekzistuese të mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të shteteve sovrane!

Sulmet ajrore të NATO-së në Kosovë, mund të shërbejnë si udhë rrëfim i diplomacisë ndërkombëtare që t'i vë në veprim mekanizmat e veta ndërkombëtare për qëllime humanitare, gjegjësisht për mbrojtjen e popullit apo të një pjese të një popullate të caktuar nga terrorizimi apo asgjësimi i planifikuar shtetëror.

A do të mbetet çështja e Kosovës pikënisje për themelimin e një rendi të ri ndërkombëtar që karakterizohet me vlera thelbësore apo jo, do të tregojë historia në të ardhmen, por vështirësitë dhe dallimet e theksuara rreth konceptimit apo vlerësimit të një krize, çfarë ishte

Kosova apo çfarë mund të jetë në të ardhmen ndonjë vend tjetër, lë shumë hapësirë për skepticizëm dhe optimizëm!

Kosova, në zgjidhjen e çështjes së vet kishte edhe fat të theksuar, sepse kriza e saj kishte arritur kulmin mu në kohën e përfundimit të luftës së ftohtë e cila identifikohet me rrënimin e Murit të Berlinit. Dhe ky fakt, medoemos ka ndryshuar pikëpamjet dhe interesat e faktorit ndërkombëtar ndaj Ballkanit në përgjithësi e Jugosllavisë në veçanti. Po ashtu, edhe OKB-ja potenconte herë pas here nevojën e ndryshimit të pikëpamjes ekzistuese të konceptimit të sovranitetit. Prandaj, besohet se tani e tutje sovraniteti nuk do të identifikohet si grumbullim i të drejtave të një shteti, si një koncept i gjeneralizuar dhe i pranuar nga të gjithë faktorët ndërkombëtarë. Presupozohej se sovraniteti duhet të lidhej detyrimsht me të drejtat dhe liritë e popullit të një shteti. Ky pikëvështrim i proklamuar, ishte një ndër faktorët më të rëndësishëm që i mundësoi Amerikës për ta përkrahur zhvillimin e reagimit ndërkombëtar ndaj krizës së Kosovës.

Diplomacia amerikane ishte shtytëse e ndryshimit të këtij koncepti stereotip ndërkombëtar, si domosdoshmëri e mbrojtjes së civilizimit dhe qytetërimit ndërkombëtar dhe të çështjes humanitare, u muar si model Kosova, sepse, në të gërshetoheshin të gjitha dukuritë që arsyetonin pikëpamjen amerikane për ndryshimet e domosdoshme të konceptimit dhe veprimit të mekanizmave ndërkombëtar për çështje jo vetëm të interesave shtetërore apo ndërshtetërore, por edhe për ato etike universale.

Me nismën e Serbisë, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi më 8 tetor 2008 Rezolutën 63/3, përmes së cilës, bazuar në nenin 96 të Kartës së OKB-së dhe në nenin 65 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i kërkohej kësaj të fundit të jepte mendim konsultativ lidhur me pyetjen: "A është Deklarata e njëanshme e Pavarësisë, e marrë nga institucionet vetëqeverisëse të Kosovës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?"

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e dha mendimin e saj këshillimor më 22 korrik 2010, duke deklaruar me 10 vota pro dhe 4 kundër se "Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 nuk cenon normat e së drejtës ndërkombëtare" me çka edhe në aspektin e drejtësisë ndërkombëtare u konstatua se Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme

Ky punim, në vete pasqyron edhe mos unitetin dhe mos organizimin adekuat të spektrit politik shqiptar ndaj përgjegjësive që së pari ia kanë përcaktuar vetvetes, e më pastaj edhe të përkrahur nga populli. Po ashtu, edhe mospërgatitjen e tyre të duhur politike dhe diplomatike për

tu ballafaquar me një problem të tillë me çfarë ballafaqohet jo vetëm Kosova në arenën ndërkombëtare. Kjo çështje determinon nevojën për shkollimin dhe përgatitjen e kuadrove diplomatike e drejtuese të Kosovës, meqenëse kudri aktual argumenton se nuk është e aftë të i përgjigjet detyrave që parashtrohen para tyre dhe për këtë arsye Pavarësia e Kosovës nga një anë e Shteti i Kosovës nga ana tjetër në vend se të fuqizohet e të funksionon ashtu si duhet e si i ka predispozitat është vënë në apati dhe me këtë jo vetëm që nuk ofron perspektivë për qytetarët e vet por edhe e rrezikon apo zbeh Pavarësinë dhe Shtetin e Kosovës.

Edhe diplomacia ndërkombëtare edhe spektri politik i Kosovës pritin shumë nga njëri-tjetri, por as njëra palë e as tjetra nuk ishte në kohezion të duhur me kohën dhe realitetin në terren. Pasivitetin dhe mos koordinimin e ndërsjellë të tyre e paguante populli me gjak, frikë dhe trishtim në të kaluarën ndërsa tani me mosperspektivë dhe mos funksionim adekuat të Shtetit të Kosovës për çka vetëm në 2-3 muajtë e parë të vitit 2015 janë shpërngulur rreth 100.000 qytetarë nga Kosova për shkak të mos perspektivës dhe shpresës së nga aspekti ekonomik do të bëhet më mirë në një të ardhme të afërt...

Është shumë akuzues fakti se si spektri politik i Kosovës nuk ka arritur të institucionalizohet dhe ka lejuar që përfaqësimi i popullit që iu është besuar ta përfaqësojnë në nivel ndërkombëtar, ta prezantojnë në këtë nivel shqetësues.

Krejtësisht në fund të këtij punimi mund të konstatojmë se zgjidhja e çështjes së Kosovës, më shumë ishte rezultat i rastësive “ditore” se sa ekzistimi i një plani të caktuar politik si nga ana e Kosovës ashtu edhe nga ana e diplomacisë ndërkombëtare. Po ashtu, punimi vë në pah edhe rolin e disa qeveritarëve ndërkombëtarë të cilët me karakteret e tyre dhe ndjenjën humanitare kanë kompensuar mosekzistimin e planeve, programeve apo politikave të qarta të diplomacisë apo të qeverive ndërkombëtare përkitazi me zgjidhjen e çështjes së Kosovës, dhe kanë bindur, të mos them, kanë detyruar qeveritë e tyre dhe të tjerat që të veprojnë me forcë drejtë mbrojtjes së idealit njerëzor për një jetë pa dhunë e frikë shtetërore .

Edhe pas rastit të Kosovës, shtetet e pavarura mbesin shtylla elementare të marrëdhënieve ndërkombëtare, por tani, koha kur qeveritë kishin mundësi ta trajtonin popullin e vet si të donin, duke e injoruar dhe nënçmuar opinionin dhe bashkësinë perendimore ndërkombëtare, me rastin e Kosovës duket se kanë përfunduar përfundimisht.

V. Kapitulli Pestë: Konkluzione dhe rekomandime

Qëllimi bazë i këtij studimi konsiston në elaborimin e ndikimit të politikës të Serbisë/Slllobodan Millisheviqit ndaj qëndrimit fillestar të diplomacisë ndërkombëtare rreth çështjes së Kosovës e cila pothuaj ishte unike dhe e “panegociushme” që Kosova në të gjitha opsionet mbetet pjesë e pandashme fillimisht e RSFJ-së e më pastaj edhe e RFJ-së gjegjësisht Serbisë, dhe në kuadër të tyre t’u njihen dhe garantohen të drejtat qytetare dhe politike.

Një qëndrim i tillë i “vendosur” i bashkësisë ndërkombëtare ka vazhduar edhe me fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë në vitin 1991, me shpalljen e pavarësisë së dy republikave më të zhvilluara të RSFJ-së, Sllovenisë dhe Kroacisë, ka vazhduar edhe në: a) Konferencën e parë për Jugosllavinë që u mbajt në vitin 1991, b) Komisioni i Arbitrazhit i Konferencës mbi Jugosllavinë, i njohur ndryshe si Komisioni i Badinterit, i cili u krijua nga Këshilli i Ministrave të Komunitetit Europian më 27 gusht 1991 për t’i dhënë Konferencës mbi Jugosllavinë autoritet ligjor, c) Marrëveshja e Dayton-it në vitin 1995, d) Konferenca në Rambuje etj., meqenëse ende ishin të panegociushme themelet stereotipe të sistemit ndërkombëtar të cilat bazoheshin në parimet vestfaliane të sovranitetit shtetëror gjegjësisht të parimit *Uti possidetis i cili nënkuptonte* ruajtjen e kufijve të Republikave në momentin e shpërbërjes së Jugosllavisë duke mos marrë parasysh përbërjen etnike të tyre.

Ndërhyrja ndërkombëtare në Kosovë një kohë të gjatë ishte hezituese, e pa planifikuar dhe e pakoordinuar mirë dhe jo unike. Kjo ndërhyrje apo kyçje e faktorit ndërkombëtarë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës u realizua në kuadër të diplomacisë së SHBA-ve, KE/BE, OKB, NATO, KSBE/OSBE në mënyrë individuale e në vijim të procesit edhe në mënyrë të bashkërenduar, koordinuar. Ajo u realizua duke përdorur fillimisht instrumente politiko diplomatike të ashtuquajtura “**bashkëpunuese - jo kërcnuese**”, siq ishin: bisedimet, shërbimet e mira, ndërmjetësimi, ndihmat dhe premtimet e caktuara politike e ekonomike. Meqenëse, në rastin Serbi – Kosovë, kjo mënyrë e çasjes nuk jepte rezultate prekëse, bashkësia ndërkombëtare ishte e shtrënguar që mënyrën e bashkëpunimit ta kombinoi i me “Mjetet e Shtrëngimit”, si p.sh.; sanksionet ekonomike ndërkombëtare, diplomacia imponuese, izolim diplomatik ndërkombëtar ndërhyrje ushtarake, mjetet gjyqësore (Arbitrazhi, Krijimi i Gjykatës ndërkombëtare për krimet e luftës në ish-Jugosllavi) etj.

Paraqitja publike e UÇK-së, u bë në kohën më të përshtatshme dhe më të favorshme për Kosovën, mu atëherë kur u bë e qartë se arritja e synimeve pro pavarësi me mjete paqësore të proklamuar nga presidenti Rugova nuk po japin rezultatet e pritura dhe nuk po i'a imponojnë bashkësisë ndërkombëtare një çasje më serioze dhe më pozitive ndaj çështjes së Kosovës.. Po të paraqitej më herët UÇK-ja, viktima në njerëz dhe pasuri do të kishte disa dhjetëra herë më shumë dhe njëkohësisht diplomacia ndërkombëtare do të kishte një çasje ndëshkuese dhe kategorikisht jo të favorshme për Kosovën. Po të paraqitej më vonë, kur Jugosllavia e re do t'i rikthente dhe forconte pozicionet e veta, faktori ndërkombëtar do të vazhdonte të ishte kundër pavarësisë së Kosovës.

Bashkësia ndërkombëtare për zgjidhjen e krizave në ish Jugosllavi u përcaktua në tri forma të ndërhyrjes, ato ishin:

1. Ndërmjetësimi politiko-diplomatik ndërkombëtar i zgjidhjeve para, gjatë dhe pas konflikteve. Ky ndërmjetësim i ndërkombëtarëve është realizuar përmes angazhimit të misionëve dhe prezencës diplomatike të tyre në vatrat e krizës, përmes angazhimit të emisarëve dhe zyrtarëve të lartë të sferës politike e diplomatike të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare.

2. Imponimi i zgjidhjeve të ndërmjetësuar të paqes përmes përdorimit të kufizuar të forcës ushtarake prej organizatave ndërkombëtare dhe Fuqive të Mëdha është karakteristike për krizat konfliktuale të BeH dhe Kosovës. Kurse në rastin e krizës maqedonase, ndërkombëtarët kanë imponuar përmes trysnisë diplomatike tek faktorët dhe aktorët e përfshirë në krizë.

3. Monitorimi ndërkombëtar për implementimin paqësor të marrëveshjeve të ndërmjetësuar. Ky monitorim është shoqëruar me krijimin dhe prezencën aktive të strukturave ndërkombëtare në të gjithë hapësirat e krizave.

Keto tri metoda nuk kanë një “mur ndarës” të qartë midis tyre. Kjo edhe për shkak se organizatat ndërkombëtare të angazhuara, si NATO, kanë në vetvete një profil me natyrë të dyfishtë: *politike dhe ushtarake*. Për konsequencë, ***NATO u paraqit si një organizëm që mekanizmin e forcës e përdori vetëm pas ezaurimit të një procesi politiko-diplomatik shterues ndërkombëtar.***

Përdorimi i Paktit NATO, u imponua tek diplomacia e Fuqive të Mëdha si instrument imponues aktiv në ndalimin dhe zgjerimin e konflikteve tek pas ezaurimit të një procesi të stërzgjatur politiko – diplomatik edhe për faktin e mbrojtjes së kredibilitetit ndërkombëtar të diplomacisë së tyre e cila nuk sillte kurfarë rezultatesh në terren.

Edhe pse, sovraniteti shtetëror ende mbetet dhe konsiderohet parimi themelor i së drejtës ndërkombëtare, i njëjti pas Masakrës së Srebrenicë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe rastit të Kosovës filloi të diskutohet dhe kontestohet në opinionin publik ndërkombëtar dhe në demokracitë në mbarë botën..

Lufta në Kosovë, determinoi kuptimin e ri, se koncepti ekzistues mbi sovranitetin dhe paprekshmërinë territoriale në të gjitha rrethanat ka ngecur në raport me zhvillimet shoqërore meqenëse një parim i tillë ndërkombëtarë cenon dhe injoron vlerat universale njëzore. Për këtë arsye në vitet e fundit, ky parim i nënshtrohet trysnisë për evoluim si rezultat i ndikimit gjithnjë e më të madh të vlerave etike në të drejtën ndërkombëtare. Për shumë shtete demokratike, diplomatë dhe njohës të së drejtës ndërkombëtare, konsiderohet apo vlerësohet se pas luftës së Kosovës, konceptimi i së drejtës ndërkombëtare (edhe pse ende nuk është pranuar në formë të shkruar) ka shkuar aq larg sa që ua merr të drejtën shteteve për të qeverisur pjesë të territorit të tyre, në rast të keqtrajtimit të rëndë dhe përmanent të popullatës.

Hipoteza kryesore e këtij punimi ka qenë e bazuar në një presupozim se diplomacia ndërkombëtare në përgjithësi në të gjitha variantët e tyre Kosovën e shihnin si pjesë të pandashme të Jugosllavisë/Serbisë. Fillimet e para të rishqyrtimit të përcaktimeve të deriatëhershme unike ndërkombëtare për një opsion ndryshe të zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës filluan në vitin 1999, si rezultat i injorimit permanent dhe të vendosur të presidentit serb Slobodan Millosheviq që i'a bënte ofertave të shumta të diplomacisë ndërkombëtare reth zgjidhjes së çështjes së Kosovës, në të cilat pranohej tërësia territoriale e Serbisë me Kosovën si pjesë të pandashme e saj, me kërkesë të vetme që shteti serb të ndërpret dhunën dhe krimet ndaj popullatës së pafajshme, të pa armatosur e të pa mbrojtur shqiptare në Kosovë, e t'i pranohej atyre një autonomi substanciale me drejtat në arsim, kulturë, të drejtat qytetare e politike etj.

Në bazë të analizës përmbajtësore dhe me metodologji dhe metoda shkencore të materjës është vërtetuar në tërësi Hipoteza themelore e këtij studimi, se politika e Serbisë e proklamuar nga presidenti i saj Slobodan Millosheviq është një nga faktorët kyç që e ka detyruar diplomacinë ndërkombëtare të ndryshoj përcaktimin e deriatëhershëm të tyre se Kosova në çdo variantë të zgjidhjes së statusit të saj të jetë në korniza të Serbisë në Pavarësi të mbikëqyrur ndërkombëtare për Kosovën.

Disa vlerësime jo të pakta ekzistuese, se i tërë procesi i zgjidhjes së çështjes së Kosovës është determinuar nga interesat nacionale e shtetërore të SHBA-ve dhe shteteve tjera të fuqishme

evropiane nuk qendrojnë nga vet fakti se e gjithë ajo gamë e diplomacive ndërkombëtare me vite të tëra (1990 – 1998) e më pastaj e kanë konsideruar dhe trajtuar Serbinë dhe presidentin e tyre si faktor të paqës dhe stabilitetit në rajon, për çfarë si mirënjohje dhe mirëkuptimi i kanë ofruar me dhjetëra e dhjetëra opsione shumë të lëvërdishme për Serbinë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Analiza e veprimeve të diplomacisë ndërkombëtare në rastin e Kosovës dokumenton se ndërhyrja ushtarake e NATO-së në Kosovë dhe pranimi i së drejtës së Kosovës për shkëputje nga Serbia dhe pavarësimi i saj është si rrjedhojë e krimeve të Serbisë në BH – rasti i Srebernicës dhe lufta e Serbisë me përmasa të gjenocidit në Kosovë që rrumbullakon arsyetimin ndërkombëtarë se Kosova është rast “sui generis” në marrëdhënie ndërkombëtare meqenëse e tërë përmbyllja finale e çështjes së Kosovës është bazuar në normat humanitare të civilizimit dhe qytetërimit botëror. Me këtë, ndoshta nuk duhet të apstrahohen apo përjashtohen edhe interesat gjeostrategjike në raport Serbi/Rusi – SHBA/Perendim por këto interesa në atë fazë të zgjidhjes së problemit të Kosovës ishin në plan të dytë.

Angazhimi i SHBA-ve në zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe çasja e Serbisë ndaj faktorit ndërkombëtar, në veçanti ndaj SHBA-ve e ka detyruar Amerikën që të angazhohet më tepër në këtë pjesë të Ballkanit dhe Evropës Juglindore meqenëse ky territor edhe një kohë të gjatë do të mbetet “bure barroti” për shkak të tentimit të Rusisë që përmes Serbisë e Kishës serbe të shtrinë ndikimin dhe sundimin e kësaj pjese.

Gjatë metodologjisë së punës jam bazuar në shumë metoda hulumtuese por përparësi i kam dhënë **metodës deskriptive** të bazuar në pasqyrimin e kriterit të paanshmërisë gjatë prezantimit të shkaqeve - pasojave të ngjarjeve dhe fakteve . Kam shfrytëzuar **metodën e analiizës** për të paraqitur dhe përshkruar ngjarjet në kontinuitet e në mënyrë kronologjike në të gjithë kapitujt e studimit duke u munduar që në mënyrë sa më të thjeshtë dhe më të qartë të shpjegoj ato ngjarje, dokumentet, rrjedhën dhe qendrimet e konferencave, të takimeve, të akterëve kryesor në procesin e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, kuptohet në kontekst të kohës e rrethanave politike e shoqërore të kohës së përcaktuar në punim. Me anë të **metodës komparative** jam përpjekur të i krahasoj të gjeturat dhe t’i paraqes qëndrimet e palëve të caktuar Kam përdorur **metodën e argumentimit apo kundërshtimit** të tezave të ndryshme lidhur me ngjarjet dhe perceptimit të përmbajtjeve të dokumentacionit relevant, poashtu kam përdorur **metodën e analizës sistematike** për analizën e llojllojshmërinë e burimeve juridike, përmes **analizës krahasuese** kam analizur ngjashmëritë dhe dallimet në mes shteteve lidhur me çështje

të caktuara si dhe me rastin e konkluzioneve përfundimtare kam përdorur **Metodën e sintezës** për të mbështetur faktet dhe gjithë proceset të cilat janë hulumtuar në kontinuitet etj.

Studimi argumenton faktin se shqiptarët të shtrirë në 5 shtete, “fqinje” njëra me tjetrën janë faktorë stabiliteti në këtë pjesë të Ballkanit dhe më gjërë e këtë e kanë konfirmuar me çasjen dhe partneritetin e tyre me bashkësinë ndërkombëtare ndaj zhgjidhjes së çështjes së Kosovës. Prandaj, dy shtete me mbi 95% të kombit shqiptarë duhet të konceptohen dhe promovohen jo si rrezik për Ballkanin dhe Europën por si ura lidhëse dhe bashkëjetese në mes shteteve dhe kombeve në regjion.

Njëkohësisht, “rasti i Kosovës” na mëson se pavendosmëria e veprimit të faktorit ndërkombëtar në kohën e duhur, ka rezultuar me dhjetëra e qindra mijëra viktima në njerëz dhe kolona të mëdha refugjatësh anekënd botës. Përvojat nga konfliktet apo lufrat në ish jugosllavi dëshmuar, se shtetet me probleme me dimensione ndëretnike, ndërfetare, politike e sociale, paraqesin një rrezik permanent për shpërthimin e konflikteve të armatosura. Parandalimi efikas në të tilla raste bëhet vetëm përmes një angazhimi të hershëm dhe të koordinuar të Fuqive të Mëdha, në rradhë të parë të SHBA-ve, pa të cilën asnjë konflikt serioz pothuaj askund në botë e veçmas në Ballkan nuk mund të zgjidhet.

Problemet, si rasti i Kosovës a ai i Jugosllavisë, është dëshmuar se nuk mund të zgjidhet vetëm me konferenca, rezoluta ose me deklarata, andaj thënia e Kisingjerit: “Diplomacia pa forcë është sikurse simfonia pa instrumente muzikore”, është konstatim i saktë.

Ndërtimi i institucioneve funksionale dhe të besueshme në rastin e Kosovës ka dëshmuar se Misionet Ndërkombëtare siq ishte rasti i Misionit të OKB-së në Kosovë duhet të jetë i një niveli shumë më të lart profesional se sa ka qenë në Kosovë...

Studimi, vë në pah rëndësinë dhe rolin e diplomacisë ndërkombëtare në raportet midis shteteve prandaj, Kosova duhet të investojë shumë në cilësinë dhe profesionalizimin e diplomacisë së vet. Dhe krejtësisht në fund, politika serbe e identifikuar (si politikë amnistuese ndaj Serbisë) me presidentin e tyre, Slobodan Millosheviq, është një mësim se si humbet apo pezullohet një miqësi, përkrahje apo ndihmë qindra vjeçare e shteteve përkatëse veq e veq apo të asaj ndërkombëtare në përgjithësi

BIBLIOGRAFIA/LITERATURA

- 1) Abazi, Enika. “Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm”. Archives – ouvertes.fr. Studime Historike, Institute of History, Tirana, 2012, 66 (3-4), pp.187-216. Tiranë, 2013.
- 2) Ahrens, Geert Hinrich, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Tiranë: Toena 2010
- 3) Ahtisaari, Martti, “Detyra në Beograd” Shtëpia botuese Trend. Tiranë, 2012
- 4) Ajvazi, Fehmi. *Spastrimi etnik Kosovës.Zemra shqiptare. 19.12.2007*
- 5) Akademia e Shkencave, *Qen. Enci. Shqip. Kosova në vështrim enciklopedi, botimet “Toena”,*
- 6) Akademia e Shkencave të RPS Të Shqipërisë “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi” Tiranë 1990
- 7) Albright, Madeleine. “Zonja Sekretare”, “Dudaj”,Tiranë, 2004,
- 8) Amnesty International Yugoslavia. *Police Violence in Kosovo* – London: Plutobooks 2000
- 9) Antonic, Slobodan, *Zarobljena zemlja: Srbija za vlade Slobodana Milosevica*, Beograd: Otkrovenje, 2002
- 10) Arkivi i Jugosllavisë, serija e dokumenteve “Burimet për historinë e Jugosllavisë”.
- 11) Badsey Stephen, Latawski Paul, *Britain, NATO and the lessons of the Balkan Conflicts 1991-1999*, London: Frank Cass Publishers 2004
- 12) Ball, Laurie, *United States Diplomacy in Kosovo Final Status Talks: A Case Study in Multilateral Negotiations With Principle Negotiations*, WWS 547, May 12, 2009
- 13) Banac, Ivo *Raspad Jugoslavije* Zagreb: Derieux, 2001
- 14) Bajrami, Arsim “Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës”, Artini 2011, Prishtinë
- 15) Bajrami, Arsim.[http://www.ashak.org/repository/docs/Ligjerata_Inaguruese_-](http://www.ashak.org/repository/docs/Ligjerata_Inaguruese_-_Arsim_Bajrami_36843.pdf)
_Arsim_Bajrami_36843.pdf (qasur më 14. 3. 2015),
- 16) Bajrami, Arsim “E drejta e Kosovës në tranzicion: e Drejta Kushtetuese libri – II, Universiteti i Prishtinës 2001,
- 17) Baker, James. *The politics of diplomacy – revolution, war and peace, 1989-1992*. New York: G.P.Puntam’s Sons, 1995.

- 18) Baev Jordan. *US Intelligence Community Estimates on Yugoslavia*. National Security and the future, 2000
- 19) Bajrami, Hakif, *Kosova njëzet shekuj të identitetit të saj*, Prishtinë, 2001
- 20) Bajrami, Hakif. “Politika dhe lufta e drejtë shqiptare përball neofashizmit serb 1989-1999”, “Dukagjini”, Pejë, 2006,
- 21) Bejtush, Gashi. Pjetër Hidri, *Konflikti ndërkombëtar dhe ndëretnik*, Twins 2008
- 22) Biserko, Sonja *Yugoslavia's Implosion - Fatal attraction of Serbian Nationalism*, Belgrade: Zagorac 2012
- 23) Borisav Jović, *Poslednji dani SFRJ*, (Beograd: Politika 1995),
- 24) Boshkovich, Ivan. “Peace Conference; Road to the Conference and Results”, HIST 7602, Pierre Aselin,
- 25) Brownlie, Ian. “Principles of Public International Law” VIII edition, Oxford University Press in UK and certain other countries, 2012,
- 26) Burns, Nicholas R. Nën-sekretar për çështje politike. The Outlook for the Independence of Kosovo [Qëndrimi për pavarësinë e Kosovës]. Statement Before the House Committee on Foreign Affairs Washington, DC April 17, 2007, <http://www.state.gov/p/us/rm/2007/83120.htm> (qasur me 16 maj 2015).
- 27) Bugajski Janos, *Ngritja e Kosovës*, Koha, Prishtinë, 2006
- 28) Burchill, Scott, *International Relations, London, second edition*, 2001
- 29) Bytyçi, Enver. “Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë”, Instituti i studimeve të Evropës Juglindore, Tiranë, 2012,
- 30) Buxhovi, Jusuf. “Kthesa historike I e II”, “Faik Konica”, Prishtinë, 2008, 2009,
- 31) Buja, Ramë. “Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë” Universiteti AAB, Prishtinë, 2007,
- 32) Buja, Ramë. “Konferenca e Rambujesë (aspekti juridik, politik e ndërkombëtar” Universiteti AAB, Prishtinë, 2007,
- 33) Christopher, Waren, *In a stream of History, Shaping Foreign Policy in the New Era*. Stanford: Stanford University Press, 1998
- 34) Clark, Howard, *Civil Resistance in Kosovo*, London: Plutobooks 2000
- 35) Clinton, Bill, *My Life*, Alfred A. Knopf, New York, 2004

- 36) Council of the European Union, Press Release 2851st Council meeting, General Affairs and External Relations, Brussels, 18 February, 2008 - 6496/08 (Presse41)
- 37) Congressional Record, US House of Representative. Regarding Albanian Minorities in Yugoslavia, vol.136, no.145, 22 October 1990, H11472. 1990
- 38) Çernomirdin, Viktor dhe Talbott, Strobe, *Kujtime-Prapaskenat e kapitullimit të Millosheviqit*, Tiranë: HS, 2009
- 39) Çetta, Anton, *Pajtimi i gjakeve*, SHB "ERA", Prishtinë, 2001
- 40) Ç'thonë dhe ç'kërkojnë kosovarët (përmbledhje studimesh, artikujsh, intervistash dhe komentesh I, II, dhe III", "8 Nëntori", Tiranë, 1990,
- 41) Development Group. Dialogu Kosovë-Serbi, Larg qytetarit afër BE-së, Prishtinë 2012
- 42) Debora Garcia - Orrico, "Kosovo",
- 43) Deklarata e 2 Korrikut
- 44) Deklarata e Kuvendit të Kosovës për pranimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Pakoja Ahtisaari)-Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë këtë Deklaratë më 5 prill 2007,
- 45) Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurt-it 2008,
- 46) Deklarata për bashkëpunimin joformal politik evropian-Mbledhja ministrore për Jugosllavinë, Chateau de Sennigen, 26 mars 1991,
- 47) Dedushaj, Naim "Paradiplomatic Relations between the United States and Kosova: A Friendship between an elephant and a mouse",
- 48) Dinan, Desmond. "Historia e integritimit evropian, AIIS për botimin shqip,Tiranë (pa vit botimi),
- 49) Dikson, Martin. "E drejta ndërkombëtare, AiSS, Tiranë, (pa vit botimi),
- 50) Dobbs, Michael, *Madeleine Albright. A Twentieth Century Odyssey*. New York: Henry Holt and Co, 1999
- 51) Dokumenti zyrtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të datës 10 korrik 2010 lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës.
- 52) Dole,B, „Don't Turn Yugoslavia into Europe's Lebanon“, New York Times, 3December 1990
- 53) Dokumentation: Marti ahtisari's Reportt on Kosovo's Future Status, 26 March 2007;
- 54) Dreshaj, Sylë. Levizja e përgjithshme e shqiptarëve në luftë përpavarësi në Kosovë, "Dukagjini", Pejë, 2002

- 55) Dufour , Pierre. “Kosova - Paqja e shpërfillur”, “Rozafa”, Prishtinë, 2010,
- 56) Dunne, Tim, “Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare”
- 57) Fisher, Joschka. “*Vitet kuq-gjelbër*”, “KOHA”, Prishtinë, 2008,
- 58) Fjalimi i Marti Ahtisaarit i mbajtur në Kuvendin e Kosovës me 15 qershor 2009,
- 59) Forum 2015, Kosovo-EU Relations: The history of unfulfilled Aspirations? Kosovo Foundation for Open Society, Prishtina 2013,
- 60) Frashëri, Kristo. “Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera” “Edisud”, Tiranë, 2006,
- 61) Francis Fukuyama, *Fundi i Historisë dhe Njeriu i Fundit* (Prishtinë: Zenith, 2006),
- 62) Gaber, Slavko dhe Kuzmanić, Tonci “*Kosovo-Srbija-Jugoslavia*” (Lubjanë: Krt 1989
- 63) Gazeta ditore “*Večernje novosti*” në dy vazhdime, 24. dhe 25. shtator 1986.
- 64) Ganić, Ejup, *Bosanska otrovna jabuka*. Sarajevo: Bosanska knjiga, 1995
- 65) Goldstein, Joshua. “Marrëdhëniet ndërkombëtare”, “Dituria”, Tiranë, 2003,
- 66) Gow, James. Deconstructing Yugoslavia”. *Survival*, vol. 33, - july-august 1999
- 67) Gruda Zejnullah, *E Drejta Ndërkombëtare Publike* (Botim i plotësuar dhe i përmirësuar), 2007 Furkam ISM – Shkup
- 68) Gjeloši, Nikë. “Kosova 1999, as republikë e proklamuar, as autonomi e imponuar”, “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2002,
- 69) Haziri, Mustafë, *Greva e minatorëve të ”Trepçës”*, botoi lidhja e historianëve të Kosovës “Ali Hadri”, 2011.
- 70) Haliti, Xhavit, *Kështu e bëmë luftën*, Prishtinë: Orbis, 2013
- 71) Howard Clark, “*Civil Resistance in Kosovo*”, (London: Plutobooks 2000),
- 72) Halberstam, David, *War in a Time of Peace, Bush, Clinton and the Generals*. New York: Simon & Schuster, 2002
- 73) Historia e popullit shqiptar I dhe II”, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës-botimi i dytë, Beograd, 1969,
- 74) Hrvatski Memorijalno Dokumentacijski Centar Domovinskog Rata
- 75) H. Henry& Jr. Perritt; “Ushtria Çlirimtare e Kosovës- Rrëfim prej brenda për një kryengritje”, Prishtinë 2008.
- 72) Holbrooke, Richard *To end a War-Završiti Rat*, Sahinpasic 1998
- 73) Human Rights Watch, Nën pushtetin e urdhrave -krimet e luftës në Kosovë, Tiranë, 2005
- 74) ICO; EUPT and Commision of the EU, European Union. Perparing for a Futer

- International and EU Presence in Kosovo, Brussels, Prishtina, May 2007;
- 75) International Crisis Group, Kosova dhe Serbia pas mendimit të GJND-së, Raporti për Evropë, nr. 206, i datës 26 gusht 2010,
- 76) Independent International Commission on Kosovo
- 77) Ivo Banac, *Raspad Jugoslavije*, (Zagreb: Derieux, 2001),
- 78) Jović, Borislav, *Poslednji dani SFRJ*. Kragujevac: Izdanje autora, 1996
- 79) Jolyon Nyagele, The Case of United Nations Mission in Kosovo, (pa vit botimi)
- 80) Judah Tim; “Kosova luftë dhe hakmarje” Prishtinë 2002
- 81) Jevgenij Primakov, *Minsko Polje politike*, CEMA, Zagreb, 2011,
- 82) Kadijevic, Veljko, *Moje vidjenje raspada*, Beograd: Politika 1993
- 83) Kelmendi, Muhamed “Vështrimi juridiko-politik i çështjes shqiptare në prag të luftës së fundit në Kosovë 1990-1998”, UM “Iliria”, Prishtinë, 2006,
- 84) Këshilli i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, *Raportet ditore*, Prishtinë, 1990.
- 85) Këpuska, Avni. ”Qenësia e territorit dhe e kufijve etnikë autoktonë të Kosovës – etnogjeneza e popullit shqiptar që nga lashtësia iliro-dardane e Kosovës deri në ditët e sotme”, “Rilindja”, Prishtinë, 2001,
- 86) King Lain & Mason Whit; “Paqe me çdo kusht”, Prishtinë 2007
- 87) KIPRED, Administrimi dhe qeverisja në Kosovë – Një projekt i koordinuar nga CASIN, 2005, Prishtinë-Gjenevë,
- 88) KIPRED, Analizë e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 2007
- 89) KIPRED, *Konkluzionet e Këshillit rreth Procesit të Zgjerimit dhe Stabilizim- Asociimit*, 3210 Mbledhja e Këshillit të Punëve të Përgjithshme në Bruksel
- 90) Knock, Thomas *To end all wars: Woodrow Wilson and the Quest for a New World Order*, (Princeton: University Press. Reprint 1995)
- 91) Kontributi i shkruar të SHBA-vë dorëzuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë përkitazi me Pavarësinë e Kosovës,
- 92) Konventa e Montevideos 1933,
- 93) Konferenca e parë ndërkombëtare për Jugosllavinë e cila u mbajt me 26 e 27 gusht të vitit 1991
- 94) Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e vitit 2001

- 95) Kontributet e shkruara të shteteve, dorëzuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë përkitazi me pavarësinë e Kosovës.
- 96) Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr.182, Prishtinë (Beograd) New York (Brussels),2007, S/1999/648,
- 97) Kosovo-Srbija-Jugosllavija. Univerzitetna Konferenca - Knjizna zbirka Krt 46. Ljubljana, maj 1989
- 98) Kovacevic, Zivorad, *Amerika i raspad Jugoslavije*, Beograd: Filip Visnjic 2007
- 99) Krasniqi Jakup; “Kthesa e madhe” Prishtinë 2006
- 100) Kraja, Mehmet “Mirupafshim në një luftë tjetër”, “Rozafa”, Prishtinë, 2003,
- 101) Kraja, Mehmet. “Vite të humbura”, “Rozafa”, Prishtinë, 2003,
- 102) Krisafi, Ksenofon, *E drejta e organizatave ndërkombëtare I*, SHB ”Onufri”, Tiranë,
- 103) Kushtetuta e Republikës së Kosovës, miratuar në Kaçanik me 7 shtator 1990
- 104) Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008
- 105) Kushtetuta e RFPJ 1946, Gazeta Zyrtare, nr.10/46, Beograd ,1963
- 106) Kushtetuta e RSFJ e vitit 1974
- 107) Kushtetuta e Krahinës Autonome të Kosovës të vitit 1974
- 108) Kushtetuta e RFJ- së e vitit 1992
- 109) Kushner, Bernard, *Luftëtarët e pages*, Mësonjëtorja, 2004
- 110) Kval-Melibye Tranfy “Politika dhe demokracia”, “Rozafa”, Prishtinë, 2006,
- 111) “Komunist”, 22. 11. 1989,
- 112) Latawski, Paul dhe Smith, Martin, *The Kosovo Crisis and the evolution of post-Cold War European Security*, New York: Palgrave, 2003
- 113) “La Turquie”, maj 1878 etj.
- 114) Law Review, vol. 23, 1992, no. 2
- 115) Law of the unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of self-government of Kosovo, 17 July 2009
- 116) Legality of Kosovo’s Territorial Status, EJIL. (2003).
- 117) Louis Sell. “Kosovo, the Key to Balkan Stability, Problems of post communism”, vol.49, January/February 2002 M. E. Sharpe, Inc,
- 118) Lora Sibel&Alan Litl “Smrt Jugoslavije”
- 119) Lukaj, Nazmi “Përtej statusit të Kosovës”, Prishtinë, 2007,

- 120) Malnar, Dario , *SHBA-ja dhe Kosova*, Prishtinë: KOHA, 2013
- 121) Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë-Marrëveshja e Rambouillet e vitit 1999
- 122) Marrëveshja teknike-ushtarake e Kumanovës;
- 123) Marrëveshja e Dejtonit për Bosnjën dhe Hercegovinën
- 124) Martin, Bridgette. “Secession and Statehood, The International Legal Status of Kosovo”, Dunedin, 2008
- 125) Maxhuni, Fadil. “Protokolli diplomatik”, “Era”, Prishtinë, 2008,
- 126) Malcolm, Noel. “Kosova, një histori e shkurtër”, “KOHA”, Prishtinë, 2001
- 127) Maloku, Sherif. “Kosova tërësi e lashtë gjeografike e politike”, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1994,
- 128) Memorandumi i SANU-Memorandumi i Akadem. Serbe të Arte. dhe Shkenc. – 1986
- 129) Mesiç, Stipe. *Si u shkatërrua Jugosllavia*, Prishtinë 2011
- 130) Meier Viktor; “Fundi i Jugosllavisë goditja në Kosovë” Lublanë 2006
- 131) Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, Further Written Contribution of the Republic of Kosovo, dërguar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisës, 17 korrik 2009, version,
- 132) Mingst, A. Karen “Bazat e marrëdhënieve ndërkombëtare” AIIS, Tiranë, 2008,
- 133) Milo, Paskal. “Ditari i një Ministri të Jashtëm -konflikti i Kosovës 1997-2001”, botimet “Toena”, Tiranë, 2009,
- 134) Milo, Paskal. “Kosova nga Rambuje në pavarësi”, botimet “Toena” Tiranë, 2009,
- 135) Milano, Enrico. Security Council Action in the Balkans”: Reviewing the
- 136) Morgenthau, Hans. “Politika Ndërmjet Kombeve”
- 137) Montevideo Convention on the Rights and duties of States, 1933
- 138) Naša Borba”, Beograd, 28 shkurt 1989,
- 139) National Intelligence Estimate, NIE 15-90: Yugoslavia Transformed, Director of Central Intelligence, Langley, VA, 18 October 1990
- 140) Nathanaili, Petrit, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga origjina e deri më sot*, Tiranë, 2009
- 141) Nelson R. “Autoktonia e shqiptarëve në studime gjermane”, “Rilindja”, Prishtinë, 1990,
- 142) Netherlands International Law Review Vol. 56, no. 3

- Williams, Paul. 2004. *Earned Sovereignty: Conflict Over Kosovo's Final Status* [Sovraniteti i fituar: konflikti rreth statusit përfundimtar të Kosovës]. *Denver Journal of International Law and Policy*. Vol. 31:3. pp. 387-430,
http://www.law.du.edu/ilj/online_issues_folder/williams.pdf (qasur me 15 maj 2014).
- 143) Nebojsa Raicevic, *Humanitarna Intervencija u Medjunarodnom Javnom Pravu*, Doktorska Dizertacija, Universitet u Nis-u.
- 144) Nyagele, Jolyon. "The Case of United Nations Mission in Kosovo",
- 145) NSDD 133. *March 14 "US Policy Toward Yugoslavia"* (National Security Decision Directives)
- 146) New York Times, *Casualty Figures*, 28 shkurt 1992
- 147) Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i datës 10 korrik 2010,
- 148) Opinioni nr. 1 të Komisionit të Arbitrazhit, të datës 29 nëntor 1991
 Promoting Democracy in Post-Conflict and failed states: Lessons and Challenges,
 Prepared for the National Policy Forum on Terrorism, Security, and America's Purpose,
 Larry Diamond, Washington, DC, e disponueshme në.....:
[web.stanford.edu/~ldiamond/papers/Promoting Democracy 0905.htm](http://web.stanford.edu/~ldiamond/papers/Promoting%20Democracy%200905.htm)
- 149) Owen, David *Balkan Odyssey*, London: Victor Gollanz, 1995
- 150) Parimet Vestfaliane të vitit 1648
- 151) Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit për të ardhmen e Kosovës, S/2005/709,
 10 Nëntor 2005
- 152) Parimet udhëheqëse të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës-
[http://www.unosek.org/docref/2005-10-07_-_Contact_Group_](http://www.unosek.org/docref/2005-10-07_-_Contact_Group_-_Ten_Guiding_principles_for_Ahtisaari_-_albanian.pdf)
[_Ten_Guiding_principles_for_Ahtisaari_-_albanian.pdf](http://www.unosek.org/docref/2005-10-07_-_Contact_Group_-_Ten_Guiding_principles_for_Ahtisaari_-_albanian.pdf)
- 153) Perović, Latinka. *Zatvaranje kruga-ishod rascepa 1971-1972*. Svijetlost., Sarajevo 1991
- 154) Pauer, Kolin L, *Jedna američka priča*, Beograd: BMG, 2002
- 155) Petar Popovic. *Prijepori o teorijama medjunarodnih odnosa. Politicka kultura*, Zagreb, 2012
- 156) Petritsch, Wolfgang & Pichler, Robert, "Ruga e gjatë në luftë-Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999", "KOHA", Prishtinë,
- 157) Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës e vitit 2007
- 158) Promoting Democracy in Post-Conflict and failed states: Lessons and Challenges,

- Prepared for the National Policy Forum on Terrorism, Security, and America's Purpose, Larry Diamond, Washington, DC, e disponueshme në.....
web.stanford.edu/~ldiamond/papers/Promoting Democracy 0905.htm
- 159) Pushkolli, Fehmi. "Mbrotjtja Kombëtare Shqiptare e Kosovës 1878-1990"
 - 160) Qosja, Regjep, *Çështja shqiptare, historia e politika*, Prishtinë 1994
 - 161) Qosja Rexhep; "Paqja e përgjakshme, konferenca ndërkombëtare për Kosovën", Tiranë 1999
 - 162) Raporti i Kai Aides 13 maj, 2005 (S/2005/335).
 - 163) Raicevic, Nebojsa, Humanitarna Intervencija u Medjunarodnom Javnom Pravu, Doktorska Disertacija, Universitet u Nis-u.
 - 164) Raportet e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë gjatë viteve 1999 – 2010
 - 165) Raporti i Martti Ahtisaarit dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, S/2007/168, datë: 26 mars 2007
 - 166) Report on a Comprehensive Review, UN documents S/2005/635,
 - 167) Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme, Accordance with International
 - 168) Rhode, David, *The Betrayal and Fall of Srebrenica, Europe's Worst Massacre Since World War II*. London: Penguin Books, London, 1997
 - 169) Reka Blerim: "Kosova në dokumentet e Kongresit Amerikan (1986-1995) Prishtinë 1995
 - 170) Reka, Blerim. (2002). *Kosova a Cast for Preventive Diplomacy*, Shkup.
 - 171) Reka, Blerim. (2003). *UNMIK as an international governance in pos-war Kosova*
 - 172) Report Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr. 182, Prishtinë, (Beograd, New York), Brussels, 2007
 - 173) Rezoluta e Konferencës së Bujanit - nxjerrë nga libri Këshilli Popullori Krahinës Autonome të Kosovës dhe Dukagjinit
 - 174) Rezolutën A/RES/63/3 e datës 30 shtator 2008
 - 175) "Rilindja", Prishtinë, 28 shkurt 1989,
 - 176) Rotberg, I. Robert Failed States, Collapsed States, Weak States "Causes and Indicators, brookings.edu/press/books/chapter_1/statefailureandstateweaknessinatimeofterror.pdf.

- 177) Rregulloret e UNMIK-ut
- 178) Ramet P Sabrina. *Ballkan Babel-The Disintegration of Yugoslavia from the death of Tito to the fall of Milosevic*. (Boulder Westview Press, 2002)
- 179) Rrahmani, Bashkim “Pozita juridiko - ndërkombëtare e Kosovës 1974-2011” (Tema e doktoraturës”, UET,
- 180) Rregullorja e UNMIK-ut,nr.2001/9
- 181) Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 1999/1, 25 qershor 1999
- 182) S/PRST/2005/51,
- 183) Rezoluta A/RES/63/3 e datës 30 shtator 2008.
- 184) Ramet and Simkus, “*The Roots of Instability and the Prerequisites of Stability in Kosovo*
- 185) S/1999/648 of 7 June.
- 186) Simić, Predrag. “Put u Rambuje: Kosovska kriza 1995-2000”, “Nea”, Beograd, 2000,
- 187) Scheffer D: Toward a Modern Doctrine of Humanitarian Intervention, University of Toledo Law Review, vol. 23, 1992, no. 2.
- 188) State Building and Exit - The international Civilian Office and Kosovo’s Supervised
- 189) Security Council Resolution 1160 (1998),
- 190) Stefan Trobestm, *The Kosovo Conflict*, (SIPRI Yearbook 1999),
- 191) Indipendence 2008-2012, Prishtinë 2012.
- 192) Sumner, Rebecca. *A New World Order*, London Daily Online,
<http://www.london-daily.com/art/ldrebec.htm>
- 193) Schwartz, Stephen: *Kosova – prejardhja e një lufte*, Prishtinë, 2006
- 194) Susan L. Wood Ward, Does Kosovo’s Status Matter “On the International management of Statehood, *Sudosteuroopa*, 55 (2007)1, S. 1-25,
- 195) Sibel, Lora (korospodente e Finasial Times për Ballkanin) dhe Litl, Alan(korospondent i radio televizionit të BBC në Jugosllavi). *Vdekja Jugosllavisë.Otokar Kersovani, Rijeka – Kroaci, 1996*.
- 196) Scott Burchill et al, *Theories of International Relations, 2nd. edition* (London: Palgrave, 2001).
- 197) Steiner, Michael, *Fjalim para Këshillit të Sigurimit, 24 Prill 2002*, Press release SC/7375, 24 Prill 2002. Security Council.

- 198) Sherifi, Isak "The International Community Role and NATO Intervention in Kosovo-Kumanovo Agreement", Mediterranean Journal of Social Sciences, MCSER Publishing, Rome-Italy, 2004, ISSN 2039-2117,
- 199) Shoqata e të Burgosurëve Politikë të Kosovës. "Pajtimi i gjaqeve 1990-1991", "Era", Prishtinë, 2001
- 200) Shala, Blerim. "Vitet e Kosovës 1998-1999", "Gama", Prishtinë, 2001, "Shkëndija", Prishtinë, 1995,
- 201) Shala, Blerim, *The Diplomatic War for Kosova: A dialogue with Ambassador Christopher Hill*, Prishtinë: Zëri, 2003
- 202) Tahiri Editë; "Konferenca e Rambujesë (procesi negociator dhe dokumentet)", Pejë, 2002
- 203) Tim Dunne, Milja Kurki, Steve Smith: *Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare*
- 204) The EC Declaration Concerning the Conditions for Recognition of New States. Extraordinary EPC meeting, Brussels, December 16, 1991
- 205) THE RULE OF LAW IN INDEPENDENT KOSOVO *Europe Report Nr. 204 – 19 May 2010.*
- 206) Vidojević, Aleksandar. (2007). "What Could the EU Accomplish in Kosovo? Between the Hammer and the Anvil".
- 207) Weller, Marc. (1999). *The Rambouillet conference on Kosovo.*
- 208) Weller, Marc. *Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence*, (Oxford: University of the Press 2009)
- 209) Welle, Marc. *Shtetësia e kontestuar*, "KOHA", Prishtinë, 2009
- 210) Weller, Marc. (2008). *The Vienna negotiations on the final status for Kosovo*, Institute of International Affairs.
- 211) The World Bank in Kosovo. *Country snapshot*. October 2013
- 212) Wilson, Gary. Self-determination, recognition and the problem of Kosovo, in Netherlands International Law review Vol.56, no 3
- 213) Wesley, Clark. *Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the future Combat*, Public Affairs, New York, 2001
- 214) Vervy W.D.: *Humanitarian Intervention in the 1990s and Beyond: An international*

- Law Perspective, in: Pieterse J.N: World Orders in the Making – Humanitarian Intervention and Beyond, The Hague, 1998
- 215) Vickers, Miranda & Pettifer, James. Shqipëria nga anarkia të një identitet ballkanik, “Toena”, Tiranë, 1998
- 216) Ukshini, Sylë. “Nga lufta në paqe”, “Rozafa”, Prishtinë, 2004,
- 217) UN, Ekstrakte nga debatet në Këshillin e Sigurimit lidhur me Rezolutën 1160 (1998)
- 218) United Nations Documents on UNMIK - Reports of the Secretary-General
- 219) UN Security Council Resolution 1160, 31 March 1998
- 220) US Congress files, April 4, 1995.
- 221) United Nations Security Council Resolution 1244
- 222) United Nations - Security Council, Letter dated 26 March, 2007 from the Secretary General addresset to the President of the Security Council, Addendum
- 223) UNMIK Regulation 2001/9, ‘On A Constitutional Framework for Provisional Self-government in Kosovo’, 15 May 2001.
- 224) UNSC Resolution 1244/ 1999, The strukture of UNMIK, ‘ UNIMIK as a International Governance , Post – War Kosova Nato Intervention, UN Administration, Kosovar Aspirations’’ Blerim Reka. Botimi Logos-a 2003, Shkup
- 225) Woehrel, Steven. (2012). *Kosovo: Current Issues and U.S. Policy*’.
- 226) www.UNOSEK,
- 227) <http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf>
- 228) <http://www.un.org/en/index.html>
- 229) <http://en.wikipedia.org/wiki/State-building>
- 230) Victor Meier, Fundi Jugosllavisë, goditja në Kosovë, Lublanë, 2007
- 231) Versailles zum Weltkrieg, *Përmbledhje dokumentesh*, Munchen , 1965
- 232) Wodwar, L. Susan. (200). *Independent Kosovo. Research Paper Philosophy, Politics and Economics Institute Colgate*. University Hamilton, NY.
- 233) *and Economics Institute Colgate*. University Hamilton, NY.
- 234) Written contribution of the Republic of Kosovo, submitted to the International Court of Justice, April 17, 2009.
- 235) Wilson, Gary, *Self- determination, recognition and the problem of Kosovo*” in
- 236) Zejnulla Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*.
- 237) Zejnullahu, Veton. “Zgjidhja paqësore e konflikteve”(Temë e doktoraturës),

Universiteti i Tiranës, 2003,

238) Zimmermann, Warren. “Burimet e një katastrofe” “Besa”, Tiranë, 1996,

239) “Zëri i rinisë”, Prishtinë, 1991,

240) www.un.org/peace/kosovo/98sc1160.htm (19.02.2015)

.....